




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

PROVIMI I SHTETIT
FONDI I PYETJEVE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË
FARMACISTIT


1. Kimi Farmaceutike

1. Një klasifikim shumë i përdorur për antibiotikët β -laktamikë merr parasysh praninë e disa pjesëve strukturore karakteristike. Cilit nga emrave të mëposhtëm i korrespondon struktura e treguar?




- A) Penam
- B) Cefem
- C) Monobaktam
- D) Karbapenem

2. Cilit nga emrave të mëposhtëm i korrespondon struktura e treguar?




- A) Penam
- B) Cefem
- C) 6-APA
- D) 7-ACA

3. Acidi 6-APA përbëhet nga unaza tiazolidinike dhe ajo:



- A) Piridinike
- B) Piperidinike
- C) β -laktamike
- D) Oksazolike

4. Acidi 7-ACA është i përbërë nga unaza β -laktamike dhe ajo:



- A) Pirolidinike
- B) Tiazolidike
- C) Dihidrotiazinike
- D) Oksazolike


5. Imipenemi përdoret i shoqëruar me cilastatinë, për të:

- A) Penguar oksidimin e shpejtë
- B) Frenuar hidrolizën në nivel renal
- C) Frenuar degradimin e shpejtë nga β -laktamazat
- D) Rritur përqendrimin plazmatik

6. Cila nga thëniet e mëposhtme për aciklovirin është e gabuar:


- A) Është derivat i bazës purinike guanozinë
- B) Vepron ndaj viruseve me ARN
- C) Forma aktive përmban fosfat
- D) Është analog i remë i bazave nukleotide

7. Çfarë kanë të përbashkët komponimet e mëposhtëme:



- A) Bëjnë pjesë tek barnat ACE-Inhibitorë
- B) Janë derivate të pirimidinës
- C) Kanë veprim sinergjik antibakteror
- D) Kanë veprim antagonist

8. Formula e mëposhtme kimike paraqet një agjent.




- A) Antibakterial
- B) Antimykotik
- C) Antituberkular
- D) Antiviral

9. Cila nga zgjedhjet e mëposhtme nuk qëndron:

- A) Streptomycin me rrugë endovenoze
- B) Gentamycin me rrugë endovenoze
- C) Neomycin me rrugë orale
- D) Penicilin G me rrugë orale

10. Përcaktoni numrin total të përbërësve aromatike të pranishëm në strukturën e eritrocinës:



- A) 0
- B) 1
- C) 2
- D) 3

11. Një substancë që mund të sintetizohet nga bakteret, por që njerëzit e marrin me anë të dietës, është:

- A) Sulfanilamidi
- B) PABA
- C) PASA
- D) Acidi folik

12. Fluorkinolonet janë:

- A) Antimetabolitë
- B) Bakterostatikë
- C) Me spektër të gjerë
- D) Me spektër të ngushtë


13. Ciprofloksacina vepron në:

- A) ADN xhirazën bakterore
- B) Murin qelizor bakteror
- C) Metabolizmin energjistik të qelizës bakterore
- D) Nënjesinë ribozomike 30S

14. Cili nga pohimet e mëposhtme për ciprofloksacinën, është i vërtetë:

- A) Prania e fluorit në strukturë bën që të vepron vetëm mbi bakteret Gram negative
- B) Prania e fluorit në strukturë bën që të vepron vetëm mbi bakteret Gram pozitive
- C) Barnat antiacid që përmbajnë hidrokسيد Al përmirësojnë përthithjen e barit
- D) Barnat antiacid që përmbajnë hidrokسيد Mg pakësojnë përthithjen e barit

15. Ceftraksioni, që ka strukturën e mëposhtme përmbahet në specialitetin farmaceutik “Rocefin”. Në cilën nga pikat e mëposhtme vepron ai?




- A) Acidet nukleike të qelizës bakterike
- B) Murin qelizor bakteror
- C) Metabolizmin energjistik të qelizës bakterore
- D) Sintezën proteinike ribozomike

16. Acidi klavulonik është në gjendje të:


- A) Fuqizojë veprimin e antibiotikëve me strukturë glikozidike
- B) Inhibojë acetilazat bakteriale
- C) Inhibojë β -laktamazat
- D) Inhibojë adenilazat dhe fosfatazat bakteriale

17. Ç'lidhje kanë midis tyre komponimet e mëposhtëme:



- A) Bëjnë pjesë në të njëjtin grup farmakologjik
- B) Bëjnë pjesë në të njëjtin grup kimik
- C) Jepen të kombinuar bashkë në terapi
- D) Kanë të njëjtin mekanizëm veprimi

18. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar:




- A) Kjo formulë është struktura bazë e cefalosporinave
- B) Cikli A paraqet unazën β -laktamike
- C) Cefalosporinat ndryshojnë nga radikalet R1 e R2
- D) Në pozicionin 4 ka një grup karboksilik

19. Ka në strukturën kimike, një nitrogrup aromatik dhe mbetjen dikloracetamidike:

- A) Ampicilina
- B) Eritromicina
- C) Kloramfenikoli
- D) Gentamicina

20.

ka strukturën e pjeshme të treguar?




- A) Dezinfektantë - fenole
- B) Antibakterialë - kinolone
- C) Antibiotikë - penicilina
- D) Antibakterialë - sulfonamide

21. Cili nga pohimet e mëposhtme për sulfasalazinën është i vërtetë:


- A) Përthithet mirë në traktin gastrointestinal
- B) Pëson reduktim deri në acid p-aminosalicilik
- C) Është një promedikament
- D) Gjendet në treg kryesisht në formë supozitorësh

22. Sulfadoksina ka gjysëjetë plazmatike:




- A) Më pak se 12 orë
- B) 12 deri në 24 orë
- C) 24 deri në 48 orë
- D) 120 deri në 150 orë

23. Cili grup farmakologjik i përket një komponim që ka strukturën e pjeshme të treguar?




- A) Antibiotikë - penicilina
- B) Antibiotikë - tetraciklina
- C) Antibakterialë - kinolone
- D) Antibakterialë - sulfonamide

24. Kur modifikohet grupi fenilac etamidik i penicilinës G me grupin R të paraqitur më poshtë, përfitohen penicilina:




- A) Të qëndrueshme në mjedis acid
- B) Me efekt të zgjatur
- C) Me spektër të gjerë
- D) Rezistente ndaj β -laktamazave

25. Kur grupi aminik i 6APA acilohet me grupin R të treguar më poshtë, përfitohet amoksisilina, që i përket klasës së penicilinave:




- A) Me efekt të zgjatur
- B) Të qëndrueshme në mjedis acid
- C) Rezistente ndaj β -laktamazave
- D) Antipseudomonas

26. Pivamicilina është një promedikament i:



- A) Benzilpenizilinës
- B) Ampicilinës
- C) Propicilinës
- D) Oksacilinës

27. Ku vepron medikamenti me strukturëm e mëposhtme kimike:



- A) Inhibon ADN-xhirazën
- B) Në membranën citoplazmatike
- C) Në njësinë ribozomike 50S
- D) Në njësinë ribozomike 30S

28. Tiamfenikoli në strukturën e tij përveç grupit dikloroacetamidik, ka në unazën aromatike edhe një grup:

- A) -NO
- B) -SH
- C) -SO₃H
- D) -SO₂CH₃

29. Bacitracina bën pjesë në klasën e antibiotikëve:

- A) Aminoglikozidik
- B) Makrolidik
- C) Penicilina
- D) Polipeptidikë

30. Nitrofurantoina përdoret si:

- A) Antibakterik intestinal
- B) Antibakterik sistemik
- C) Antibakterik urinar

D) Antiprotozoar


31. Cili nga grupet e mëposhtme me veti antimikrobike, vepron mbi acidet nukleike të qelizës bakterore:

- A) Kinolonet (mbi ADN xhitrazen)
- B) Tetraciklinat
- C) Monobaktamet
- D) Rifampicinat (mbi ARN sintetazen)

32. Antimykotikët e serisë së imidazoleve, ia detyrojnë veprimtarinë e tyre:


- A) Bllokimit të sintezës së kolesterolit
- B) Bllokimit të sintezës së ergosterolit
- C) Dezintegrimin të membranës së mykut
- D) Bllokimit të topoizomerazës mykotike

33. Amfotericina B, që ka strukturën e treguar kimike, është bari i ygjedhur për trajnimin e:



- A) Skizofrenisë
- B) Ulçerës peptike
- C) Hipertensionit
- D) Mykozave sistematike

34. Bari me strukturën e mëposhtme ka veprim:




- A) Antimykotik
- B) Antituberkular
- C) Antitumoral
- D) Antiviral

35. Toksiciteti i ulët, efikasiteti dhe selektiviteti i aciklovirit, varen nga fakti që principi aktiv:

- A) Aktivizohet në qelizat e infektuara nga timinë kinaza e virusit
- B) Paraqet një farmakokinetikë të favorshme
- C) Mund të nxisë prodhimin selektiv të interferonit
- D) Inhibon në mënyrë selektive një enzimë proteolitike virale

36. Cilit grup farmakologjik i përket komponimi me strukturë të pjesshme të tregur:



- A) Antibiotikë - tetraciklina
- B) Antiprotozoarë - 4-aminokinolina
- C) Antiprotozoarë - 8-aminokinolina
- D) Antibakterialë - sulfamidikë

37. Ndër karakteristikat dhe vetitë e mëposhtme tregoni atë që përshkruan më mirë veprimin farmakologjik të agjentit antitumoral doksorubicinë:

- A) Agjent alkilues
- B) Antibiotik interkelues
- C) Antimetabolit antifolat
- D) Antimetabolit antagonist pirimidinik


38. Cili nga antitumoralët e mëposhtëm, nuk vepron nëpërmjet alkilimit të ADN-së:

- A) Klorambucili
- B) Busulfani
- C) Prokarbazina
- D) Merkaptopurina

39. Cili nga principet aktive të mëposhtme, është një citostatik alkilues:


- A) Fluorouracili
- B) Melfalani
- C) Merkaptopurina
- D) Metotreksati

40. Emërtimi kimik i ciklofostamidit është **(RS)**-2-[bis(2-kloretil)amino]tetrahidro-2H-1,2,3-oksazoforino-2-oksidi. Cilës qendër kirale i referohet?




- A) Fosforit
- B) Azotit terciar
- C) Azotit sekondar
- D) Oksigjenit ciklik

41. Grupi përgjegjës për veprimin në strukturën e ciklofosfamidit është:




- A) Cikli oksazofosforinik
- B) Fragmenti N, N-bis-(2-kloretilaminik)
- C) Grupi fosfamidik
- D) E gjithë molekula

42. Cilit grup farmakologjik i përke struktura e mëposhtme:



- A) Analeptik
- B) Dezinfektues
- C) Antitumoral
- D) Antimikrobik

43. Me cilin nga komponimet e mëposhtme ka ngjashmëri më të madhe kleftamidi, një amebicid sintetik që ka strukturën e mëposhtme:




- A) Nitrofurantin
- B) Melfalanin
- C) Furosemidin
- D) Kloramfenikolin

44. Cili nga barnat e mëposhtëm, nuk ka veprim ndaj Mycobacterium tuberculosis:


- A) Etambutoli
- B) Etionamidi
- C) Metronidazoli
- D) PAS

45. Cili është veprimi farmakologjik më i rëndësishëm që mund të supozohet për strukturën kimike të mëposhtme:



- A) Nikotinik
- B) Anksiolitik
- C) Kolinergjik
- D) Antimuskarinik

46. Skopolamina që ka strukturën e mëposhtme, është një alkaloid me bërthamë:




- A) Indolike
- B) Imidazolike
- C) Tropanike
- D) Benzilizokinolinike

47. Cili nga barnat e mëposhtëm nuk është një antagonist i receptorëve β -adrenergjikë?


- A) Fentolamina
- B) Tolazolina
- C) Dobutamina
- D) Prazosina

48. Cili është aktiviteti farmakologjik që mbart struktura e mëposhtëme kimike?




- A) Nikotidik
- B) Kolinergjik
- C) Anestezik
- D) Antimuskarinik

49. Cili është aktiviteti farmakologjik më i rëndësishëm që mbart struktura kimike?



- A) Antihistaminik - H2
- B) Adrenergjik
- C) Neuroleptik
- D) Kolinergjik


50. Cili është aktiviteti farmakologjik i strukturës së treguar dhe analogëve të saj strukture:



- A) Adrenergjikë - alfa-agonistë selektiv
- B) Adrenergjikë - alfa-agonistë dekongestant nazal

- C) Adrenergjikë - alfa1-antagonistë jo selektiv
- D) Adrenergjikë - beta-antagonistë dhe/ose agonistë

51. Përdorimi më i zakonshëm i ipratropiumit, i cili ka strukturën e treguar, është rruga:



- A) Subkutane
- B) Intramuskulare
- C) Inhalatore
- D) Orale

52. Cila nga benzodiazepinat e mëposhtme, ka gjysmëjetë më të shkurtër:

- A) Diazepam
- B) Bromazepam
- C) Flurazepam
- D) Triazolam

53. Duke pasur parasysh strukturën kimike, cili nga këto grupe paraqet ndryshimet strukturore më të mëdha nga neurotransmetuesit endogjene:

- A) Agonistët β_1 selektiv
- B) Agonistët β_2 selektiv
- C) Antagonistët alfa1 selektiv
- D) Antagonistët β_2 selektiv

54. Paroksetina është një bar antidepressiv, që vepron duke bllokuar:

- A) Rikapjen e noradrenalinës dhe dopaminës
- B) Sintezën e serotoninës
- C) Rikapjen e serotoninës
- D) Sintezën e dopamines

55. Antitrombina III, është e domosdoshme për veprimin antikoagulant të:

- A) Heparinës
- B) Ëarfarinës
- C) Dikumarolit
- D) Fenprokumonit

56. Cili nga medikamentet, është antikoagulant me veprim të pavarur nga antagonizmi me vitaminën K:


- A) Dikumaroli
- B) Heparina
- C) Acenokumaroli
- D) Ëarfarina

57. Cili nga grupet e barnave të mëposhtëm, nuk përdoret në trajtimin e skizofrenisë:

- A) Fenotiazinat
- B) Feniletilaminat

- C) Tioksantenet
- D) Butirofenonet

58. Komponimi i mëposhtëm paraqet një bar:




- A) Antidepresiv
- B) Sedativo-hipnotik
- C) Neuroleptik
- D) Barbiturat

59. Cili nga veprimet e mëposhtme, përshkruan saktë mekanizmin e veprimit të benzodiazepinave:

- A) Bllokim i veprimit nxitës të acidit glutamik
- B) Inhibim i enzimës GABA transaminazë
- C) Rritje e përcjellshmërisë për klorin e ndërmjetësuar nga GABA
- D) Rritje e aktivitetit të enzimës adenilat ciklazë

60. Tregoni numrin që i korrespondon pozicionit të treguar nga shigjeta në formulën e fenotiazinës:



- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

61. Mekanizmi kryesor i veprimit të barnave antipsikotike me strukturë fenotiazinike, është:

- A) Aktivizimi i receptorëve muskarinikë
- B) Inhibimi i receptorëve D2 të dopaminës
- C) Aktivizimi i MAO-A
- D) Rritje e përshkueshmërisë së membranës plazmatike

62. Cila nga lëndët vepruese të mëposhtme, është volatil dhe administrohet me inhalim:

- A) Diazepam
- B) Haloperidoli
- C) Tiopentali
- D) Halotani

63. Cila nga lëndët vepruese të mëposhtme, paraqet aktivitetin më të ulët ekstrapiramidal:


- A) Haloperidoli
- B) Flufenazina

- C) Tiotikseni
- D) Risperidoni

64. Cili nga barnat e mëposhtëm, nuk i përket grupit të antidepressivëve triciklikë:


- A) Klomipramina
- B) Amitriptilina
- C) Desipramina
- D) Fluoksetina

65. Levodopa që ka strukturën e treguar, përshkon barrierën hematoencefalike pasi:




- A) Është polare
- B) Është lipofile
- C) Lidhet me proteinat plazmatike
- D) Ka një transportues specifik

66. Cilit prej faktorëve të mëposhtëm i detzohet kohëzgjatja e shkurtër e veprimit e metohexitaët që ka strukturën e treguar:




- A) Lidhjes së dobët me proteinat plazmatike
- B) Liposolubilitetit të ulët
- C) Metabolizimit të shpejtë
- D) Rishpërndarjes së shpejtë nga truri në indet e tjera

67. Ç'aktivitet farmakologjik zotëron struktura e mëposhme:



- A) Anestezik i përgjithshëm
- B) Anestezik lokal
- C) Analgjezik
- D) Adrenergjik

68. Në strukturën e acidit barbiturik, shigjeta tregon pozicionin:



- A) 1
- B) 3
- C) 5
- D) 7


69. Cila nga lëndët vepruese të mëposhtme, nuk përdoret si antikonvulsiv:

- A) Acidi valproik
- B) Amitriptilina
- C) Vigabatrina
- D) Karbamazepina

70. Fenfluramina është një bar me strukturë të ngjashme me N-etilamfetaminën. Fenfluramina përdoret si:


- A) Antiazmatik
- B) Anoreksik
- C) Dekognezant nazal
- D) Deprimues i SNQ-së

71. Në cilin grup farmakologjik bën pjesë struktura e mëposhtme:



- A) Adrenergjik alfa1-selektiv
- B) Adrenergjik alfa2-selektiv
- C) Antihistaminik H1
- D) Antihistaminik H2


72. Cili është aktiviteti farmakologjik kryesor që ka struktura e treguar:



- A) Antidepresiv
- B) Neuroleptik


- C) Antiepileptik
- D) Anestezik lokal

73. Cili është aktiviteti farmakologjik që ka struktura e pjesshme e treguar:




- A) Anestezik lokal
- B) Antidepressiv
- C) Antiepileptik
- D) Antimuskarinik

74. Amfetamina, që ka strukturën e treguar, depërton në sistemin qendror pasi:




- A) Ka një koeficient ndarjeje lipid/ujë të lartë
- B) Nuk degradohet nga MAO
- C) Nuk metabolizohet nga COMT
- D) Konjugohet me acid glukuronik

75. Cili është veprimi farmakologjik që mbart struktura e pjesshme e treguar:



- A) Hipnotik
- B) Neuroleptik
- C) Antikonvulsiv
- D) Antimuskarinik

76. Barnat e mëposhtme përdoren shpesh në terapinë e ulçerës gastrike pasi:



- A) Blllokojnë H⁺/K⁺ ATP-azën në nivel të qelizave parietale të mukozës gastrike
- B) Janë antagonistë histaminikë H₂
- C) Janë agonistë histaminikë H₂

D) Janë antagonistë histaminikë H1


77. Cila nga lëndët e mëposhtme, nuk bën pjesë në grupin e lëndëve psikodisleptike:

- A) Meskalina
- B) LSD
- C) Dekstrometorfani
- D) Psilocibina

78. Haloperidoli, është një bar me strukturë:


- A) Fenotiazinike
- B) Difenilbutilpiperidinike
- C) Butirofenike
- D) Dibenzazepinike

79. Piroxikami ka strukturën e treguar. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gbur:



- A) Tolerohet më mirë krahasuar me aspirinën dhe indometacinën
- B) Është në gjendje të shkaktojë dëmtime në nivel gastrointestinal
- C) Përthithet me vështirësi në nivel gastrik pas administrimit oral
- D) Ka gjysmëjetë të shkurtër, prandaj janë të nevojshme disa administrime në ditë

80. Ndarja e enantiomerëve të ibuprofenit (struktura e treguar) është e mundur, por përdorimi i secilit enantiomer më vete nuk është i shpeshtë sepse:




- A) Të dy enantiomerët kanë të njëjtin aktivitet
- B) Izomeri më pak aktiv R in vivo shndërrohet në izomerin aktiv S
- C) In vivo ka një racemizim të shpejtë
- D) Dy enantiomerët janë pak të qëndrueshëm si të tillë në format farmaceutike

81. Toksiciteti kronik i fenacetinës (I), paracetamolit (II) dhe acetanilidit (III), i detyrohet:

- A) Reaktivitetit të grupit -NH₂ që çlirohet nga hidroliza metabolike
- B) Reaktivitetit të grupit -OH të pranishëm ose me origjinë metabolike
- C) Formës kinonike ose kinoniminike të përftuar nga metabolizmi oksidues
- D) Formimit të epoksideve aromatike

82. Aldosteroni, që ka strukturën e treguar, ka një veprim kryesisht:




- A) Mineralkortikoid
- B) Glukokortikoid
- C) Androgjenik
- D) Estrogjenik

83. Etinilestradioli dhe mestranoli, të përdorur në formulimet e kontraceptivëve, ndryshojnë nga:


- A) Kiraliteti i karbonit 17
- B) Njëri është eteri metilik i tjetrit
- C) Stereokimia e lidhjes midis unazave C e D
- D) Aromaticiteti i unazës A

84. Struktura e treguar i korrespondon:



- A) Estranit
- B) Estradiolit
- C) Mestranolit
- D) Etinilestradiolit

85. Cilit grup farmakologjik i përket komponimi me strukturën e pjeshme të mëposhtme:



- A) Estrogjeneve
- B) Progestogjeneve
- C) Androgjenikëve
- D) Anabolizantëve


86. Spironolaktoni është:

- A) Antagonist konkurues i receptorit citoplazmatik të aldosteronit
- B) Inhibues i sintezës së aldosteronit
- C) Agonist i receptorit të membranës së aldosteronit
- D) Blllokues direkt i kanaleve të Na⁺ të membranës luminale të nefronit

87. Të gjithë lëndët vepruese të mëposhtme janë glukokortikoide, me përjashtim të


- A) Deksametazonit
- B) Triamcinolonit
- C) Danazolit
- D) Flunisolidit

88. Futja e një grupi në pozicionin 17 α të steroideve androgjenë:




- A) Pakëson toksicitetin e produkteve
- B) Mundëson përdorimin me rrugë orale
- C) Stabilizon lidhjen me proteinat plazmatike
- D) Rrit aktivitetin e komponimeve

89. Cilit numër i korrespondon pozicioni i treguar me shigjetë në formulën e përgjithshme të steroideve?



- A) 10
- B) 14
- C) 18
- D) 19

90. Cilit grup farmakologjik i përket komponimi me strukturën e pjeshme të mëposhtme?




- A) Estrogjeneve
- B) Progestogjeneve
- C) Anabolizantëve
- D) Glukokortikoideve

91. Numri i atomeve të karbonit të skeletit të androstanit, është:


- A) 19
- B) 21
- C) 24
- D) 27

92. Glibenklamidi, me strukturën e treguar, është hipoglicemizues sepse:



- A) Rrit çlirimin e insulinës endogjene
- B) Nxist çlirimin e glukagonit
- C) Ndërvepron me receptorët e insulinës
- D) Ndryshon përshkueshmërinë e qelizave ndaj glukozës

93. Komponimet që kanë strukturën e mëposhtme e ushtrojnë veprimet e tyre hipoglicemiyues:



- A) Duke ndërvepruar me receptorët për insulinën
- B) Duke ndërvepruar me receptorët specifikë që inhibojnë kanalet e K⁺ ATP vartëse
- C) Duke rritur katabolizmin e insulinës
- D) Duke rritur çlirimin e glukagonit


94. Me cilin mekanizëm, biguanidet si metformina ushtrojnë efektin e tyre terapeutik:

- A) Çlirojnë insulinë nga qelizat β të pankreasit
- B) Stimulojnë katabolizmin e glukozës në indet periferike
- C) Aktivizojnë glukoneogenezën
- D) Nxisin çlirimin e glukagonit

95. Format farmaceutike më të përhapura që përmbajnë insulinë, përbëhen nga:

- A) Kapsula e tableta me administrim oral
- B) Pezulli të insulinës (të komplekuara ose jo me zink) që kanë kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- C) Pezulli të insulinës (të komplekuara ose jo me kalçium) që kanë kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- D) Tretësira të insulinës të kripëzuara me zink

96. Disa specialitete mjeksore të përdorura kundër diabetit përmbajnë kombinime që kanë grup funksioner sulfonamidik të kombinuar me lëndën vepruese që ka strukturën e mëposhtme, emri i të cilit është:



- A) Fenforminë
- B) Insulinë
- C) Sulfadiazinë
- D) Metforminë

97. TRH (hormoni çlirues i tireotropinës):


- A) Është një hormon hipofizar

- B) Është një hormon i tiroides
- C) Është një hormon hipotalamik
- D) Ka si organ shenjë tiroiden

98. Medroksiprogesteroni, është një bar:

- A) Kortikosteroid
- B) Anabolizant
- C) Antiestrogjen
- D) Progestagen

99. Dy strukturat e paraqitura:




- A) Janë i njëjti komponim
- B) Janë enantiomerë
- C) Jane izomerë gjeometrikë
- D) Bioizosterë

100. Termat eutomer dhe distomer, përdoren për të karakterizuar dy barna, që janë:

- A) Agonist mbi të njëjtin receptor
- B) Antagonist mbi të njëjtin receptor
- C) Izomerë konformacionalë
- D) Izomerë optik

101. Dy strukturat e paraqitura më poshtë përfaqësojnë:




- A) Diasteromerë
- B) Izomerë gjeometrikë
- C) Bioizosterë
- D) Izomerë konformacionalë

102. Ndër barnat antiemetik, cili është më efikas për t'u përdorur për një pacient në terapi me barna citostatikë:

- A) Domperidoni
- B) Ondansetrone
- C) Metoklopramidi
- D) Difenhidramina

103. Cili nga pohimet që lidhen me marrdhëniet strukturë-veprim të kortikosteroidëve nuk është i saktë:




- A) Esterifikimim i grupit -CH₂OH zgjat gjysmëjetën e produktit
- B) Zëvendësimi i grupit 17 alfa me një grup alkil mundëson administrimin oral
- C) Futja e F në pozicionin 9 alfa rrit aktivitetin
- D) Lidhja dyfishe 1-2 rrit qëndrueshmërinë ndaj degradimit metabolik

104. Bllokimi i ovulacionit nga kontraktivët oral, i detyrohet:

- A) Frenimit të çlirimit të LH e FSH
- B) Frenimit të çlirimit të GH
- C) Shtimit të çlirimit të progesteronit
- D) Shtimit të çlirimit të estrogenit

105. Në cilin nga rastet e mëposhtme gjejnë përdorim derivatet sulfonilureike:



- A) Diabet insulino vartës (Tipi I)
- B) Diabet jo insulino vartës (Tipi II)
- C) Rezistencë muskulare ndaj insulinës
- D) Diabet insipidus

106. Cili nga pohimet e mëposhtme për paracetamol, është i saktë:

- A) Ka efekt të fortë antiinflamtor sepse frenon ciklooksigenazën
- B) Ka veprim të mirë antipiretik në pacientët që nuk përdorin dot aspirinën
- C) Në treg nuk ka specialitet farmaceutik që ta përmbajë bashkë me aspirinën
- D) Jep irritim të mukozës së traktit gastrointestinal

107. Cili nga principet aktive të mëposhtme, në sajë të afinitetit për receptorët estrogenik, mund të përdoret si citostatik në tumoret e gjirit:

- A) Medroksiprogesteroni
- B) Kuinestrol
- C) Lomustina
- D) Tamoksifeni

108. Përdorimi për një kohë të gjatë i benzodiazepinave, mund të shkaktojë:

- A) Konvulsione
- B) Çrregullime motorrike
- C) Vetëm tolerancë
- D) Tolerancë dhe vartësi

109. Frenuesit e dihidrofolat reduktazës si trimetoprini e pirimetamina, shfaqin përzgjedhshmëri të lartë në veprim, për shkak të:

- A) Vetive të ndryshme farmakokinetike
- B) Ekzistencës së izoenzimave të dihidrofolat reduktazës në baktere e protozoarë
- C) Ndryshimeve citologjike ndërmjet baktereve, protozoarëve, etj
- D) Arsyeve ende të panjohura plotësisht

110. Fluoksetina ndërhyt në transmetimin serotoninergjik, sepse:

- A) Nxit receptorët 5-HT1
- B) Nxit receptorët 5-HT2
- C) Çliron serotoninën nga mbaresat sinaptike
- D) Frenon rikapjen e serotoninës

111. Sumatriptani ndërhyt në transmetimin serotoninergjik, sepse:

- A) Nxit receptorët 5-HT1D
- B) Frenon sintezën e serotoninës
- C) Frenon kapjen e serotoninës
- D) Frenon monoamino oksidazën

112. Levodopa ka veprim antiparkinsonik, sepse:

- A) Vepron si antikolinergjik
- B) Frenon enzimin triptofan karboksilazë
- C) Rrit përqendrimin e dopaminës në SNQ
- D) Frenon monoamino oksidazën

113. Fenobarbitali:

- A) Frenon sintezën e GABA
- B) Frenon rikapjen e GABA
- C) Shton lirimimin e GABA nga mbaresat parapsinaptike
- D) Është agonist jonofor i receptorit të GABA


114. Antidepresivët ciklik të gjeneratës së parë:

- A) Janë antagonistë të receptorëve dopaminergjik
- B) Shfaqin një latencë klinike prej 2-3 javësh
- C) Frenojnë sintezën e acetilkolinës
- D) Janë agonistë të receptorëve të GABA

115. Efektet e anësore më të zakonshme që lidhen me antidepresivët ciklik, janë me natyrë:

- A) Adrenergjike
- B) Antikolinergjike
- C) Antidopaminergjike
- D) GABA mimetike

116. Cili nga pohimet për difenhidraminën, struktura në vijim, është i gabuar:



- A) Ka veti të spikatura sedative

- B) Ka aktivitet të ulët antimuskarinik në traktin GI
- C) Bën pjesë në grupin e antihistaminikëve
- D) Është derivat i propanolaminës

117. Mekanizmi i veprimit të etosuksimidit (antiepileptik), mbështet në:

- A) Bllokimin e kanaleve të Ca^{2+} në bërthamat talamike
- B) Bllokimin e përkohshëm të sinapseve neuromuskulore
- C) Aktivizimin e receptorëve β adrenergjik
- D) Shtimin e sintezës së neuropeptideve

118. Antidepresivët triciklik, shpesh mund të shkaktojnë:

- A) Miozë
- B) Bradikardi
- C) Takikardi
- D) Diarre

119. Amfetamina, është një:

- A) Aminë simpatomimetike me veprim të drejtpërdrejtë
- B) Aminë simpatomimetike me veprim jo të drejtpërdrejtë
- C) Anatagonist konkurues i receptorëve alfa adrenergjik
- D) Frenues i rikapjes së monoaminave

120. Nëse jemi të detyruar të zëvendësojmë diklofenakun me një nga antiinflamatorët e renditur që ka strukturë kimike të ngjashme, cili do të ishte më pak i përshtatshëm:

- A) Sulindak
- B) Indometacin
- C) Ibuprofen
- D) Piroksikam

121. Cila pjesë e strukturës, është përgjegjëse për veprimin tek antibiotikët β -laktamik:

- A) Cikli gjashtëkëndor
- B) Cikli katërkëndor
- C) Cikli pesëkëndor
- D) Pjesa amidike jodiclike

122. Diskinezitë tarditive, shfaqen nga terapia e zgjatur me:

- A) Antiulceroz
- B) Antiepileptik
- C) Antipsikotik tipik
- D) Frenues të MAO-s

123. Aktiviteti antimalarik i klorokinës, i detyrohet:

- A) Interkelimit në ADN-në e protozoarit
- B) Frenimit të një enzime specifike të protozoarit
- C) Bllokimit të sistemit nervor të protozoarit
- D) Një mekanizmi ende të pasqaruar plotësisht

124. Fenfluramina, bashkëvepron me sistemin serotoninergjik:

- A) Çliron serotoninën nga mbaresat sinaptike
- B) Bllokon sintezën e serotoninës

- C) Antagonizon serotoninën në receptorët 5-HT1
- D) Është agonist i receptorëve 5-HT3


125. Cili nga barnat e mëposhtëm, është zgjedhja e duhur në rastin e një krize epilesie:

- A) Klonazepam
- B) Diazepam
- C) Haloperidol
- D) Acid valproik

126. Duke krahasuar vetitë e hiosciaminës dhe atropinës, cili nga pohimet është i gabuar:

- A) Hiosciamina ka aktivitet farmakologjik më të lartë se atropina
- B) Në specialitetet mjekësore gjen më shumë atropinë se hiosciaminë
- C) Hiosciamina është forma racemike e atropinës
- D) Atropina dhe hiosciamina kanë veti spasmolitike

127. Përparishtë që paraqet esteri i dzfishtë në strukturën e pivamicilinës, në krahasim me esterin e thjeshtë janë:



- A) Hidrolizë e shpejtë dhe e plotë pas përthithjes
- B) Aktivitet farmakologjik i shtuar i diesterit
- C) Lipofilitet i shtuar
- D) Efekte anësore të ulta

128. Karbidopa përdoret në mjekimin e Parkinsonit, sepse:

- A) Pakëson katabolizmin e dopaminës cerebrale
- B) Frenon rikapjen neuronale të dopaminës cerebrale
- C) Frenon shëndrrimin e levodopës në dopaminë në nivele periferike
- D) Shton çlirimin e dopaminës

129. Antidepresivët triciklik e arrijnë efektin terapeutik, duke:

- A) Nxitur në mënyrë të drejtpërdrejtë receptorët muskarinik
- B) Bllokuar rikapjen e noradrenalinës dhe serotoninës
- C) Stabilizuar membranat qelizore
- D) Bllokuar sintezën e dopaminës

130. Desimipramina klasifikohet si:

- A) Neuroleptik
- B) Antihistaminik
- C) Antidepresiv
- D) Anoreksik

131. Cili nga barnat e mëposhtëm, aktivizon në mënyrë përzgjedhëse receptorët muskarinik:

- A) Betanekoli
- B) Neostigmina

- C) Fiziostigmina
- D) Suksinilkolina


132. Cila nga lëndët vepruese të mëposhtme, pakëson takikardinë:

- A) Propranololi
- B) Izoprenalina
- C) Ekonazoli
- D) Cimetidina

133. Aktiviteti antiinflamator i aspirinës, i detyrohet faktit që:

- A) Shkatërron prostaglandinat
- B) Frenon në mënyrë të kthyeshme ciklooksigenazën
- C) Provokon më shumë se një nga efektet e përmendura
- D) Rrit përqendrimin e tromboksanit

134. 6-Glukuronil derivati i morfinës, është një nga metabolitet krzesorë të saj. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?




- A) Ai është pa veprim
- B) Ka aktivitet të ngjashëm me morfinën
- C) Është një metabolit i morfinës në sasi të papërfillshme
- D) Është pa aktivitet, por është toksik

135. Guanfacina, është një antihipertensiv që:


- A) Stimulon receptorët alfa2 në SNQ
- B) Bllokon receptorët alfa1 në vazat rezistente
- C) Shton katabolizmin e noradrenalinës
- D) Frenon rikapjen e noradrenalinës

136. Desimipramina, me strukturën kimike të paraqitur, klasifikohet si një antidepressiv:



- A) Që frenon rikapjen e serotoninës
- B) Që frenon enzimën MAO
- C) Triciklik me grup aminik primar
- D) Triciklik me grup aminik sekondar

137. Struktura e mëposhtme paraqet një lëndë vepruese që ka veprin:



- A) Antikonvulsant
- B) Antihistaminik
- C) Notropik
- D) Anestezik lokal

138. Efekti anësor më i rëndësishëm, që shkaktojnë barnat antipsikotik është:

- A) Atazia
- B) Nauza
- C) Diskinezia tarditive
- D) Ulja e pragut për konvulsionet

139. Sumatriptani, është një lëndë vepruese:

- A) Anoreksike
- B) Antidepresiv i gjeneratës së dytë
- C) Antimigretike
- D) Antidod i etanolit

140. Cili nga pohimet e mëposhtme për trazodonin, nuk është i vërtetë:

- A) Ka veti sedative
- B) Në disa raste shkakton hipotension
- C) Nuk ka ngjashmëri strukturore me fenelzinën
- D) Është frenues specifik i MAO-s

141. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm, përftohet edhe sot nëpërmjet fermentimit:

- A) Demeklociklina
- B) Ampicilina
- C) Minociklina
- D) Cefaleksina

142. Neuroleptikët ndërhyjnë në sistemin dopaminergjik:

- A) Frenojnë rikapjen e dopaminës në nivel qëndror
- B) Nxisin sekretimin e dopaminës
- C) Blllokojnë receptorët e tipit D2 dopaminik
- D) Frenojnë katabolizmin e dopaminës


143. Kloruri i hekza- dhe dekametonium, janë kripëra që përbëhen nga një varg i gjatë alkilik dhe dy grupe amoniumi kuaternar në skaje. Këto lëndë:

- A) Veprojnë si antagonistë të receptorëve nikotinik
- B) Ndërveprojnë me receptorët muskarinik
- C) Pësojnë një oksidim të shpejtë metabolik
- D) Kanë gjysmëjetë plazmatike të gjatë

144. Naloksoni përdoret në:

- A) Trajtimin e depresionit
- B) Trajtimin e hipertensionit
- C) Parandalimin e sindromës së abstinencës nga morfina
- D) Trajtimin e një rasti mbidozimi të heroinës

145. Cilit numër i korrespondon pozicioni i treguar nga shigjeta:



- A) 7
- B) 6
- C) 5
- D) 4

146. Cili nga efektet anësore të mëposhtme, mund të shkaktohet nga acidi valproik:

- A) Nekrozë hepatike
- B) Insuficencë renale akute
- C) Insuficencë kardiake
- D) Insuficencë mbiveshkore akute


147. Qëndrueshmëria e penicilinave në mjedis acid, rritet nga:

- A) Grupit acilamidik hidrophil në pozicionin 6
- B) Esterifikimi i grupit karboksilik në pozicionin 3
- C) Krijimi i kripërave me tretshmëri të ulët
- D) Mbetjet acilike që kanë grupe elektrondhënëse

148. Cila nga lëndët vepruese të mëposhtme, nuk i përket kategorisë antidepresivë:

- A) Fluoksamina
- B) Klorpromazina
- C) Nortriptilina
- D) Klomipramina

149. Duke pasur parash strukturën, çfarë veprimi shfaq kjo lëndë vepruese?



- A) Spazmolitike
- B) Anestezike lokale
- C) Antimetorike
- D) Laksative

150. Cila nga karakteristikat e mëposhtme është e rëndësishme, për veprimin e antibiotikëve që frenojnë D-alaninë peptidazën:

- A) Një strukturë tetraciklike

- B) Grupi karboksilik
- C) Cikli β laktamik
- D) Grupi acilamidik

151. Veprimi hipertensiv i adrenalinës mund të shndërrohet në hipotensiv, nëse më parë administrojmë:

- A) Prazosinë
- B) Propranololin
- C) Atropinë
- D) Rezerpinë


152. Veprimi antiinflamator i indometacinës, i detyrohet:

- A) Rritjes së përqendrimit të prostaglandinave
- B) Krijimit të lidhjes amidike me ciklooksigenazën
- C) Frenimit në mënyrë të kthyeshme të ciklooksigenazës
- D) Veprimit direkt mbi tromboksanin duke i zvogëluar përqendrimin

153. Veprimi antipiretik i antiinflamatorëve jo steroidikë, vjen nga:


- A) Shpërndarja e nxehtësisë nga vazodilatacioni në lëkurë
- B) Frenimi i sintezës së prostaglandinave në disa rajone cerebrale
- C) Efekti stabilizues mbi membranat neuronale
- D) Bllokimi i receptorëve 5 HT2 në hipotalamus

154. Cili nga pohimet e mëposhtme për klopentiksolin është i gabuar:




- A) Është derivat tioksantinik
- B) Është derivat piperazinik
- C) Është deprimues i SNQ
- D) Është stimulues i SNQ

155. Labetololi (struktura në vijim) përmban në yinxhirin e tik:




- A) Tre qendra kirale (CHOH, NH, CHCH3)
- B) Dy qendra kirale (CHOH, NH)
- C) Dy qendra kirale (CHOH, CHCH3)
- D) Vetëm një qendër kirale (CHCH3)

156. Ondansetroni është:



- A) Antagonist i receptorëve sigma
- B) Alkaloid i Segale cornuta
- C) Antagonist i receptorëve 5 HT3
- D) Myorelaksues periferik

157. Fenilefrina (struktura e paraqitur), aplikohet në mukozën e hundës:



- A) Për të bllokuar receptorët histaminik
- B) Për të bllokuar receptorët β adrenergjik
- C) Për të shkaktuar vazodilacion
- D) Për të shkaktuar vazokonstriksion


158. Duke i konsideruar të gjithë kushtet e tjera të ngjashme, në cilin rast do të kishim një përthithje më të mirë të një barbiturati në traktin gastrointestinal:

- A) pH 7.4
- B) pH 6.0
- C) pH 2.0
- D) pH 8.0

159. Klonidina vepron si agonist i receptorëve alfa2 adrenergjik dhe shkakton:

- A) Shtim të peristaltikës intestinale
- B) Pakësim të aktivitetit qendror simpatik
- C) Shtim të kontraktimit të miokardit
- D) Bronkokostruksion

160. Në cilën klasë mund të klasifikohet bar-i me strukturën e dhënë:



- A) Kontaceptiv hormonal
- B) Antihistaminik
- C) Benzodiazepinë orale
- D) Hipoglicemik oral

161. Antibiotikët aminoglikozidik kur administrohen në rrugë orale, përdoren për:

- A) Infeksione të traktit respirator
- B) Infeksione renale
- C) Tuberkuloz
- D) Infeksione intestinale

162. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk bashkëvepron me receptorët GABAA:

- A) Barbituratet
- B) Benzodiazepinat
- C) Alkaloidet e opiumit
- D) Bikukulinat

163. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk duhet administruar, në një pacient asmatik:

- A) Atropina
- B) Sotaloli
- C) Adrenalina
- D) Noradrenalina

164. Barnat antihipertensiv me veprim qendror:

- A) Antagonizojnë receptorët muskarinik
- B) Stimulojnë receptorët β adrenergjik
- C) Stimulojnë receptorët alfa1
- D) Stimulojnë receptorët alfa2 presinaptik

165. Tioridazina nuk shkakton parkinsonizëm, sepse:

- A) Ka efekt të spikatur alfa1 bllokues
- B) Ka aktivitet antimuskarinik intrinsik
- C) Ka kapacitet për të aktivizuar MAO-n
- D) Ka më pak aftësi të antagonizojë receptorët D1

166. Cila nga klasat e mëposhtme, nuk ka efekt antidepresiv:

- A) Neuroleptikët
- B) Kripërat e litiumit
- C) Frenuesit e rikapjes së serotoninës
- D) Analogët e amitriptilinës

167. Një specialitet mjekësor përmban paracetamol, fenilpropanolaminë, e klorfenaminë, pra përmban lëndë me veti:

- A) Antipiretike
- B) Antimuskarinike
- C) Antibakterike
- D) Antivirale

168. Anestezikët e përgjithshëm, me përjashtim të atyre me administrim endovenoz, kanë të përbashkët:

- A) Analogjinë strukturore
- B) Shpërbashkohen lehtë në jone
- C) Mungesën e atomeve halogjene
- D) Volatilitetin e lartë

169. Nëse do të duhet të zëvendësojmë sulindakun me një analog që ka ngjashmëri strukturore, do të zgjidhnim:

- A) Diklofenak
- B) Indometacin
- C) Ibuprofen
- D) Flurbiprofen

170. Cila nga gjendjet e mëposhtme, shkatohet nga një antagonist jo përzgjedhës i receptorëve β adrenergjik:

- A) Takikardi sinusale
- B) Hiperglicemi
- C) Bronkokonstriksion
- D) Hipertension


171. Cili nga pohimet e mëposhtme për glukagonin, është i vërtetë:

- A) Është një lëndë me natyrë glucidike
- B) Është një lëndë me natyrë peptidike
- C) Përdoret në urgjencën hiperglicemike
- D) Pakëson formimin e glukozës në gjak

172. Cili nga indikacionet e mëposhtme për karbamazepinën, nuk është i saktë:

- A) Epilepsitë Gran mal
- B) Nevralgji të trigemin
- C) Aritmi supraventrikulare
- D) Shqetësime bipolare të humorit

173. Zëvendësimi i grupit aminik të karbutamidi (I) me grupin metilik të tulbotamidi (II) rezultoi i vlefshëm sepse:




- A) Eliminon aktivitetin antibakteror
- B) Fuqizon aktivitetin hipoglicemik
- C) Përmirëson farmakokinetikën
- D) Pengon metabolizimin e shpejtë

174. Ndër karakteristikat kimike dhe fiziko-kimike që përmenden më poshtë, cila ndeshet më shpesh tek barnat anestezik të përgjithshëm:

- A) Shpërbashkim të shpejtë jonik
- B) Koeficient të ndarjes vaj/ujë të lartë
- C) Shkallë viskoziteti të lartë
- D) Peshë molekulare të madhe

175. Cili nga pojimet lidhur me marrdhëniet strukturë-veprim të sulfonamideve është i gabuar:




- A) Aktiviteti varet nga pKa e hidrogjenit tek azoti N1
- B) Azoti N1 mund të jetë terciar
- C) Azoti N4 mund të zëvendësohet nga grupe të hidrolizueshme
- D) Cikli i benzenit nuk mund të zëvendësohet me cikle të tjera

176. Antimetabolitët antiviral, veprojnë në:


- A) Virusin jashtëqelizor
- B) Fazën e depërtimit të virusit në qelizë
- C) Fazën e shumimit të virusit
- D) Sintezën e proteinave virale

177. Strukturat e pjeshme të paraqitura i përkasin anestezikëve lokal. Cila nga lëndët e përdorura ka strukturë të ngjashme me (I)?




- A) Bupivakaina
- B) Prokaina
- C) Benzokaina
- D) Tetrakaina

178. Strukturat e pjeshme të paraqitura i përkasin anestezikëve lokal. Cila nga lëndët e përmendura ka strukturë të ngjashme me (II)?




- A) Mepivakaina
- B) Lidokaina
- C) Tetrakaina
- D) Prilokaina

179. Cili nga pohimet që lidhet me marrdhëniet strukturë veprim të kinoloneve të gjeneratës së fundit është i gabuar:



- A) Azoti i pozicionit 1 mund të zëvendësohet me grupe të përshtatshëm arilik
- B) Zëvendësim i duhur është edhe futja e një cikli të azotuar në pozicioni 7
- C) Lidhja dyfishtë në 2-3 mund të zëvendësohet me një lidhje të ngopur
- D) Azoti i pozicionit 1 dhe karboni në 8 mund të bashkohen me një cikël

180. Lënda vepruese e paraqitur në figurë përdoret si:



- A) Diuretik
- B) Sulfamidik
- C) Hipoglicemik oral
- D) Antiinflamator

181. Përdorimi terapeutik i nitrofuraneve antibakterore, është ulur për shkak të:

- A) Toksicitetit kronik
- B) Toksicitetit akut
- C) Zbulimit të barnave më efikas
- D) Vështirësive gjatë sintezës

182. Cili nga të mëposhtmit, nuk paraqet një efekt anësor të anestetikëve lokal që janë në përdorim:

- A) Nistagem
- B) Tremor
- C) Hipertension
- D) Aritmi

183. Cila nga karakteristikat lidhur me vargun acilik në pozicionin 6 të penicilinave, favorizon veprimin mbi bakteret Gram-negative:

- A) Hidrofiliteti
- B) Lipofiliteti
- C) Efekti elektronodhënës
- D) Efekti elektronotërheqës

184. Koeficienti i ulët i shpërndarjes gjak/gaz, i anestetikëve të përgjithshëm volatil:

- A) Përshejton induktimin e anesteziës
- B) Ngadalëson induktimin e anesteziës
- C) Rrit kohëzgjatjen e anesteziës


D) Pakëson kohëzgjatjen e anestezisë

185.

Në cilin nga rastet e mëposhtme mund të gjej përdorim klinik Δ^9 -tetrahidrokanabinoli:

- A) Në epilepsitë e tipit mioklonike
- B) Në aritmitë kardiake
- C) Si antiemetik në terapitë me cisplatin
- D) Në obezitet

186. Cili nga përdorimet i korrespondon gliklazidit me strukturë kimike të paraqitur më poshtë:



- A) Antiinflamator
- B) Hipoglicemik oral
- C) Urikosurik
- D) Antibakterik

187. Cili nga këta anestetikë të përgjithshëm, nuk mund të administrohet me rrugë endovenoze:

- A) Metoheksitali
- B) Ketamina
- C) Ciklopropani
- D) Tiopentali

188. Ndër metabolitët sulfonamidik, ai që paraqet efekte toksike më të mëdha, është:

- A) Derivati N1 - glukuronik
- B) Derivati N4- glukuronik
- C) Derivati N4 - acetilik
- D) Derivati N1- sulfatik


189. Naloksoni, është një bar:

- A) Antikoagulant
- B) Antidod i etanolit
- C) Halucinogjen i përfutur me sintezë
- D) Antagonist i receptorëve opioid

190. Mekanizmi i veprimit të kinoloneve, konsiston në:

- A) Interkelimin e molekulës në ADN bakterore
- B) Bllokimin e ARN- sintetazës që varet nga ADN
- C) Dizregjimin e membranës qelizore të bakteve
- D) Formimin e komplekseve me ADN topoizomerazën bakterore

191. Alkilimi i $-NH_2$ me një grup izopropilik në strukturën e izoniazidit:



- A) Rrit aktivitetin antituberkular
- B) Pakëson efektet toksike
- C) Nxist efektet antidepresive
- D) Lehtëson përthithjen orale


192. Veprimi antiepileptik i fenitoinës, i detyrohet:

- A) Përforcimit të lidhjes GABA receptor A
- B) Bllokimit të kanaleve potencial -vartëse të Ca^{2+}
- C) Bllokimit të kanaleve të Na^+
- D) Rritjes së përcjellshmërisë për Cl^- në kanalet përkatëse

193. Cili nga mekanizmit e veprimt të përshkruar, nuk ka lidhje me kafeinën:

- A) Bllokimi i receptorëve A1 të adozinës
- B) Bllokimi i receptorëve A2 të adozinës
- C) Bllokimi i enzimës MAO
- D) Frenim i fosfodiesterazave

194. Esterifikimi i steroidit me një grup karboksilik të acidit suksinik, sikurse tregohet në figurë, ka si qëllim:




- A) Favorizimin e kalimit të barrierës hematoencefalike
- B) Zgjatjen e vargut anësor që të ngjaj me kolesterolin
- C) Transformimin e steroidit nga një lëndë e lëngët në të ngurtë
- D) Rritjen e tretshmërisë në ujë të molekulës

195. Kotrimiksazoli përbëhet nga:

- A) Sulfometoksazoli e trimetoprimi
- B) Sulfamoli e trimetoprimi
- C) Tetrazoprima e sulfadiazina
- D) Pirimetamina e sulfaleni

196. Futja e një grupi $-CF_3$ tek unaza kinolinike e antimalarikëve (si meflokina) ka si qëllim kryesor:




- A) Përmirësimin e biodisponibilitetit
- B) Pakësimin e efekteve toksike
- C) Mbrotjen nga reaksionet metabolike
- D) Rritjen e lipofilitetit

197. Cili nga barnat e mëposhtëm, vepron si frenues i dekarboksilazës periferike:

- A) Piracetami
- B) Muscimoli
- C) Benserazidi
- D) Hidralazina

198. Transformimi i tolbutamidit (I) në klorbutamid (II) nëpërmjet zëvendësimit të grupit metilik në pozicionin 4 me klor:



- A) Rrit aktivitetin hipoglicemik
- B) Bën të mundur përdorimin oral
- C) Rrit gjysmëjetën plazmatike
- D) Pakëson efektet anësore

199. Pjesa më e madhe e antimetabolitëve antiviral janë aktiv vetëm si estere të acidit fosforik, por nuk mund të administrohen në këtë formë, sepse:

- A) Janë shumë toksikë
- B) Nuk përthithen mirë
- C) Janë të vështirë për t'u sintetizuar
- D) Nuk mund të depërtojnë në qelizë

200. Cila nga lëndët e mëposhtme, nuk konsiderohet halucinogjene:

- A) Glutetimidi
- B) Psilocibina
- C) Meskalina
- D) Skopolamina

201. Cili nga efektet e mëposhtme anësore, kufizon përdorimin e klozapinës:

- A) Nekroza hepatike
- B) Insuficiencia renale
- C) Granulocitopenia
- D) Ototoksiciteti


202. Frenuesit e MAO kanë veprim antidepressiv. Cili nga të mëposhtmit nuk bën pjesë në këtë grup:

- A) Izokarboksazidi
- B) Maprotilina
- C) Moklobemidi
- D) Tranilcipramina

203. Cila nga substancat e mëposhtme, është më efiçase për pakësimin e krizave të abstinencës të heroinomanët:


- A) Morfina
- B) Kodeina
- C) Acetaminofeni
- D) Naloksoni

204. Ndër antipsikotikët ka përfaqësues me efekte ekstrapiramidale të ulta sikurse struktura e paraqitur. Kjo i detyrohet:



- A) Përzgjedhshmërisë së lartë për receptorët D2
- B) Aktivitetit të ulët parasimpatomimetik
- C) Afinitetit të ulët për receptorët D2
- D) Afinitetit të ulët për receptorët 5 HT2

205. Cila nga karakteristikat e mëposhtme është më e rëndësishmja për veprimin e acidit flufenamik?




- A) Zëvendësimi në para tek unaza antranilike me grupe elektronotërheqës
- B) Zëvendësimi në pozicionin 3 në unazën aromatike
- C) Zëvendësimi në pozicionin 4 në unazën aromatike
- D) Zëvendësimi në pozicionin 2 në unazën aromatike

206. Kontraceptivët kryesisht përmbajnë:

- A) Dy estrogenë me kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- B) Dy progestogjenë me kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- C) Një estrogen dhe një progestogjen
- D) Një gonadotropinë dhe një estrogen

207. Një lëndë vepruese me strukturën e mëposhtme, vepron si:



- A) Dezinfektant mukozash
- B) Antitumoral
- C) Antimikrobik okular
- D) Dekongjestionues nazal

208. Cila nga karakteristikat për penicilinën G, nuk është e vërtetë:

- A) Vepron kryesisht kundër baktereve Gram pozitive
- B) Degradohet shpejt në mjedis acid
- C) Nuk mund të jepet me doza që kalojnë 4g në ditë
- D) Nuk është rezistente ndaj penicilazave

209. Cila nga alternativat nuk përbën një efekt anësor, që vërehet gjatë përdorimit të zgjatur të hormoneve glukokortikoide:

- A) Oseteoporoza
- B) Hipoglicemia
- C) Imunosupresioni
- D) Hipotrofi kortikoadrenale

210. Metisergidi dhe pizotifeni janë antagonist të receptorëve serotoninerjik, që përdoren në:

- A) Parkinson
- B) Epilepsi
- C) Migrenë
- D) Depresion

211. Prociklidina përdoret si:

- A) Hipokolesterolemik
- B) Antihipertensiv me veprim qendror
- C) Antiparkinsonik
- D) Sedativ-hipnotik

212. Antibiotikët polienik si nistatina e amfotericina, veprojnë duke:

- A) Bymyer membranën e qelizave
- B) Bllokuar sintezën e steroleve membranore
- C) U integruar në steroleve membranore dhe duke krijuar çarje
- D) Modifikuar transportin e glukozës nëpërmjet membranës

213. Cila nga enzimat e mëposhtme, merr pjesë në formimin e dopaminës në organizëm:

- A) KOMT
- B) Histidin karboksilaza
- C) Dopa dekarboksilaza
- D) O-acetiltransferaza

214. Flumazenili:

- A) Pakëson nivelin e HDL në plazëm
- B) Përdoret në terapinë e detoksifikimit nga benzodiazepinat
- C) Është antagonist i receptorëve D3 të dopaminës
- D) Përdoret në insuficiencën miokardiake

215. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë, përse i përket deprenilit dhe selegilinës:

- A) Deprenili është metaboliti aktiv i selegilinës
- B) Deprenili është frenues specifik i MAO-A
- C) Selegilina është frenues specifik i MAO-B
- D) Ata përfaqësojnë lëndë të ndryshme


216. Mepivakaina është një anestezik lokal, që vepron duke:

- A) Blllokuar kanalet e Ca²⁺
- B) Hapur kanalet për K⁺
- C) Blllokuar kanalet për Na⁺
- D) Modifikuar konformacionin e receptorëve alfa

217. Cila nga lëndët e mëposhtme, shkakton ndryshime të sintezës ose metabolizmit të acideve nukleike të qelizës bakterore:

- A) Nitroimidazoli
- B) Dapsoni
- C) Trimetoprimi
- D) Penicilina

218. Cili nga pohimet e mëposhtme për sulpiridin (struktura kimike e paraqitur), është i gabuar:



- A) Është një bar antipsikotik me strukturë benzamidike
- B) Është një bar antipsikotik me veprim të ulët klinik
- C) Nuk lidhet shumë me proteinat plazmatike
- D) Përdoret në trajtimin e parkinsonizmit të nxitur nga neuroleptikët

219. Ndër cefalosporinat e gjeneratës së tretë, cila mund të administrohet me rrugë orale:

- A) Ceftazidim
- B) Ceftriakson
- C) Cefiksim
- D) Cefotaksim

220. Gentamicina vepron:

- A) Në nënjësinë ribozomike 30S
- B) Në membranën citoplazmatike
- C) Në acidet nukleike të qelizës bakterore
- D) Në metabolizmin energjistik të qelizës bakterore

221. Vankomicina vepron:

- A) Tek acidet nukleike të qelizës bakterore
- B) Në membranën citoplazmatike
- C) Në sintezën e proteinave në fazën ribozomike
- D) Në ndërtimin e murit qelizor të qelizave bakterore

222. Cila nga klasat e mëposhtme, shfaq veti hipoglicemike të theksuara:

- A) Sulfonilureikët (Gjenerata I dhe II)
- B) Benzotiadiazinat
- C) Antagonistët H₂
- D) β 2 - Agonistët

223. Cefalosporinat me administrim i.m ose i.v gjenden më shumë, në gjeneratën e:

- A) Parë
- B) Dytë
- C) Parë dhe të dytë
- D) Dytë dhe të tretë

224. Cila është rruga kryesore, për administrimin e biguanidikëve dhe sulfonilureikëve:

- A) Intramuskulare
- B) Orale
- C) Endovenoze
- D) Sublinguale

225. Cilat nga lëndët e mëposhtme, nuk veprojnë me receptorët GABA-A:

- A) Barbituratet
- B) Benzodiazepinat
- C) Alkaloidet e opiumit
- D) Zolpidemat

226. Barnat oksitocikë:

- A) Frenojnë perilstatikën e intestinit
- B) Stimulojnë perilstatikën e intestinit
- C) Frenojnë tkurrjet e uterusit
- D) Nxisin tkurrjet e uterusit

227. Cila nga lëndët e mëposhtme, vepron duke frenuar ose modifikuar sintezën proteinike në fazën ribozomike:

- A) Trimetoprimi
- B) Dapsoni
- C) Kloramfenikoli
- D) Penicilina

228. Barnat biguanidikë, e realizojnë veprimin e tyre nëpërmjet mekanizmit:

- A) Çlirojnë insulinën nga qelizat β -pankreatike
- B) Nxisin katabolizmin e glukozës në indet periferike
- C) Nxisin glukoneogjenezën
- D) Nxisin çlirimin e glukagonit

229. Pivampicilina, është një promedikament i:

- A) Benzilpenicilinës
- B) Ampicilinës
- C) Fenoksimetilpenicilinës
- D) Propicilinës


230. Nitrazepam, është një bar:

- A) Antidepresiv
- B) Antihistaminik
- C) Antiepileptik
- D) Hipnotik

231. Rifampicinat, janë frenues të:

- A) ADN sintetazës
- B) ARN sintetazës
- C) ADN xhirazës
- D) ARN transkriptazës

232. Cili është hidrokarburi tetraciklik nga i cili rrjedhin tetraciklinat:



- A) Ciklipentanhidrofenantreni
- B) Naftaleni
- C) Fenantreni
- D) Naftaceni

233. Kotrimoksazoli:

- A) Bllokon formimin e peptidoglikanit
- B) Frenon dyhidropteroat sintetazën
- C) Bllokon në dy stade formimin e acidit tetrahydrofolik
- D) Frenon sintezën proteinike

234. Që të ruajnë veprimin antibakterik, penicilinat duhet të ruajnë:

- A) Integritetin e unazës tiazolidinike
- B) Vargun anësor në pozicionin 3
- C) Unazën beta laktamike
- D) Grupin -OH në vend të radikalit R


235. Amfotericina B, ka strukturë:

- A) Policiklike
- B) Laktamike
- C) Monociklike me lidhje dyfishe
- D) Makrociklike me lidhje dyfishe të konjuguara

236. Penicilina G ndryshon nga Penicilina V, sepse:

- A) Kanë rrugë të ndryshme eliminimi
- B) Spektër të ndryshëm veprimi
- C) Administrohen me rrugë të ndryshme
- D) Biotransformohen me rrugë të ndryshme

237. Molekula e fenoprofenit ka:



- A) Një karbon asimetric
- B) Dy karbone asimetric
- C) Tre karbone asimetric
- D) Asnjë karbon asimetric

238. Cili nga antimikrobikët e mëposhtëm, shkakton ndryshime në metabolizmin energjistik të qelizës bakterore:

- A) Cefalosporina
- B) Polimiksina
- C) Vankomicina
- D) Dapsoni

239. Cila nga alternativat, nuk është karakteristikë e imipenemit:

- C) Përdorimi i një bari të vetëm në dozën terapeutike më të ulët të mundshme
- D) Administrimi i barit vetëm përmes rrugës rektale
- E) Mbajtja e terapisë së mëparshme dhe realizimi i kontroleve të vazhdueshme hematokimike

310. Administrimi i preparateve të jodit është i gabuar në rastin e:

- A) Kontaminimit aksidental nga izotope radioaktive
- B) Krizës së tireotoksikozës
- C) Tiroiditit të Hashimotos
- D) Parapregatitjes para një ndërhyrjeje kirurgjikale të tiroides
- E) Strumës endemike

311. Cili nga barnat e mëposhtëm është më efikas në trajtimin e nauzesë dhe të vjellave që shoqërojnë sëmundjen e Menierit?

- A) Ondansetroni
- B) Proklorperazina
- C) Difenidramina
- D) Fenobarbitali
- E) Cisapride

312. Mekanizmi i veprimit të antipsikotikut haloperidrol konsiston në bllokimin e receptorëve të mëposhtëm:

- A) Histaminës
- B) Dopaminës
- C) Acetilcolinës
- D) Adrenalinës
- E) GABA-s

313. Cila prej cefalosporinave të mëposhtme ka $t_{1/2}$ më të gjatë?

- A) Cefamandoli
- B) Cefsulodina
- C) Ceftriaxoni
- D) Cefonicidi
- E) Cefatrizina

314. Cili nga barnat e mëposhtëm nuk zotëron veprim antituberkular ?

- A) Isoniazidi

- B) Rifampicina
- C) Etambutolit
- D) Azitromicina
- E) Rifabutina

315. Kardiotoksiciteti që kufizon përdorimin klinik të antitumoralëve është karakteristik për grupin e:

- A) Actinomycinës
- B) Doxorubicinës
- C) Bleomicinës
- D) Cisplatinumit
- E) Vinkristinës

316. Cili nga barnat e mëposhtëm anti-diarreik nuk ndikon në Sistemin Nervor Qendror (SNQ)?

- A) Kodeina
- B) Loperamidi
- C) Morfina
- D) Difenoksilati
- E) Parakodeina

317. Në rast të Meningitit nga *Streptococcus pneumoniae*, cili nga antibiotikët e mëposhtëm është më i përshtatshëm:

- A) Oksitetraciklina
- B) Fosfomicina
- C) Gentamicina
- D) Cefotaksima
- E) Clindamicina

318. Bashkëshoqërimi i trimetoprimës me sulfametoksazolin është efikas kundër kujt prej infeksioneve oportuniste të mëposhtme

- A) Herpes simplex i diseminuar.
- B) Meningitit criptococcica.
- C) Pneumocistosës dhe Toxoplasmosës
- D) Candidosës orale.
- E) Tuberkolozit

319. Efekti anësor i terapisë me kripërat e hekurit shprehet me :

- A) Shqetësime gastrointestinale
- B) Kollë
- C) Hipertension
- D) Përgjumje
- E) Alterim i diurezës

320. Glukozidet kardiotonike kanë këto karakteristika:

- A) Indeks terapeutik të vogël
- B) Indeks terapeutik të lartë
- C) Kombinimi me simpatomimetikët është i favorshëm
- D) Kur çfaqen të vjlla preparatin e vazhdojmë me rrugë venoze.
- E) Në rastet e mbidozimit jalin kalçium glukonat në venë.

321. Në një të sëmurë me astma bronkiale është e kundërlindikuar dhënia e :

- A) Terbutalinës
- B) Teofilinës
- C) Kromoglikatit
- D) Neostigminës
- E) Prednisonit

322. Në një të sëmurë me astma bronkiale është e kundërlindikuar dhënia e :

- A) Salbutamolit
- B) Teofilinës
- C) Kromoglikatit
- D) Propranololit
- E) Prednisonit

323. Nga barnat e mëposhtëm potencial më të pakët nefrotoksik ka:

- A) Streptomicina
- B) Amfotericinab
- C) Cis-platina
- D) Vancomicina
- E) Ciprofloxacina

324. Cilët nga barnat antihipertensivë të mëposhtëm mund të shkaktojnë edema në këmbë?

- A) Antagonistët alpha-1 adrenergjik
- B) Sartanet
- C) ACE-inibitorët
- D) Kalci-antagonistët
- E) Nitroderivatet

325. Trego cila nga gjendjet e mëposhtme përbën një kundërlindikacion ndaj përdorimit të metoklopramidit:

- A) Diabeti
- B) Patologjitë ankisioze
- C) Nausea dhe të vjellat nga kemoterapia
- D) Sëmundja e Parkinsonit
- E) Artriti reumatoid

326. Cili është antipiretiku i zgjedhur në rastin e një sindrome febrile me natyrë të mundshme virale, në një fëmijë të moshës 5 vjeç:

- A) Acido acetil salicilik
- B) Piroxicami
- C) Fenilbutazoni
- D) Celecoxibi
- E) Paracetamoli

327. Meperidina është një bar:

- A) Analgjezik jo stupefiant
- B) Analgjezik stupefiant
- C) Antiinflamator analgjezik
- D) Antihistaminik
- E) Antialdosteronik

328. Nitroglicerina:

- A) Zgjeron më tepër arteriolat
- B) Zgjeron më tepër venat
- C) Rrit pas ngarkesën
- D) Nuk shkakton tolerancë
- E) Nuk duhet bashkëadministruar me beta-blokuesit

329. Cili bar nga të mëposhtëmit shkakton bllokim të receptorëve alfa-adrenergjik postsinaptik dhe redukton presionin arterial:

- A) Kinidina
- B) Mazindoli
- C) Noradrenalina
- D) Prazosina
- E) Fenilefrina

330. Cili nga efektet e mëposhtme të AIJS-ve eliminohet në rast të përdorimit të inhibitorëve selektive të COX?

- A) Efikasiteti antiinflamator
- B) Rreziku për hemorragji gastro-intestinale
- C) Rreziku i insuficiencës renale akute
- D) Rreziku i nefropatisë nga analgjezikët
- E) Rreziku i reaksioneve idiosikrazike

331. Bari që nuk ndikon në përmirësimin e insuficiencës kardiake kronike është :

- A) Digoksinat
- B) ACE-inibitorët
- C) Diuretikë të ansës
- D) Diuretikë K+ kursyes
- E) Cimetidina

332. Acidi Klavulonik ka këto veti.

- A) Penetron lehtësisht tek Gram(-).
- B) Është Specifik për Gram(+)
- C) Është inhibitor i transpeptidazës së murit qelizor.
- D) Inaktivizon beta-lakatamazën bakteriale.
- E) Ka spektër veprimi të ngjashëm me penicilinën

333. Cili nga barnat e mëposhtëm është efikas në trajtimin e nauzesë dhe të vjellave që shoqërojnë sëmundjen (sindromin) e udhëtarëve?

- A) Ondansetroni
- B) Proklorperazina
- C) Valeriana
- D) Skopolamina
- E) Cisapridi

334. Nga efektet anësore karakteristike gjatë terapisë me ampicilinë është:

- A) Konstipacioni
- B) Hiponatremia
- C) Ekzantema makulo papulare
- D) Anemia hemolitike

E) Nefriti

335. Streptomycina mund të kombinohet në mënyrë efikase me ampicilinën në infeksionet nga:

- A) Salmonela
- B) Streptococcus faecalis
- C) Mycobacterium tuberculosis
- D) Treponema
- E) Klamidia

336. Cila nga këto barna mund të shkaktojë sindromën muskarinike:

- A) Inhibitorët e kolinesterazës
- B) Frenuesit e MAO-s
- C) Kuraret
- D) Ganglioblokuesit
- E) Vagolitikët

337. Cila nga këto tipe qelizash përfaqëson shënjestrën e veprimit kryesor të ciklosporinës dhe takrolimusit:

- A) Qelizat dentritike
- B) Limfocitet
- C) Limfocitet T
- D) Makrofagët
- E) Qelizat Natural Killer

338. Studimi i farmakogjenomikës në themelin e tij:

- A) Konsiston në studimin e karakteristikave të trashëgueshme dhe të variabilitetit të tyre nga njëri individ në tjetrin
- B) Konsiston në studimin e përgjigjes ndaj barnave në grupet e ndryshme etnike
- C) Konsiston në studimin e gjenomës (ADN) dhe produkteve të saj (ARN)
- D) Konsiston në studimin e faktorëve gjenetik të trashëgueshëm që ndikojnë në përgjigjen individuale ndaj barnave
- E) Konsiston në prodhimin e barnave të reja me teknikën e inxhinierisë gjenetike

339. Efekti terapeutik i antidepressivëve triciklik nga momenti i fillimit të mjekimit shfaqet pas:

- A) 1.5 orë
- B) 3 orë
- C) 1 ditë
- D) 2-3 javë
- E) 2 muaj

340. Mikroorganizmat rezistentë ndaj një preparati të caktuar kemioterapeutik:

- A) Mund të jenë rezistente dhe ndaj kemioterapeutikëve të tjerë që i përkasin të njëjtës klasë.
- B) Janë të varur, për shumimin e tyre, nga prezenca në organizëm e atij kemioterapeutiku
- C) Humbasin në më të shumtën e rasteve fuqinë e tyre patogjene
- D) Humbasin përgjithësisht rezistencën gjatë fazës logaritmike të zhvillimit
- E) Asnjë

341. Përparësia kryesore e fenoksimetil penicilinës ndaj benzil penicilinës është se:

- A) Është më rezistente ndaj penicilinazës
- B) Eskretohet më shpejt me urinën

- C) Lidhet më pak me proteinat serike dhe indore
- D) Është më rezistent në ambient acid
- E) Ka spektër më të gjerë veprimi

342. Kombinimi i një sulfometoksazoliti me trimetoprimën është i indikuar për trajtimin e:

- A) Infeksioneve të tonsileve (tonsilite)
- B) Infeksioneve urinare
- C) Infeksionit nga Histoplasma Capsulatum
- D) Infeksionit nga Entamoeba Histolytica
- E) Infeksionit nga Candida Albicans

343. Në një diabetik të moshuar insulin-dipendent që duhet t'i nënshtrohet një trajtimi me beta-blokues për hipertensionin dhe anginën. Cila nga këto mund të jetë zgjidhja më e pranueshme :

- A) Proranolol
- B) Pindolol
- C) Atenolol
- D) Nadolol
- E) Timolol

344. Cila nga penicilinat e mëposhtme është beta laktamazë rezistente?

- A) Amoxicilina
- B) Meticilina
- C) Piperacilina
- D) Tikarcilina
- E) Feneticilina

345. Pacientët dislipidemikë që nuk kanë rezultat në terapinë me statina mund të jenë:

- A) Subjekte që administrojnë njëkohësisht derivate të acidit fibrik
- B) Pacientë me diabet melitus
- C) Pacientë me nivele e larta të LDL
- D) Pacientët me mungesë të receptorit të LDL në nivel hepatic (dislipidemi familiale)
- E) Pacientë me nivel të ulët të HDL

346. Cili nga antiparkinsonikët e shënuar jep tharje goje

- A) Levodopa
- B) Selegilina
- C) Bromokriptina
- D) Benzotropina
- E) Amantadina

347. Për diuretikët tiazidikë është e vërtetë se:

- A) Kanë një rol thelbësor terapeutik në edemat kardiake,
- B) Nuk gjejnë përdorim në insuficencën ventrikulare akute të majtë.
- C) Janë efikas vetëm nëq administrohen në rrugë parenterale.
- D) Duhet të administrohen në rrugë parenterale për të mbajtur efektin diuretik kur ndaj tyre shfaqet rezistenca.
- E) Kur administrohen në rrugë orale luftojnë në mënyrë efikase edemën pulmonare të shkaktuar nga insuficienca ventrikulare akute e majtë.

348. Ndër karakteristikat e hidroklortiazidit përmendim:

- A) efekti antihipertensiv shfaqet shpejt pas fillimit të mjekimit
- B) është antihipertensiv i përshtashëm në hipertonië gravidate
- C) është i përshtatshëm për trajtimin e hipertoniës në diabetikët
- D) Rrit nivelin e uricemisë

349. Ndër karakteristikat e furosemidit përmendim:

- A) ka indeks terapeutik më të vogël se hidroklortiazidi
- B) ka indeks terapeutik më të madh se hidroklortiazidi
- C) shkakton rritje të acidit urik në gjak
- D) kundërpërdoret në të sëmurët me insuficiencë renale

350. Ndër karakteristikat e spirolaktonit përmendim:

- A) Eshtë preparat i përshtashëm për trajtimin e hipertoniës gjatë shtatzanisë
- B) Tolerohet mirë nga aparati tretës
- C) është diuretik i fuqishëm
- D) Kundërpërdoret në rastet me insuficiencë renale

351. Për diuretikët tiazidikë është e vërtetë se:

- A) Kanë një rol thelbësor terapeutik në të sëmurët me ascit.
- B) Nuk gjejnë përdorim në insuficiencën ventrikulare akute të majtë.
- C) Janë efikas vetëm nëq administrohen në rrugë parenterale.
- D) Duhet të administrohen në rrugë parenterale për të mbajtur efektin diuretik kur ndaj tyre shfaqet rezistenca.
- E) Edhe kur administrohen në rrugë orale luftojnë në mënyrë efektive edemën pulmonare të shkaktuar nga insuficienca ventrikulare akute e majtë.

352. Cili nga barbituratet e mëposhtëm përdoret si antiepileptik?

- A) Pentobarbitali
- B) Tiopentali
- C) Fenobarbital
- D) Diazepam
- E) Secobarbital

353. Mekanizmi antibakterial i trimetoprimës realizohet nga:

- A) Inhibimi i glukozë-6 fosfat dehidrogjenazës
- B) Inhibimi i dihidropteroat sintetazës
- C) Inhibimi i timidilat sintetazës
- D) Inhibimi i rikapjes qelizore të PABA
- E) Inhibimi i dihidrofolat reduktazës

354. Barnat më efektive për reduktimin e përqendrimit plazmatik të triglicerideve janë:

- A) Statinat
- B) Probucoli
- C) Fibratet
- D) Rrëshirat për kapjen e acideve biliare
- E) Inhibitorët e lipazës pankreatike

355. Një pacient i trajtuar me penicilinë G, i cili pas 7-12 ditësh manifeston: urtikarie, temperaturë, edemë artikulare, artralgi, limfadenopati, edemë në fytyrë dhe në qafë, ka shumë propabilitet të jetë i prekur nga:

- A) Agranulocitoza
- B) Shoku anafilaktik
- C) Sëmundja e serumit
- D) Lupusi eritematoz
- E) Glomerulonefriti akut

356. Simptoma të intoksikimit me inhibitor të kolinesterazës, nuk janë:

- A) Midriaza
- B) Bronko konstrikcionit
- C) Hipersekrecioni bronkial
- D) Bradikardisë
- E) Diarresë

357. Një pacient ankohet për urinim të shpeshtë dhe me dhimbje gjatë urinimit.. Analiza e urinës tregon për hematuria mikroskopike por jo bakteruri. Cila nga barnat e mëposhtme që ai merr ka më shumë propabilitet që të jetë shkaktari për këtë efekt anësor:

- A) Ciklosporina
- B) Naprokseni
- C) Gentamicina
- D) Ciklofosfamidi
- E) Penicililina G

358. Bari më i fuqishëm për ndërprerjen e një ataku migrene është:

- A) Propranololi
- B) Metisegridi
- C) Klonidina
- D) Triptani
- E) Amitriptilina

359. Induksioni enzimatik:

- A) Përshpejton metabolizimin e barnave
- B) Ndodh brenda një kohe të shkurtër që nga administrimi i një induktuesi
- C) Është një efekt i shkaktuar vetëm nga marrja e barnave
- D) Nuk bën të detyrueshëm ndryshim të dozës
- E) Asnjë

360. Neuroleptikët janë barna që indikohen në trajtimin e:

- A) Pagjumësisë
- B) Hipertensionit
- C) Manisë akute
- D) Konvulsioneve
- E) Dhimbjeve

361. Nitratet

- A) Japin vazodilatacion vetëm në nivel të venave
- B) Janë vazodilatator specifik vetëm për arteriolat dhe vazat prekapilare
- C) Ulin si para ngarkesën dhe pas ngarkesën

- D) Nuk veprojnë në muskulaturën e lëmuar ekstravaskulare
- E) Induktojnë efekt inotrop dhe kronotrop negativ

362. Në rastet e hemorragjive të rënda që i detyrohen mbidozimit të heparinës:

- A) Është i nevojshëm administrimi i vitaminës K në rrugë endovenose
- B) Duhet dhënë plazmë e freskët
- C) Duhet nxitur eliminimi renal i barit me anë të furosemidit venoz.
- D) Duhet administruar fibrinogjen
- E) Duhet administruar sulfati i protaminës

363. Emax i një bari përcakton:

- A) Potencën
- B) Efikasitetin
- C) Madhësinë e përgjigjes
- D) Madhësinë e antagonistit
- E) Indikimin terapeutik

364. Bromuri i pankuronit përdoret për qëllim:

- A) Sedativ
- B) Analgjezik
- C) Anestetik
- D) Miorelaksant
- E) Vagolitik

365. ALJS nuk shkakton efekte anësore si:

- A) Intolerancë gastrointestinale
- B) Inhibim i agregimit trombocitar
- C) Rritje e motilitetit uterin
- D) Nefrotoksicitet
- E) Hipersensitivitet

366. Nga mbidozimi i Benzodiazepinave nuk shkaktohet:

- A) Somnolence
- B) Ataksi
- C) Asteni
- D) Diarre
- E) Relaksim muskular

367. Protoksidi i azotit:

- A) Është metabolit aktiv i nitroderivateve
- B) Është anestetik i përgjithshëm inhalator
- C) Nuk ka veprim analgjezik
- D) Shkakton hipertension që është dozë-indipendent
- E) Inhibon kontraksionet uterine

368. Në intoksikim nga opiatet pupilat janë:

- A) Miotike
- B) Midriatike
- C) Anizokorike
- D) Paralitike

369. Përdorim klinik i Benzodiazepinave është :

- A) Morbus Parkinson
- B) Glaukoma
- C) Cefalea
- D) Pagjumësia
- E) Ulcera peptidike

370. Përdorimi i bllokuesve neuromuskulorë nuk është i vlefshëm:

- A) Në anestezi për leshimin e muskulaturës skeletike
- B) Për të parandaluar traumat gjatë elektroshokut
- C) Për të lehtësuar ndërhyrjet diagnostike si, laringoscopia
- D) Në spasmat e muskulaturës së lëmuar intestinale
- E) Për kontrollin fillestar të presionit arterial në pacientët me aneurizëm të aortës

371. Penicilinazat interferojnë me veprimet antibakterike të penicilinave sipas kujt mekanizmit të mëposhtëm?

- A) Rritjes së klirensit renal të penicilinës
- B) Nëpërmjet hidrolizës së unazës beta-laktamike
- C) Nëpërmjet hidrolizës së unazës tiazolidinike
- D) Nëpërmjet largimit të penicilinës nga lidhja farmakoproteinike
- E) Nëpërmjet deaminimit të vargut lateral

372. Zgjedhja e parë si antiaritmik për trajtimin e aritmive të shkaktuara nga digitalikët është:

- A) Kinidina
- B) Lidokaina
- C) Prokainamidi
- D) Verapamili
- E) Propafenoni

373. Cili nga këta grupe preferohet në studimet eksperimentale të fazës së parë për barin:

- A) Njerëz të rritur
- B) Gra në moshën fertile
- C) Neonatalë
- D) Persona të sëmurë që marrin barna
- E) Persona të moshuar

374. Pas përfundimit të procesit të thithjes, të gjithë faktorët e mëposhtëm tentojnë të ulin C_p e barit, përveç:

- A) Ulja e biodispozibitetit
- B) Ripërthithja tubulare renale
- C) Biotransformimi metabolik
- D) Ekskretimi biliar
- E) Shpërndarja indore

375. Barnat që përdoren në trajtimin e gutës (podagrës) janë të gjithë të mëposhtëmit përveç:

- A) Allopurinolit
- B) Aspirinës
- C) Kolkicinës
- D) Indometacinës
- E) Probenecidit

376. Cili nga këto barna mund të konsiderohet zgjedhje e parë për terapinë ambulatorë në pacientët me insuficencë kardiake kronike pa fibrilacion?

- A) Dobutamina
- B) Amrinone
- C) Enalapril
- D) Digitoksina
- E) Nitroprusiati i Na

377. Cili nga barnat e mëposhtëm përdoret në trajtimin e infeksioneve sistemike fungale?

- A) Ciprofloksacina
- B) Amfotericina B
- C) Penicilina
- D) Amiodaroni
- E) Streptomicina

378. Pohimet e mëposhtme që i përkkasin përdorimit të H-2 në terapinë antiulceroze janë të gabuara, përveç

- A) Veprojnë në receptorët e pranishëm në nivel të qelizave enterokromafinë-like
- B) Nizatidina e administruar nga goja ka një biodisponibilitet minimal 30%
- C) Cimetidina inhibon aktivitetin e citokrom P450
- D) Ranitidina përdoret kryesisht në refluksin ezofageal
- E) Antagonistët H-2 ekskretohen nëpërmjet feçeve

379. Një burrë 58 vjeçar me një histori 5 vjeçare të angina pectoris dhe me një IAM kohët e fundit, ka ardhur me krizë hipertensive. Cili bar është më mirë të përdoret në këtë pacient?

- A) Diazoksidi
- B) Nifedipina
- C) Minoksidili
- D) Labetaloli
- E) Hidralazina

380. Efekti terapeutik i prazosinës është :

- A) Midriaza
- B) Ulje e frekuencës kardiake
- C) Ulje e rezistencës vaskulare periferike
- D) Retension urinar
- E) Rritje e tonusit venoz

381. Antagonistëtstët H-2 indikohen në?

- A) Astëm bronkiale
- B) Ulcera gastrike
- C) Ankth
- D) Diarre
- E) Rinite stinore

382. Karakteristikat për tetraciklinat janë.

- A) Të sigurt në gravidancë
- B) Përdorim te fëmijët
- C) Duhet të administrohen me antiacidë
- D) Të përshtatshëm në trajtimin e rikeciozave

E) Nuk induktojnë rezistencë bakteriale

383. Studimi i faktorëve që përcaktojnë variacionet e Cp me kohën e studion seksioni :

- A) Farmakodinamikë
- B) Farmakombikqyrja (Farmacosorveglianza)
- C) Farmakogjenetike
- D) Farmakokinetikë
- E) Farmakovigjilencë

384. Intoksikimi me kripëra të litiumit përmirësohet me:

- A) NaCl
- B) Neuroleptikë
- C) Anksiolitikë
- D) Ujë në doza të larta
- E) Hepatoprotektorë

385. Efektin feminizues të meshkujt gjatë një trajtimi kronik e shkakton:

- A) Cimetidina
- B) Famotidina
- C) Nizatidina
- D) Ranitidina
- E) Omeprazoli

386. Opiatet nuk duhet të jepen në gjendjet e mëposhtme:

- A) Diarre
- B) Tonsilit
- C) Dhimbje me origjinë tumorale
- D) Cefale kronike
- E) Edemë pulmonare

387. Indikohen në antagonistët H-1

- A) Konvulsione
- B) Ulcer gastrike
- C) Ankth
- D) Diarre
- E) Rinite stinore

388. Në trajtimin e tumorit të gjirit përdoret:

- A) Tamoxifeni
- B) Propranololi
- C) Prednizoloni
- D) Vitamina D
- E) Nizatidina

389. Cilët nga barnat antihipertensive të mëposhtëm mund të shkaktojnë kollë

- A) Antagonistët alpha-1 adrenergjik
- B) Sartanet
- C) ACE-inibitorë
- D) Kalci-antagonistët
- E) Nitroderivatet

390. Kalimi i parë i barit në hepar shkakton:

- A) Rrit biodisponibilitetin
- B) Ka një farë rëndësie metabolike
- C) Rrit gjithmonë toksicitetin e bari
- D) Zvogëlon biodisponibilitetin
- E) Zvogëlon gjithmonë toksicitetin e barit

391. Cili nga kimioterapikët e mëposhtëm është aktiv në infeksionet nga *Pseudomonas aeruginoza*, por mund të japë nefrotoksicitet

- A) Karbenicilina
- B) Gentamicina
- C) Kloramfenikoli
- D) Rifampicina
- E) Eritromicina

392. Cili nga mikroorganizmat e mëposhtëm është sensibil ndaj penicilinës G.

- A) Pneumokoku
- B) Rikeciet
- C) Mykolpazma
- D) Salmonela
- E) Klebsiella

393. Nga cili antagonizohet depressioni respirator i shkaktuar nga morfina:

- A) Bruprenorfina
- B) Pentazocina
- C) Naloxoni
- D) Metadoni
- E) Codeina

394. Në terapinë orale për tretjen e gurëve biliarë me kripëra të acidit ursadesoksikolik është gabim rasti kur:

- A) Është i indikuar në gurët "transparentë"
- B) Nuk është efikas në gurët "radiopakë"
- C) përdoret njëkohësisht me çfarëdolloj bari
- D) Indikohet vetëm nëse kolecisti është bërë opak gjatë një ekzaminimi kolecistigrafik nga goja
- E) Indikohet vetëm nëse gurët janë të pakët dhe me diametër të vogël

395. Spektri i veprimit për karbenicilinën:

- A) toksoplazma
- B) kandida albikans
- C) bakterium koli
- D) *Pseudomonas aeruginoza*
- E) salmonela

396. Glukokortikoidët veprojnë me:

- A) Kanalet jonike
- B) Tirozinë kinazat
- C) Proteinën G
- D) Receptorët në bërthamë.
- E) Lipidet

397. Sulfamidikët janë akoma barna që jepen

- A) Në gonorre
- B) Në meningitin cerebrospinal epidemik
- C) Në nokardiozë
- D) Në tifo abdominal
- E) Në faringitin streptokoksik

398. Preventimi i endokarditit nga streptokoku mund të bëhet me një nga barnat e mëposhtëm:

- A) Kloramfenikol
- B) Benzatin penicilin G
- C) Kanamicin
- D) Isoniazid
- E) Netilmicina

399. Një paciente 28 vjeç është tetë muaj shtatzënë dhe ka një infeksion urinar të shkaktuar nga E.Choli. Cili nga barnat e mëposhtëm është më i përshtatshmi:

- A) Sulfametoksazol - Trimetoprim
- B) Ciprofloxacina
- C) Tetraciklina
- D) Eritromicina
- E) Ampicilina

400. Cili nga barnat e mëposhtëm jep varësi:

- A) Kalcitonina
- B) Benzodiazepinat
- C) Betablockuesit
- D) Antikoagulantët oral
- E) Antihistaminikët

401. Cili nga pohimet e mëposhtme lidhur me dëmtimet e heparit nga barnat është i vërtetë:

- A) Hepatit toksik - metotreksat
- B) Hepati kronik - acetaminofen
- C) Hepatit kronik - tiazidiket
- D) Kolestaza interhepatike - ampicilina
- E) Hepatit toksik - sulfamidikët

402. Imipenemi është:

- A) Një inhibitor i beta laktamazës
- B) Një aminoglukozid
- C) Një antifungal
- D) Një makrolid
- E) Një antibiotik beta laktamik

403. Cili nga barnat e mëposhtëm antagonizon efektin vazodilatator dhe bronkodilatator të izoproterenolit:

- A) Kokaina
- B) Fenoksibenzamina
- C) Fentolamina
- D) Propranololi
- E) Rezerpina

404. Terapia gjenetike nuk aplikohet ne rastet e sëmundjes së:

- A) Fibrozës cistike
- B) Hemofilisë
- C) Ulcerës gastrike
- D) Tumoreve
- E) AIDS

405. Cila nga cefalosporinat e mëposhtme i përket gjeneratës së tretë:

- A) Cefazolina
- B) Cefuroxim
- C) Cefamandol
- D) Ceftazidim
- E) Ceftina

406. Cili nga barnat e mëposhteme është analgjezik:

- A) Haloperidoli
- B) Pentazocina
- C) Kanamicina
- D) Adrenalina
- E) Suksinil kolina

407. Cili nga këto barna nuk ka veti beta stimulante:

- A) Salbutamoli
- B) Orciprenalina
- C) Isoprenalina
- D) Propranololi
- E) Formeteroli

408. Një pacient shfaq hiperkalemi pasi ka marrë amilorid dhe mjekim tjetër. Cili mund të jetë ky mjekim ?

- A) CaCl në rrugë endovenoze
- B) Hemodializës
- C) Insulinë dhe glukozë në rrugë endovenoze
- D) Enalapril në rrugë endovenoze
- E) Klizmë me sulfonat polistiren nartiumi

409. Në një pacienet me insuficiencë kronike ventikulare sistolike të majtë të një grade të lehtë dhe pa fibrilacion atrial, cilin nga barnat e mëposhtëm do të këshillonit:

- A) Beta bllokues
- B) Spironolakton
- C) Diuretikë
- D) Ëarfarinë
- E) Digoksinë

410. Një aplikim i rëndësishëm klinik i metadonit është në terapinë zëvendësuese të varësisë dhe detoksifikim nga:

- A) Etanoli
- B) Amfetamina
- C) Benzodiazepinat
- D) Heroina

E) Kanabinoidet

411. Administrimi IV i noradrenalinës në një pacient që merr një dozë terapeutike atropine shkakton:

- A) Rritje të frekuencës kardiake
- B) Ulje të rezistencës periferike
- C) Hipoglicemi
- D) Rritje të temperaturës trupore
- E) Miozë

412. Cila nga cefalosporinat e mëposhtme preferohet për profilaksi në kirurgji?

- A) Cefamandol
- B) Cefazolina
- C) Ceftazidima
- D) cefalexine
- E) Cerfadosili

413. Depozitimet korneale, janë efekte anësore që lidhen me përdorimin e:

- A) Adenosinës
- B) Diltiazemit
- C) Lidokainës
- D) Amiodaronit
- E) Prokainamidit

414. Një pacient me urethritis të shkaktuar nga Neisseria gonorrea që prodhon penicilinazë mund të trajtohet me një prej agjentëve të mëposhtëm:

- A) Spektinomycinë
- B) Ceftriaxon
- C) Ciprofloksacinë
- D) Ofloksacinë
- E) Trimetoprim-sulfametoksazol

415. Amlodipina ka këto karakteristika :

- A) Shkakton edema në këmbët
- B) Shkakton hipotensin ortostatik
- C) Shkakton nefrotoksicitet
- D) Shkakton bradikardi
- E) Shkakton ngadalësim të përçimit atrioventrikular

416. Cili nga kimioterapeutikët e mëposhtëm është aktiv në infeksionet nga Pseudomonas aeruginoza, por mund të japë ototoksicitet

- A) Karbenicilina
- B) Gentamicina
- C) Kloramfenikoli
- D) Rifampicina
- E) Eritromicina

417. Një pacient që po mjekohet me ciprofloksacinë duhet të evitojë përdorimin e:

- A) Aspirinës
- B) Ekspozimin në diell

- C) Antogonistëve të Ca
- D) Omeprazolit
- E) Vancomicinës

418. Warfarina:

- A) Vepron shumë shpejt nëse merret me rrugë orale
- B) Veprimi i saj potenciohet nga barbituratet
- C) Antagonizohet nga sulfati i protaminës
- D) Vepron mbi aktivitetin e faktorëve të koagulimit
- E) Veprimi i saj potenciohet nga faktori i 4 i trombociteve

419. Në të sëmurët alegjikë nga penicilina zgjidhja më e mirë në një tonsilit purulent është:

- A) Cotrimoxazoli
- B) Gentamicina
- C) Cefotaksima
- D) Azitromicina
- E) Cefalexina

420. Cila nga këto penicillina paraqet aktivitet më të mirë Anti-Pseudomonas:

- A) Amoksicillina
- B) Bakampicillina
- C) Ticarcillina
- D) Ampicillina
- E) Penicillina V

421. Në format e rënda të kolitit pseudomembranoz nga antibiotikët preparat i zgjedhjes së parë është:

- A) Amoxicilina
- B) Cotrimoxazoli
- C) Amikacina
- D) Vankomicina
- E) Sparfloxacina

422. Cili nga këto opiate ka rrezik më të pakët për varësi psikologjike:

- A) Kodeina
- B) Opiumi
- C) Morfina
- D) Metadoni
- E) Heroina

423. Në një infeksion nga stafilokoku meticilin rezistent (MRSA) antibiotiku më i përshtatshëm është:

- A) Sulfamotoksazoli
- B) Doxyciclina
- C) Vankomicina
- D) Gentamicinë
- E) Trimetoprim

424. Barnat anestezike kalojnë barrierën placentare:

- A) Po

- B) Jo
- C) Vetëm ato të administruar IV
- D) Vetëm ato të administruara me rrugë inhalatore
- E) Vetëm ato të administruara me rrugë rektale

425. Cila nga penicilinat e mëposhtme është penicilazë rezistente?

- A) Penicilina V
- B) Piperacilina
- C) Ampicilina
- D) Nafcilina
- E) Bakampicilina

426. Preparatet e mëposhtme kanë këto efekte mbi vazat arteriale:

- A) Efedrina zgjeron arteriet
- B) Nimodipina ngushton arteriet
- C) Hidralazina zgjeron arteriet
- D) Minoxidili ngushton arteriet
- E) Lizinoprili ngushton venat

427. Nga barnat e mëposhtëm bari që nuk vepron në receptorin postsinaptik është:

- A) Isoprenalina
- B) Nikotina
- C) Metakolina
- D) Fenilefrina
- E) Guanetidina

428. Cili nga barnat e mëposhtëm nuk konsiderohet si antituberkular i zgjedhjes së parë?

- A) Rifampicina
- B) Etambutoli
- C) Isoniazidi
- D) PAS
- E) Streptomocina

429. Tetraciklinat:

- A) Nuk absorbohen nga aparati tretës
- B) Absorbohen në mënyrë të pjesshme nga aparati tretës
- C) Absorbohen më mirë kur shoqërohen me preparate anti-acide
- D) Absorbohen më mirë nëq administrohen bashkë me qumështin ose derivate të tij
- E) Absorbohen më mirë kur jepen pas ushqim në krahasim me paraushqimi.

430. Metotreksati inhibon në mënyrë specifike:

- A) Hipoksantinë-guaninë-fosforibosil transferazën
- B) ADN polimerazën
- C) Dihidrofosfat - reduktazën
- D) Timidinë sintetazën
- E) Ksantinë oksidazën

431. Cili nga këto barna nuk bën pjesë në klasën e antagonistëve të receptorit të angiotenzinës II ?

- A) Irbesartan
- B) Telmisartan

- C) Sumatriptan
- D) Olmesartan
- E) Valsartan

432. Cili nga inhibitorët e HMG-CoA reduktazës, është hequr nga qarkullimi?

- A) Lovastatina
- B) Simvastatina
- C) Atorvastatina
- D) Cerivastatina

433. Cili nga barnat e mëposhtëm është një beta-2 agonist me veprim të zgjatur?

- A) Fenoteroli
- B) Salbutamoli
- C) Terbutalina
- D) Salmeteroli
- E) Albuteroli

434. Cili nga këta inhibitorë të pompës protonike, nuk ka ndërveprim kur administrohet me barna të tjerë apo me ushqimin?

- A) Omeprazoli
- B) Lansoprazoli
- C) Pantoprazoli
- D) Rabeprazoli
- E) Esomeprazoli

435. Në trajtimin e takikardisë paroksizmale supra-ventrikulare cili nga këto barna dhe rrugë administrimi rezulton më efikas në pacientë pa stabilitet hemodinamik?

- A) Adenosina si bolus i shpejtë I.V
- B) Adenosina me infuzion I.V
- C) Flekainidi si bolus I.V
- D) Propafenoni si bolus I.V
- E) Propafenoni me rrugë orale

436. Cili nga këto barna Ca-blokues nuk i përket nënklasës së dihidropiridinave?

- A) Amlodipina
- B) Diltiazemi
- C) Isradipina
- D) Nifedipina
- E) Lecarnidipina

437. Clindamicina ka këto karakteristika:

- A) Bën pjesë në grupin e betalaktamikëve
- B) Bën pjesë në grupin e aminoizidikëve
- C) Frenon sintezën e ADN
- D) Është preparat i zgjedhur në infeksionet gjinekologjike
- E) Është preparat i zgjedhur në meningite

438. Cila nga këto enzima bllokohet nga acidi acetyl-salicilik?

- A) Histaminaza
- B) NADPH oksidaza

- C) Ciklo-oksigenaza 1
- D) Amilaza
- E) Fosfolipaza A2

439. Terapia me beta bllokues është e kundërindikuar në rastin e:

- A) Hipertension të lehtë dhe të moderuar
- B) Aritmi
- C) Hipertension arterial të lartë
- D) Astmë
- E) Gastrit

440. Administrimi i barnave acidifikues të urinës sjell:

- A) Reduktim të përthithjes tubulare të barnave bazike
- B) Reduktim të përthithjes së barnave acide
- C) Metabolizim të reduktuar të barnave bazike
- D) Metabolizim të reduktuar të barnave acide
- E) Asnjë nga këto

441. Cili nga efektet anësore të L-DOPA reduktohet nga shoqërimi me karbidopa:

- A) Konfuzioni mendor
- B) Diskinezia
- C) Nausea
- D) Efekti On-Off
- E) Halucinacionet

442. Indeksi terapeutik shpreh:

- A) Efikasitetin e një bari
- B) Potencën e një bari
- C) Biodisponibilitetin e një bari
- D) Sigurinë
- E) Toksicitetin akut të një bari

443. Një hiperkolesterolemi homozigote familjare:

- A) Paraqet një zvogëlim në kapacitetin e mëlçisë për të metabolizuar kolesterolin
- B) Karakterizohet nga mungesa e receptorëve qelizorë për LDL
- C) Paraqet një shtim të përthithjes së acideve yndyrore nga ana e epitelit intestinal
- D) Paraqet një zvogëlim të eliminimit të acideve yndyrore nëpërmjet rrugëve biliare
- E) Mungojnë receptorët për HDL kolesterolintociteve

444. Të gjitha pohimet e mëposhtme që i referohen verapamilin janë të vërteta përveç:

- A) Mund të bashkadministrohet pa problem me beta bllokues adrenergjike
- B) Është i nevojshëm në trajtimin e flutter-it atrial
- C) Është i nevojshëm në trajtimin e fibrilacionit atrial
- D) Veprimi i tij inotrop (-) kufizon marrjen në rast të insuficiencës kardiake
- E) Është i nevojshëm në trajtimin e takikardisë paroksizmale supraventrikulare

445. Antagonistët e receptorëve 5-HT₃ mund të jepen në terapi si:

- A) Antiemetikë
- B) Antidepresivë
- C) Anoreksizantë

- D) Sedativë
- E) Kardiotonikë

446. Cili nga barnat e poshtë shënuar është një alfa 1 agonist:

- A) Guanabenzi
- B) Guanfacina
- C) Prazosina
- D) Klonidina
- E) Metoksamina

447. Një ACE-inhibitor indikohet:

- A) Në infarkt të miokardit
- B) Në insuficiencën e valvulës mitrale
- C) Në morbuja Kushing
- D) Në infeksione urinare koronike
- E) Në hipotension arterial

448. Cili mund të konsiderohet si indikator i efikasitetit të statinave:

- A) Reduktimi i tensionit arterial
- B) Reduktimi i kolesterolit
- C) Përmirësimi i funksionit kardial
- D) Shtim i kontraktilitetit të miokardit

449. Një ACE-inhibitor indikohet:

- A) Në veset reumatizmale të zemrës.
- B) Në insuficiencën ventrikulare sistolike të majtë
- C) Në insuficiencë renale kronike
- D) Në migrenë
- E) Në takikardi suraventrikulare.

450. Një ACE-inhibitor indikohet:

- A) Në endarterit obliterant
- B) Në aterosklerozë cerebrale
- C) Në cirrozë heparike
- D) Në glomerulopati diabetike
- E) Në aritmi ventrikulare

451. Një ACE-inhibitor indikohet:

- A) Në hipertension endokranial
- B) Në glaukomë
- C) Në feokromocitomë
- D) Në hipertoni sekondare
- E) Në fibrilacion arterial

452. Toleranca si fenomen për shkak të të cilit efekti i një bari zvogëlohet gradualisht në vijim të administrimit të përsëritur nuk mund të jetë i lidhur me:

- A) Shtimin e numrit të receptorëve
- B) Reduktim të numrit të receptorëve
- C) Pakësimin e mediatorit
- D) Shtim i metabolimit hepatic të barit

E) Pakësim i albuminave plazmatike

453. Cili është mekanizmi i veprimit të antidepressantëve triciklikëve:

- A) Stimulojnë sintezën e serotoninës
- B) Blllokojnë ripërthithjen e GABA
- C) Fuqizojnë transmetimin kolinergjik
- D) Nuk veprojnë në nivel sinaptik
- E) Blllokojnë rikapjen e noradrenalinës

454. Në një pacient, gjatë aktit të atakut të angina pectoris nitroglicerina duhet administruar:

- A) Intramuskular
- B) Sublingual
- C) Nga goja
- D) Petçe transdermale
- E) Subkutan

455. Të gjithë të mëposhtmit paraqesin efekte anësore të ciklosporinës me përjashtim të:

- A) Nefrotoksicitet
- B) Hepatotoksicitet
- C) Hipertension arterial
- D) Toksicitet gastro-intestinal
- E) Alopeci

456. Një bar xhenerik ka karakteristikë se është:

- A) Një molekulë e përdorur në terapi për shumë sëmundje
- B) Një përzierje e molekulave
- C) Një bar i përdorur në terapinë homeopatike
- D) Një bar që mund të merret pa recetë mjekësore
- E) Një bar që i ka mbaruar afati kohor i patentës

457. Cili nga barnat që vijnë shton tonusin e sfinkterit ezofageal në pacientë me refluks gastroezofageal pa shtuar sekretimin e acidit gastrik:

- A) Cisapridi
- B) Hidroksidi i magnezit
- C) Betanekol
- D) Cimetidine
- E) Omeprazol

458. Nga efektet anësore të mëposhtme prej benzodiazepinave nuk mund të shkaktohet:

- A) Cefale
- B) Inkoordinim motor
- C) Marrje mendsh
- D) Amnezi anterograde
- E) Kapllëk

459. Bromokriptina ka këto ndikime:

- A) Stimulon çlirimin e hormonit të Gonadotropinës
- B) Stimulon drejtpërdrejt vezoret
- C) Është një antagonist i estrogjenëve që shton çlirimin e Gonadotropinës
- D) Inhibon hiperprolaktineminë

E) Shton sintezën e FSH.

460. Cili nga këto preparate përdoret si antiagregant?

- A) Paracetamoli
- B) Nimesulidi
- C) Nabumetoni
- D) Kloidogreli
- E) Ibuprofeni.

461. Kur dëshirojmë efektin e dilatimit pupilar, por jo cikloplegji, cili do të jetë bari i zgjedhur?

- A) Homatropina
- B) Pilokarpina
- C) Izoproterenoli
- D) Tropikamidi
- E) Fenilefrina.

462. Në cilin nga indet, barnat shpërndahen në përgjithësi ngadalë?

- A) Mushkëri
- B) Mëlçi
- C) Indin kockor
- D) Tiroide
- E) Muskulin skeletik.

463. Me cilin nga barnat e mëposhtëm duhet të trajtohet një grua shtatzënë me urinim të shpeshtë, disuri dhe bakteruri?

- A) Ciprofloksacinë
- B) Norfloksacinë
- C) Cefaleksinë
- D) Trimetoprim-Sulfametoksazol
- E) Doxycycline.

464. Cili nuk është neurotransmetues?

- A) Acetilkolina
- B) Noradrenalina
- C) Tromboksani
- D) Dopamina
- E) 5-hidroksitriptamina.

465. Amiodaroni është një bar:

- A) Gjumëdhënës
- B) Antiacid
- C) Antiaritmik
- D) Beta-nxitës
- E) Beta-bllokues.

466. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm do të preferohet në rast të një pneumonie nga Legionela?

- A) Vankomicina
- B) Eritromicina
- C) Ampicilina
- D) Oksacilina

E) Fosfomicina.

467. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë?

- A) Sulfaniluret reduktojnë sekretimin e insulinës
- B) Tolbutamidi kundëringkohet në pacientët me diabet të tipit - II
- C) Glipizidi shton sekretimin e Glukagonit
- D) Biguanidet mund të shkaktojnë acidozën laktike
- E) Insulina mund të administrohet per os.

468. Eliminimi i penicilinës G natrium kristalizatum bëhet:

- A) Përmes sekretimit tubular
- B) Përmes filtrimit glomerular
- C) Përmes sekretimit biliar
- D) Përmes sekretimit intestinal
- E) Përmes rrugës pulomonare

469. Penicilina G natrium kristalizatum ka këto karakteristika:

- A) Eliminohet kryesisht në formë të metaboliteve
- B) Eliminohet në formën e lirë dhe të metaboluar
- C) Eliminohet në formë të lirë ,e pa metaboluar.
- D) Ka efekt baktericid kundër bakterium koli.
- E) Mund të jepet me aerosol

470. Një grua me hirsutizëm për shkak se ka nivele të larta serike të dihidrotestosteronit, mund të mjekohet me:

- A) Ketokonazol
- B) Tamoksifen
- C) Finasterid
- D) Ciproteron
- E) Flutamid

471. Barnat sipas rrugëve që administrohen:

- A) Intramuskul, absorbohen më ngadalë sesa kur jepen subkutan
- B) Subkutan absorbohen më ngadalë sesa intramuskul
- C) Intramuskul dhe subkutan, absorbohen me të njëjtën shpejtësi
- D) Përmes rrugës rektale absorbohen më ngadalë se sa nga goja
- E) Përmes rrugës orale nuk i nënshtrohen kalimit të parë në hepar.

472. Të gjitha kushtet e mëposhtme bëjnë pjesë tek indikacionet e mundshme të opioideve, përveç:

- A) Diarresë
- B) Kollës
- C) Dhimbjes me origjinë nga kanceri
- D) Dhimbjes kronike të kokës
- E) Edemës pulmonare.

473. Të gjitha efektet e mëposhtme janë manifestime nga mbidozimi me barbiturate, përveç:

- A) Eksitimit
- B) Konfuzionit mendor
- C) Letargjisë
- D) Hipotermisë

E) Hipotensionit

474. Nitroglicerina në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me rrugë reflektore, jep të gjitha efektet e mëposhtme përveç:

- A) Takikardisë
- B) Zvogëlimit të forcës tkurrëse të zemrës
- C) Rritjes së kapacitetit venoz
- D) Zvogëlimit të tensionit të fibrave intramiokardiale
- E) Zvogëlimit të pasngarkesës.

475. Në një pacient të prekur nga glaukoma ndalohet përdorimi i:

- A) Barbiturateve
- B) Skopolaminës
- C) Antibiotikëve
- D) Benzodiazepinave
- E) Amfetaminave.

476. Terapia me estrogjenë është e lidhur me këto efekte negative, përveç:

- A) Hiperplazisë endometriale
- B) Nauzesë
- C) Dhimbjes së gjoksit
- D) Hipoglicemisë
- E) Hemikranisë.

477. Efektet gastrointestinale të metoklopramidit dhe cisapridit, antagonizohen nga barna që bllokojnë receptorët e:

- A) Dopaminës
- B) Serotoninës
- C) Muskarinike
- D) Nikotinike
- E) Motilinës

478. Rreziku për hemorragji në pacientë të trajtuar me heparinë rritet nga përdorimi i aspirinës, sepse kjo e fundit:

- A) Inhibon aktivitetin antikoagulant të heparinës
- B) Inhibon funksionin e agregimit trombocitar
- C) Shkëput heparinën nga lidhja me proteinat plazmatike
- D) Inhibon formimin e protrombinës
- E) Jep trombocitopeni

479. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm përdoret për kolitin e shkaktuar nga Clostridium Difficile?

- A) Rifampicina
- B) Eritromicina
- C) Vankomicina
- D) Tetraciklina
- E) Cefazolina

480. Cili nga barnat e shënuar antidepresive jep më shumë efekte anësore?

- A) Amitriptilina
- B) Citaloprami

- C) Sertralina
- D) Paroksetina
- E) Fluoksetina

481. Cilat jane efektet e padëshiruara të fenotiazinës?

- A) Dhimbja e kokës
- B) Paraliza spastike
- C) Korea
- D) Fotofobia
- E) Shqetësimet ekstrapiramidale

482. Efekti toksik kryesor i frenuesve të enzimës HMG-CoA reduktazë është:

- A) Aritmia e rëndë kardiake
- B) Japin nivele të rritura të enzimave hepatike dhe muskulare
- C) Gurë biliarë
- D) Pankreatit akut
- E) Neuropati periferike

483. Të gjitha pohimet e mëposhtme për varfarinën janë të gabuara, përveç:

- A) Vepron shpejt nëse administrohet nga goja
- B) Veprimi i saj potencohet nga barbituratet
- C) Antagonizohet nga protamine sulfati
- D) Vepron në aktivitetin e faktorëve të koagulimit
- E) Potencohet nga faktori 4 i koagulimit

484. Omeprazoli nuk përfshihet në indikacionet e patologjive të mëposhtme:

- A) Sindromës Zollinger-Ellison
- B) Ulcerës peptike
- C) Ezofagjitit të refluksit
- D) Diarresë
- E) Ulcerës gastrike

485. Lidokaina ka veprime:

- A) Simpatikolitike
- B) Miorelaksante
- C) Parasimpatikomimetike
- D) Anestezike lokale
- E) Spazmolitike

486. Indikacionet klinike të mëposhtme janë specifike për benzodiazepinat, përveç:

- A) Konvulsioneve
- B) Ataket e panikut
- C) Pagjumesisë
- D) Depresionit
- E) Ankthit

487. Në rastin e trajtimit me antikolinergjikë, nuk mund të ndodhin efekte anësore si p.sh.ai i:

- A) Konstipacionit
- B) Reduktimit të pH-it gastrik
- C) Tharjes së gojës

- D) Takikardisë
- E) Bronkokonstriksionit

488. Cili nga antibiotikët e mëposhtëm i përket grupit të polimiksinave?

- A) Eritromicina
- B) Kolistina
- C) Doksiciklina
- D) Cefalotina
- E) Gentamicina

489. Në pacientët asmatikë, salbutamoli i administruar me rruge inhalatore:

- A) Nuk mund të manifestojnë efekte kardiake
- B) Mund të japi bradikardi, për shkak të stimulimit vagal
- C) Nuk kalon në stomak, nuk jep efekte sistemike
- D) Mund të japi efektet e nxitjes së receptorëve B1

490. Indikacionet e benzodiazepinave nuk përfshijnë

- A) Konvulsionet
- B) Abstinencën akute nga etanoli
- C) Sëmundjen e udhëtimit
- D) Ankthin
- E) Qetësimin preoperator

491. Paracetamoli zotëron njëkohësisht edhe efekte:

- A) Antibiotike
- B) Analgjezike
- C) Stupefiante
- D) Antikolinergjike
- E) Fibrinolitike

492. Antibiotiku "me spektër të gjerë" është:

- A) Antibiotiku që ka një gamë të gjerë efektesh të padëshiruara
- B) Antibiotiku aktiv kundrejt mikroorganizmave rezistente ndaj antibiotikëve me spekter të ngushtë
- C) Antibiotiku aktiv kundrejt një numri të madh mikroorganizmash
- D) Antibiotiku që ka një numër të madh indikacionesh terapeutike
- E) Antibiotiku që ka njënumur të madh nderveprimesh.

493. Nga cefalosporinat në vazhdim thithet mirë pas përdorimit me rrugë orale:

- A) Cefalotina
- B) Cefaloridina
- C) Cefaleksina
- D) Cafamandol
- E) Cefuroksima

494. Në efektet farmakologjike të barbiturateve nuk mund të ndodhi që:

- A) Në dozë 10 mg. të reduktojnë reagimin e organizmit ndaj stimujve të dhimbshëm
- B) Rrisin kohëzgjatjen totale të gjumit dhe ndryshojnë kohëzgjatjen e fazave të tij
- C) Deprimojnë në mënyrë të kthyeshme aktivitetin e gjithë indeve të eksitueshem
- D) Kanë aktivitet anestezik të përgjithshëm
- E) Mund të shkaktojnë tolerancë

495. Tregoni cili glukokortikoid ka kohëzgjatje të mesme veprimi:

- A) Hidrokortizoni
- B) Kortizoni
- C) Fludrokortizoni
- D) Betametazoni
- E) Prednizoloni

496. Karbenicilina indikohet në mënyrë specifike në infeksionet nga:

- A) Pseudomonas Aeruginoza
- B) Enterokoku
- C) Streptokoku viridant
- D) Stafilokoku Aureus
- E) Hemofilus Influence

497. Kriprat e litiumit përdoren kryesisht në:

- A) Skizofreni
- B) Depresion Endogjen
- C) Intoksikacion me Neuroleptikë
- D) Psikoza Manjako-Depresive
- E) Distoni neurovegetative

498. Për Pindololin pohojmë se:

- A) Është një beta-1 bllokues selektiv
- B) Është alfa dhe beta bllokues
- C) Është një bllokues jo selektiv, agonist parcial
- D) Nuk është në gjendje që të stabilizojë membranën
- E) Metabolizohet më lehtësisht se propranololi

499. Manitoli është:

- A) Një antikoagulant oral
- B) Një diuretik osmotik
- C) Një beta-blokues
- D) Një antagonist i kalciumit
- E) Një antidot që lidh Pb

500. Proranololi kundërrindikohet:

- A) Në hipotireozë
- B) Në diabetin e tipit të dytë
- C) Në insuficiencën kardiake kongjestive
- D) Në diabetin tip 1
- E) Në astmën bronikale

501. Efekti anësor më i shpeshtë gjatë trajtimit me enalapril është:

- A) Anemia
- B) Hipertensioni
- C) Halucinacionet
- D) Kolla
- E) Rrjedhje hundësh

502. Intoksikimi nga kriprat e litiumit mund të ndodhi më lehtësisht:

- A) Në subjektet me kompromentim të rëndë të funksionit renal
- B) Në subjektet maniakale
- C) Në skizofrenët
- D) Në gratë me moshë nga 30 deri në 40 vjeç
- E) Në subjektet me depression

503. Në efektet anësore të kontraceptivëve oral nuk bën pjesë:

- A) Infarkt i miokardit
- B) Sëmundje tromboembolike venoze
- C) Iktus trombotik
- D) Hemoragji subaraknoidale
- E) Hipotensioni

504. Valproati i Na indikohet si :

- A) Antidiarreik
- B) Kundër enurezëz nokturne
- C) Antiepileptik
- D) Antihipertensiv
- E) Antidepresiv

505. Administrimi i vazhdueshëm i Furosemidit nuk shkakton:

- A) Hiperkalcemi
- B) Hiperuricemi
- C) Hipokalemi
- D) Ototoksicitet
- E) Alkalozë

506. Acidi vanilmandilik është kataboliti kryesor i:

- A) Histaminës
- B) Serotoninës
- C) Dopaminës
- D) GABA-s
- E) Katekolaminave

507. Biodisponibiliteti i një bari:

- A) Është fraksioni i dozës së administruar që arrin qarkullimin sistemik
- B) Është përpjestimor me efektin
- C) Është në përpjestim të zhdrejtë me dozën e administruar
- D) Nuk varion në varësi të rrugës së administrimit
- E) Është më i vogël për barnat me potencë të vogël

508. Efektet anësore të Adrenalinës nuk mund të jenë:

- A) Aritmi ventrikulare
- B) Hemorragji cerebrale
- C) Përkeqësim të simptomave në pacientët psikotik
- D) Ankth
- E) Përkeqësim të simptomave të bronkospazmës

509. Farmakokinetika nuk përfshin studimin e:

- A) Mekanizmit të veprimit
- B) Shpërndarjes
- C) Metabolizmit
- D) Perthithjes
- E) Ekskretimit

510. Diuretikët inhibitor të anhidrazës karbonike:

- A) Përdoren në uljen e presionit okular në glaukomën me kënd të gjerë
- B) Shkaktojnë acidozë sepse reduktojnë eliminimin e bikarbonateve
- C) Inhibojnë anhidrazën karbonike në glomerulat.
- D) Inhibojnë anhidrazën karbonike të stomakut dhe për pasojë kanë një efekt antisekretor gastrik me rëndësi terapeutike
- E) Manifestojnë efektin diuretik kur inhibojnë 10-20% të anhidrazës karbonike tubular

511. Në një pacient të dekompensuar të trajtuar me digoksinë të vjellat, nausea dhe aritmitë janë shprehje e:

- A) Një përkeqësimi të dekompensimit
- B) Një intolerance ndaj barit
- C) Një reaksioni alergjik ndaj digoksinës
- D) Një efekti toksik për shkak të dozës së ekzagjeruar të barit të administruar
- E) Një retension hidrik

512. Cili nga barnat e mëposhtëm ka mekanizëm veprimi të ngjashëm me penicilinën:

- A) Cefuroksima
- B) Tobramicina
- C) Spiramicina
- D) Paramomicina
- E) Kloramfenikoli

513. Ndërprerja e menjëhershme e terapisë antihipertensive me beta-blokues nuk jep si efekt anësor:

- A) Mbajtje të kriprave dhe ujit
- B) Infarkte të miokardit
- C) Angina pectoris
- D) Takikardi
- E) Hiperaktivitet katekolaminergjik

514. Nitroderivatet kanë këto karakteristika:

- A) Efekti i trinitrinës zgjat 3 minuta
- B) Efekti i trinitrinës zgjat 20 minuta
- C) Efekti i trinitrinës zgjat 6-7 orë
- D) Trinitrina nuk metabolohet dhe eliminohet e pa ndryshuar
- E) Trinitrina pakëson TA pasi ka efekt inotrop negativ

515. Nitrovazodilatatorët nuk shkaktojnë efekte anësore si:

- A) Hipotension
- B) Takikardi reflektore
- C) Cefalea
- D) Lupus iatrogjen

E) Tolerancë

516. Amoksicilina ndryshon nga ampicilina sepse:

- A) Eleminohet me rrugë urinare
- B) Është bactericide ndaj pseudomonasit
- C) Ka qëndrueshmëri më të madhe në ambient urinar
- D) Ka përthithje më të mirë me rrugë orale
- E) Është beta-laktamazë rezistente

517. Bromokriptina është:

- A) Është një agonist D2
- B) Është agonist N
- C) Është një agonist D1
- D) Agonist H1
- E) Agonist H2

518. Në cilat prej mikroorganizmave të mëposhtëm është aktive polimixina:

- A) Streptokokë
- B) Stafilokokë
- C) Listeria
- D) Pseudomonas
- E) Klostridium

519. Një grua 59 vjet duhanpirëse u diagnostikua me tumor pulmonar 2 muaj më parë. Hyn në spital në koma. Kalciumi serik është në nivelin 16mg/dl. Cili prej barnave të mëposhtëm do të ishte më i dobishmi për ta ulur shpejt Ca serik?

- A) Manitoli
- B) Hidroklortiazidi
- C) Acetazolamidi
- D) Furosemidi
- E) Spironolaktoni

520. Kromonet indikohen:

- A) Në atakun akut të astmës
- B) Në terapinë e bronkoektazisë
- C) Në terapinë mbajtëse parandaluese të astmës bronkiale
- D) E shoqëruar me atropinikë për të ulur efektet e padëshiruara
- E) Ekskluzivisht në astmën bronkiale në moshat pedriatike

521. Në një pacient me edemë cerebrale do të preferohet:

- A) Acetazolamidi
- B) Amiloridi
- C) Acidi etakrinik
- D) Furosemidi
- E) Manitoli

522. Cili nga diuretikët ka karakteristike efekt anësor si tinitus, humbje të dëgjimit?

- A) Manitol
- B) Acid etakrinik
- C) Spironolakton

- D) Acetazolamid
- E) Hidroklortiazid

523. Cili nga diuretikët ka karakteristike efekt anësor marrje mendsh dhe çregullim të dëgjimit?

- A) Indaamid
- B) Amiloridi
- C) Acetazolamid
- D) Acid etakrinik
- E) Hidroklortiazid

524. Heparina ka këto karakteristika:

- A) Zotëron efekt trombolitik
- B) Nuk ndikon në agregimin e trombociteve.
- C) Vepron duke bllokuar sintezën e tromboxanit A2
- D) Vepron duke u lidhur me antitrombinën 3
- E) Bllokon veprimin e vitaminës K

525. Në një pacient 30 vjeç që ka marrë overdozë me morfinë . Për momenti TA 110/70 mmHg, pulsi 100/min dhe respiracioni 10 herë në minutë. Trego cili është bari me të cilin ndërhyet

- A) Fenobarbital
- B) Metadon
- C) Aspirinë
- D) Naloxon
- E) Diazepam

526. Një student u dërgua në urgjencë për shkak se kishte marrë overdozë të një bari të paligjshëm. Është i axhituar, nuk është i qartë në mendime, shfaq simptoma paranoje dhe "dëgjon zëra". Droga përgjegjëse për gjendjen e tij është:

- A) Heroina
- B) Etanoli
- C) Metamfetamina
- D) Marijuana
- E) Efedrina

527. Me efekt të kalimit të parë kuptohet:

- A) Efekti i parë që një bar shfaq, kur ka arritur në vendin e veprimit
- B) Efektet neurologjike, që një bar shfaq gjatë kalimit të parë në sistemin nervor qëndror.
- C) Biotransformimit që bari pëson gjatë kalimit të parë në hepar.
- D) Eleminimi i barit gjatë kalimit të parë në veshka.
- E) Efekti intestinal i një bari të administruar nga goja.

528. Bllokuesit Beta 1 selektiv shkaktojnë:

- A) Efekt kronotrop dhe inotrop pozitiv i shoqëruar me shtim të presionit arterial
- B) Efekt kronotrop dhe inotrop negativ i shoqëruar me pakësim të presionit arterial
- C) Aktivizim të receptorëve beta të pranishëm në muskulaturën e lëmuar të bronkeve shoqëruar me bronkodilatacion
- D) Reduktim të presionit arterial duke vepruar direkt në receptorët e SNQ.
- E) Halucinacione dhe delir në rast të ndërprerjes së menjëhershme të medikamentit

529. Medikamentet nuk e evitojnë kalimin e parë në hepar nëq administrohen në:

- A) Rrugë orale
- B) Rrugë sublinguale
- C) Rrugë rektale
- D) Rrugë transdermike
- E) Nën lëkurë

530. Kush nga këto barna, është një antagonist i kalciumit që vepron si tek qelizat e vazave të gjakut ashtu dhe në ato kardiake:

- A) Verapamili
- B) Nimodipina
- C) Ranitidina
- D) Fluvastatina
- E) Teofillina

531. Cila nga patologjitë e më poshtëme nuk është kundëriindikacion për AIJS:

- A) Shqetësime të koagulimit të gjakut
- B) Astma bronkiale
- C) Sëmundje ulcerative gastrike
- D) Insuficiencë renale
- E) Depresion psikik

532. Cili nga agjentët e mëposhtëm antimikrobikë është absolutisht i kundëriindikuar në shtatëzani dhe në fëmijët:

- A) Tetraciklina
- B) Penicilina
- C) Cefalosporina
- D) Eritromicina
- E) Kotrimazoli

533. Për një person të trajtuar me varfarinë duhet të jetë i kujdeshëm sepse mund të ketë rrezik për:

- A) Shtim të numrit të trombociteve pas ndërprerjes së preparatit
- B) Tendencë për hemorragji nëse kombinohet me amoksicilinën
- C) Tendencë për hemorragji nëse kombinohet me fenobarbitalin
- D) Insuficiencë kardiake
- E) Edemë pulmonare

534. Koha e nevojshme që përqëndrimi maksimal i barit të përgjysmohet quhet:

- A) Biodisponibilitet
- B) Gjysëmjetë
- C) Klirens
- D) Volum apparent i shpërndarjes
- E) Dozë efektive DE50

535. Atropina është:

- A) Vagomimetike
- B) Vagolitike
- C) Parasimpatomimetike
- D) Simpatolitike
- E) Simpatomimetike

536. Aminoglikozidet nuk kanë veti që të:

- A) Shkaktojnë dëmtim vestibular
- B) Pengojnë sintezën e proteinave
- C) Indikohen në infeksionet e shkaktuara nga Gram(-)
- D) Janë komponime polare
- E) Janë efikase kundër Bacteroides fragilis

537. Në një person me diabet bari antihipertensiv i duhur është:

- A) Bllokues i kanaleve të Ca
- B) Një tiazidik
- C) Një Alfa 1 bllokues
- D) Një Beta bllokues
- E) Një ACE-inhibitor

538. Nga penicilnat e administruara në rrugë i.m, ajo që absorbohet më ngadalë është:

- A) Penicilina G
- B) Benzatin-penicilina
- C) Ampicilina
- D) Meticilina
- E) Carbenicilina

539. Trego se cili nga barnat e mëposhtëm nuk i përket klasës së antidepresantëve triciklike

- A) Amitriptilina
- B) Desipramina
- C) Doxepina
- D) Fluoksetina
- E) Imipramina

540. Enzimat mikrozomiale:

- A) Kur pësojnë induksion pozitiv zgjatën dhe fuqizojnë efektin e barnave të tjera
- B) Inhibohen nga ekspozimi kronik me fenobarbital
- C) Zakonisht nuk ndikojnë në kohëzgjatjen e efektit të barnave
- D) Janë të lokalizuara në rrjetin endoplazmatik kokrrizor
- E) Mund të shtohen në raste të ikterit obstruktiv.

541. Atropina është e kundërindikuar në:

- A) Diabet
- B) Insuficiencë renale kronike
- C) Glaukomë
- D) Insuficiencë surenale
- E) Bradikardi

542. Lidokaina e administruar endovenë:

- A) Ristabilizon ritmin sinusal në fibrilacion atrial
- B) Redukton hyrjen e joneve Ca⁺ në qelizat pacemaker të ventrikulit
- C) Frenon funksionin pacemaker të nyjes sinusale
- D) Metabolizohet ngadalë
- E) Eleminon ekstrasistolat ventrikulare

543. Një person diabetik në trajtim insulinik të kontrolluar dobët ankohet për djersitje, uri, palpitatione dhe ka një lëkurë e lagësht dhe të zbehtë. Për ç'gjendje bëhet fjalë në bazë të simptomave të të sëmurit?

- A) Doza e insulinës është e pamjaftushme
- B) Shenjat tregojnë shfaqjen e hipoglicemisë
- C) Shenjat lidhen me hipergliceminë
- D) Pacienti po humbet sheqer në urinë
- E) Po zhvillohet një infeksion sistemik

4. Farmakognozi dhe Fitoterapi

1. Cila nga drogat e mëposhtme përmban glikozide kardioaktive të tipit kardenolid:

- A) Folium Crataegi
- B) Semen Strophanthi
- C) Bulbus Scillae
- D) Herba Polygoni

2. Cila nga drogat e mëposhtme përmban glikozide kardioaktive të tipit bufadienolid

- A) Folium Digitalis lanatae
- B) Folium Oleandri
- C) Rhizoma Helleboris
- D) Rhizoma Rhei

3. Cila nga drogat e mëposhtme përdoret në industrinë farmaceutike të prodhimit të barnave kardioaktive.

- A) Folium Hyosciami
- B) Flores Tiliae
- C) Folium Digitalis
- D) Herba Rutae

4. Cila nga drogat e mëposhtme përmban përbërës aktivë që përdoren në insuficiencë kardiake:

- A) Radix Rauëolfiae
- B) Herba Convallaria
- C) Cortex Chinae
- D) Herba Vincae minor

5. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi rrugën biogjenetike të formimit të glikozideve kardiake është e saktë:

- A) Nëpërmjet rrugës së acetateve.
- B) Nëpërmjet rrugës së trupëzimit të azotit inorganik.
- C) Nëpërmjet rrugës së acidit shikimik.
- D) Nëpërmjet rrugës së bashkimit midis acetylCoA dhe malonilCoa.

6. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm është i pranishëm në Semen Strophanthi:

- A) Helebrigenina
- B) Adonitoksina
- C) Oubaina
- D) Konvalatoksina

7. Në cilën nga drogat bimore të mëposhtme ndodhet shilareni A:

- A) Digitalis purpurea
- B) Adonis vernalis
- C) Helleborus niger
- D) Scilla maritime

8. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi formën farmaceutike të marrjes së oleandrinës, në mënyrë që të mënjanohet përndryshimi i saj nga lëngu i stomakut, është e saktë:

- A) Në formë tretësire të injektueshme.
- B) Në formë shurupesh.
- C) Në formë supostesh.
- D) Në formë tabletash gastrorezistente.

9. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ushtron efekt më të mirë në mjekimin e edemave periferike që shkaktohen nga pamjaftueshmëria e punës së zemrës:

- A) Bulbus Scillae
- B) Radix Helleboris
- C) Herba Adonidis
- D) Folium Digitalis lanatae

10. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi cimarinën është e saktë:

- A) Ndodhet tek S. Strophanthi si heterozid dytësor.
- B) Ndodhet tek S. Strophanthi si heterozid tretësor.
- C) Ndodhet tek H. Convallariae si heterozid dytësor.
- D) Ndodhet tek H. Convallariae si heterozid tretësor.

11. Cila nga drogat e mëposhtme me glikozide kardiake përdoret dhe si anestetik lokal:

- A) Bulbus Scillae
- B) Radix Helleboris
- C) Folium Oleandro
- D) Herba Adonidis

12. Cila nga drogat e mëposhtme, me glikozide kardiake, mund të përdoret në mjekimin e nefriteve kronike, hidropizi renale, në sajë të veprimit të theksuar diuretik të saj.

- A) Semen Strophanthi
- B) Radix Helleborus
- C) Folium Digitalis ferruginea
- D) Bulbus Scillae

13. Efekti diuretik i drogave me glikozide kardiake i dedikohet veprimit sinergjistik midis grup përbërësve:

- A) Steroleve dhe fenoleve
- B) Steroleve dhe sheqernave
- C) Saponanive dhe lipideve
- D) Saponinave dhe flavonoideve

14. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi vetitë fiziko-kimike të glikozideve kardiotonike nuk është e saktë:

- A) Glikozidet kardiotonike janë lëndë kristalore të tretshme në ujë
- B) Glikozidet kardiotonike janë lëndë kristalore të tretshme në etanol.

- C) Tretshmëria e tyre në ujë rritet krahas me shkurtimin e zinxhirit glucidik.
- D) Tretshmëria e tyre në ujë bie krahas me shkurtimin e zinxhirit glucidik.

15. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi sasinë e tipit të heterozideve kardiotonike që ndodhen në drogat me glikozide kardiake është e saktë:

- A) Në drogë ndodhen më shumë heterozide dytësore.
- B) Në drogë ndodhen më shumë heterozide parësore.
- C) Në drogë ndodhen më shumë heterozide tretësore.
- D) Në drogë ndodhen më shumë aglukone të lira.

16. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është i pranishëm në drogën Folium D. purpurea tharë), si heterozid i qëndrueshëm.

- A) Purpureaglikozidi B
- B) Digitoksina
- C) Acetildigitanina
- D) Glukodigoksigenina

17. Cila nga drogat e mëposhtme përdoret për përfitim të digoksinës:

- A) Digitalis ferruginea
- B) Digitalis purpurea
- C) Digitalis lanata
- D) Digitalis lutea

18. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ka veprim kardiotonik dhe diuretik më të theksuar se drogat e tjera kardiotonike.

- A) Semen Strophanthi
- B) Herba Convallariae
- C) Folium Oleandri
- D) Radix Helleboris

19. Për cilën nga drogat bimore të mëposhtme, me glikozide kardiake, duhet të tregohet kujdes gjatë përpunimit pasi acaron mukozën e hundës:

- A) Folium Oleandri
- B) Herba Convallariae
- C) Radix Helleboris
- D) Herba Adonidis

20. Cili nga heterozidet e mëposhtme kardiotonikë, të pranishëm në D. lanata, grumbullohet më shumë në organizëm gjatë përdorimit të drogës:

- A) Digoksina
- B) Digitonina
- C) Digitoksina
- D) Acetildigitoksina

21. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi rolin e grupit acetyl në tretshmërinë e glikozideve kardiake, të pranishëm në Digitalis lanatae, është e saktë:

- A) Ky grup ul tretshmërinë e heterozidit duke penguar në këtë mënyrë përthithjen e tij.
- B) Ky grup rrit tretshmërinë e heterozidit duke ndikuar në këtë mënyrë në përthithjen e tij.
- C) Ky grup nuk ndikon në tretshmërinë e heterozidit.
- D) Nuk dihet akoma nëse ky grup ndikon në tretshmërinë e heterozidit.

22. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi shndërrimin e lanatocidit A në purpureaglikozid A është e saktë:

- A) Njëpërmjet hidrolizës enzimatike
- B) Njëpërmjet hidrolizës në mjedis acid
- C) Njëpërmjet hidrolizës në mjedis bazik
- D) Njëpërmjet hidrolizës në pH neutral.

23. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë:

- A) Digoksina kur merret nga goja shfaq efektin pas 2 orësh dhe arrin kufirin më të lartë të veprimit pas 8 orësh.
- B) Digoksina kur merret nga goja shfaq efektin pas 2 orësh dhe arrin kufirin më të lartë të veprimit pas 6 orësh.
- C) Digoksina kur merret nga goja shfaq efektin pas 3 orësh dhe arrin kufirin më të lartë të veprimit pas 6 orësh.
- D) Digoksina kur merret nga goja shfaq efektin pas 3 orësh dhe arrin kufirin më të lartë të veprimit pas 8 orësh.

24. Cila nga drogat e mëposhtme fuqizon veprimin e përgatesave digitalike në sajë të përbërësve flavonoidik të saj:

- A) Folium Helichrysi
- B) Herba Polygoni avicularis
- C) Folium et Fructus Crataegus
- D) Herba Melilotus

25. Cila nga alternativat e mëposhtme, mbi shkakun e rritjes së efekteve toksike të Digoksinës nga marrja e saj e njëkohshme me Radix Glycyrrhizae, është e sakta:

- A) Shtohet eliminimi i natriumit.
- B) Shtohet eliminimi i hekurit.
- C) Shtohet sasia e kalciumit.
- D) Shtohet eliminimi i kaliumit.

26. Cili nga sheqernat e mëposhtëm nuk është i pranishëm në glikozidet kardiake:

- A) Cimarozë
- B) Apiozë
- C) Fukoza
- D) Digitoksoza

27. Cila nga alternativat e mëposhtme është e sakta në përcaktimin se kur një drogë bimore konsiderohet si drogë me cilësi siguri dhe efikasitet të garantuar (Drogë officinale):

- A) Kur plotëson njëkohësisht si kërkesat e përgjithshme të farmakopesë edhe kërkesat në monografinë farmakopeale korresponduese.
- B) Kur plotëson kërkesat e përgjithshme të farmakopesë.
- C) Kur plotëson kërkesat në monografinë farmakopeale korresponduese.
- D) Kur plotëson kërkesat e Standardit shtetëror.

28. Cili nga përbërësit e mëposhtëm ndodhet tek Opiumi.

- A) Kelidonina
- B) Narceinë
- C) Heroinë
- D) Hipericinë

29. Cila ndër alternativat e mëposhtme është përkufizimi i saktë për Opiumin:

- A) Opiumi është lëngu qumështor i tharë i nxjerrë nga prerja e kapsulave të papjekura të Papaver somniferum.
- B) Opiumi është lëngu qumështor i tharë i nxjerrë nga prerja e gjetheve të Papaver somniferum.
- C) Opiumi është ekstrakti uJOR i tharë i nxjerrë nga kapsulat e Papaver somniferum.
- D) Opiumi është lëngu qumështor i tharë i nxjerrë nga prerja e kercellit të Papaver somniferum.

30. Përmbajtja e morfinës në Opium është:

- A) Ndërmjet 0.5 dhe 1%
- B) Ndërmjet 1 dhe 5%.
- C) Ndërmjet 5 dhe 10%.
- D) Ndërmjet 10 dhe 15%

31. Cila prej alternativave të mëposhtme është Kodeina?

- A) Monometileteri i morfinës
- B) Acetilderivat i morfinës
- C) Dietil eteri i morfinës
- D) Dimetil eter i morfinës

32. Morfina ndryshon nga alkaloidet rrjedhës të saj pasi zotëron një prej cilësive të mëposhtme:

- A) Morfina ka një unazë piperidinike
- B) Morfina ka dy grupe metoksi
- C) Morfina ka grup hidroksilik fenolik që të tjerët nuk e kanë.
- D) Morfina nuk ka grup hidroksilik fenolik që të tjerët e kanë.

33. Cili nga llojet tipet e alkaloidëve të mëposhtme nuk ndodhet tek Opiumi:

- A) Benzilizokinolinës
- B) Ftalidizokinolinës
- C) Morfinanit
- D) Benzofenantridinës

34. Cili nga alkaloidet e mëposhtme nuk ndodhet tek Opiumi:

- A) Protopina
- B) Kelidonina
- C) Tebaina
- D) Laudanina

35. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimin e Opiumit është e saktë:

- A) Nxitës i SNQ.
- B) Qetësues i dhimbjeve.
- C) Laksativ
- D) Rrit presionin arterial.

36. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt hipnotik:

- A) Flores Lupuli
- B) Flores Verbasci
- C) Flores Cyani
- D) Flores Tagetes

37. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme bën pjesë në fitopreparatet me efekt hipnotik
- Polygonum hydropiperis
 - Passiflora incarnata
 - Ononis spinosa
 - Oenothera biennis
38. Mekanizmi i veprimit të valerianës lidhet me aktivitetin e saj si:
- Adrenalin-mimetike
 - GABA-mimetike
 - Estrogjenike
 - Antispazmodike
39. Efekti hipnotik dhe sedativ i valerianës i dedikohet veprimit sinergjistik midis përbërësve kimik të saj, të paraqitur në cilën prej alternativave të mëposhtme?
- Acidit valerenik dhe valopotriateve.
 - Acidit valerenik dhe valerianinës.
 - Valerinës dhe valerenalit.
 - Valerianolit dhe valopotriateve.
40. Gjatë përdorimit të valerianës nuk duhet që të merren:
- Pije të gazuara
 - Pije me sheqerna
 - Pije veshtullore
 - Pije alkoolike
41. Ndaj cilit prej përbërësve kimik të mëposhtëm standardizohen ekstraktet e Valerianës:
- Acidit valerenik
 - Acidit gama-aminobutirik
 - Valerianinës
 - Valerinës
42. Cili nga përbërësit e mëposhtëm të Radix Valerianae bën pjesë në grupin e esencave:
- Valerinë
 - Izovaltrat
 - Valerianol
 - Arginë
43. Cila nga alternativat e mëposhtme, përbërës kimik të R. Valerianae, nuk bën pjesë në grupin e valopotriateve.
- Valtrat
 - Valeranal
 - Izovaltrat
 - Dihidrovaltrat
44. Cila nga organet bimore të mëposhtme të Lupulinum-it nuk përdoret si drogë mjekësore:
- Pluhuri
 - Lulet femerore
 - Gjethet
 - Frutesat si boçe

45. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm nuk luan rol në aktivitetin sedativ dhe hipnotik të ekstrakteve të lupulinum-it :
- A) alfa-acidi humulon
 - B) Acidi klorogjenik
 - C) Acidi 2-metil 3-buten-ol
 - D) beta-acidi kolupulon
46. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi veprimet farmakologjike të Flores Lupuli nuk është e saktë:
- A) Amaro tonik
 - B) Antimykotik
 - C) Sedativ
 - D) Koleretik
47. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi ruajtjen e drogës Lupulinum është e saktë:
- A) Ruhet deri gjashtë muaj nga koha e mbledhjes
 - B) Ruhet deri një vit nga koha e mbledhjes
 - C) Ruhet deri dy vjet nga koha e mbledhjes
 - D) Ruhet deri 5 vjet nga koha e mbledhjes.
48. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm është i pranishëm në esencën e Herba Melissa:
- A) Geranial
 - B) Azulen
 - C) Karvakrol
 - D) Tujon
49. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi veprimet farmakologjike të H. Melissa nuk është e saktë:
- A) Spazmolitik
 - B) Antimykotik
 - C) Karminativ
 - D) Diaforetik
50. Në cilin grup kimik bën pjesë citronelal-i përbërës i H. Melissa:
- A) Në komponimet terpenike të oksigjenuara
 - B) Në hidrokarburet monoterpenike
 - C) Në hidrokarburet diterpenike
 - D) Në derivatet fenilpropanike
51. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi standardizimin e Herba Melissa është e saktë:
- A) Standardizohet ndaj kuercetinës në sasi 4%.
 - B) Standardizohet ndaj kuercetinës në sasi 2%.
 - C) Standardizohet ndaj përmbajtjes së ac. rozmarinik në sasi 4%.
 - D) Standardizohet ndaj përmbajtjes së ac. rozmarinik në sasi 2%.
52. Në cilin nga grupet kimike të mëposhtme bëjnë pjesë Skaftozidet përbërës tek Herba Passiflorae:
- A) Flavonoidet
 - B) Fenolet
 - C) Kumarinat

D) Saponinat

53. Në cilin nga tipet e alkaloidëve të mëposhtme bën pjesë harmani përbërës tek *H. Passiflorae*:

- A) Tipi i ftalidizokinolinës
- B) Tipi i emetinës
- C) Tipi i beta-karbolinës
- D) Tipi i indolilalkilaminës

54. Është i saktë pohimi: "Efekti hipnotik dhe sedativ i *H. Passiflorae* i dedikohet veprimit sinergjistik midis:

- A) Fenoleve dhe alkaloidëve.
- B) Flavonoideve dhe alkaloidëve.
- C) Kumarinave dhe flavonoideve.
- D) Saponinave dhe alkaloidëve.

55. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi standardizimin e *H. Passiflorae* është i saktë:

- A) Standardizohen ndaj sasisë së saponinave
- B) Standardizohen ndaj sasisë së alkaloidëve
- C) Standardizohen ndaj sasisë së flavonoideve
- D) Standardizohen ndaj sasisë së esencave.

56. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm ndodhet tek *Piper methysticum*:

- A) Dioscina
- B) Ergina
- C) Kuercetina
- D) Kavaina

57. Cili nga organet bimore të mëposhtme të *Piper methysticum* përdoret për përftimin e drogës:

- A) Rrënjët e bimës.
- B) Gjethet e bimës.
- C) Lulet e bimës.
- D) E gjithë pjesa mbitokësore e bimës.

58. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi mekanizmin e veprimit të *P. methysticum*, sipas studimeve eksperimentale të fundit, është e saktë:

- A) Kavalaktonet inhibojnë aktivitetin e receptorëve GABAA.
- B) Kavalaktonet forcojnë aktivitetin e receptorëve GABAA.
- C) Metisticinat inhibojnë aktivitetin e receptorëve GABAA.
- D) Metisticinat forcojnë aktivitetin e receptorëve GABAA.

59. Përbërësit me efekt hipnotik dhe sedativ tek *Flores Lupuli* i përkasin grupit kimik të:

- A) Esencave
- B) Flavonoideve
- C) Floroglucinave
- D) Tanineve

60. Dozat ditore të *Herba Melissa* në formë çaji, me efekt sedative të SNQ, janë:

- A) 2-4 gr 3 herë në ditë.
- B) 3-5 gr 3 herë në ditë.
- C) 2-4 gr 4 herë në ditë.

D) 3-5 gr 4 herë në ditë.

61. Efektet sedative dhe hipnotike të bar bletës fuqizohen nga kombinimi i saj me droga sedative të tjera si:

- A) Valerianë dhe Hypericum.
- B) Valerianë dhe Lupulin.
- C) Valerianë dhe Kava-Kava.
- D) Valerianë dhe Stramon.

62. Cili nga efektet anësore të mëposhtëm mund të shkaktohet nga përdorimi për kohë të gjatë dhe në doza të larta i ekstrakteve të Piper methysticum:

- A) Dëmtime të mëlçisë
- B) Dëmtime të veshkave
- C) Çrregullime gastrointestinale
- D) Marrje mendsh

63. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ka efekt sedativ të SNQ:

- A) Rhizoma Hydrastidis
- B) Radix Valeriana
- C) Radix Althaea
- D) Radix Belladonna

64. Sipas studimeve të kohëve të fundit, bartës i efektit antidepressiv të Herba Hyperici është:

- A) Pseudohipericina
- B) Hipericina
- C) Hiperina
- D) Hiperforina

65. Ekstraktet e Herba Hyperici standardizohen ndaj përmbajtjes së:

- A) Hiperforinës
- B) Hipericinës
- C) Kuercetinës
- D) Kemferolit

66. Në grupin kimik të cilës prej alternativave të mëposhtme bën pjesë hipericina, përbërës kryesor i Herba Hypericit:

- A) Flavoneve
- B) Kalkoneve
- C) Diantroneve
- D) Antranoleve

67. Në grupin kimik të cilës prej alternativave të mëposhtme bën pjesë hiperforina, si një nga përbërësit e rëndësishëm të Herba Hyperici:

- A) Fenoleve
- B) Flavoneve
- C) Floroglucinoleve
- D) Furanokromoneve

68. Fitopreparatet me ekstrakt të lulebasanit nuk duhet të merren njëkohësisht për shkak të ndërveprimit me:

- A) Ampicilinë
- B) Paracetamol
- C) Digoksinë
- D) Teofilinë

69. Marrja e njëkohshme e ekstraktit të lulebasanit dhe Ciklosporinës sjell:

- A) Ulje të biodisponibilitetit të ciklosporinës
- B) Ulje të biodisponibilitetit të ekstraktit të lulebasanit
- C) Shpejtim të përthithjes së ciklosporinës
- D) Shpejtim të përthithjes së ekstraktit të lulebasanit.

70. Cili nga efektet anësore të mëposhtme mund të shfaqet, me marrjen për kohë të gjatë, të ekstrakteve të lulebasanit në doza të larta:

- A) Dhimbje koke
- B) Dhimbje muskulare
- C) Çrregullime të të parit
- D) Çrregullime gastrointestinal

71. Cila nga alternativat e mëposhtme i përket llojit të çajit që përftohet nëpërmjet procesit të fermentimit të *Camellia sinensis*:

- A) Çaji i gjelbër
- B) Çaji i briketuar.
- C) Çaji i zi
- D) Çaji lule

72. Kafeina në drogën *Semen Coffae* ndodhet kryesisht e lidhur me:

- A) Acid shikimik
- B) Acid klorogjenik
- C) Flavonoide
- D) Tanine

73. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm të *Semen Coffae* shkakton acarim të mukozës së stomakut:

- A) Acidi kinik
- B) Acidi kafeik
- C) Kafeoli
- D) Kafeoni

74. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është alkaloid që rrjedh nga ornitina dhe lizina.

- A) Beladonina
- B) Kinolizina
- C) Kuinina
- D) Striknina

75. Cila nga drogat bimore të mëposhtme këshillohet të përdoret si ndihmëse, në ngacmimet motorike që shfaqen në disa forma sëmundjesh:

- A) *Folium Cocae*
- B) *Folium Hederae*
- C) *Folium Hyosciami*
- D) *Folium Serpylli*

76. Cila nga drogat e mëposhtme ka përmbajtjen më të lartë të skopolaminës:

- A) Folium Cocae
- B) Folium Hyosciami
- C) Folium Stramoni
- D) Folium Verbenae

77. Cili nga pohimet është i saktë: "Beladonina formohet nga dimerizimi i"

- A) Hiosciaminës
- B) Apoatropinës
- C) Kokainës
- D) Hioscinës

78. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt ekspektorant:

- A) Radix Ratanhiae
- B) Rhizoma Primulae
- C) Fructus Cynosbati
- D) Fructus Anisi

79. Cila nga drogat e mëposhtme me prejardhje nga deti ka efekt ekspektorant:

- A) Agar-agar
- B) Carrageen
- C) Stipites Laminariae
- D) Oleum Jecori

80. Cila nga drogat e mëposhtme, në sajë të vetive të saj bekike, hyn në çajrat pektoral:

- A) Folium Malvae
- B) Folium Hyosciami
- C) Fructus Anisi
- D) Fructus Cynosbati

81. Cilët nga përbërësit kimik të mëposhtëm janë bartës të efekteve të dëmshme, që mund të shfaqen, gjatë përdorimit të Tussilago farfarae:

- A) Alkaloidet izokinolinike
- B) Alkaloidet pirolizidinike
- C) Flavaspidina
- D) Albaspidina

82. Malva sylvestris, sipas përbërësve kimik të saj, bën pjesë në drogat me:

- A) Flavonoide
- B) Fenole
- C) Saponina
- D) Mucilagje

83. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet e farave të gjethedellit është e gabuar:

- A) Si mjet diuretik
- B) Si qetësues i kollës
- C) Si mjet antiflogjistik
- D) Si mjet stomakik

84. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm nuk ndodhet në Folium Plantagini:

- A) Taninet
- B) Derivate iridoidik
- C) Esenca
- D) Saponina

85. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi disa veti të aukubinës, përbërëse në specie të gjinisë Plantagis, nuk është e saktë:

- A) Heterozidi aukubinë është monoterpen i grupit të iridoideve.
- B) Heterozidi aukubinë është lëndë vepruese në mjekimin e kollës.
- C) Heterozidi aukubinë është lëndë e paqëndrueshme.
- D) Heterozidi aukubinë është lëndë vepruese në mjekimin e abceseve.

86. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përkufizimin e mucilagjeve është e saktë:

- A) Mucilagjet janë polisakaride johomogjene, të cilat formohen në bimë nga shndërrimi i membranave të qelizave me rrugë normale.
- B) Mucilagjet janë polisakaride johomogjene, të cilat formohen në bimë nga shndërrimi i membranave të qelizave me ndërhyrje nga jashtë.
- C) Mucilagjet janë polisakaride homogjene, të cilat formohen në bimë nga shndërrimi i membranave të qelizave me rrugë normale.
- D) Mucilagjet janë polisakaride homogjene, të cilat formohen në bimë nga shndërrimi i membranave të qelizave me ndërhyrje nga jashtë.

87. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm ndodhet tek herba Viola tricoloris e përdorur si ekspektorante:

- A) Vinkristina
- B) Viteksina
- C) Vinkamina
- D) Violutozidi

88. Cili nga veprimet terapeutike të Herba Asperulae nuk është i saktë:

- A) Diuretik
- B) Ekspektorant
- C) Koleretik
- D) Sedativ

89. Flores Tiliae ka efekt më të fuqishëm ekspektorant nëse:

- A) Përdoret si drogë më vete.
- B) Përdoret e përzier me Flores Malvae.
- C) Përdoret e përzier me Flores Sambuci.
- D) Përdoret e përzier me Flores Helichrysi.

90. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi grupimin kimik ku bën pjesë Flores Tiliae është e saktë:

- A) Në drogat me fenole.
- B) Në drogat me kumarina.
- C) Në drogat me iridoide.
- D) Në drogat me flavonoide.

91. Cila nga alternativat e mëposhtme, mbi mekanizmin e veprimit ekspektorant të saponinave, nuk është e saktë:

- A) Saponinat e marra nga goja ngacmojnë disa mbaresa nervore të vagusit në mukozën e stomakut dhe në mënyrë reflektore nxisin ekspektorimin.
- B) Saponinat veprojnë në receptorët M kolinergjikë të cilat ngacmojnë qendrat bulbare që rregullojnë sekrecionin e bronkeve.
- C) Një pjesë e madhe e saponinave përthithen në rrugën digjестive dhe arrijnë nivelin e mukozës së bronkeve ku nxisin drejtpërsëdrejti sekrecionin.
- D) Një sasi shumë e pakët, gjurmë saponinash, përthithen në rrugën digjестive dhe arrijnë nivelin e mukozës së bronkeve ku nxisin drejtpërsëdrejti sekrecionin.

92. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet terapeutike të Radix Liquiritiae është e gabuar:

- A) Ekspektorante
- B) Antiulçeroze
- C) Laksative
- D) Diuretike

93. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përbërësit kimik me efekt ekspektorant, në Radix Liquiritiae, është e saktë:

- A) Veprimi ekspektorant i drogës i kushtohet kryesisht pranisë së glicirizinës dhe primulageninës.
- B) Veprimi ekspektorant i drogës i kushtohet kryesisht pranisë së glicirizinës dhe gliciretinës.
- C) Veprimi ekspektorant i drogës i kushtohet kryesisht pranisë së acidit bosvelik dhe gliciretinës.
- D) Veprimi ekspektorant i drogës i kushtohet kryesisht pranisë së acidit bosvelik dhe primulageninës.

94. Në çfarë lloj përgatesash galenike përdoret më së shumti Radix Liquiritiae:

- A) Në formë infuzi.
- B) Në formë dekokti.
- C) Në formë ekstrakti të thatë.
- D) Në formë tinkture.

95. Cila nga alternativat e mëposhtme duhet pasur parasysh gjatë përdorimit të Radix Glycyrrhizae:

- A) Shkakton dhimbje koke.
- B) Shkakton të vjella.
- C) Ka veprim të ngjashëm me glikozidet kardiake.
- D) Ka veprim të ngjashëm me lëndët kortizonike.

96. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm nuk ndodhet në Radix Glycyrrhizae:

- A) Liquiritigenina
- B) Estradioli
- C) Escina
- D) Acidi gliciretik

97. Cila nga saponinat e mëposhtme ndodhet në sasi më të lartë në Radix Primula officinalis:

- A) Acidi elatiorik
- B) Acidi oleanolik
- C) Acidi primulik
- D) Acidi kuinalik

98. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përbërësit kimik, në të cilët zërthehet pas hidrolizës acidi elatiorik, është e sakta:

- A) Në primulageninë A dhe 4 molekula sheqeri.
- B) Në primulageninë A dhe 2 molekula sheqeri.
- C) Në primulageninë C dhe 4 molekula sheqeri.
- D) Në primulageninë C dhe 2 molekula sheqeri.

99. Në cilin grupim kimik të drogave bën pjesë rrënja e aguliçes:

- A) Në drogat me flavonoide.
- B) Në drogat me fenole.
- C) Në drogat me saponina.
- D) Në drogat me sterole.

100. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi veprimin ekspektorant të Flores Verbasci-t është e saktë:

- A) Vepron më mirë kur përdoret si drogë më vete.
- B) Vepron më mirë kur përdoret e kombinuar me Folium Althaea.
- C) Vepron më mirë kur përdoret e kombinuar me Herba Leonuri.
- D) Vepron më mirë kur përdoret e kombinuar me Herba Convallariae.

101. Cili nga aglukonet e mëposhtme ndodhet në Hederakozidin B:

- A) Acidi bosvelik
- B) Acidi kuinalik
- C) Acidi oleanolik
- D) Amirinë

102. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet e Folium Hederae nuk është e saktë:

- A) Ekspektorante
- B) Antiedematoze
- C) Spazmolitike
- D) Antiseptike

103. Në cilin grup kimik bën pjesë verbenina me efekt ekspektorant:

- A) Saponinat
- B) Iridoidet
- C) Esencat
- D) Fenolet

104. Cila nga drogat e mëposhtme me alkaloidet hyn në speciet ekspektorante:

- A) Herba Chelidoni
- B) Fructus Capsici
- C) Rhizoma Hydrastidis
- D) Flos Rhoeados

105. Cili nga alkaloidet e mëposhtëm izokinolinik ka efekt ekspektorant.

- A) Roeadina
- B) Kelidonina
- C) Sanguinarina
- D) Boldina

106. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi dozat e përdorimit të Radix Ipecacuanhae nuk është e saktë:

- A) Doza ditore terapeutike e ipekës është 0.15 gr.
- B) Doza maksimale terapeutike, e njëhershme, e ipekës nga goja është 2 gr.
- C) Doza maksimale terapeutike, e njëhershme, e ipekës nga goja është 4 gr.
- D) Doza terapeutike, e njëhershme, e marrë nga goja është 0.05 gr

107. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi patologjitë që mund të shkaktohen gjatë pluhurizimit të rrënjës së ipekës është e gabuar:

- A) Konjuktivit
- B) Bronkit
- C) Krizë astme
- D) Të vjella

108. Në cilin nëngrup kimik të alkaloidëve bën pjesë cefelina:

- A) Në alkaloidet izokinolinike
- B) Në alkaloidet indolike
- C) Në alkaloidet steroidike
- D) Në protoalkaloidet

109. Në cilin lloj çajrash, sipas efektit terapeutik, bëjnë pjesë përzierjet e drogave bimore: Folium Farfarae, Radix Altheae, Herba Serpylli:

- A) Në çajrat antiflogjistike.
- B) Në çajrat diaforetike.
- C) Në çajrat koleretike
- D) Në çajrat ekspektorante.

110. Cila nga esencat e mëposhtme ka efekt ekspektorant:

- A) Aetheroleum Juniperis
- B) Aetheroleum Terebenthinae
- C) Aetheroleum Lavandulae
- D) Aetheroleum Rosae

111. Cila nga alternativat e mëposhtme, në lidhje me mekanizmin e veprimit si ekspektorante të esencave, është e saktë:

- A) Veprimi irritues i lehtë i tyre në gjendrat bronkiale.
- B) Veprimi antiseptik i përgjithshëm i tyre.
- C) Veprimi spazmolitik në bronke.
- D) Veprimi antimikotik i tyre.

112. Cila nga drogat e mëposhtme me aldehide terpenike ka efekt ekspektorant:

- A) Herba Melissa
- B) Rhizoma Iridids
- C) Camphorae
- D) Fructus Anethi

113. Cila nga drogat e mëposhtme hyn në çajrat antiastmatike:

- A) Folium Menthae
- B) Folium Melissa
- C) Flores Cyani
- D) Folium Salviae

114. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet e Folium Eucalypti-t nuk është e saktë:

- A) Në sajë të esencës droga ka veprim ekspektorant.
- B) Në sajë të tanineve, droga ka veprim antidiarrok.
- C) Në sajë të lëndëve të hidhura përdoret si tonik i hidhur.
- D) Në sajë të lëndëve të hidhura përdoret si koleretik.

115. Esenca e Eucalyptit nuk përdoret në mjekimin e cilës prej patologjive të mëposhtme:

- A) Konjuktivit
- B) Bronkit
- C) Rinit
- D) Faringit:

116. Në cilin grup të drogave, sipas klasifikimit kimik, bën pjesë Folium et Aetheroleum Eucalypti:

- A) Në drogat me esenca me fenole terpenike.
- B) Në drogat me esenca me alkoole terpenike.
- C) Në drogat me tanine.
- D) Në drogat me esenca me okside terpenike.

117. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm ndodhet me shumicë tek Aetheroleum Eucalypti:

- A) Tujoni
- B) Timoli
- C) Cineoli
- D) Linalooli

118. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet terapeutike të Herba Serpyllit nuk është e saktë:

- A) Ekspektorant
- B) Karminativ
- C) Spazmolitik
- D) Diaforetik

119. Në cilin nga grupet kimike të mëposhtme bën pjesë bari i Zhumbricës (apo listrës):

- A) Fenole një valente.
- B) Esenca me fenole terpenike.
- C) Esenca me derivate të izoalilbenzenit.
- D) Derivate fenilpropanike.

120. Ila nga drogat barëra të mëposhtme bën pjesë në shurupet ekspektorantë:

- A) Herba Satureja
- B) Herba Thymi
- C) Herba Mentha
- D) Herba Leonuri

121. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm ndodhet në sasi të lartë tek Aetheroleum Serpylli:

- A) Timoli
- B) Askaridoli
- C) Azuleni
- D) alfa-pineni

122. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm nuk ndodhet në Aetheroleum Thymi:

- A) Linalooli
- B) Karvakroli
- C) Cineoli
- D) Tujoni

123. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi veprimet e Herba Thymit është e pasaktë:

- A) Droga ka efekt karminativ në sajë të acideve kafeik dhe klorogjenik.
- B) Droga ka efekt karminativ në sajë të esencës që përmban.
- C) Droga ka efekt diuretik në sajë të acideve kafeik dhe klorogjenik.
- D) Droga ka efekt antiseptik në sajë të esencave.

124. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi veprimin antiparazitar të timolit është e saktë:

- A) Timoli ka veprim antihelmintik dhe përdoret kundër parazitit Ankilostoma duodenale.
- B) Timoli nuk ka veprim antihelmintik dhe nuk përdoret kundër parazitit Ankilostoma duodenale.
- C) Timoli ka veprim antihelmintik por nuk përdoret kundër parazitit Ankilostoma duodenale.
- D) Timoli ka përdorim shumë të kufizuar ndaj parazitit Ankilostoma duodenale pasi dozat vepruese janë të barabarta me ato helmuese.

125. Cila nga drogat bimore të mëposhtme nuk përdoret, në formë gargare, në shpëlarje të gojës:

- A) Herba Origani
- B) Folium Rosmarinae
- C) Folium Salviae
- D) Flores Chamomillae

126. Cila nga drogat e mëposhtme bën pjesë në drogat me esenca fenolike:

- A) Herba Satureja
- B) Herba Absinthi
- C) Herba Meliloti
- D) Herba Millefoli

127. Cila nga drogat e mëposhtme bën pjesë në preparatin Tusipektol:

- A) Balsam i Perusë
- B) Balsam i Tolusë
- C) Resina Mastix
- D) Resina Colophoni

128. Cila nga drogat e mëposhtme me esenca bën pjesë në specie ekspektorante:

- A) Fructus Foeniculi
- B) Fructus Apii
- C) Flores Arnicae
- D) Fructus Anisi

129. Në cilin grup të drogave, sipas klasifikimit kimik të tyre, bën pjesë fruti i Anasonit:

- A) Në esencat me aldehide terpenike
- B) Në esencat me alkoole terpenike
- C) Në esencat me rrjedhës të izoalilbenzolit
- D) Në esencat me rrjedhës të alilbenzenit

130. Në cilin grup të drogave, sipas klasifikimit kimik të tyre, bën pjesë Herba Drosera:

- A) Me floroglucina të thjeshta.
- B) Me izoflavone dhe kalkone.
- C) Në fitoncidet me derivate të sulfuruara.
- D) Në fitoncidet me derivate të benzonaftokinonit.

131. Efekti ekspektorant i Radix Ipecacuanhae i dedikohet pranisë në drogë të:

- A) Saponinave triterpenike
- B) Alkaloideve indolike
- C) Esencave seskuiterpenike
- D) Derivate floroglucinike

132. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt qetësues së kollës së thatë:

- A) Folium Salviae
- B) Folium Hederæ
- C) Herba Asperulae
- D) Herba Equiseti

133. Cila nga drogat barëra të mëposhtme ka efekt ekspektorant:

- A) Herba Serpylli
- B) Herba Menthae
- C) Herba Melissa
- D) Herba Leonuri

134. Fructus Cupressi, me veti qetësuese në kollën spazmotike, bën pjesë në grupin kimik të:

- A) Esencave me përbërës hidrokarbure monoterpene
- B) Esencave me përbërës terpene të oksigjenuara
- C) Esencave me përbërës hidrokarbure seskuiterpenike
- D) Esencave me përbërës terpene aciklike.

135. Efekti ekspektorant i Radix Liquiritiae i dedikohet pranisë në drogë të:

- A) Escinës
- B) Glicirizinës
- C) Gipsogeninës
- D) Hederageninës

136. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme hyn në përbërjen e specieve ekspektorante.

- A) Althea officinalis
- B) Cynaria scolymus
- C) Foeniculum vulgare
- D) Hyosciamus niger

137. Plantago major, me veti qetësuese të kollës, bën pjesë në drogat me:

- A) Flavonoide
- B) Fenole
- C) Mucilagje
- D) Esenca

138. Alkaloidet e Ipecacuanhae-s kanë efekt:

- A) Qetësues të dhimbjeve

- B) Sedativ të SNQ
- C) Ekspektorant
- D) Antipiretik

139. Si mund të përgatitet një ekstrakt me mucilagje nga Farat e Lirit?

- A) Farave të Lirit të shtypura u shtohet përzierje hidroalkoolike dhe ngrohen.
- B) Farat mbulohen dhe lihen me ujë pa i shtypur dhe pa i ngrohur.
- C) Farave të Lirit të shtypura u shtohet alkool dhe ngrohen.
- D) Farave të Lirit u shtohet alkool pa i shtypur.

140. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt laksativ

- A) Fructus Senna
- B) Herba Hyperici
- C) Radix Urticae
- D) Herba Equiseti

141. Cila nga drogat e mëposhtme përmban antrakinone:

- A) Folium Betulae
- B) Folium Rubi idaea
- C) Rhizoma Rhei
- D) Herba Hernariae

142. Përbërësi kryesor tek Cortex Cascarae është:

- A) Purpurina
- B) Alizarina
- C) Diosmetina
- D) Barbaloina

143. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë: "Ekstrakti i thatë i Senës standartizohet ndaj sasisë së"

- A) Senozideve B nga 5.5- 8%.
- B) Senozideve B nga 3.5-5%.
- C) Senozideve C nga 5.5-8%
- D) Senozideve C nga 3.5-5%

144. Cila nga bimët mjekësore që shërbejnë si burim biologjik të Senës kanë sasi më të lartë të antrakinoneve:

- A) Cassia acutifolia
- B) Cassia angustifolia
- C) Cassia anisifolia
- D) Cassia obovata

145. Lëndët e padëshirueshme në Folium Sennae që shkaktojnë efekte anësore janë:

- A) Senozidet D
- B) Senanigrinat
- C) Senapikrinat
- D) Senareinat

146. Cila nga dozat terapeutike të Fol. Sennae nuk shkaktojnë irritime në zorrë:

- A) 2 deri 3 gram

- B) 3 deri 4 gram
- C) 1 deri 2 gram
- D) 2 deri 4 gram

147. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë: "Veprimi i Cortex Frangulae shfaqet" :

- A) 5 orë pas marrjes së dekoktit të drogës.
- B) 5 orë pas marrjes së infuzit të drogës.
- C) 10 orë pas marrjes së dekoktit të drogës.
- D) 10 orë pas marrjes së infuzit të drogës.

148. Cili nga heterozidet e mëposhtme është përbërës i qëndrueshëm në drogën C. Frangulae

- A) Frangulinat
- B) Glukofrangulinat
- C) Frangulemodinat
- D) Aloemodinat

149. Cili nga aglukonet e mëposhtme është përbërësi kryesor i heterozideve në Folium Sennae.

- A) Krizofanol
- B) Reinë
- C) Fishion
- D) Emodina

150. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi grupimin kimik ku bëjnë pjesë drogat laksative stimuluese është e saktë:

- A) Në drogat me vajra yndyrore
- B) Në drogat me antrakinone
- C) Në drogat me oligosakaride
- D) Në drogat me polisakaride

151. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ka efekt purgativ

- A) Semen Amygdali
- B) Semen Ricini
- C) Semen Strychni
- D) Semen Sinapis

152. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme bën pjesë në grupin e laksativëve masëformuese

- A) Aloe vera
- B) Amygdalum amara
- C) Linum usitatissimum
- D) Trifolium pretense

153. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi mekanizmin e veprimit të farave të ricinit është e saktë:

- A) Veprimi purgativ i vajit i kushtohet acidit të lirë ricinoleik dhe stereoizomerit të tij të cilët lirohen me hidrolizë në duoden.
- B) Veprimi purgativ i vajit i kushtohet acidit të lirë ricinoleik dhe stereoizomerit të tij të cilët lirohen me hidrolizë në zorrë.
- C) Veprimi purgativ i vajit i kushtohet acidit të lirë stearik dhe stereoizomerit të tij të cilët lirohen me hidrolizë në duoden.
- D) Veprimi purgativ i vajit i kushtohet acidit të lirë stearik dhe stereoizomerit të tij të cilët lirohen me hidrolizë në zorrë.

154. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi dozat dhe kohën e shfaqjes së veprimit purgativ të farave të ricinit është e saktë:

- A) Efekti purgativ shfaqet brenda 2-4 orësh nga koha e marrjes së 5-10 gr vaji
- B) Efekti purgativ shfaqet brenda 4-6 orësh nga koha e marrjes së 5-10 gr vaji.
- C) Efekti purgativ shfaqet brenda 4-6 orësh nga koha e marrjes së 15-30 gr vaji
- D) Efekti purgativ shfaqet brenda 2-4 orësh nga koha e marrjes së 15-30 gr vaji.

155. Cila nga drogat e mëposhtme përdoret si mjet spazmolitik në mahisjet gastrike dhe gjëndje dispeptike:

- A) Flores Arnicae
- B) Flores Chamomillae
- C) Folium Betulae
- D) Folium Urticae

156. Cili nga grupet kimike të mëposhtme është bartës i efekteve spazmolitike të Flores Chamomillae:

- A) Fenolet dhe iridoidet
- B) Flavonoidet dhe tioglikozidet
- C) Flavonoidet dhe kumarinat
- D) Kumarinat dhe floroglucidet.

157. Një nga efektet anësore që vërehen nga përdorimi i tepërt i drogave me efekt laksativ është:

- A) Hiperkalemia
- B) Hipokalemia
- C) Hiponatremia
- D) Hiperkolesterolemia

158. Hipokalemia është më e theksuar nëse drogat laksative merren njëkohësisht me:

- A) Droga me glikozide kardiake
- B) Droga me vajra esenciale
- C) Droga me fitoncide
- D) Droga me iridoide

159. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë: "Drogat me antrakinone nuk këshillohen në periudhën e shtatzanisë pasi....."

- A) Shkaktojnë marrje mendsh.
- B) Shkaktojnë dhëmbje koke.
- C) Shkaktojnë hiperemi në bark.
- D) Shkaktojnë rritje të presionit.

160. Cila nga drogat e mëposhtme bën pjesë në klizmat.

- A) Folium Malvae
- B) Folium Myrtilli
- C) Herba Equiseti
- D) Herba Rutae

161. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt emolient në traktin gastrointestinal:

- A) Folium Hyosciami
- B) Flores Lavandula
- C) Herba Centauri

D) Folium Althaea

162. Cila nga drogat e mëposhtme me flavonoide bën pjesë në specie laksative:

- A) Herba Polygoni avicularis
- B) Herba Leonuri
- C) Flores Helychrisi
- D) Flores Sambuci

163. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi mekanizmat e veprimit të drogave me antrakinone nuk është e saktë:

- A) Ndërpresin përthithjen e ujit ndërmjet mureve të zorrës së trashë
- B) Rrisin peristaltikën e zorrës.
- C) Rrisin funksionin sekretor të mukozës së zorrës.
- D) Rrisin përthithjen e ujit ndërmjet mureve të zorrës së trashë.

164. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme përmban tanine të kondensuara

- A) Hamamelis virginiana
- B) Krameria triandra
- C) Centaurea cyanus
- D) Rubus ulmifolius

165. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme përmban tanine të hidrolizueshme

- A) Vaccinium myrtillus
- B) Hamamelis virginiana
- C) Urtica dioica
- D) Verbena officinalis

166. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ka efekt adstrigjent në sajë të përmbajtjes së lartë të tanineve.

- A) Cortex Ulmi
- B) Cortex Fraxini
- C) Cortex Viburni
- D) Cortex Cinnamomi

167. Është i saktë përkufizimi që: "Tanine apo lëndë taninike quhet..."

- A) Përzierja e fenoleve të azotuara helmuese.
- B) Përzierja e polifenoleve të azotuara jo helmuese.
- C) Përzierja e polifenoleve të paazotuara jo helmuese.
- D) Përzierja e polifenoleve të paazotuara helmuese.

168. Veprimi farmakologjik adstrigjent i drogave me tanine bazohet në vetinë e tyre që:

- A) Të lidhen me proteinat duke formuar komponime të ndjeshme ndaj enzimave proteolitike
- B) Të lidhen me proteinat duke formuar me to komponime rezistente ndaj enzimave proteolitike
- C) Të lidhen me polisakaridet duke formuar komponime të qëndrueshme
- D) Të lidhen me polisakaridet duke formuar komponime të paqëndrueshme.

169. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi mënyrën e përgatitjes së përgatesave me tanine, me qëllim ekstraktimin e plotë të tyre nga drogat dhe shmangien e efekteve të dëmshme të tyre, është e saktë:

- A) Dekoktet e rrënjeve dhe lëvoreve nuk duhet të valojnë më shumë se 5 minuta.

- B) Dekoktet e rrënjeve dhe lëvoreve nuk duhet të valojnë më shumë se 10 minuta.
- C) Dekoktet e rrënjeve dhe lëvoreve nuk duhet të valojnë më shumë se 15 minuta.
- D) Dekoktet e rrënjeve dhe lëvoreve nuk duhet të valojnë më shumë se 20 minuta.

170. Duke u bazuar në qëndrueshmërinë kimike të tanineve, cila nga alternativat e mëposhtme mbi mënyrën e përdorimit të tanineve (për përdorim të brendshëm) nuk është e saktë:

- A) Përdorimi i tanineve të bashkuara me albumin.
- B) Përdorimi i ekstrakteve bimore të disa bimëve me tanine.
- C) Përdorimi i ekstrakteve me droga me tanine katetionike.
- D) Përdorimi i tanineve të lira.

171. Taninet nuk përdoren në mjekimin e djegieve në sipërfaqe të mëdha sepse:

- A) Përthithen dhe dëmtojnë veshkat.
- B) Përthithen dhe dëmtojnë mëlçinë.
- C) Nuk arrijnë të formojnë membranën mbrojtëse proteinotaninore.
- D) Nuk arrijnë të fundërojnë lëndët helmuese që rrjedhin nga proteinat e djegura.

172. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi disa veti fiziko-kimike të tanineve nuk është e saktë:

- A) Treten pak ose aspak në tretësa organik.
- B) Kanë veti që të aglutinojnë eritrocitet.
- C) Ato polimerizohen dhe oksidohen në flobafene.
- D) Me proteinat formojnë komponime që tregohen me lehtësi.

173. Cila nga alternativat e mëposhtme është e sakta mbi mënyrën e përfutimit të acidit tanik:

- A) Përfutet nga ekstraktimi me ujë të ngopur me eter i Gallae Turcicae të fermentuara.
- B) Përfutet nga ekstraktimi me ujë të Gallae Turcicae.
- C) Përfutet nga ekstraktimi me eter të Folium Hamamelidis.
- D) Përfutet nga ekstraktimi me ujë të ngopur me eter të Folium Hamamelidis.

174. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet e acidit tanik nuk është e saktë:

- A) Përdoret si antidiarrok.
- B) Përdoret si antidot në helmimet me alkaloidet.
- C) Përdoret në mjekimin e scabies.
- D) Në mjekimin e dermatozave.

175. Cilat nga drogat e mëposhtme përdoret në mjekimin e dispepsive dhe katereve të zorrëve:

- A) Folium et pericarpium Juglandis.
- B) Flores Rosae
- C) Folium Crataegus
- D) Folium Hamamelidis

176. Cila nga drogat e mëposhtme këshillohet të përdoret si antiseptik intestinal veçanërisht në gastroenteritet tek fëmijët:

- A) Herba Centaurea
- B) Fructus Myrtilli
- C) Fructus Cynosbati
- D) Herba Millefolium

177. Cili nga grupet kimike të mëposhtme nuk ndodhet tek Fructus Myrtilli:

- A) Tanine të kondensuara

- B) Pigmente antocianike
- C) Vitaminë C
- D) Acide yndyrore

178. Cila nga alternativat e mëposhtme, mbi formën farmaceutike me veprim bakteriostatik më të fuqishëm të fruteve të boronicës, është e saktë:

- A) Veprim më të fuqishëm kanë ekstraktet hidroalkoolike.
- B) Veprim më të fuqishëm kanë ekstraktet ujore.
- C) Veprim më të fuqishëm kanë ekstraktet eterike.
- D) Veprim më të fuqishëm ka infuzi i drogës.

179. Përdorimi i ekstrakteve të Boronicës në retinopatitë diabetike i dedikohet përbërësve të drogës që hyjnë në grupin kimik të:

- A) Floroglucinave
- B) Antrakinoneve
- C) Antocianidinave
- D) Esencave

180. Cila nga drogat e mëposhtme ka efekt karminativ

- A) Cortex Frangulae
- B) Folium Menthae
- C) Fructus Silybi mariani
- D) Herba Centauri

181. Në cilin grup kimik hyjnë përbërësit kryesor kimik të Fr. Foeniculi

- A) Esencave me derivate terpenike
- B) Esencave me derivate të izoalilbenzolit
- C) Fenoleve të thjeshta
- D) Furano dhe piranokumarinave

182. Cila nga drogat e mëposhtme këshillohet të përdoret si mjet spazmolitik në mahisjet gastrike, në ngërçe të traktit gastrointestinal, kryesisht tek fëmijët.

- A) Fructus Foeniculi
- B) Fructus Cynosbati
- C) Herba Melissa
- D) Herba Satureja

183. Është i saktë pohimi: " Përdoret në formë të kapsulave me veshje enterike për sindromën e zorrës së irrituar "

- A) Esenca e anasonit
- B) Esenca e dafinës
- C) Esenca e mentës
- D) Esenca e rigonit

184. Cila nga drogat bimore të mëposhtme ka efekt diuretik:

- A) Folium Betulae
- B) Folium Laësoniae
- C) Folium Oleandri
- D) Folium Stramoni

185. Cila nga drogat bimore të mëposhtme është pjesë përbërëse e specieve diuretike dekloruruese.

- A) Herba Helichrysi
- B) Herba Equiseti
- C) Herba Urticae
- D) Herba Melissae

186. Efekti diuretik i disa drogave bimore mjekësore i dedikohet pranisë në to të:

- A) Floroglucinave të përbëra
- B) Saponinave triterpenike
- C) Furano dhe piranokumarinave
- D) Acideve terpenike

187. Efekti diuretik i një droge bimore mjekësore fuqizohet nga prania në të njëkohësisht e përbërësve kimik që i përkasin grupimeve:

- A) Tanine dhe flavonoide
- B) Fenole dhe alkaloidë
- C) Flavonoide dhe saponina
- D) Flavonoide dhe antrakinone

188. Në cilin grup të përbërësve bën pjesë arbutina

- A) Glikozide flavonoike
- B) Glikozide fenolike
- C) Glikozideve furanokumarinike
- D) Glikozideve floriglucinike

189. Cili nga përbërësit kimik bimor të mëposhtëm, me efekt diuretik, bën pjesë në grupin e kumarinave:

- A) Escina
- B) Eskulina
- C) Fraksina
- D) Cinarina

190. Folium Uvae ursi, që të ketë efekt antiseptik në rrugët urinare, duhet të përmbajë derivate hidrokinonike të llogaritura si arbutinë së paku në sasinë:

- A) 6%
- B) 8%
- C) 12%
- D) 10%

191. Cili nga pohimet është plotësisht i saktë "Arbutina ushtron efekt urologjik (bakteriostatik) pas"

- A) Zbërthehet në hidrokinon në prani të enzimës beta-glukozidazë.
- B) Zbërthehet në metilhidrokinon në prani të enzimës beta-glukozidazë.
- C) Eleminohet nëpërmjet veshkave në formën e saj të plotë.
- D) Eleminohet nëpërmjet veshkave si hidrokinon i zbërthyer nga mirozinaza.

192. Gjatë marrjes për një kohë të gjatë të Uvae ursit mund të vërehen të vjella nga prania në të e përbërësve:

- A) Fenolik
- B) Flavonoidik
- C) Taninik

D) Antocianidik

193. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme, me efekt diuretik, irriton indin e veshkës:

- A) Galium odoratum
- B) Juniperis communis
- C) Betula verrucosa
- D) Ononis spinosa

194. Cila nga drogat bimore të mëposhtme, ka përbërës aktive me efekt antitumoral të vërtetuar.

- A) Herba Vinca minor
- B) Herba Vinca rosea
- C) Herba Parietaria
- D) Herba Chelidoni major

195. Cila nga bimët mjekësore të mëposhtme bën pjesë në fitopreparatet me efekt ndihmës në terapinë antitumorale:

- A) Rauëolfia serpentina
- B) Veratrum album
- C) Glycerrhiza glabra
- D) Viscum albi

196. Cili nga principet aktive antitumorale vepron duke inhibuar topoizomerazën I që merr pjesë në replikimin e AND.

- A) Kamptotekina
- B) Podofilotoksina
- C) Ajmalina
- D) Vinblastina

197. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë në lidhje me mekanizmin e veprimit të taksolit:

- A) Frenon mitozën pasi inhibon polimerizimin e mikrotubulave.
- B) Frenon mitozën pasi promovon polimerizimin e mikrotubulave.
- C) Frenon mitozën pasi inhibon enzimën topoizomerazë.
- D) Frenon mitozën pasi promovon veprimin e topoizomerazës.

198. Cili nga antitumoralët e mëposhtëm është derivat gjysëmsintetik i kamptotekinës:

- A) Topotecina
- B) Etoposidi
- C) Topotekani
- D) Teniposidi

199. Taxanet, në sajë të natyrës kimike të tyre, bëjnë pjesë në grupin kimik të derivateve të cilit lloj ndër alternativat e mëposhtme:

- A) Derivateve iridoidik
- B) Derivateve diterpenoidik
- C) Derivateve indolik
- D) Derivateve seskuiterpenik

200. Cili nga pohimet e mëposhtme mbi përdorimin klinik të kamptotekinës është i saktë:

- A) Kamptotekina përdoret në trajtimin e kancerit të gjirit.
- B) Kamptotekina përdoret në mjekimin e limfomave.

- C) Kamptotekina nuk përdoret për shkak të toksicitetit të lartë.
- D) Kamptotekina nuk përdoret për shkak të vartësisë që krijon.

201. Cili nga alkaloidet e mëposhtme, përbërës në Herba Catharanthi, është bisindolik

- A) Vinkamina
- B) Vinblastina
- C) Katharantina
- D) Vindolina

202. Cili nga efektet anësore të mëposhtme, ndodh më shpesh, gjatë mjekimit me taksol.

- A) Neurotoksiciteti periferik
- B) Trombocitopenia
- C) Mielosupresimi
- D) Diarrea

203. Cili nga pohimet është i saktë: "Podofilin quhet....."

- A) Rrëshira që nxirret nga ekstraktimi me alkool i Rhizoma Podophylli
- B) Goma që nxirret nga ekstraktimi me alkool i Rhizoma Podophylli
- C) Rrëshira që nxirret nga ekstraktimi me alkool i Rhizoma Filicis.
- D) Rrëshira që nxirret nga ekstraktimi me kloroform i Rhizoma Filicis.

204. Podofilina është drogë zyrtare dhe standardizohet në Farmakope kundrejt grupit kimik të:

- A) Fenoleve
- B) Furanokumarinave
- C) Lignaneve
- D) Flavolignaneve

205. Cili nga përbërësit e mëposhtëm nuk ndodhet në Resina Podophylli :

- A) Podofilotoksina
- B) alfa-peltatina
- C) beta-peltatina
- D) beta-peltatin glukozidi

206. Cili nga përbërësit kimik të Podophyllum-it ka veprim purgativ më të fuqishëm:

- A) beta-peltatina
- B) Podofilotoksina
- C) alfa-peltatina
- D) gama-peltatina

207. Podofilina ushtron veprim purgativ në intervalin e dozave:

- A) nga 1-5 mg
- B) nga 5-10 mg
- C) nga 10-50 mg
- D) nga 50-100 mg

208. Mekanizmi i veprimit citostatik të Resina Podophyllum-it është i ngjashëm me mekanizmin e veprimit të njërës nga drogat:

- A) Origanum vulgarea
- B) Vinca rosea
- C) Oenothera bienis

D) Colchicum autumnale

209. Në cilën nga format farmaceutike të poshtshënuara përdoret Podofilina, në mjekimin e epiteliomave:

- A) Tinkturë
- B) Macerat
- C) Pomadë
- D) Krem

210. Cili nga pohimet e mëposhtme mbi mekanizmin e veprimit të barnave, derivatë gjysëmsintetikë të podofilinës, është i sakti:

- A) Inhibojnë enzimën Topoizomerazë II.
- B) Nxisin veprimin e enzimës Topoizomerazë II.
- C) Frenojnë formimin e mikrotubuleve.
- D) Shtojnë polimerizimin e mikrotubuleve.

211. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është derivat gjysmësintetik i podofilinës:

- A) Topotekani
- B) Taxotere
- C) Irinotekani
- D) Teniposidi

212. Cila nga alternativat mbi përdorimet mjekësore të Resina Podofilium-it është e gabuar.

- A) Bakteriostatike
- B) Antimikotike
- C) Diuretike
- D) Kolagoge

213. Cila nga alternativat e mëposhtme është derivat gjysëmsintetik i vinblastinës:

- A) Vinkamina
- B) Vinkamidi
- C) Vinkristina
- D) Vinorelbina

214. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimin klinik të Vindesinës nuk është e saktë:

- A) Epitelioma
- B) Kancer i gjirit
- C) Leuçemi limfoidike
- D) Kancer i ovareve

215. Cili nga efektet anësore të mëposhtme mund të shfaqet gjatë mjekimit me topotekan:

- A) Çrregullime të shikimit
- B) Çrregullime të dëgjimit
- C) Apne
- D) Anemi

216. Cila nga alternativat e mëposhtme, sipas ndërtimit kimik të saj, është alkaloid monomer indolik:

- A) Hederagenina
- B) Katarantina

- C) Vinkristina
- D) Hidrastina

217. Vinkaleukoblastina formohet nga bashkimi midis :

- A) Katarantinës dhe ajmalinës
- B) Serpentinës dhe ajmalinës
- C) Vindolinës dhe Katarantinës
- D) Ajmalicinës dhe vindolinës

218. Pararendës në rrugën biogjenetike të alkaloidëve tek *Vinca rosea* është:

- A) Triptofani
- B) Ornitina
- C) Tiramina
- D) Tirozina

219. Cila nga alternativat e mëposhtme është e sakta: "Në rrugën biogjenetike të vindolinës merr pjesë ":

- A) Komponimi terpenik i tipit të ibogës
- B) Komponimi terpenik i tipit farnezen
- C) Komponimi terpenik i tipit korinante
- D) Komponimi terpenik i tipit aspidozpermë

220. Gjatë marrjes së cilit nga antitumoralët e mëposhtëm mund të shkaktohet sindromë hiponatremike:

- A) Vinkristinë
- B) Vinblastinë
- C) Taxol
- D) Tenopocid

221. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm ndodhet në lëvoren e *Taxus brevifolia*:

- A) 10-hidroksikamptotekina
- B) 10-deacetylbatatina
- C) Ajmalicina
- D) Elipticina

222. Cila nga kërpudhat e mëposhtme zotëron rrugën biogjenetike të formimit të Taxol-it:

- A) *Aspergillus nomius*
- B) *Aspergillus flavus*
- C) *Taxomyces cereviceae*
- D) *Taxomyces andreana*

223. Cili nga efektet anësore që mund të shfaqen gjatë marrjes së taxol-it nuk është i vërtetë:

- A) Neurotoksiciteti periferik
- B) Reaksione alergjike
- C) Dobësim të shikimit
- D) Kardiotoksicitet

224. Dhjetë-deacetylbatatina III ndodhet në sasi më të madhe në:

- A) Lëvoren e *Taxus baccata*
- B) Gjethet e *Taxus baccata*

- C) Majat e lulëzuara të *Taxus baccata*
- D) Gjethet e *Taxus brevifolia*

225. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është alkaloid me efekt antitumoral.

- A) Fizostigmina
- B) Serpentina
- C) Viteksina
- D) Kamptotekina

226. Cila nga alternativat e mëposhtme, mbi arsytet e mospërdorimit klinik të kamptotekines, nuk është e saktë:

- A) Biodisponibilitet i kufizuar.
- B) Toksicitet i lartë.
- C) Shpërndarje e ngadaltë
- D) Përthithje e shpejtë

227. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimin klinik të Topotekanit nuk është e vërtetë:

- A) Në tumoret e mushkërisë
- B) Në tumoret e ovareve
- C) Në tumoret e kockave
- D) Në leuçemi

228. Cila nga alternativat e mëposhtme është përbërësi me efekt citotoksik të mundshëm, në farat e *Oenothera biennis*:

- A) Acidi linoleik
- B) Acidi hidnokarpik
- C) Acidi bosvelik
- D) Acidi shikimik

229. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi përdorimet terapeutike, si mjet ndihmës, të vajit të *Oenotherës* është e pa saktë:

- A) Egzema atopike
- B) Sindromë premenstruale
- C) Patologji të koronareve
- D) Çrregullime të shikimit

230. Cili nga grupet kimike të mëposhtme, përbërës në bimët mjekësore, ka efekt antioksidues të vërtetuar.

- A) Antranolet
- B) Antocianidinat
- C) Furanokumarinat
- D) Saponinat

231. Cila nga drogat bimore të mëposhtme bën pjesë në një fitopreparat me efekt antitumoral:

- A) *Radix Ginseng*
- B) *Folium Juglandis*
- C) *Radix Saponariae*
- D) *Folium Tussilago*

232. Cila nga alternativat e mëposhtme mbi mekanizmin e veprimit, si ndihmës antitumoral, të ekstraktit të *Viscum albi* është e sakta:

- A) Rrit proliferimin e mikrotubuleve.
- B) Shton proliferimin e Limfociteve T.
- C) Inhibon enzimën Topoizomerazë.
- D) Inhibon depolimerizimin e mikrotubuleve.

233. Cili nga përbërësit kimik të *Viscum albi* ka efekt citotoksik më të lartë:

- A) Acidet yndyrore
- B) Flavonoidet
- C) Terpenoidet
- D) Alkaloidet

234. Cili nga organet bimore të *Viscum albi* nuk përdoret për përgatitjen e ekstraktit të bimës:

- A) Gjethet
- B) Rrënja
- C) Degët
- D) Frutat

235. Cili nga përbërësit kimik të mëposhtëm është i duhuri në plotësimin e pohimit:

"Efekti antimitotik i kolkicinës i kushtohet pranisë së"

- A) Benzocikloheptanit
- B) Benzociklopentanit
- C) Tropolonit
- D) Tropinonit

236. Cili nga alkaloidet e mëposhtme të xhërrokullit është më pak helmues:

- A) Kolkicina
- B) Demekolcina
- C) Kolkikoina
- D) Kolkikoina B

237. Cila nga alternativat e mëposhtme, mbi grupin kimik ku bën pjesë kolkicina, është e sakta:

- A) Alkaloidet terpenike
- B) Alkaloidet steroidike
- C) Protoalkaloidet
- D) Alkaloidet indolike

238. *Radix Valerianae* përdoret në formë të çajrave hipnotik e përzier me njëjërën nga drogat e mëposhtme:

- A) *Herba Hyperici*
- B) *Flores Tiliae*
- C) *Flores Sambuci*
- D) *Flores Lupuli*

5. Teknologji Farmaceutike

1. Si ndikon rritja e veshitullisë së një pezullie në shkallën e sedimentimit të fazës së shpërndarë?
A) sedimentimi nuk ndryshon
B) sedimentimi rritet
C) sedimentimi zvogëlohet
D) sedimentimi nuk ndodh
2. Cili nga fenomenet e mëposhtme është i padëshirueshëm në pezullitë për përdorim farmaceutik?
A) Sedimentimi i ngadaltë i grimcave
B) Aglomerimi i grimcave në kristale
C) Rishpërndarja e grimcave pas tundjes
D) Dekantimi i shpejtë i grimcave
3. Rritja e përqendrimit të lëndës tensiovepruese mbi përqendrimin micelar kritik do të japë:
A) Rritje të tensionit sipërfaqësor
B) Ulje të tensionit sipërfaqësor
C) Rritje të numrit të micelave
D) Zvogëlim të numrit të micelave
4. Termi i përgjithshëm për molekulat dhe jonet që vendosen në ndërfaqet e fazave është:
A) Agjentë kundër shkumës
B) Detergjentë
C) Agjentë njomës
D) Surfaktantë (Tensioveprues)
5. Cili nga kushtet e mëposhtme do të rrisë shkallën e tretjes së barit nga tableta?
A) Rritja e madhësisë së grimcave të barit
B) Rritja e sipërfaqes specifike të grimcave të barit
C) Rritja e kohës së zbërthimit
D) Rritja e sasisë së eksipientëve për hollimin e barit
6. Pluhurat shpërndahen dhe treten më shpejt sesa tabletat për arsye se:
A) Përmbajnë zbërthyes
B) Janë lyrësuar më mirë
C) Kanë sipërfaqe specifike më të madhe
D) Rrjedhin më mirë
7. Cili është procesi i përfshirë në shpërbërjen kimike të tamoksifenit?
A) oksidimi
B) hidroliza
C) polimerizimi
D) izomerizimi
8. Cila është epërsia kryesore e pluhurave dhe granulave?
A) Pluhurat transportohen më lehtë nga pacientët
B) Janë më të qëndrueshme sesa përgatesat e lëngëta
C) Mund të maskojnë shije të papëlqyeshme
D) Përdoren për formulimin e barnave higroskopikë

9. Cila është metoda më e përshtatshme për përzierjen homogjene të barnave me veprim të fortë?
- A) thyerja
 - B) fërkimi
 - C) hollimi
 - D) granulimi
10. Gazi që çlirohet nga tretja e tabletave përshkumëzuese në ujë është:
- A) Oksigjeni
 - B) Dioksidi i karbonit
 - C) Monoksidi i karbonit
 - D) Avulli i ujit
11. Cila nga metodat e mëposhtme mund të përdoret për të përfshirë brenda së njëjtës tabletë dy lëndë të papajtueshme midis tyre?
- A) Veshja me sheqer
 - B) Veshja me cipë
 - C) Veshja enterike
 - D) Veshja me tabletim
12. Solubilizimi i lëndëve vepruese me ciklodekstrina shërben për parandalimin e
- A) oksidimit
 - B) hidrolizës
 - C) izomerizimit
 - D) polimerizimit
13. Në cilën pjesë të recetës jepen udhëzime mbi përgatitjen dhe dorëzimin e barit nga ana e farmacistit?
- A) inscriptio
 - B) subscriptio
 - C) praescriptio
 - D) signatura
14. Cili nga pluhurat e mëposhtëm është më hidrofil?
- A) stearati i magnezit
 - B) pluhuri i karbonit vegjetal
 - C) lauril sulfati i magnezit
 - D) stearati i zinkut
15. Cili nga pluhurat e mëposhtëm është më lipofil?
- A) acidi borik
 - B) benzoati i natriumit
 - C) acidi stearik
 - D) kloruri i natriumit
16. Si ndryshon përqendrimi i formës së pajonizuar të një bari acid me $pK_a=4.5$ nqs tretësirën ku ai ndodhet e përziejme më një tretësirë ujore me të njëjtin pH?
- A) përgjysmohet
 - B) rritet pak
 - C) dyfishohet
 - D) nuk ndryshon

17. Cila nga lëndët e mëposhtme mund të përdoret për të parandaluar rritjen e myqeve në përgatesat e lëngëta?

- A) klorbutanoli
- B) edetati i natriumit
- C) mentoli
- D) acidi benzoik

18. Cili nga kombinimet e mëposhtme emër tregëtar-emër lënde ndihmëse është korrekt dhe i përdorur në emërtimin e emulgatorëve?

- A) Tween 20 – monostearat sorbitani
- B) Tween 80 - monooleat polioksietilensorbitani
- C) Span 40 – monooleat polioksietileni
- D) Tween 80 - metilcelulozë

19. Cila nga lëndët e mëposhtme rrit qëndrueshmërinë e qelqit për përdorim farmaceutik ndaj ndryshimeve të temperaturës, veprimit të ujit dhe acideve?

- A) K_2O
- B) B_2O_3
- C) As_2O_3
- D) PbO

20. Liofilizimi është

- A) një metodë pluhurizimi me lëndë të ndërmjetme
- B) një metodë tharjeje me sublimimin e akullit në zbrazëti
- C) një metodë tharjeje me avullim në zbrazëti
- D) një metodë për homogjenizimin e emulsioneve

21. Cila nga lëndët e mëposhtme ka veprim antioksidues?

- A) metabisulfiti i natriumit
- B) miristati i izopropilit
- C) sulfati i bakrit
- D) alkoli benzilik

22. Hidrokortizoni, biologjikisht veprues, parapëlqehet ndaj kortizonit, një paraardhës i tij joveprues, sepse ky i fundit

- A) është i hidratuar dhe ka probleme me tretjen
- B) jep tableta të forta dhe që zbërthehen me vështirësi
- C) është lipofil dhe lidhet me yndyrnat
- D) ngop sistemin metabolik dhe nuk shndërrohet i tëri në metabolitin veprues

23. Lëndët pirogjene janë

- A) lëndë fluore që nxisin inflamacionin
- B) grimca pluhuri të pranishme në tretësirën për injeksion
- C) produkte të paqëndrueshmërisë së lëndës vepruese
- D) produkte të shkatërrimit të strukturës bakterore

24. Molaliteti i një bari në tretësirë është numri i

- A) moleve për litër tretës
- B) gramëve për kilogram tretës

- C) moleve për kilogram tretës
- D) osmoleve për kilogram tretës

25. Cila nga lëndët plastike të mëposhtme të përdorura në ambalazhimin farmaceutik është opake?

- A) polistireni
- B) rrëshira akrilike
- C) PVC
- D) tefloni

26. Në cilin lloj bën pjesë qelqi sodo-kalcik për përdorim farmaceutik?

- A) I
- B) II
- C) III
- D) IV

27. Gjatë procesit të pluhurizimit vetëm një pjesë e vogël e energjisë shkon për zvogëlimin e madhësisë së grimcave. Përqindja e energjisë së dobishme është

- A) 2%
- B) 10%
- C) 15%
- D) 20%

28. Ligji i Rittinger mat energjinë mekanike të nevojshme për procesin e pluhurizimit. Cilat lëndëve i përshtatet më mirë ky ligj?

- A) lëndëve elastike
- B) lëndëve të thyeshme
- C) lëndëve veshtullore
- D) lëndëve plastike

29. Koha e zbërthimit të tabletave të veshura me cipë duhet të jetë më e vogël se

- A) 5 minuta
- B) 15 minuta
- C) 30 minuta
- D) 60 minuta

30. Cila nga metodat e mëposhtme është metoda më e përshtatshme për sterilizimin e pomadave oftalmike?

- A) sterilizimi me avuj uji
- B) sterilizimi nën trysni
- C) sterilizimi më nxehtësi të thatë
- D) filtrimi sterilizues

31. Në rast se sasia e barit e tretur në ujë shprehet si numri i moleve në një litër tretësirë, përqendrimi është shprehur në

- A) molaritet
- B) osmolalitet
- C) osmolaritet
- D) molalitet

32. Format farmaceutike në trajtë aerosoli përmbajnë zakonisht si propellent
- një lëng me temperaturë vlimi të ulët
 - një lëng me temperaturë vlimi të lartë
 - ajër nën tryzni
 - azot të gaztë
33. Cilët nga fluidet e mëposhtme paraqesin dukurinë e histerezës?
- fluidet njutoniane
 - fluidet plastike
 - fluidet dilatante
 - fluidet tiksotrope
34. Sistemi Abak® përdoret për ambalazhimin e përgatesave oftalmike. Ky sistem është
- ampulë prej qelqi me dy mbyllje
 - flakon prej polietileni të padeformueshëm
 - flakon prej polietileni njëdozësh
 - flakon shumëdozësh pa konservues
35. Për cilën veti përdoret hidrokispropilceluloza e natriumit në përgatesat farmaceutike?
- sinergjizuese
 - holluese
 - trashëse
 - gastro-rezistente
36. Cila nga lëndët e mëposhtme ka veti izotonizuese?
- EDTA (acidi etilendiaminotetraacetik)
 - glukoza
 - acidi benzoik (në formën e benzoatit sodik)
 - kloruri i cetilpiridinës
37. Sa është kohëzgjatja maksimale e lejuar e përdorimit të kolireve pas hapjes së flakonit shumëdozësh?
- 1 javë
 - 2 javë
 - 3 javë
 - 4 javë
38. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret për rritjen e veshtullisë?
- karboksipolimetileni
 - polietilenglikoli 400
 - alkooli benzilik
 - celuloza mikrokristallore
39. Cili nga konfirmimet e mëposhtme në lidhje me sapunet është i gabuar?
- sapunet përndryshojnë tensionin sipërfaqësor të ujit
 - lëndët me veti tensiovepruese mund të jenë anionike dhe kationike
 - sapuni i zakonshëm është një sapun anionik që përmban natrium
 - sapunet përndryshojnë tensionin sipërfaqësor të avujve të ujit

40. Paracetamoli është një lëndë vepruese që gjatë procesit të tabletimit pëson
- A) deformim elastik
 - B) deformim plastik
 - C) thyerje
 - D) shkrirje
41. Cili nga konfirmimet e mëposhtme në lidhje me sapunet është i saktë?
- A) sapunet përndryshojnë tensionin e avujve të ujit
 - B) pH acid i sapuneve alkaline i detyrohet ndarjes elektrolitike të molekulës
 - C) sapunet anionike me prejardhje nga yndyrnat kanë një pH më të vogël se 7
 - D) oleati i natriumit në prani të klorurit të benzalkonit jep një fundërrësë
42. Dukuria e hemolizës shfaqet nëse i vendosim rruazat e kuqe të gjakut në një tretësirë me NaCl me përqendrimin
- A) 0.95 - 0.98 %
 - B) 0.99 – 1.1 %
 - C) 1.2 – 1.3 %
 - D) 0.44 - 0.48 %
43. Cili nga konfirmimet e mëposhtme në lidhje me sapunet është i gabuar?
- A) sapunet anionike e kationike janë të papajtueshme me njëri-tjetrin
 - B) sapunet e kalciumit janë shumë të tretshme në ujë
 - C) sapunet e forta janë sapune që përmbajnë magnez
 - D) sapunet anionike formojnë një fundërrësë në prani të sapuneve kationikë
44. Dukuria e efloreshencës është i lidhur me
- A) sublimimin e ujit
 - B) avullimin e ujit
 - C) vlimin e ujit
 - D) formimin e përzierjeve eutektike
45. Lëndët ndihmëse që i shtohen pluhurave gjatë përgatitjes së tabletave me qëllim parandalimin e ngjitjes në punsone dhe matrica quhen:
- A) lidhëse
 - B) zbërthyes
 - C) lyresuese
 - D) holluese
46. Laktoza është një lëndë ndihmëse që gjatë procesit të tabletimit pëson
- A) deformim elastik
 - B) deformim plastik
 - C) thyerje
 - D) shkrirje
47. Glicerolati i amidonit është
- A) një hidroxhel
 - B) një pomadë
 - C) një krem
 - D) një pastë

48. Dy tretësira ujore kanë vlera të ndryshme të temperaturës së ngrirjes. Nqs e para ngrin në një temperaturë më të lartë sesa e dyta, do të thotë se e para është ndaj të dytës
- A) izoosmotike
 - B) izotonike
 - C) hipertnike
 - D) hipotonike
49. Cila nga lëndët e mëposhtme është lëndë holluese?
- A) bioksidi i titanit
 - B) celuloza mikrokristallore
 - C) acidi algjinik
 - D) silici koloidal
50. Cila nga lëndët e mëposhtme bën pjesë në lëndët rrëshqitëse?
- A) dioksidi i titanit
 - B) laktoza
 - C) fosfati dibazik i kalciumit
 - D) silici koloidal
51. Nëse do të përgatisim një përgatesë për injeksion, cila prej lëndëve vepruese të mëposhtme, ka më shumë nevojë për një vehikul vajor?
- A) glukozë
 - B) vitamina A
 - C) penicilina G kripë e kaliumit
 - D) klorhidrati i morfinës
52. Cila nga rrugët e mëposhtme të përdorimit të barnave paraqet më shumë probleme nëse bari ka natyrë peptidike?
- A) parenterale
 - B) nazale
 - C) rektale
 - D) orale
53. Në sistemin oftalmik Ocusert membranat polimerike janë të përbëra nga
- A) derivate vinilike
 - B) polivinipirrolidon
 - C) polivinilpirrolidon i retikular
 - D) polivinilalkooli
54. Për të treguar shumëfishat dhe nënfishat e njësive të matjes përdoren parashtesa specifike. Cila nga renditjet e mëposhtme, duke i konsideruar nga e majta në të djathtë, tregon një rradhë në rritje të madhësisë së marrë në konsideratë?
- A) kilo, centi, deka
 - B) mili, nano, mikro
 - C) mega, deka, piko
 - D) mikro, mili, centi
55. Gjени pohimin e pasaktë. Rritja e numrit të grimcave në tretësirë sjell
- A) rritje të trysnisë osmotike
 - B) rritje të temperaturës së vlimit

- C) rritje të temperaturës së ngrirjes
- D) zvogëlim të trysnisë së avujve të ujit

56. Për bar të skaduar nënkuptohet specialiteti farmaceutik

- A) në të cilin kufiri i papastërtive është më i madh se 2%
- B) në të cilin forma farmaceutike ka humbur karakteristikat e saj të qëndrueshmërisë
- C) që nuk është ruajtur në kushte të përshtatshme
- D) që gjendet në farmaci pas datës së skadencës të shkruajtur në kuti

57. Çfarë do të thotë termi compliancë?

- A) ndërlikime që mund të lindin gjatë marrjes së barit
- B) lehtësi e marrjes së barit për shkak të formës farmaceutike
- C) aftësia e pacientit për të ndjekur terapinë e përshkruar
- D) zbatim i saktë i rregullave në dorëzimin e recetës

58. Cila nga lëndët e mëposhte nuk përdoret si bashkëtrëtes në përgatitjen e përgatesave parenterale?

- A) etanoli
- B) metanoli
- C) propilenglikoli
- D) glicerina

59. Tretësirat izotonike kanë

- A) të njëjtën përcjellshmëri
- B) të njëjtën temperaturë ngrirjeje me serumit e gjakut
- C) të njëjtin pH
- D) të njëjtën dendësi

60. Dy tretësira ujore paraqesin vlera të ndryshme të temperaturës së vlimit. Nqs e para vlon në një temperaturë më të lartë sesa e dyta, do të thotë që e para me të dytën është

- A) izoosmotike
- B) izotonike
- C) hipotonike
- D) hipertotonike

61. Cila nga rrugët e mëposhtme të përdorimit të barnave nuk këshillohet në mjekimet që kërkojnë dozim të saktë të barit?

- A) parenterale
- B) intravenoze
- C) orale
- D) rektale

62. Cili nga pohimet nuk është i vërtetë? Zvogëlimi i madhësisë së grimcave çon në

- A) ulje të helmueshmërisë
- B) përmirësim të njëtrajtshmërisë në përmbajtje
- C) zvogëlim të irritimit mekanik të pomadave
- D) rritje të biodisponibilitetit

63. Hidrokortizoni paraqet dukurinë e polimorfizmit. Cila nga teknikat e mëposhtme nuk është në gjendje të evidentojë këtë dukuri?

- A) rrezet X
- B) temperatura e shkrirjes
- C) DSC (Differential Scanning Calorimetry)
- D) spektroskopia UV

64. Uji për përgatesa për injeksion mund të përftohet me anë të

- A) vlimit për 30 minuta
- B) filtrimit me karbon aktiv
- C) trajtimit me rrëshira jonokembyese
- D) distilimit

65. Sa është përqindja e lagështisë që parapëlqehet për pluhurizimin në të njomë të pluhurave?

- A) mbi 40%
- B) mbi 50%
- C) mbi 60%
- D) mbi 70%

66. Cila nga tretësirat e mëposhtme ka trysinë osmotike më të lartë nqs përqendrimit e tyre janë shprehur në molaritet?

- A) klorhidrati i pilokarpinës 0.05
- B) sulfati i pilokarpinës 0.05
- C) kloruri i natriumit 0.08
- D) sakaroza 0.2

67. Dekoksioni bëhet duke e vendosur drogën e grimtuar në kontakt me ujin

- A) e ftohtë për 1orë
- B) në 70 grade C për gjysmë ore
- C) të vluar për 5 minuta
- D) të ftohtë dhe duke e lënë të vlojë për 30 minuta

68. Cila nga lëndët e mëposhtme është një koloid liofob?

- A) albumina
- B) xhelatina
- C) ari
- D) amidoni

69. Cili nga përkufizimet e mëposhtme i përfaqëson më shumë termit biodisponibilitet të barit?

- A) shpejtësia me të cilën jashtëqitet
- B) shpejtësia me të cilën metabolizohet
- C) sasia e barit që kalon në qarkullimin e përgjithshëm
- D) sasia e barit që kalon në tretësirë

70. Sa është përqindja e ujit që largohet gjatë tharjes parësore në procesin e liofilizimit?

- A) 85%
- B) 90%
- C) 95%
- D) 99%

71. Cili nga përkufizimet e mëposhtme në lidhje me sapunet është i gabuar?

- A) sapunet modifikojnë tensionin sipërfaqësor të ujit

- B) sapunet anionikë që përmbajnë kalium quhen sapune të buta
- C) sapuni i zakonshëm është një sapun kationik që nuk përmban azot
- D) tensioaktivët janë lëndë kationike ose anionike

72. OROS është:

- A) një sistem me shkëmbim jonik
- B) një sistem osmotik
- C) një sistem i biodegradueshëm
- D) një sistem transdermik

73. Avicel është emri tregtar i një lënde ndihmëse në përgatitjen e tabletave. Cila është kjo lëndë?

- A) laktoza
- B) hidrokispropilmetilceluloza
- C) celuloza mikrokristallore
- D) fosfati dikalcik i dyujësuar

74. Cilat nga lëndët ndihmëse të mëposhtme favorizojnë procesin e zbërthimit të tabletave?

- A) lëndët holluese që treten në ujë
- B) lëndët holluese që nuk treten në ujë
- C) lëndët lidhëse
- D) lëndët lypësuese

75. Tharja e granulatit në furra me zbraçeti bazohet në mekanizmin e tharjes me

- A) konveksion
- B) liofilizim
- C) përcjellshmëri
- D) rrezatim

76. Format farmaceutike më të përdorura me përmbajtje insuline janë

- A) ngjitëse transdermike
- B) pezulli të insulinës (të kompleksuara ose jo me zink) me kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- C) pezulli të insulinës (të kompleksuara ose jo me kalcium) me kohëzgjatje të ndryshme veprimi
- D) tretësira të insulinës të kripëzuara me zink

77. Polimeri PEG 400, i përdorur si lëndë ndihmëse, i përket klasës së

- A) poliestereve
- B) poliacideve
- C) poliamideve
- D) polieterëve

78. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret si lëndë holluese në tabletat që përtyphen për shkak të nxehtësisë së saj negative në tretësirë?

- A) sorbitoli
- B) manitoli
- C) laktoza
- D) celuloza mikrokristallore

79. Formimi i granulit gjatë procesit të granulimit ndodh në disa faza. Sa është numri i tyre?

- A) 2
- B) 3

- C) 4
- D) 5

80. Cili nga pohimet e mëposhtme për lëndët lyrsuese nuk është i vërtetë?
A) shtohen vetëm pasi të gjithë përbërësit e tjerë janë në gjendje homogjene
B) përzihen jo më shumë se 2 - 5 minuta
C) zgjatja e kohës së përzierjes mund të shkaktojë probleme në tretje
D) shtohen përpara granulimit në të njomë

81. Kushtet optimale të ruajtjes së kapsulave bosh janë
A) 5 gradëC dhe 10% LR
B) 15 gradëC dhe 30% LR
C) 20 gradëC dhe 40% LR
D) 30 gradëC dhe 60% LR

82. Cila nga lëndët lyrsuese të mëposhtme është e tretshme në ujë?
A) stearati i natriumit
B) benzoati i natriumit
C) acidi stearik
D) talku

83. Një lëndë tensiovepruese me vlerë të HLB-së më të madhe se 20 përdoret si
A) lëndë kundër shkumës
B) lëndë njomëse
C) emulsionues ujë në vaj
D) lëndë solubilizuese

84. Vazelina ka dendësi 0.9 g/ml. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë? Vazelina pas përzierjes me ujë
A) rri në sipërfaqe
B) bie në fund
C) vepron me të
D) tretet

85. Celulaza mund të përdoret si lëndë zbërthyesë. Me çfarë mekanizmi vepron ajo?
A) veprim kapilar
B) veprim enzimatik
C) bymim
D) çlirim gazesh

86. Përzierja e kripërave ($\text{NaHSO}_3 + \text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_5$) gjendet në treg si lëndë ndihmëse. Çfarë funksioni kryejnë kur shtohen në një formë farmaceutike?
A) antimikrobik
B) antioksidues
C) acidifikues
D) alkalizues

87. Cila nga vetitë e mëposhtme është e njëjtë për lëndët polimorfe?
A) tretshmëria
B) dendësia

- C) temperatura e shkrirjes
- D) temperatura e vlimit

88. Sistemi Ocusert është një insert oftalmik i formuluar si

- A) sistem matricial
- B) sistem rezervuar
- C) sistem lipozomial
- D) sistem me pompë osmotike

89. Cila nga provat e mëposhtme të kontrollit të cilësisë nuk kryhet për kapsulat?

- A) zbërthimi
- B) shpejtësia e tretjes
- C) lagështia e përthithur
- D) njëtrajtshmëria e diametrit mesatar

90. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret si lëndë plastifikuese në veshjen me cipa të tabletave?

- A) dioksidi i titanit
- B) dietilftalati
- C) hidroksipropilmetilceluloza
- D) metilceluloza

91. Kapsulat xhelatinore të buta mbushen me një fluid tiksotrop pasi ky i fundit

- A) xhelifikon kur mbaron përzierja
- B) vepron me mbështjellën e kapsulës
- C) mbetet i lëngët në temperaturën e ambientit
- D) xhelifikon në temperatura të larta

92. Çfarë pohon ligji i Stoksit?

- A) që shpejtësia e sedimentimit të një grimce në një mjedis të lëngët është në përpjestim të drejtë me nxitimin e forcës së rëndesës
- B) që shpejtësia e sedimentimit të një grimce në një mjedis të lëngët është në përpjestim të zhdrejtë me nxitimin e forcës së rëndesës
- C) që shpejtësia e sedimentimit të një grimce në një mjedis të lëngët është në përpjestim të zhdrejtë me katrorin e diametrit të saj
- D) që shpejtësia e sedimentimit të një grimce në një mjedis të lëngët është në përpjestim të drejtë me viskozitetin e mjedisit

93. EUDRAGIT® L përdoret për veshjen gastrorezistente të tabletave. Në cilin pH është i tretshëm ky polimer?

- A) 4
- B) 5
- C) 6
- D) 7

94. EUDRAGIT® S përdoret për veshjen gastrorezistente të tabletave. Në cilin pH është i tretshëm ky polimer?

- A) 4
- B) 5
- C) 6
- D) 7

95. Në kapsulat xhelatinore të forta që mbushen me përzierjen e pluhurave, lënda vepruese zë
- një vëllim të vogël
 - një vëllim të madh
 - 1/2 e vëllimit
 - 1/3 e vëllimit
96. Rrjedhja e përmbajtjes së kapsulave xhelatinore të buta shkaktohet nga
- shtimi i tensiovepruesve
 - vajrat bimorë
 - hidroliza e xhelatinës në pH të ulët
 - polietilenglikol 6000
97. Cila nga vetitë e mëposhtme është e njëjtë për lëndët polimorfe?
- fortësia
 - tretshmëria
 - gjendja fizike
 - vetitë elektrike
98. Përzgjedhja e lëndës tensiovepruese është e lidhur me strukturën e saj dhe pH-in e tretësirës. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë?
- tensioveprues anionik-pH në intervalin 2-4
 - tensioveprues anionik-pH në intervalin 5-7
 - tensioveprues jojonik-pH në intervalin 3-10
 - tensioveprues kationik-pH në intervalin 7-9
99. Cila është diferenca më e madhe midis xhelatinës së tipit A dhe tipit B të përdorura në përgatitjen e kapsulave të forta?
- A prodhohet me hidrolizë alkaline dhe B me hidrolizë acide
 - A prodhohet me hidrolizë acide dhe B me hidrolizë alkaline
 - A prodhohet nga kockat dhe B nga lëkura e kafshëve
 - A përmban kryesisht alaninë dhe B përmban kryesisht glicinë
100. Cili nga pohimet e mëposhtme (lëndë ndihmëse - funksion specifik) është i saktë?
- karbon aktiv - lëndë lidhëse
 - edetati i natriumit - lëndë kelante
 - polisorbati 80 - lëndë holluese
 - acidi benzoik - lëndë tensiovepruese
101. Gjatë përgatitjes së kapsulave xhelatinore të forta nuk është e rëndësishme
- përzierja dhe homogjeniteti i pluhurave
 - rrjedhshmëria e pluhurave
 - lubrifikimi i pluhurave
 - kompaktimi i pluhurave
102. Polimorfizmi është një dukuri në të cilin lënda vepruese
- ka kristale të ngjashme me një lëndë vepruese tjetër
 - formon përzierje me kristale të lëndëve të tjera
 - jep përzierje eutektike me kristalet e një lënde tjetër
 - paraqitet në dy apo më shumë trajta kristalore

103. Biodisponibiliteti i një lënde vepruese që paraqitet në dy apo tri trajta polimorfe, mund të ndryshojë në formën farmaceutike
- A) emulsion
 - B) tretësirë që merret nga goja
 - C) tretësirë për injeksion
 - D) pezulli
104. Përzierja e gjatë e stearatit të magnezit me granulatën për tabletim ndikon në
- A) rritjen e fortësisë së tabletës
 - B) zvogëlimin e fortësisë së tabletës
 - C) rritjen e shpejtësisë së zbërthimit
 - D) rritjen e shpejtësisë së tretjes
105. Silici koloidal nuk përdoret në tableta si lëndë
- A) rrëshqitëse
 - B) holluese
 - C) lubrifikuese
 - D) ndajthithese
106. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon negativisht në shkallën e çlirimit të barit prej tabletave?
- A) paqëndrueshmëria kimike
 - B) sipërfaqja specifike e vogël e lëndës vepruese
 - C) tretshmëria e mirë në ujë të ëndës lidhëse
 - D) mungesa e polimorfizmit
107. Lipozomet janë mikrogrimca të përbëra nga
- A) polietilenglikole
 - B) derivate të celulozës
 - C) fosfolipide
 - D) derivate të acidit algjinik
108. Koeficienti i ndarjes V/U është karakteristike për molekulën dhe përshkruan vetitë e saj
- A) sterike
 - B) hidrofobe
 - C) konfiguracionale
 - D) elektronike
109. Lënda vepruese çlirohet nga insertet oftalmike me anë të procesit të
- A) erozionit ose shpërhapjes
 - B) jonoforezës
 - C) trysnisë osmotike
 - D) shkëmbimit jonik
110. Një nga të metat e tabletave si formë farmaceutike është se
- A) gjatë tabletimit mund të ndodhin përdryshime fizike të lëndës vepruese
 - B) tabletat janë të vështira për t'u transportuar
 - C) çlirimi i lëndës vepruese nuk mund të kontrollohet
 - D) nuk mund të prodhohen në mënyrë uniforme

111. Cila nga lëndët ndihmëse të mëposhtme nuk përdoret në tabletat që mbahen në gojë?
- A) sakaroza
 - B) povidoni me lidhje të kryqezuar
 - C) laktoza
 - D) xhelatina
112. Cila nga lëndët e mëposhtme mund të përdoret si lëndë lidhëse në përgatitjen e tabletave?
- A) stearati i magnezit
 - B) talku
 - C) karbonati i magnezit
 - D) karbomerët
113. Sakaroza është një disakarid i përbërë nga
- A) glukozë dhe galaktozë
 - B) galaktozë dhe fruktozë
 - C) glukozë dhe fruktozë
 - D) dy molekula glukozë
114. Vlera e pH-it nga ana matematikore është
- A) log i përqendrimit të joneve OH-
 - B) log negativ i përqendrimit të joneve OH-
 - C) log i përqendrimit të joneve H+
 - D) log negativ i përqendrimit të joneve H+
115. Një lëndë vepruese, që ka karakteristikat e një elektroliti të dobët, nqs përdoret "per os", përthithet më mirë nga organizmi sa më shumë që
- A) është e jonizuar
 - B) është e pajonizuar
 - C) janë polare grupet e saj të jonizuara
 - D) janë hidrofile grupet e saj të jonizuara
116. Gjatë përgatitjes së supozitorëve, polietilenglikolet përdoren si
- A) eksipientë të tretshëm në indyrna
 - B) plastifikues
 - C) baza të tretshme në ujë
 - D) rregullues të temperaturës së shkrirjes
117. Cila është lënda antimikrobike më e përdorur për ruajtjen e përgatesave oftalmike?
- A) nipagina
 - B) nipazoli
 - C) klorbutanoli
 - D) kloruri i benzalkonit
118. Cila nga dukuritë e mëposhtme përmirëson rrjedhshmërinë e pluhurave?
- A) adezioni
 - B) përputhja mekanike
 - C) këndi i rrëshqitjes
 - D) forca sipërfaqësore

119. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret për veshjen me cipë të tabletave jo gastrorezistente?

- A) polivinilacetofalati
- B) acetofalati i celulozës
- C) ftalati i hidroksipropilmetilcelulozës
- D) hidroksipropilmetilceluloza

120. Cila nga metodat e mëposhtme përdoret për përgatitjen e mikrokapsulave?

- A) koacervimi
- B) liofilizimi
- C) pluhurizimi
- D) atomizimi

121. Insulina nuk përdoret nga goja sepse

- A) është hidrophile
- B) është lipofile
- C) ka peshë molekulare të madhe
- D) zbërthehet me lehtësi

122. Cili është funksioni i tiomersalit në format farmaceutike?

- A) lëndë njomëse
- B) lëndë holluese
- C) lëndë zbërthyese
- D) lëndë antimikrobike

123. Ushqimi ndikon në përthithjen e

- A) insulinës
- B) grizeofulvinës
- C) heparinës
- D) N-butilskopolaminës

124. Cila nga metodat e mëposhtme për matjen e madhësisë së grimcave është një metodë automatike?

- A) sitja
- B) numëruesi Coulter
- C) mikroskopia
- D) sedimentimi

125. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret për rregullimin e aciditetit në format farmaceutike të lëngëta?

- A) dietilftalati
- B) citrati i natriumit
- C) kloruri i natriumit
- D) kloruri i benzalkonit

126. Formimi i një fundërresë të patretshme si rezultat i bashkëveprimit të kripërave të kalciumit me fosfatet është shembull i papajtueshmërisë

- A) kimike
- B) fizike
- C) terapeutike
- D) farmakologjike

127. Në disa raste, veshja e tabletave me cipa ka për qëllim çlirimin e lëndës vepruese në një pjesë të caktuar të traktit gastro-intestinal. Cili nga kombinimet e mëposhtme, lëndë ndihmëse-pjesë e traktit gastro-intestinal ku ndodh çlirimi, është i saktë?

- A) sakarozë - zorrë
- B) acetoftalat celulozë - zorrë
- C) hidroksipropilmetilcelulozë - zorrë
- D) metilceluloze - zorrë

128. Me termin porozitet nënkuptohet madhësia

- A) në përpjestim të drejtë me diferencën (vëllim aparent - vëllim i vërtetë)
- B) në përpjestim të drejtë me shumën (vëllim aparent + vëllim i vërtetë)
- C) i barabartë më raportin (vëllim aparent/vëllim i vërtetë)
- D) i barabartë më prodhimin (vëllim aparent x vëllim i vërtetë)

129. Një lëndë vepruese me veti acide përthithet më shpejt në stomak nqs vlera e pH-it gastrik

- A) është rritur për shkak të përdorimit të njëkohësishëm të cimetidinës
- B) është më i vogël sesa pKa i lëndës vepruese me të paktën 2 njësi
- C) është më i madh sesa pKa i lëndës vepruese me të paktën 2 njësi
- D) është i barabartë me pKa e lëndës vepruese

130. Cila nga lëndët ndihmëse të mëposhtme mund të përdoret si lëndë me veprim te forte zberthyes?

- A) povidoni me lidhje te kryqëzuar
- B) polietilenglikoli
- C) metilceluloza
- D) etilceluloza

131. Filtrat HEPA përdoren në

- A) filtrimin e tretësirave për injeksion
- B) filtrimin e kollireve që nuk mund të sterilizohen
- C) filtrimin e ajrit në lokalet e llojit D
- D) filtrimin e ajrit në lokalet e llojit A

132. Lëndët ndihmëse që i shtohen pluhurit, gjatë përgatitjes së tabletave, me qëllim përmirësimin e rrëshqitjes quhen

- A) zberthyes
- B) lubrifikuese
- C) rrëshqitëse
- D) holluese

133. Gjatë përdorimit nga goja, barnat që sillen si elektrolitë, përthithen më shumë nëse

- A) sillen si elektrolitë të fortë
- B) pH-i i vendit të përthithjes nuk favorizon jonizimin e tyre
- C) molekula e pajonizuar nuk është lipofile
- D) molekula e pajonizuar është hidrofile

134. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk përdoret si lëndë lidhëse?

- A) derivatet e celulozës
- B) laurilsulfati i natriumit

- C) polivinipirrolidoni
- D) acidi algjinik

135. Quhen lëndë rrëshqitëse lëndët ndihmëse që

- A) mbajnë pluhurin të bashkuar gjatë tabletimit
- B) lehtësojnë rrjedhjen e pluhurit në makinën e tabletimit
- C) parandalojnë ngjitjen e pluhurit në makinën e tabletimit
- D) bëjnë të mundur zbërthimin e tabletës në mjedis ujor

136. Cili nga faktorët e mëposhtëm është më i rëndësishëm në arritjen e efektit të lëndës vepruese?

- A) tretshmëria në ujë
- B) përqendrimi i lëndës vepruese pranë receptorit përkatës
- C) koha e shfaqjes së efektit pas përdorimit nga goja
- D) përqendrimi minimal i efektshëm

137. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk përdoret për rregullimin e pH-it të përgatesave të lëngëta që duhet të kenë pH të ngjashëm me lëngjet biologjike?

- A) citrati i natriumit
- B) dietilftalati
- C) acetati i natriumit
- D) fosfati monobazik i kaliumit

138. Cila nga kripërat e mëposhtme të kalciumit përdoret si lëndë për parandalimin e ngjitjes së tabletave në punsonet e makinës së tabletimit?

- A) sulfati i kalciumit
- B) stearati i kalciumit
- C) fosfati bazik i kalciumit i ujësuar
- D) karbonati i kalciumit

139. Tetraciklina përthithet me shumë pas përdorimit nga goja nqs merret

- A) para ushqimit
- B) me qumësht
- C) me kripëra të kalciumit
- D) me kripëra të hekurit

140. Matja e këndit të qetësisë alfa së një pluhuri shërben për të vlerësuar

- A) porozitetin
- B) dendësinë
- C) aftësinë për t'u njomur
- D) rrjedhshmërinë

141. Cili është funksioni i nitratit fenilmerkurik ne format farmaceutike

- A) lëndë antimikrobike
- B) lëndë acidifikuese
- C) lëndë antioksiduese
- D) lëndë njomëse

142. Shurupi që përgatitet "ex tempore" është

- A) shurup i thjeshtë që i shtohet "ex tempore" një lëndë vepruese

- B) shurup që përdoret për rregullimin e shijes së një emulsioni që merret nga goja
- C) një pluhur ose granulat nga i cili përftohet shurup nga shtimi i ujit
- D) një shurup pa lëndë konservuese

143. Cila nga lëndët e mëposhtme mund të përdoret si lëndë zbërthyesë?

- A) PVP
- B) PVA
- C) sakaroza
- D) glikolati sodik i amidonit

144. Cili nga acidet e mëposhtme, paraqet shkallën më të lartë të jonizimit kur ndodhet në tretësirë ujore?

- A) benzilpenicilina (pKa = 2.8)
- B) aspirina (pKa = 3.5)
- C) indometacina (pKa = 4.5)
- D) ibuprofeni (pKa = 5.2)

145. Termi dendësi aparente do të thotë

- A) vëllimi i zënë nga 1 g lëndë e ngurtë
- B) raporti midis porozitetit dhe dendësisë së vërtetë
- C) pesha e vëllimit aparent
- D) pesha e lëndës së ngurtë që zë vëllimin 1ml

146. Rruga e përdorimit në venë nuk është e përshtatshme për

- A) tretësira ujore
- B) tretësira vajore
- C) emulsione
- D) lëndë irrituese

147. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk është lëndë holluese?

- A) silici koloidal
- B) manitoli
- C) fosfati i kalciumit dibazik
- D) sorbitoli

148. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret më shpesh si lëndë izotonizuese?

- A) acidi algjinik
- B) glukozë
- C) lanolina
- D) metilceluloza

149. Polisorbati është

- A) një polisakarid
- B) një përzierje e estereve të sorbitanit me acide yndyrore
- C) një bashkëpolimer i sorbitanit me oksid etileni
- D) një bashkëpolimer i sorbitanit me oksid etileni i esterifikuar me acide yndyrore

150. Emulsioni i vajit të ricinit përdoret si:

- A) Antidiarreik
- B) Purgativ

- C) Zbutës
- D) Hidratues

151. Cila nga lëndët e poshtëshënuara bën pjesë tek bazat e vetëmulsionueshme?

- A) Gjalpi i kakaos
- B) Polisorbati 61
- C) Lanolina
- D) Vazelina

152. Formulimi [oleum helianthi 74 g, solutio ammonii hydroxydi 25 g] bëhet i plotë nëse shtojmë:

- A) Acid fosforik
- B) Alkool etilik
- C) Acid oleik
- D) Alkool metilik

153. Cili nga emulgatorët e mëposhtëm përdoret për përgatitjen e pomadave emulsione U/V?

- A) Sapuni kaliumit
- B) Alkooli cetilik
- C) Polisorbati 20
- D) Spen 60

154. Infuzioni ndryshon nga dekokcioni nga:

- A) Tretësi që përdoret
- B) Lloji i drogës bimore që përdoret
- C) Koha e vlimit
- D) Aparatura që përdoret

155. Cili nga emulgatorët e mëposhtëm përdoret për përgatitjen e pomadave emulsione V/U?

- A) Polisorbati 80
- B) Oleati i kalciumit
- C) Spen 65
- D) Përzierjet pluronike

156. Pezullitë kanë biodisponibilitet më të ulët sesa:

- A) Kapsulat
- B) Tabletat
- C) Emulsionet
- D) Tretësirat

157. Mucilagja e gomës arabike 30% sillet si :

- A) Trup pseudoplastik
- B) Xhel plastik
- C) Trup tiksotrop
- D) Trup njutonian

158. Procesi i perkolimit për përfitim e ekstrakteve ndryshon nga ai për përfitim e tinkturave vetëm nga fakti se:

- A) Në të mblidhen 1000 ml ekstrakt i përqendruar për 1 kg drogë, ndërsa për tinkturat perkolimi vazhdon deri sa droga të shterrojë.
- B) Si tretës për ekstraktet përdoret uji, ndërsa për tinkturat përdoret alkooli.

- C) Për përfitim të ekstrakteve ushtrohet temperaturë e lartë, ndërsa për tinkturat procesi zhvillohet në temperaturën e ambjentit.
D) Për përfitim të ekstrakteve ushtrohet tryzni mbikritike, ndërsa për tinkturat jo.

159. Ekstraktimi i kafeinës nga gjethet e çajit (*Coffea arabica*) bëhet nëpërmjet:

- A) Ekstraktimit me fluide mbikritike,
B) Reperkolimit
C) Ekstraktim me ultratinguj
D) Vibroekstraktim

160. Në cilin nga grupet e mëposhtme bën pjesë Qumështi kozmetik?

- A) Kremra dite
B) Kremra hidratues
C) Emulsione
D) Pomada

161. Ekstraktimi i floroglucinoleve nga *Hypericum perforatum* bëhet duke përdorur:

- A) CO₂ në gjendje mbikritike
B) Metanol
C) Etanol
D) Amoniak

162. Shpejtësia e ndarjes së fazave të një emulsioni mund të zvogëlohet në qoftë se:

- A) Ulet madhësia e grimcave
B) Ulet dendësia e mjedisit shpërndarës
C) Ulet veshtullia
D) Ulet forca e rëndesës

163. Në përgatesat gjysëm të ngurta bëjnë pjesë:

- A) Glicerolatet
B) Supozitorët
C) Emulsionet
D) Pezullitë

164. Cila nga bazat e mëposhtme është bazë për pomadat e tretshme në yndyrna?

- A) Algjinati i natriumit
B) Propilenglikoli
C) Stearina
D) Cetilsulfati i natriumit

165. Cila nga lëndët e mëposhtme është bazë për pomada hidrofille?

- A) Acidi stearik
B) Silikoni
C) Bentoniti
D) Akooli cetilik

166. Cila nga lëndët e mëposhtme është bazë për pomada emulsione V/U?

- A) Sapunet alkaline
B) Sapunet alkalino-tokësore
C) Alkooli cetilstearylilik

D) Parafina

167. Cila nga lëndët e mëposhtme është bazë për pomada emulsione U/V?

- A) Dylli i bletës
- B) Lanolina
- C) Alkooli polivinilik
- D) Metilceluloza

168. Nga kombinimi i një baze yndyrore me pluhur në përqendrim të lartë përftohet:

- A) Krem
- B) Pezulli
- C) Pastë
- D) Emulsion

169. Për të pëftuar një bazë kremi duhet të kombinojmë:

- A) Bazë yndyrore me ujë
- B) Pluhur dhe ujë
- C) Bazë yndyrore me pluhur
- D) Bazë hidrofile me emulgator

170. Cila nga lëndët e mëposhtme pengon depërtimin në lëkurë të rrezeve UV duke i përthithur ato?

- A) Hidrokinoni
- B) Dioksidi i Titanit
- C) Benzofenoni
- D) Oksidi i zinkut

171. Për ruajtjen e pomadave yndyrore nga oksidimi duhet shtuar:

- A) Nipaginë
- B) Acid benzoik
- C) Klorheksidinë
- D) alfa-tokoferole

172. Cili nga filtrat e mëposhtëm për mbrojtjen nga dielli reflekton rrezet e dritës UV:

- A) Benzofenoni
- B) Dioksidi i Titanit
- C) APAB
- D) Oksibenzoni

173. Faktori SPF:

- A) Mat shkallën e mbrojtjes nga rrezet UV
- B) Mat eritemën e shkaktuar nga rrezet UV
- C) Mat rezistencën e kremit ndaj ujit
- D) Mat sasinë minimale të rrezatimit

174. Barnat që merren në trajtë aerosoli:

- A) Pranohen më lehtë nga i sëmuri
- B) Përthithen më pak në aparatit tretës
- C) Janë më pak komode
- D) Përdoren doza më të mëdha

175. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret si gaz i ngjeshur për përgatitjen e aerosoleve?

- A) Metanoli
- B) Azoti
- C) CFC-11
- D) HFA-227

176. Gjatë përgatitjes së një pomade me acid salicilik në farmaci nuk duhet përdorur:

- A) Enë plastike
- B) Havan porcelani
- C) Spatul metalike
- D) Pllakë qelqi

177. Për ruajtjen e një pomade tip hidroxhel nga kontaminimi mikrobik përdoret:

- A) alfa-tokoferoli
- B) Acidi benzoik
- C) Vitamina E
- D) Acidi stearik

178. Sapuni më acarues për lëkurën është:

- A) Stearati i natriumit
- B) Stearati i amonit
- C) Stearati i kaliumit
- D) Stearati i trietanolaminës

179. Pasta e oksidit të zinkut (pasta zinci oxydi) është sistem:

- A) Dilatant
- B) Pseudoplastik
- C) Plastik
- D) Tiksotrop

180. Cila është trajta polimorfe më e qëndrueshme e gjalpfit të kakaos?

- A) Trajta beta
- B) Trajta alfa
- C) Trajta beta'
- D) Trajta gama

181. Në formë supozitori fenobarbitali sodik, i tretshëm në ujë, përthithet më mirë se fenobarbitali, i tretshëm në yndyrna, pasi:

- A) në rektumin bosh ka një sasi 1-3 ml lëngu uxor me pH =7.2 dhe duke qenë një sasi kaq e vogël ka aftësi tamponuese.
- B) në rektumin bosh ka sasi të madhe lëngu uxor me pH =7.2 që nuk ka aftësi tamponuese.
- C) në rektumin bosh ka sasi të madhe lëngu uxor me pH =7.2 që ka aftësi tamponuese.
- D) në rektumin bosh ka një sasi 1-3 ml lëngu uxor me pH =7.2 dhe duke qenë një sasi kaq e vogël nuk ka aftësi tamponuese.

182. Për optimizimin e procesit teknologjik të përgatitjes së supozitorëve, veçanërisht rritjen e temperaturës së shkrirjes përdorim:

- A) Alkool cetilik
- B) Stearat natriumi
- C) Njëstearat glicerili

D) Vaj ricini

183. Një vështirësi teknologjike, që haset shpesh gjatë përgatitjes së supozitorëve, është veshtullia e ulët e bazave të shkriara. Për të mënjanuar këtë problem shtojmë:

- A) Dyllë blete
- B) Spermacet
- C) Lecitinë
- D) Kolesterol

184. Gjatë përgatitjes së supozitorëve me shkrirje e derdhje në forma, humbjet në sasi të lëndëve të para duhen llogaritur në masën:

- A) 15%
- B) 10%
- C) 5%
- D) 3%

185. Barnat kardiotonike, nga të cilat kërkojmë një veprim të shpejtë, trupëzohen si:

- A) Supozitor ku shpërndahe në trajtë emulsioni i tipit V/U
- B) Supozitor ku shpërndahe në trajtë tretësirë
- C) Supozitor ku shpërndahe në trajtë pezullie
- D) Supozitor ku shpërndahe në trajtë emulsioni U/V

186. Sapunëzimi i Oleum Helianthi 50 g, Alcoholum 10 g, Aqua destillata q.s. është i plotë nëse shtojmë:

- A) Stearat Natriumi
- B) Lanolinë
- C) Vazelinë
- D) Hidroksid kaliumi

187. Emulgatori i mëposhtëm ka origjinë natyrore:

- A) Goma arabike
- B) KMC-Na
- C) Alkooli polivinilik
- D) Polisorbati 20

188. Infuzioni ndryshon nga macerimi nga:

- A) Tretësi që përdoret.
- B) Temperatura e zhvillimit të operacionit.
- C) Aparatura e përdorur për këtë proces
- D) Lehtësia e kryerjes së procesit.

189. Cili nga raportet e mëposhtme drogë bimore – ekstrakt zbatohet për ekstraktet e lëngëta që përftohen me perkolim:

- A) 1000 ml për 1 kg drogë
- B) 40-60 ml për 100 g drogë
- C) 50 ml për 100 g drogë
- D) 800 ml për 1000 g drogë

190. Shpejtësia e sedimentimit të fazës së ngurtë të një pezullie mund të rritet në qoftë se:

- A) Rritet madhësia e grimcave

- B) Rritet dendësia e mjedisit shpërndarës
- C) Rritet veshtullia
- D) Rritet nxitimi i rënies së lirë

191. Mucilagja e gomës tragakantë 2% sillet si:

- A) Trup pseudoplastik
- B) Trup tiksotrop
- C) Lëndë dilatante
- D) Trup njutonian

192. Infuzet filtrohen:

- A) Mbi temperaturën 30°C
- B) Në temperaturë vlimi
- C) Mbi temperaturën kritike
- D) Në temperaturë mjedisi

193. Për përftimin e ekstraktit të gjetheve të senës përdoret procesi i:

- A) Macerimit
- B) Infuzionit
- C) Dekoksionit
- D) Perkolimit

194. Ekstraktimi i epikatekinave nga farat e rrushit bëhet duke përdorur:

- A) Dioksid karboni
- B) Metanol 40%
- C) Etanol 70%
- D) Amoniak

195. Cila nga metodat e mëposhtme përdoret për përftimin e ekstraktit të fryteve të boronicës (Myrtilli Fructus)?

- A) Macerimi
- B) Infuzioni
- C) Dekoksioni
- D) Perkolimi

196. Pomadat mund të homogjenizohen duke përdorur:

- A) Mullirin me rruaza
- B) Aparatin Eureka
- C) Mullirin me 3 cilindra
- D) Aparatin Kuet

197. Për cilin nga veprimet e mëposhtme përdoret Butil- hidroksi- tolueni?

- A) Veprim baktericid
- B) Veprim bakteriostatik
- C) Veprim antioksidues
- D) Veprim antimykotik

198. Në cilin nga grupet e mëposhtme bën pjesë Acidi benzoik?

- A) Lëndë konservuese
- B) Lëndë antioksiduese

- C) Lëndë emulsionuese
- D) Lëndë zbutëse

199. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk është gjithmonë i pranishëm në një specialitet farmaceutik?

- A) ambalazhi parësor
- B) ambalazhi dytësor
- C) etiketa e jashtme
- D) etiketa e brendshme

200. Dokumentacioni i marrjes së lejes për shitje të barnave xhenerikë kërkon të dhëna të studimeve të

- A) farmakologjisë
- B) toksikologjisë
- C) klinike
- D) biodisponibilitetit

201. Përgatesat që nuk mund të përgatiten në farmaci janë:

- A) përgatesa magjistrale
- B) përgatesa oficinale
- C) përgatesa xhenerike
- D) përgatesa spitalore

202. Me termin bazë klasifikohen eksipientët që transportojnë lëndën vepruese në përgatesat

- A) e lëngëta
- B) e gazta
- C) e ngurta
- D) tretësira

203. Me termin vehikul klasifikohen eksipientët që transportojnë lëndën vepruese në përgatesat

- A) xhele
- B) e ngurta
- C) gjysmë të ngurta
- D) e lëngëta

204. Pilulat janë forma farmaceutike

- A) të gazta
- B) të lëngëta
- C) të ngurta
- D) gjysmë të ngurta

205. Çfarë ngjyre duhet të ketë etiketa në barnat që i dorëzohen të sëmurit për përdorim të brendshëm?

- A) të kuqe
- B) të bardhë
- C) të verdhë
- D) të kaltër

206. Çfarë ngjyre duhet të ketë etiketa në barnat që i dorëzohen të sëmurit për përdorim të jashtëm?

- A) të kuqe

- B) të bardhë
- C) të verdhë
- D) të kaltër

207. Përgatesa parenterale me vëllim të madh quhen tretësirat per injeksion që kanë një vëllim më të madh se

- A) 100 ml
- B) 250 ml
- C) 500 ml
- D) 1000 ml

208. Përgatesa parenterale me vëllim të vogël quhen tretësirat per injeksion që kanë vëllim deri në

- A) 2 ml
- B) 10 ml
- C) 50 ml
- D) 100 ml

209. OBSH-ja publikon

- A) farmakopenë europiane
- B) formularin terapeutik
- C) farmakopenë ndërkombëtare
- D) formularin farmaceutik

210. Në cilin shtet nuk ka farmakope homeopatike?

- A) Francë
- B) Gjermani
- C) Itali
- D) SHBA

211. Në Bashkimin Europian produktet homeopatike klasifikohen si:

- A) integrorë
- B) produkte bimore
- C) produkte të sintezës
- D) barna

212. Gjени pohimin e gabuar. Çlirimi i barit mund të përndryshohet duke ndikuar në:

- A) shpejtësinë
- B) kohën
- C) vendin e veprimit
- D) eliminimin e barit

213. Cili nga pohimet në lidhje me format farmaceutike me çlirim të përndryshuar është i gabuar?

- A) rritet complianca e pacientit
- B) kosto e krahasuar me e lartë sesa e formave të zakonshme
- C) rrezik ekonomik më i vogël
- D) rrisin efektshmërinë e veprimit farmakologjik

214. Lënda vepruese paraqet probleme të përthithjes "in vivo" në qoftë se tretshmëria e saj në ujë në 37 gradëC është më e vogël se

- A) 10 mg/ml
- B) 5 mg/ml

- C) 2 mg/ml
- D) 1 mg/ml

215. Personi i kualifikuar që ka për detyrë të kontrollojë zbatimin korrekt të GMP-së në një industri farmaceutike është:

- A) Drejtuesi teknik
- B) Shefi i sektorit të prodhimit
- C) Shefi i sektorit të kontrollit të cilësisë
- D) Përgjegjësi i sektorit të garantimit të cilësisë

216. Gjени pohimin e gabuar. Nxehtësia në procesin e tharjes mund të transferohet me:

- A) rrezatim termik
- B) konveksion
- C) përcjellshmëri
- D) ndajthithje gazi

217. Garantimi i cilësisë së një produkti farmaceutik shprehet skematikisht me anën e rrathëve bashkëqendrorë. Rendisni nga më i jashtëmi tek më i brendshmi tre elementët e mëposhtëm të cilësisë:

- A) GMP, Kontrolli i cilësisë, Garantimi i cilësisë
- B) GMP, Garantimi i cilësisë, Kontrolli i cilësisë
- C) Garantimi i cilësisë, Kontrolli i cilësisë, GMP
- D) Garantimi i cilësisë, GMP, Kontrolli i cilësisë

218. Proçedura që bën të mundur realizimin e një dokumentacioni që përmbledh provat e kryera në faktorët e prodhimit është

- A) Kontrolli përfundimtar i cilësisë
- B) Konvalidimi
- C) Autoinspektimi
- D) Proçedura operative standard

219. Lëndët pirogjene:

- A) janë fluore
- B) çaktivizohen nga baktericidet
- C) nuk kalojnë nëpërmjet filtrave sterilizues
- D) i rezistojnë temperaturave më të larta sesa atyre të përdorura në procesin e sterilizimit

220. Lokalet që shërbejnë për përgatitjet që bëhen në mjedise sterile klasifikohen në klase A-B-C-D. Cili prej mjediseve quhet ndryshe edhe klasa 100?

- A) A
- B) B
- C) C
- D) D

221. Testi LAL përdoret për të verifikuar

- A) efikasitetin e proçesit të sterilizimit
- B) praninë e lëndëve pirogjene të çdo natyre
- C) praninë e endotoksinave bakterore
- D) praninë e baktereve

222. Cila është ajo karakteristikë e filtrave që shpreh sasinë e fazës së ngurtë, të shprehur në gram, që një filtër është në gjendje të mbajë, përpara se të bllokohet tërësisht?

- A) Kapaciteti
- B) Efikasiteti
- C) Shkalla e filtrimit
- D) Poroziteti

223. Cila është ajo karakteristikë e filtrave që shpreh madhësinë e grimcave më të vogla që filtri mund të mbajë?

- A) Kapaciteti
- B) Efikasiteti
- C) Shkalla e filtrimit
- D) Poroziteti

224. Cila është ajo karakteristikë e filtrave që shpreh saktësinë në mbajtjen e grimcave me një madhësi të caktuar?

- A) Kapaciteti
- B) Efikasiteti
- C) Shkalla e filtrimit
- D) Poroziteti

225. Klasifikimi i tretësirave në tretësira oficinale, magjistrale dhe industriale është klasifikim sipas

- A) natyrës së tretësit
- B) mënyrës së formulimit
- C) mënyrës së përgatitjes
- D) mënyrës së veprimit

226. Proçesi i autoklavimit garanton

- A) sterilitetin e përgatesës
- B) apirogjenitetin
- C) izotonicitetin
- D) rregullimin e pH-it

227. Etanoli është një tretës

- A) me konstante dielektrike të vogël
- B) me konstante dielektrike mesatare
- C) me konstante dielektrike të lartë
- D) i papërziueshëm më ujë

228. Cila nga vetitë e mëposhtme në lidhje me ultrafiltrat nuk është e saktë?

- A) mbajnë lëndët pirogjene
- B) mbajnë kripërat inorganike
- C) mbajnë viruset
- D) mbajnë mikroorganizmat

229. Nëse në formulën e një recete magjistrale shkruhet "alkool i holluar" pa ndonjë specifikim tjetër atëherë bëhet fjalë për alkool në përqendrimin

- A) 30 %
- B) 50 %
- C) 70 %

D) 96 %

230. Në përgatitjen e tretësirës alkoolike të jodit 1% gjen zbatim procesi i solubilizimit me

- A) bashkëtrretës (alkool)
- B) lëndë tensiovepruese
- C) zvogëlim të madhësisë së grimcave
- D) kompleksoformim

231. Një përgatesë konsiderohet sterile atëhere kur

- A) është përgatitur në kushte aseptike
- B) në të janë shtuar lëndë antimikrobike
- C) është sterilizuar në ambalazhin e saj përfundimtar
- D) lëndët e para janë sterilizuar para përgatitjes

232. Përgatitja e tretësirës përshkumëzuese parashikon eliminimin e një papajtueshmërie. Për çfarë papajtueshmërie bëhet fjalë?

- A) kimike
- B) fizike
- C) farmakologjike
- D) terapeutike

233. Tretësi joujor i përdorur në përgatitjen e pikave për veshë të kloramfenikolit 1% është

- A) alkooli
- B) glicerina
- C) propilenglikoli
- D) polietilenglikoli

234. Cila nga lëndët e mëposhtme përdoret për qartësimin e shurupeve (që përmbajnë tanine) me mjete kimike?

- A) talku 1%
- B) karboni 0.5%
- C) karbonati i magnezit
- D) tretësira e holluar e albuminës

235. Shurupi i thjeshtë është tretësirë ujore e përqendruar e sheqerit. Sa është përqendrimi i kësaj tretësire?

- A) 65% p/v
- B) 65% v/v
- C) 64% p/p
- D) 65% v/p

236. Sistemet me çlirim të përndryshuar të barit quhen ndryshe

- A) sisteme polimerike
- B) sisteme aminike
- C) sisteme depozitë
- D) sisteme matriciale

237. Për të gjetur shpejtësinë e shpërhapjes së lëndës vepruese nga sistemet me çlirim të përndryshuar përdoret

- A) ekuacioni i Noyes-Ëhitney
- B) ekuacioni i Fick-ut
- C) ekuacioni i Stoksit
- D) ekuacioni i Arrheniusit

238. Cili nga elementët e mëposhtëm duhet shënuar gjithmonë në etiketën e një përgatëse galenike?

- A) emri i farmacisë/farmacistit që ka bërë përgatitjen
- B) emri i pacientit
- C) çmimi
- D) përbërja dhe sasia e të gjitha lëndëve të përdorura

239. Shurupi i thjeshtë është tretësirë ujore e përqendruar e sheqerit. Sa është përqendrimi i kësaj tretësire?

- A) rreth 33% p/v
- B) rreth 66% p/v
- C) rreth 77% p/v
- D) rreth 87% p/v

240. Sa është tretshmëria e sheqerit në ujë në 20 gradë C?

- A) 0.6 g/ml
- B) 1 g/ml
- C) 2 g/ml
- D) 3 g/ml

241. Cili nga polimerët e mëposhtëm nuk përdoret në ambalazhimin e barnave?

- A) polipropileni
- B) polietilenglikoli
- C) polietileni
- D) kloruri i polivinilit

242. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar në lidhje vetitë e aluminit si material ambalazhues?

- A) i papërshkueshëm nga avujt e ujit
- B) i papërshkueshëm nga drita
- C) shumë i plogët ndaj yndyrnave
- D) aftësi e lartë për të përthithur nxehtësine

243. Në çfarë përqendrimi tretësira e acidit borik është izotonike me lotët?

- A) 1 %
- B) 1.9 %
- C) 2.9%
- D) 3 %

244. Cila nga rrëshirat e mëposhtme nuk e duron nxehtësinë?

- A) fenolike
- B) aminike
- C) ureike
- D) polietilenike

245. Për të ambalazhuar 250 g shurup të thjeshtë është më e përshtatshme të përdoret një shishe me vëllim:

- A) 200 ml
- B) 250 ml
- C) 300 ml
- D) 350 ml

246. Në qoftëse ju kërkohet të përgatisni 1000 ml shurup të thjeshtë, sa është sasia e ujit që ju nevojitet?

- A) rreth 850 g
- B) rreth 650 g
- C) rreth 550 g
- D) rreth 460 g

247. Pesha e sheqerit dhe ujit të nevojshëm për përgatitjen e shurupit të thjeshtë respektojnë një raport të caktuar. Sa është ky raport?

- A) 3:1
- B) 2:1
- C) 1:2
- D) 1:3

248. Në rast se farmacisti përgatit një përgatesë galenike për përdorim të brendshëm, a është i detyruar ai të shënojë në etiketë specifikimin "për përdorim të brendshëm"?

- A) Po, në rast se mund të krijohen dyshime mbi rrugën e përdorimit
- B) Po, por vetëm për përgatesat e formularit farmaceutik
- C) Po, gjithmonë
- D) Po, por vetëm për përgatesat e lëngëta

249. Cila nga rrugët e përdorimit të barnave ka ndryshueshmërinë më të vogël në biodisponibilitet?

- A) nga goja
- B) në venë
- C) në muskul
- D) nën lëkurë

250. Përdorimi i metilcelulozës si lëndë ndihmëse në përgatesat oftalmike ka për qëllim të

- A) mbrojtë lëndën vepruese nga oksidimi
- B) bëjë përgatesën izotonike me lotët
- C) shtojë kohën e kontaktit të përgatesës
- D) zvogëlojë inflamacionin

251. Cili është procesi i parë që duhet të ndodhë në mënyrë që lënda vepruese e tabletës të përthithet?

- A) jonizimi i lëndës vepruese
- B) tretja e lëndës vepruese në pështymë
- C) tretja e lëndës vepruese në gjak
- D) tretja e lëndës vepruese në lëngjet GI

252. Kur nga matja e aftësisë rrjedhëse së një pluhuri rezulton se ai ka një kënd pushimi midis 25 dhe 30 gradë, atëherë aftësia e tij rrjedhëse është:

- A) shumë e mirë
- B) e mirë
- C) e pranueshme

D) e pamjaftueshme

253. Vehikuli i përdorur për hollim në përgatitjen e përgatesave homeopatike është

- A) Glicerina
- B) Laktoza
- C) Amidoni
- D) Uji

254. Një bar me natyrë acide A i shtohet tretësirës ujore së një bari tjetër acid B dhe si rrjedhojë pH-i i tretësirës ndryshon fare pak. Në këtë rast mund të themi se tretësira është:

- A) izotonike
- B) e ngopur
- C) e tamponuar
- D) izoosmotike

255. Kur nga matja e aftësisë rrjedhëse së një pluhuri rezulton se ai ka një kënd pushimi midis 10 dhe 20 gradë, atëherë aftësia e tij rrjedhëse është:

- A) shumë e mirë
- B) e mirë
- C) e pranueshme
- D) e pamjaftueshme

256. Prova e njëtrajtshmërisë në peshë të kapsulave kryhet në:

- A) kapsulat bosh
- B) kapsulat e mbushura dhe të hapura
- C) përmbajtjen e kapsulës
- D) kapsulat e mbushura dhe të mbyllura

257. Për të përfutur lakoren e biodisponibilitetit të një bari që merret nga goja, me anë të dozimit të barit ose metabolitëve të tij në urinë, është e nevojshme që marrja e kampionëve të bëhet:

- A) për një kohë që e kalon të paktën një deri në tre herë kohën e gjysmëjetës së barit
- B) për një kohë që e kalon të paktën një deri tre orë kohën e gjysmëjetës së barit
- C) për një kohë që e kalon të paktën tre deri në pesë herë kohën e gjysmëjetës së barit
- D) për një kohë që e kalon të paktën shtatë deri në dhjetë herë kohën e gjysmëjetës së barit

258. Në format farmaceutike të ngurta, gjysme të ngurta ose të lëngëta, karbonati i kalciumit është i papajtueshëm me:

- A) penicilinat
- B) kloramfenikolin
- C) tetraciklinat
- D) antihistaminikët

259. Në format farmaceutike gjysme të ngurta ose të lëngëta, karbonati i kalciumit është i papajtueshëm me:

- A) stearatin e natriumit
- B) stearatin e magnezit
- C) HPMC
- D) celulozën

260. Ciklodekstrinat janë të përbëra nga njësi

- A) sakaroze
- B) fruktoze
- C) galaktoze
- D) glukoze

261. Tretësira e Lugolit (e përshkruar në Formularin Farmaceutik) është

- A) tretësirë ujore
- B) tretësirë alkoolike
- C) tretësirë ujqorë-alkoolike
- D) tretësirë glicerimore

262. Në cilën nga format farmaceutike të mëposhtme dukuria e polimorfizmit ndikon në biodisponibilitet?

- A) tretësira sterile me vëllim të madh
- B) tretësira sterile me vëllim të vogël
- C) tretësira për përdorim nga goja
- D) pezulli për përdorim nga goja

263. Lipozomet mund të përkufizohen si

- A) bashkëpolimerë të përfutuar nga vinilacetati dhe etileni
- B) celuloze e modifikuar me fosfolipide
- C) sisteme të përbëra nga fosfolipide në shtresë dyfishe
- D) pjesë e membranave të organizmave qelizore

264. Polimerët akrilikë me grupe acidike dhe bazike të forta përdoren në formulimin e sistemeve me çlirim të kontrolluar të barit. Në përgjithësi këto polimerë janë të tretshëm në

- A) të gjitha vlerat e pH-it
- B) në pH acid
- C) në pH bazik
- D) në pH 7

265. Cili nga elementët e një përgatëse galenike magjistrale nuk ndikon në efikasitetin e lëndës konservuese?

- A) lënda vepruese
- B) materiali i ambalazhit
- C) mbyllja e ambalazhit
- D) përqendrimi i lëndës vepruese

266. Cili nga përbërësit e mëposhtëm nuk është i detyrueshëm të shtohet në përgatësat oftalmike të lëngëta në dozë të vetme?

- A) lënda vepruese
- B) tretësi
- C) lënda konservuese
- D) lënda izotonizuese

267. Polimerët akrilikë me grupe karboksilike, të përdorura në formulimin e sistemeve me çlirim të kontrolluar të barit, zakonisht, janë të tretshëm në mjedise ujore

- A) me pH acid
- B) me pH bazik

- C) me pH asnjanes
- D) në të gjitha pH-et

268. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk është lëndë konservuese?

- A) kloruri i benzalkonit
- B) polisorbati 80
- C) propil p-hidroksibenzoati
- D) acidi benzoik

269. Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk i përket tabletave që e çlirojnë lëndën vepruese në gojë?

- A) tableta të veshura me cipë
- B) tableta të paveshura me cipë
- C) tableta që treten përpara se të gëlltiten
- D) tableta që zbërthehen brenda 3 minutash

270. Cila nga vetitë e mëposhtme të pluhurave mund të konsiderohet si karakteristikë primare?

- A) aftësia për t'u ngjeshur
- B) forma e grimcave
- C) dendësia e grimcave
- D) poroziteti i grimcave

271. Termi "barasvlerës farmaceutikë" përdoret për:

- A) lëndë vepruese që u ka mbaruar mbrojtja nga patenta prej 5 vjetësh
- B) forma farmaceutike që u ka mbaruar mbrojtja nga patenta prej 5 vjetësh
- C) forma farmaceutike që përmbajnë të njëjtën sasi terapeutikisht aktive të një lënde vepruese
- D) forma farmaceutike të njëjta që përmbajnë të njëjtën sasi, të së njëjtës lëndë vepruese

272. Kur nga matja e aftësisë rrjedhëse së një pluhuri rezulton se ai ka një kënd pushimi midis 40 dhe 50 gradë, atëherë kjo aftësi është:

- A) shumë e mirë
- B) e mirë
- C) e pranueshme
- D) e pamjaftueshme

273. Cili nga pohimet në lidhje me polimorfizmin është i gabuar?

- A) ndryshon tretshmërinë e lëndës
- B) ndryshon vetitë fiziko-kimike të lëndës
- C) nuk ndryshon vetitë e lëndëve organike
- D) nuk vërehet në lëndët në gjendje të lëngët

274. Sorbitoli i përdorur si lëndë ndihmëse në përgatitjen e tabletave që mbahen në gojë përftohet nga:

- A) tretësira e përqendruar e glukozës
- B) tretësira e përqendruar e fruktozës
- C) tretësira e përqendruar e sakarozës
- D) tretësira e përqendruar e sakarinës

275. Manitoli i përdorur si lëndë ndihmëse në përgatitjen e tabletave që mbahen në gojë përftohet nga:

- A) celuloza
- B) fruktoza
- C) sakaroza
- D) sakarina

276. Kur nga matja e aftësisë rrjedhëse të një pluhuri rezulton se ai ka një kënd pushimi midis 30 dhe 40 gradë, atëherë kjo aftësi është:

- A) shumë e mirë
- B) e mirë
- C) e pranueshme
- D) e pamjaftueshme

277. Tabletat e veshura me një polimer që ka në molekulë një grup dimetilaminik treten lehtë në stomak. Arsyeja qëndron në faktin se veshja ka natyrë

- A) acide
- B) bazike
- C) amfolite
- D) anionike

278. Xhelatina në tretësinë ujore është e papajtueshme me

- A) acidin algjinik
- B) gomën arabike
- C) tragakantën
- D) etilcelulozën

279. Format farmaceutike me çlirim të përndryshuar ndryshojnë nga format farmaceutike të zakonshme

- A) vetëm për shpejtësinë e çlirimit të lëndës vepruese
- B) për shpejtësinë dhe vendin e çlirimit të lëndës vepruese
- C) vetëm për vendin e çlirimit të lëndës vepruese
- D) për shkak të rrugës së ndryshme të përdorimit

280. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk përdoret në përgatitjen e tretësirës alkoolike të jodit (sipas Formularit Farmaceutik)?

- A) joduri i kaliumit
- B) jodi
- C) uji i distiluar
- D) fenoli

281. A mund të konsiderohen pluhurat një formë farmaceutike e veçantë?

- A) Po
- B) Jo
- C) Po, nëq granuloohen
- D) Po, nëq tabletohen

282. Cila nga vetitë e mëposhtme të pluhurave mund të konsiderohet si karakteristikë sekondare?

- A) madhësia e grimcave
- B) forma e grimcave
- C) sipërfaqja e grimcave
- D) poroziteti i grimcave

283. Ruajtja e mirë e një përgatëse galenike magjistrale nuk varet nga

- A) zgjedhja e ambalazhit
- B) përcaktimi i qartë i mënyrës së përgatitjes
- C) nga kushtet e ruajtjes
- D) nga përzgjedhja e lëndëve antimikrobike

284. Termi "alternativë farmaceutike" përdoret

- A) lëndë vepruese që zakonisht nuk përdoren për përgatitjen e specialiteteve farmaceutike
- B) forma farmaceutike që nuk gjendet në treg por mund të përgatitet në farmaci
- C) forma farmaceutike që përmbajnë të njëjtën sasi terapeutikisht aktive të një lëndë vepruese
- D) forma farmaceutike të njëjta që përmbajnë të njëjtën sasi, të së njëjtës lëndë vepruese

285. Sa është kufiri maksimal i lejueshëm i përmbajtjes në lagështi të një pluhuri i cili do të grimcohet/pluhurizohet në të thatë?

- A) 0.5%
- B) 1%
- C) 5%
- D) 10%

286. Cili nga aparatet e mëposhtme të përdorur në procesin e pluhurizimit klasifikohet si mulli me trup të lëvizshëm?

- A) mulliri me thika
- B) mulliri me rruaza
- C) mulliri me çekiçë
- D) mulliri me energji fluide

287. Glicerina ka dendësi 1.26 g/ml. Në rast se glicerina i shtohet ujit atëherë ajo

- A) rri në sipërfaqe
- B) bie në fund
- C) përzihet me ujin
- D) bashkëvepron me ujin

288. Farmakopeja parashikon provën e thërrmueshmërisë "friabilitetit" për kontrollin e cilësisë së tabletave. Numri i tabletave që nevojiten për kryerjen e provës është:

- A) 6
- B) 10
- C) 12
- D) 20

289. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk përdoret si lëndë izotonizuese në përgatësat parenterale?

- A) acidi borik
- B) kloruri i natriumit
- C) glukozja
- D) kloruri i benzalkonit

290. Në një sistem terapeutik transdermik depozitë, çlirimi dhe shpërhapja e lëndëve vepruese në lëkurë është në varësi të

- A) karakteristikave të membranës
- B) kapacitetit të depozitës

- C) përbërjes së depozitës
- D) lartësisë së depozitës

291. Cila nga rrugët e mëposhtme të përdorimit të barnave është e papërshtatshme për barnat që i nënshtrohen efektit të kalimit të parë?

- A) nga goja
- B) nën gjuhë
- C) transdermike
- D) vaginale

292. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk përdoret si lëndë antioksiduese?

- A) acidi benzoik
- B) acidi askorbik
- C) tokoferoli
- D) bisulfiti i natriumit

293. Cila nga lëndët e mëposhtme është lëndë holluese në përgatitjen e tabletave?

- A) kaolina
- B) manitoli
- C) silici koloidal
- D) xhelatina

294. Poroziteti i tabletave është i lidhur me

- A) zbërthimin, fortësinë dhe qëndresën e tyre
- B) shumën e vëllimit aparent dhe të vërtetë
- C) me raportin e vëllimit aparent me atë të vërtetë
- D) me prodhimin midis vëllimit aparent me atë të vërtetë

295. Në një sistem terapeutik transdermik matricial, çlirimi dhe shpërhapja e lëndëve vepruese në lëkurë është në varësi të

- A) përbërjes dhe strukturës së matricës
- B) sipërfaqes së matricës
- C) aftësisë së matricës për t'u ngjitur
- D) elasticitetit të matricës

296. Cila nga karakteristikat e mëposhtme është e njëjtë për lëndët polimorfe?

- A) fortësia
- B) formula kimike
- C) temperatura e shkries
- D) forma kristalore

297. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk ka veti lidhëse kur përdoret si eksipient për tableta?

- A) rrjedhësit e celulozës
- B) povidoni
- C) rrjedhësit e amidonit
- D) stearatet

298. Cila nga lëndët e mëposhtme është më hidrofille?

- A) silikati i magnezit dhe zinkut
- B) stearati i zinkut

- C) stearati i aluminit
- D) karboni bimor pluhur

299. Për të përftuar lakoren e biodisponibilitetit të një bari që merret nga goja, me anë të kontrollit të niveleve plazmatike, është e nevojshme që marrja e kampionëve të bëhet

- A) për një kohë që e kalon të paktën një herë kohën e gjysmëjetës së barit
- B) për një kohë që e kalon të paktën një orë kohën e gjysmëjetës së barit
- C) për një kohë që e kalon të paktën tri herë kohën e gjysmëjetës së barit
- D) për një kohë që e kalon të paktën katër orë kohën e gjysmëjetës së barit

300. Tinktura e jodit (e përshkruar në Formularin Farmaceutik) përmban si vehikul

- A) ujë
- B) alkool 50%
- C) alkool 70%
- D) alkool 96%

301. Cila nga lëndët ndihmëse të përdorura në formulimin e tabletave ka veti përthithëse?

- A) silici koloidal
- B) dietilftalati
- C) kloruri i natriumit
- D) stearati i kalciumit

302. Vëllimi i tretësit që nevojitet për të tretur 1 g lëndë, të përshkruar si "e tretshme me lehtësi" nga USP-ja është:

- A) më i vogël se 1 ml
- B) nga 1 deri në 10 ml
- C) nga 10 deri në 30 ml
- D) nga 30 deri në 100 ml

303. Cila nga lëndët nuk përdoret për të krijuar veshjen izoluese gjatë procesit të drzhifikimit?

- A) acetoftalati i celulozës
- B) amidoni
- C) acetotftalati i polivinilit
- D) polibutilmetakrilati

304. Fuqia konservuese e acidit benzoik është më e madhe në mjedis acid sesa në mjedis asnjës. Kjo ndodh për shkak se

- A) bakteret janë më të ndjeshme në mjedis acid
- B) përqendrimi që arrihet brenda qelizave bakterore është më i madh
- C) jonet hidrogjen hyjnë më shpejt në qelizat bakterore
- D) qëndrueshmërisë më të madhe të lëndës në mjedis acid

305. Një farmacist që përgatit një përgatesë galenike oficinale është i detyruar të shkruajë në etiketë

- A) vetëm emrin e lëndës vepruese
- B) të gjithë përbërësit e përgatesës
- C) emrin e përgatesës dhe sasinë e përgatitur
- D) vetëm përbërësit që ai konsideron të rëndësishëm

306. Në rast se farmacisti përgatit një përgatesë galenike për përdorim të jashtëm, a është ai i detyruar që të shënojë në etiketë specifikimin "për përdorim të jashtëm"?

- A) Po
- B) Jo
- C) Po, në rast se mund të krijohen dyshime mbi rrugën e përdorimit
- D) Po, por vetëm për përgatesat e formularit farmaceutik

307. Në përgatitjen e tretësirës alkoolike të jodit 2%, parashikohet përdorimi i jodurit të kaliumit, i cili ka funksion

- A) vetëm konservues
- B) vetëm kompleksoformues
- C) kompleksoformues dhe konservues
- D) kompleksoformues dhe stabilizues

308. Cila nga lëndët ndihmëse ka funksion lidhës në tabletat me çlirim të përndryshuar?

- A) silici koloidal
- B) laktoza
- C) celuloza mikrokristallore
- D) hidroksipropilmetilceluloza

309. Prania e ushqimit në traktin gastro-intestinal ndikon në përthithjen e

- A) lidokainës
- B) grizeofulvinës
- C) insulinës
- D) heparinës

310. Cila nga rrugët e përdorimit të barnave ka ndryshueshmërinë më të madhe në biodisponibilitet?

- A) nga goja
- B) në venë
- C) në muskul
- D) nën lëkurë

311. Benzeni është një tretës

- A) me konstante dielektrike të vogël
- B) me konstante dielektrike mesatare
- C) me konstante dielektrike të lartë
- D) me konstante dielektrike shumë të lartë

312. Tretësira ujore e glukozës është izotonike me plazmën kur është në përqendrimin:

- A) 1%
- B) 5%
- C) 10%
- D) 40%

313. Cila formë farmaceutike nuk këshillohet që të merret në të njëjtën kohë me qumështin?

- A) shurupet
- B) tinkturat
- C) tabletat gastrorezistente
- D) tabletat e veshura me hidroksipropilmetilcelulozë

314. Cili nga ushqimet/lëngjet e mëposhtme nuk duhet marrë në të njëjtën kohë me tabletat e disulfiramit?

- A) uji
- B) qumeshti
- C) kafja
- D) alkooli

315. Në rast se vlera e ekstraktimit hepatic të një bari hipotetik është 1, atëherë ai bar duhet të formulohet si:

- A) tretësirë për përdorim nga goja
- B) pezulli për përdorim nga goja
- C) tabletë gastrorezistente
- D) tretësirë parenterale

316. A është i autorizuar farmacisti të përgatisë përgatesa galenike të formularit farmaceutik?

- A) Po, por vetëm në rast se autorizohet nga mjeku
- B) Po, por vetëm përgatesa për përdorim të jashtëm
- C) Po
- D) Jo

317. Cila është arsyeja që tabletat e veshura me polimerë që kanë në molekulë një pjesë acide dhe një estere, treten lehtë në zorrë?

- A) veshja ka karakter amfolit
- B) veshja ka karakter kationik
- C) veshja, në mjedis acid, pëson sapunëzimin të pjesës esterore
- D) veshja ka karakter acid

318. Cila është metoda që përdoret për përgatitjen e barnave homeopatike?

- A) metoda e Avogadros
- B) metoda e Korsakovit
- C) metoda e Hahnemanit
- D) metoda e Hipokratit

319. Biodisponibiliteti i lëndës vepruese në format farmaceutike të zakonshme është në varësi të:

- A) karakteristikave fiziko-kimike të lëndës vepruese
- B) karakteristikave fiziko-kimike të lëndëve ndihmëse
- C) karakteristikave të formës farmaceutike
- D) të proceseve teknologjike të përdorura

320. Një sistem terapeutik transdermik nuk mund të formulohet si:

- A) matricë njështrësore
- B) matricë shumështrësore
- C) depozitë, e cila nga njëra anë ka një membranë
- D) depozitë e mbyllur hermetikisht

321. Formuluesi duhet të marrë parasysh efektin e kalimit të parë nëse ai është duke formuluar një formë farmaceutike:

- A) nga goja
- B) rektale
- C) transdermike
- D) në venë

322. Çlirimi i lëndës vepruese nga sistemet monolite që bymehen kontrollohet nga
- A) shpërhapja në lëngun e bymimit
 - B) tretja e plota e matricës
 - C) zbërthimi i matricës
 - D) erozioni i matricës
323. Cila nga lëndët e mëposhtme mund të përdoret si lëndë izotonizuese në përgatitjen e pikave për sy të nitratis të argjendit?
- A) kloruri i kaliumit
 - B) kloruri i natriumit
 - C) sulfati i natriumit
 - D) nitrati i kaliumit
324. Në rast se farmacisti përgatit një përgatesë magjistrale, a është i detyruar të shkruajë në etiketë datën e përgatitjes?
- A) Po, por vetëm nëse e kërkon mjeku
 - B) Po
 - C) Jo
 - D) Po, për vetëm në rast se lënda vepruese është e paqëndrueshme
325. Prova e njëtrajtshmërisë në përmbajtje të formave farmaceutike të ngurta njëdozëshe bazohet në përcaktimin e
- A) përmbajtjes individuale në lëndë vepruese në një numër të caktuar njësisish të zgjedhur në mënyrë rastësore
 - B) përmbajtjes mesatare në lëndë vepruese në një numër të caktuar njësisish të zgjedhur në mënyrë rastësore
 - C) të masës individuale të kampionëve të zgjedhur në mënyrë rastësore
 - D) të masës mesatare të kampionëve të zgjedhur në mënyrë rastësore
326. Cila nga metodat e mëposhtme nuk përdoret në përcaktimin e madhësisë së grimcave?
- A) mikroskopia
 - B) sitja
 - C) sedimentimi
 - D) piknometria me helium
327. Poliakrilatet përdoren gjatë procesit të
- A) veshjes me cipa
 - B) mikronizimit
 - C) filtrimit
 - D) emulsionimit
328. Pilulat klasifikohen si forma farmaceutike
- A) industriale
 - B) galenike
 - C) homeopatike
 - D) ekstrakte
329. Çlirimi i lëndës vepruese nga sistemet matriciale poroze, që nuk bymehen dhe nuk janë të biodegradueshme, kontrollohet nga
- A) depërtimi i lëngjeve GI në poret e matricës, tretja e barit dhe nga shpërhapja e tretësirës jashtë

- B) dilatimi i poreve të matricës dhe tretja e barit në lëngjet GI
- C) zbërthimi i matricës
- D) erozioni i matricës dhe tretja e mëpasshme e barit

330. Efekti i kalimit të parë është i pranishëm në një % të vogël dhe duhet patur parasysh në formulimin e formave farmaceutike

- A) që merren nga goja
- B) rektale
- C) transdermike
- D) nëpërmjet venës

331. A ka të drejtë farmacisti të përgatisë përgatesa oficinale sterile?

- A) Jo, asnjëherë
- B) Po, por vetëm nëse respekton rregullat e përgatitjes së mirë në farmaci
- C) Po, por vetëm në farmacinë spitalore
- D) Po, por vetëm nëse farmacia është e pastër

332. A është i detyruar farmacisti të ketë peshore për përdorim farmaceutik në farmacinë e tij?

- A) Jo
- B) Po
- C) Po, por vetëm nëse bën përgatitje magjistrale
- D) Po, por vetëm nëse e kërkojnë pacientët

333. Lokalet që shërbejnë për përgatitjet që bëhen në mjedise sterile klasifikohen në klase A-B-C-D. Cili prej mjediseve quhet ndryshe edhe klasa 10?

- A) A
- B) B
- C) C
- D) D

334. A duhet shkruar në etiketën e përgatesës galenike emri i farmacistit dhe/ose farmacistit që ka bërë përgatitjen?

- A) Po
- B) Jo
- C) Po, nëse në farmaci ka më shumë se një farmacist
- D) Po, nëse e kërkon pacienti

335. Cila nga lëndët përdoret si lëndë holluese në përgatitjen e tabletave?

- A) talku
- B) acidi benzoik
- C) benzoati i natriumit
- D) fosfati i kalciumit

336. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me karboksimetilcelulozën e natriumit është i gabuar?

- A) përdoret si lëndë lidhëse
- B) përdoret si lëndë zbërthuese
- C) nuk përthith ujë
- D) rrit veshullinë

337. Personi i kualifikuar që mban përgjegjësi për zbatimin korrekt të GMP-së në një industri farmaceutike është

- A) Drejtuesi teknik
- B) Shefi i sektorit të prodhimit
- C) Shefi i sektorit të kontrollit të cilësisë
- D) Përgjegjësi i sektorit të garantimit të cilësisë

338. Proçedura nëpërmjet së cilës është e mundur të verifikohet nëse organizimi i proçesit të prodhimit është në përputhje me Rregullat e Fabrikimit të Mirë dhe nëse ligjet dhe normativat e shtetit janë zbatuar me saktësi është:

- A) Kontrolli i cilësisë përfundimtar
- B) Konvalidimi
- C) Autoinspektimi
- D) Proçedura operative standard

339. Koha e zërthimit e tabletave përshkumëzuese duhet të jetë më e vogël se

- A) 3 minuta
- B) 5 minuta
- C) 15 minuta
- D) 30 minuta

340. Koha e zërthimit e tabletave të zakonshme duhet të jetë më e vogël se

- A) 3 minuta
- B) 5 minuta
- C) 15 minuta
- D) 30 minuta

341. Temperatura e mjedisit uxor të përdorur në provën e zërthimit të tabletave përshkumëzuese duhet të jetë:

- A) 4 gradëC
- B) 10 gradëC
- C) 20 gradëC
- D) 37 gradëC

342. Shmangia e peshës së tabletës nga pesha mesatare ndikon në përmbajtjen në lëndë vepruese. Ndikimi është më i madh kur % e lëndës vepruese ndaj peshës së përgjithshme të tabletës është

- A) 10%
- B) 30%
- C) 50%
- D) 90%

343. Njëri nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë. Proçesi i granulimit me rrugë të njomë mund të favorizojë:

- A) formimin e hidrateve
- B) shndërrimin polimorfik
- C) përmirësimin e aftësisë rrjedhëse
- D) rritjen e qëndrueshmërisë së lëndës vepruese

344. Cila nga metodat e mëposhtme nuk është metodë granulimi me rrugë të njomë?

- A) granulimi me briketim

- B) granulimi me fluidizim
- C) granulimi me tharje me mjegullim
- D) granulimi me përzierës "high shear"

345. Cila nga metodat e granulimit të mëposhtme nuk është proces që zhvillohet në një fazë të vetme?

- A) granulimi me fluidizim
- B) granulimi me tharje me mjegullim
- C) granulimi me përzierës "high shear"
- D) granulimi me estruzion dhe sferonizim

346. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me lëndët lyresuese është i gabuar?

- A) shtohen vetëm pasi përbërësit e tjerë janë në gjendje homogjene
- B) përzihen jo më shumë se 2-5 minuta
- C) shtohen përpara granulimit me rrugë të njomë
- D) nëse janë hidrofile mund të shtohen si tretësira alkoolike

347. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me lëndët lyresuese të patretshme është i saktë?

- A) zvogëlojnë kohën e zbërthimit
- B) rrisin shpejtësinë e tretjes
- C) rrisin fortësinë e tabletës
- D) nuk shtohen përpara granulimit me rrugë të njomë

348. Gjatë procesit të përgatitjes së tabletave duhet që lëndët lyresuese

- A) të shtohen përpara granulimit me rrugë të njomë
- B) të përzihen sa më shumë me pluhurat e tjerë
- C) të përzihen për jo më shumë se 2-5 minuta menjëherë përpara tabletimit
- D) të përzihen për jo më shumë se 5 minuta menjëherë përpara granulimit

349. Granulimi me rrugë të njomë

- A) është fazë fillestare e tabletimit të drejtpërdrejtë
- B) këshillohet për lëndët me qëndrueshmëri të kufizuar
- C) zvogëlon papajtueshmëritë midis përbërësve
- D) përmirëson aftësinë e lëndëve për të dhënë tableta

350. Vetitë rrjedhëse të pluhurave mund të përmirësohen më shumë nëpërmjet

- A) granulimit me rrugë të njomë
- B) granulimit me rrugë të thatë
- C) pluhurizimit
- D) mikronizimit

351. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë? Granulati i përftuar nga pluhurat me anë të granulimit me rrugë të njomë

- A) përmirëson paraqitjen
- B) përmirëson përzierjen
- C) eliminohen grimcat
- D) mënjanon papajtueshmëritë midis lëndëve

352. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me procesin e granulimit me rrugë të njomë është i saktë?

- A) proçesi ul koston e prodhimit të tabletave
- B) humbje e materialit për shkak të fazave të shumta
- C) rritet qëndrueshmëria e barnave të ndjeshëm
- D) konvalidimi i proçesit nuk paraqet probleme

353. Dy epërsitë kryesore të granulave janë

- A) aftësia për t'u tabletuar dhe aftësia rrjedhëse
- B) paraqitja dhe biodisponibiliteti
- C) biodisponibiliteti dhe qëndrueshmëria
- D) biodisponibiliteti dhe kostoja

354. Granulimi me avuj është një përndryshim i granulimit me rrugë të njomë, në të cilin avulli përdoret si lidhës në vend të ujit. Ky proçes

- A) është i shkurtër
- B) është i përshtatshëm për barnat e ndjeshme ndaj nxehtësisë
- C) nuk kërkon pajisje të posaçme
- D) është i përshtatshëm për lidhësit të cilët nuk aktivizohen nga kontakti me avujt e ujit

355. Vëllimi i tretësit që nevojitet për të tretur 1 g lëndë, të përshkruar si "e tretshme" nga USP-ja është:

- A) më i vogël se 1 ml
- B) nga 1 deri në 10 ml
- C) nga 10 deri në 30 ml
- D) nga 30 deri në 100 ml

356. Nëse një bar në tretësirë shpërbëhet me një reaksion të rendit zero atëherë

- A) shpejtësia e shpërbërjes është e pavarur nga përqendrimi i mbetur
- B) shpejtësia e shpërbërjes është në varësi të përqendrimit të mbetur
- C) gjysmëjeta e barit është e pavarur nga përqendrimi fillestar
- D) njësia e matjes së konstantes së shpejtësisë është kohë⁻¹

357. Nëse një bar në tretësirë shpërbëhet me një reaksion të rendit të parë atëherë

- A) shpejtësia e shpërbërjes është në varësi të përqendrimit të mbetur
- B) shpejtësia e shpërbërjes është e pavarur nga përqendrimi i mbetur
- C) gjysmëjeta e barit rritet me rritjen e përqendrimit fillestar
- D) njësia e matjes së konstantes së shpejtësisë është mg/ml*orë

358. A lejohet që format farmaceutike të mbidozohen me lëndë vepruese në nivelet 10-30%?

- A) Po, gjithmonë
- B) Jo, asnjëherë
- C) Po, por vetëm për format farmaceutike që përmbajnë antibiotikë që duhen përdorur me doza sulmi
- D) Po, por vetëm për lëndë vepruese të paqëndrueshme dhe që nuk paraqesin rrezikshmëri gjatë periudhës së parë të përdorimit

359. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me tabletimin e drejtpërdrejtë nuk është i vërtetë?

- A) përdoren më pak lëndë ndihmëse
- B) proçes ekonomik
- C) zvogëlohet mundësia e bashkëveprimit midis lëndëve

D) nuk është i këshillueshëm për lëndët e ndjeshme ndaj nxehtësisë

360. Përgatitja e tabletave me anë të tabletimit të drejtpërdrejtë mund të krijojë probleme për

- A) lëndët vepruese me dozë të vogël
- B) lëndët vepruese të ndjeshme ndaj nxehtësisë
- C) lëndët vepruese të ndjeshme ndaj lagështisë
- D) lëndët vepruese me ngjyrë të bardhë

361. Dekoktet janë forma farmaceutike

- A) gjysmë të ngurta
- B) të ngurta
- C) të lëngëta
- D) të gazta

362. Polisorbati 61 në supozitorët është bazë e tipit:

- A) Hidrofob
- B) Hidrofil
- C) Emulsion
- D) Vetëmulsionues

363. Spen 40 bën pjesë në bazat supozitorëve të tipit:

- A) Emulsion
- B) Hidrofobe
- C) Vetëmulsionuese
- D) Hidrofile

364. Formulimi [oleum helianthi , kalii hydroxydum, alcoholum, aqua destillatae] është:

- A) Emulsion
- B) Liniment
- C) Pezulli
- D) Sapun mjekësor

365. Cetilsulfati i natriumit është emulgator i tipit:

- A) Sapun
- B) Karbopol
- C) Kripë katërsore e amonit
- D) Alkilsulfat

366. Shpejtësia e sedimentimit të aerosoleve është në përpjesëtim të zhdrejtë me:

- A) Forcën e rëndesës
- B) Shpejtësinë e lëvizjes së grimcave
- C) Veshullinë e mjedisit shpërndarës
- D) Rrezen e grimcave të fazës së ngurtë

367. Lecitina bën pjesë në grupin e emulgatorëve:

- A) Sintetikë
- B) Gjysëmsintetikë
- C) Të patretshëm
- D) Natyrorë

368. Xhelatina është emulgator:

- A) Anionik
- B) Kationik
- C) I patretshëm
- D) Natyror

369. Silikoni e derivatet e tij nuk duhen përdorur në kremra për trajtimin e:

- A) Ekzemave
- B) Plagëve me qelb
- C) Hemorroideve
- D) Lëkurave të thata

370. Qëndrueshmëria e pezullive është në përpjesëtim të drejtë me:

- A) Forcën e rëndesës
- B) Rrezen e grimcave të fazës së ngurtë
- C) Trashësinë e shtresës dyfishe elektrike
- D) Veshtullinë e mjedisit shpërndarës

371. Cila nga pohimet e mëposhtme është i saktë?

- A) Përbërësit e kemit nuk duhet të lejojnë frymëkëmbimin e lëkurës
- B) Përbërësit e kemit duhet të pengojnë largimin e sekrecioneve të lëkurës
- C) Përbërësit e kemit duhet të fermentohen në kontakt me sekrecionet e lëkurës
- D) Përbërësit e kemit nuk duhet të jenë helmues

372. Qëndrueshmëria e aerosoleve është në përpjesëtim të drejtë me:

- A) Trashësinë e shtresës dyfishe elektrike
- B) Rrezen e grimcave të fazës së shpërndarë
- C) Veshtullinë e fazës shpërndarëse
- D) Forcën e rëndesës

373. Gjatë përgatitjes së supozitorëve, cila nga lëndët e mëposhtme nuk mund të zëvendësojë gjalpin e kakaos?

- A) Masat witepsol
- B) Masat Estarinum
- C) Vaji i kikirikut i hidrogjenuar
- D) Lanolina e hidrogjenuar

374. Shpejtësia e sedimentimit të emulsioneve është në përpjesëtim të zhdrejtë me:

- A) Forcën e rëndesës
- B) Veshtullinë e mjedisit shpërndarës
- C) Diferencën e dendësive midis dy fazave
- D) Rrezen e grimcave të fazës së ngurtë

375. Laurilsulfati i natriumit është emulgator i tipit:

- A) Anionik
- B) Kationik
- C) Amfoter
- D) Jojonik

376. Pomadat me glukokortikoide që përdoren për trajtimin e ekzemave nuk duhet të përmbajnë:

- A) Dyllë blete
- B) Vaj parafine
- C) Kolesterol
- D) Ujë

377. Sistemi HLB i Griffin shërben për:

- A) Përzgjedhjen e kombinimit të emulgatorëve
- B) Përzgjedhjen e raportit të fazave në emulsion
- C) Raportin e përzierjes së filtrave solar
- D) Raportin e gazeve propulsore

378. Shkalla e shpërndarjes së grimcave është më e vogël tek:

- A) Pomadat tretësira
- B) Pomadat emulsione
- C) Pomadat pezulli
- D) Pomadat hidrofobe

379. Në rastet e ekzemave është i kundërrindikuar përdorimi i:

- A) Lanolinës
- B) Parafinës
- C) Vazelinës
- D) Dyllit

380. Gjatë përgatitjes së supozitorëve parapëlqehet që, lënda vepruese të shpërndahet në trajtë tretësire sesa në trajtë emulsioni apo pezullie pasi kështu:

- A) Lënda vepruese çlirohet më shpejt
- B) Lënda vepruese është e shpërndarë njëtrajtësisht
- C) Nuk krijon vështirësi gjatë përgatitjes
- D) Nuk ndikon në temperaturën e shkrirjes së supozitorit

381. Supozitorët janë formë farmaceutike që konsiderohet si:

- A) Njëdozëshe
- B) Shumëdozëshe
- C) Doza me çlirim të ngadalshëm
- D) Doza me çlirim të përndryshuar

382. Ndryshe nga CFC, hidrofluoroalkanet nuk e dëmtojnë shtresën e ozonit sepse:

- A) Nuk përmbajnë klor
- B) Pëngojnë depërtimin e rrezeve UV
- C) Reflektojnë rrezet UVB të spektrit UV
- D) Përdoren në sasi më të vogël

383. Gjatë përgatitjes së pomadave me salicilat metili nuk duhen përdorur mjete:

- A) Porcelani
- B) Qelqi
- C) Metalike
- D) Plastike

384. Infuzioni ndryshon nga dekokcioni nga:

- A) Tretësi që përdoret
- B) Temperatura në të cilën kryhet procesi
- C) Aparatura e përdorur gjatë këtij procesi
- D) Lehtësia e kryerjes së këtij procesi

385. Stearati i trietanolaminës është emulgator i tipit:

- A) Sapun i metaleve alkalino-tokësore
- B) Sapun i metaleve alkaline
- C) Sapun i bazave organike
- D) Sapun rrëshinor

386. Për të përfutur një pezulli homogjene kusht themelor është:

- A) Përzgjedhja e lëndës vepruese sipas tretshmërisë
- B) Ruajtja larg dritës e nxehtësisë
- C) Ngrohja në temperaturën e duhur
- D) Njomja e grimcave të fazës së ngurtë

387. Kremrat ushqyese me përmbajtje të hormoneve nuk duhet të përmbajnë:

- A) Sapun trietanolamine
- B) Spermacet
- C) Alkool cetilik
- D) Kolesterol

388. Hidrokarburet e klorofluoruara përdoren si:

- A) Lëndë njomëse
- B) Lëndë shpërndarëse
- C) Lëndë ftohëse
- D) Lëndë mbushëse

389. Ndër lëndët e poshtëshënuara cila ka origjinë shtazore?

- A) Silikoni
- B) Parafina e lëngët
- C) Bentoniti
- D) Dylli i bletës

390. Përdorimi i CFC-ve përbën një shqetësim madhor mjedisor sepse:

- A) Rrisin nivelin e C në ajër
- B) Rrisin nivelin e F në ajër
- C) Zvogëlojnë shtresën e ozonit
- D) Zvogëlojnë ngrohjen e globit

391. Supozitorët rektalë ndryshojnë nga ata vaginalë nga:

- A) Eksipientët që përdorin
- B) Mënyra e përgatitjes
- C) Peshë 1-3g
- D) Trajta e tyre

392. Për përcaktimin e mënyrës së veprimit të një përgatëse dermatologjike nuk merret parasysh:

- A) Lëkura

- B) Lënda vepruese
- C) Eksipientët
- D) Mënyra e përgatitjes

393. Dymetilsulfoksidi (DMSO) përdoret si bazë për përgatitjen e:

- A) Pomadave oftalmike
- B) Pomadave hidrofile
- C) Pomadave mbrojtëse
- D) Pomadave me glukokortikoide

394. Bromuri i cetiltrimetilamonit është emulgator i tipit të:

- A) Alkilsulfateve
- B) Alkilsulfonateve
- C) Sapuneve
- D) Kriprave katërsore të amonit

395. Lanolina ka aftësi të përthithë një sasi uji deri në:

- A) 25% të peshës së saj
- B) 50% të peshës së saj
- C) 100% të peshës së saj
- D) 200% të peshës së saj

396. Pas përdorimit për një kohë të gjatë cila nga lëndët e mëposhtme mund të shkaktojë rritje të ndjeshmërisë?

- A) Vazelina
- B) Silikoni
- C) Dylli
- D) Lanolina

397. Cili nga produktet e mëposhtme ka origjinë shtazore?

- A) Parafina
- B) Vazelina
- C) Lanolina
- D) Bentoniti

398. CFC-t kontribuojnë në ngrohjen globale pasi:

- A) Kanë aftësi të rrisin temperaturën e ajrit
- B) Dëmtojnë shtresën e ozonit
- C) Kanë aftësi të shkrijnë akujt
- D) Rrisin trysninë atmosferike

399. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk është derivat i lanolinës?

- A) Eucerina
- B) Kolesterolli
- C) Alkoolët e lanolinës
- D) Alkooli cetilik

400. Pastat janë pomada pezulli që përmbajnë:

- A) 10% lëndë të gurtë
- B) Mbi 25% lëndë të ngurtë

- C) 15% lëndë të ngurtë
- D) Mbi 5% lëndë të ngurtë

401. Supozitorët rektalë ndryshojnë nga ata vaginalë nga:

- A) Pësha 1-3g
- B) Mënyra e përgatitjes
- C) Mënyra e formulimit
- D) Eksipientët që përdorin

402. Për përgatitjen e përgatesave me jod nuk duhen përdorur enë:

- A) Porcelani
- B) Metalike
- C) Qelqi
- D) Plastike

403. Qëndrueshmëria e emulsioneve është në përpjesëtim të drejtë me:

- A) Trashësinë e shtresës dyfishe elektrike
- B) Rrezën e grimcave të fazës së brendshme
- C) Veshtullinë e fazës së jashtme
- D) Forcën e rëndesës

404. Cila nga pohimet e mëposhtme është e pasaktë?

- A) Përbërësit e kemit duhet të fermentohen në kontakt me sekrecionet e lëkurës
- B) Përbërësit e kemit duhet të lejojnë frymëkëmbimin e lëkurës
- C) Përbërësit e kemit nuk duhet të pengojnë largimin e sekrecioneve të lëkurës
- D) Përbërësit e kemit nuk duhet të jenë helmuese

405. Kremrat e yndyrta përdoren për:

- A) Lëkurë normale
- B) Lëkurë të thatë
- C) Lëkurë të yndyrte
- D) Lëkurë të mbiujësuar

406. Nga lëndët e poshtëshënuara cila nuk është filtër mbrojtës?

- A) Acidi tanik
- B) Acidi p-aminobenzoik
- C) Nipagina
- D) Fenazoni

407. Kur bëhet fjalë për kremrat e thata kemi parasysh:

- A) Kremrat e natës
- B) Kremrat e ditës
- C) Koldkremrat
- D) Kremrat hidratues

408. Cili nga emulgatorët e mëposhtëm nuk jep emulsione të tipit V/U?

- A) Sapuni kaliumit
- B) Laurilsulfati i natriumit
- C) Polisorbati 80

D) Spen 60

409. Pastat janë:

- A) Pomada emulsione
- B) Pomada tretësira
- C) Pomada pezulli
- D) Pomada të përziera

410. Cila nga hidrohelet e mëposhtme përmban lëndë me origjinë natyrore?

- A) Hidrokheli i metilcelulozës 5%
- B) Hidrokheli i karboksimetilcelulozës sodike 15%
- C) Hidrokheli i algjinatit të natriumit 10%
- D) Hidrokheli i alkooli polivinilik 5%

411. Cila nga bazat e pomadave oftalmike çliron më shpejt lëndën vepruese?

- A) Bazat V/U
- B) Bazat hidrohele
- C) Bazat U/V
- D) Bazat yndyrore

412. Në çfarë temperature shfaqen format e paqëndrueshme të gjalpët të kakaos?

- A) 34-35°C
- B) > 40°C
- C) 20-25°C
- D) < 30°C

413. Shpejtësia e sedimentimit të pezullive është në përpjesëtim të zhdrejtë me:

- A) Forcën e rëndesës
- B) Rrezen e grimcave të fazës së ngurtë
- C) Trashësinë e shtresës dyfishe elektrike
- D) Veshtullinë e mjedisit shpërndarës

414. Lënda vepruese e shpërndarë në bazën e supozitorit do të çlirohet më shpejt nëse:

- A) Është në trajtë tretësire
- B) Është në trajtë emulsioni V/U
- C) Është në trajtë pezullie
- D) Është në trajtë emulsion U/V

415. Ovulat janë përgatesa për përdorim:

- A) Të brendshëm
- B) Parenteral
- C) Të jashtëm
- D) Oral

416. Cila nga lëndët e mëposhtme nuk është lëndë antimikrobike?

- A) Acidi sorbik
- B) Klorheksidina
- C) Alfa-tokoferoli
- D) Acidi benzoik

417. Kremrat e yndyrta përdoren:

- A) Disa herë në ditë
- B) Një herë në mëngjes
- C) Një herë në mbrëmje
- D) Dy herë në ditë

418. Kremrat me stearate nuk duhen përdorur në:

- A) Lëkurat e yndyrta
- B) Lëkurat e kongjestionuara
- C) Lëkurat e skuqura
- D) Lëkurat e thata

419. Shpejtësia e sedimentimit të pezullive mund të zvogëlohet në qoftë se:

- A) Ulet madhësia e grimcave të fazës së shpërndarë
- B) Ulet dendësia e mjedisit shpërndarës
- C) Ulet veshullia e mjedisit shpërndarës
- D) Ulet energjia e lirë e sistemit

420. Cili nga emulgatorët e mëposhtëm nuk jep emulsione të tipit U/V?

- A) Oleati i kalciumit
- B) Spen 60
- C) Goma arabike
- D) Bromuri i cetiltrimetilamonit

421. Cila nga bazat e mëposhtme për supozitorë është bazë e vetëemulsionueshme?

- A) Lanolina
- B) Stearati i polioksietilenit 40
- C) PEG 4000
- D) Xhelatina

422. Cila nga bazat e mëposhtme është bazë e pomadave emulsione?

- A) Stearina
- B) Parafina
- C) Vazelina
- D) Alkooli cetilsteartilik

423. Shpejtësia e sedimentimit mund të rritet në qoftë se:

- A) Rritet madhësia e grimcave
- B) Rritet dendësia e mjedisit shpërndarës
- C) Rritet veshullia
- D) ulet madhësia e grimcave

424. Cila nga lëndët e mëposhtme nën veprimin e një force do të sillet si trup pseudoplastik?

- A) Vaji i lirit
- B) Uji i mentës
- C) Celuloza
- D) Alkooli etilik

425. Sedimentimi është dukuri e paqëndrueshmërisë së:

- A) Tabletave

- B) Tretësirave ujore
- C) Emulsioneve
- D) Tretësira vajore

426. Prova e akantozës për pomadat bën pjesë në kontrollin:

- A) organoleptik
- B) kimik
- C) reologjik
- D) biologjik dhe klinik

427. Në provat e kontrollit reologjik të pomadave nuk bën pjesë:

- A) Prova për aftësinë e përhapjes
- B) Përcaktimi i veshtullisë
- C) Prova e akantozës
- D) Përcaktimi i depërtimit

428. Treguesi i ujit është një nocion që shërben për të vlerësuar:

- A) pH-in e ujit që përdoret për pomadat
- B) Aftësinë e përthithjes së ujit nga bazat e pomadave
- C) Fortësinë e ujit që përdoret për kremrat
- D) Aftësinë e emulgatorëve për ta mbajtur ujin

429. Depërtuesmatësi mat:

- A) Shkallën e përhapjes së pomadave
- B) Shpërndarjen e lëndës vepruese në bazën e pomadave
- C) Shkallën e konsistencës së pomadave
- D) Ndikimin e lëndëve vepruese në epidermë

430. Prova e akantozës përcakton trashjen e epidermës që ndodh faktikisht në :

- A) Shtresën e brirëzuar
- B) Shtresën germinative
- C) Shtresën gjembore
- D) Shtresën e shndritshme

431. Faktori i akantozës konsiderohet i parëndësishëm nëse është në vlerat:

- A) 2-4
- B) 1,6-1,9
- C) Mbi 4
- D) 1-1,5

432. Për të mënjeluar shpërbërjen, parashikohet që për pomadat emulsione të shtohet 0,1-0,2% nipaginë e tretur në:

- A) Fazën vajore
- B) Në ndërfazë
- C) Në të dyja fazat
- D) Në fazën ujore

433. Për të mënjeluar shpërbërjen, parashikohet që për pomadat me baza të ndjeshme ndaj oksidimit të shtohen 0.03% alfa-tokoferol në:

- A) Fazën vajore

- B) Në ndërfazë
- C) Në të dyja fazat
- D) Në fazën ujore

434. Pastat përdoren kur duam një efekt:

- A) Sistemik
- B) Antireumatizmal
- C) Lokal
- D) Antipiretik

435. Lënda vepruese depërton më shumë kur trupëzohet në:

- A) Pasta
- B) Pomada pezulli
- C) Pomada emulsione
- D) Pomadat yndyrore

436. Lënda vepruese depërton më pak kur trupëzohet në:

- A) Pomada hidrofile
- B) Pomada pezulli
- C) Pasta
- D) Pomadat yndyrore

437. Shpejtësia e ndarjes së fazave në një emulsion mund të zvogëlohet në qoftë se:

- A) Rritet shkalla e shpërndarjes së fazës së brendshme
- B) Ulet dendësia e mjedisit shpërndarës
- C) Ulet veshtullia e mjedisit shpërndarës
- D) Ulet energjia e lirë e sistemit

438. Kur një emulsioni me emulgator oleatin e natriumit i shtojmë një elektrolit si kloruri i kalciumit ndodh dukuria e:

- A) Sedimentimit
- B) Skremimit
- C) Inversionit të fazave
- D) Koaleshencës

439. Me anën e Numratorit Koulter masim:

- A) Ngarkesën e grimcave të fazës së brendshme
- B) Peshën e grimcave të fazës së brendshme
- C) Numrin dhe shkallën e shpërndarjes së grimcave
- D) Ngarkesën elektrike të sistemit

440. Shkalla e flokulimit është raporti midis vëllimit të sedimentit dhe vëllimit fillestar të pezullisë. Vlera ideale e tij është:

- A) 2
- B) 1.5
- C) 1
- D) 0

441. Gjatë kontrollit të cilësisë së një pezullie peshorja "Figurovski" shërben për:

- A) Përcaktimin e peshës së pezullisë

- B) Përcaktimin e sasisë së sedimentit
- C) Përcaktimin e shpejtësisë së sedimentimit
- D) Përcaktimin e vëllimit të sedimentit

442. Gjatë kontrollit të cilësisë së një pezullie aparati elektronik Koulter shërben për:

- A) Përcaktimin e përmbajtjes sasiore të lëndës vepruese
- B) Përcaktimin e shpejtësisë së lëvizjes së grimcave
- C) Përcaktimin e madhësisë dhe numrit të grimcave
- D) Shkallën e flokulimit të fazës së shpërndarë

443. Përcaktimi i veshtullisë së pezullive nuk kryhet me:

- A) metodën kapilare
- B) metodën e rënies së rruzullit
- C) metodën me rrotullim
- D) metodën me mikroskop

444. Potenciali zeta matet me anë të zetamatësit dhe është karakteristik për:

- A) Pezullitë
- B) Emulsionet
- C) Pomadat
- D) Supozitorët

445. Për të përcaktuar shpejtësinë e sedimentimit të pezullive shpesh përdoret termi i:

- A) Periudhës së dyfishimit
- B) Periudhës së përgjysmimit
- C) Periudhën e shflokulimit
- D) Periudhën e qetësisë

446. Cila nga provat e mëposhtme të kontrollit të cilësisë nuk janë specifike vetëm për sistemet terapeutike transdermale (STT)?

- A) Shkalla e ngjitjes
- B) Qëndrueshmëria e membranave
- C) Shpejtësia e çlirimit dhe depërtimit të lëndës vepruese
- D) Përcaktimi sasior i lëndës vepruese

447. Cila nga rrugët e mëposhtme nuk përdoret nga lënda vepruese për të depërtuar në lëkurë?

- A) Përmes folikulave
- B) Përmes hapësirave ndërqelizore
- C) Përmes qelizave
- D) Përmes matricave

448. Në grupin e koloideve molekulare bëjnë pjesë:

- A) Komponentet makromolekulare
- B) Lëndët tensiovepruese
- C) Lëndët njomëse
- D) Lëndët ngjyuese

449. Në grupin e koloideve të shoqërimit nuk bëjnë pjesë:

- A) Lëndët ngjyuese
- B) Lëndët njomëse

- C) Lëndët tensiovepruese
- D) Komponimet makromolekulare

450. Përqendrimi micelar kritik (PMK) është përqendrimi:

- A) Më i ulët në të cilin shfaqen micelat
- B) Më i lartë në të cilin shfaqen micelat
- C) Jonik i micelave
- D) Plazmatik i micelave

451. Reologjia nuk ka rëndësi:

- A) Për operacionet e ndryshme farmaceutike
- B) Gjatë përdorimit të përgatesave farmaceutike
- C) Për fiziologjinë
- D) Për anatominë

452. Sistemet e shpërndara heterogjene nuk karakterizohen nga:

- A) Shkalla specifike e shpërndarjes
- B) Homogjeniteti
- C) Prania e shumë fazave
- D) Paqëndrueshmëria termodinamike e kinetike

453. Cila nga format e mëposhtme farmaceutike bën pjesë në sistemet e shpërndara heterogjene?

- A) Tretësirat ujore
- B) Tretësirat vajore
- C) Pomadat yndyrore
- D) Emulsionet

454. Sipërfaqja ndarëse është karakteristikë e:

- A) Pezullive
- B) Tretësirave ujoro-elektrolitike
- C) Tretësirave vajore
- D) Pomadave yndyrore

455. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk përfshihet drejtpërdrejt në formulën e Stoks-it ?

- A) Rrezja e grimcave të fazës së shpërndarë
- B) Veshullia e mjedisit shpërndarës
- C) Tensioni sipërfaqësor
- D) Diferenca midis dendësive të dy fazave

456. Formula e Stoks-it nuk përdoret për:

- A) Emulsionet
- B) Kremrat
- C) Aerosolet
- D) Tretësirat

457. Përgatitja e barnave oficinale bazohet në:

- A) formularin farmaceutik
- B) farmakopenë
- C) kushtin teknik

D) standardin shtetëror

458. Përgatitja e barnave magjistrale bazohet në:

- A) farmakopenë
- B) recetën e mjekut
- C) standardin shtetëror
- D) kushtin teknik

459. Një seri tregon sasinë e barnave që prodhohen bnda një:

- A) ore
- B) dite
- C) muaji
- D) cikli fabrikimi

460. Narkotikët bëjnë pjesë në grupin e barnave:

- A) oficinale
- B) magjistrale
- C) industriale
- D) helmuese

461. Në dispersionet koloidale bëjnë pjesë:

- A) emulsionet
- B) pezullitë
- C) pomadat
- D) mucilagjet e gomave dhe komponimeve të tjera makromolekulare

462. Nga elementet e mëposhtëm të lakores së përqendrimit plazmatik, cili prej tyre lidhet me biodisponibilitetin:

- A) PME
- B) gjerësia terapeutike
- C) Pmaks
- D) SNL (ABC, AUC)

463. Në cilën nga format e mëposhtme farmaceutike biodisponibiliteti është më i lartë:

- A) pluhurat
- B) tretësirat ujore
- C) emulsionet e tipit V/U
- D) pezullitë ujore

464. Në cilën nga format e mëposhtme farmaceutike shpejtësia e tretjes është më e ulët:

- A) tabletat
- B) emulsionet e tipit V/U
- C) tretësirat ujore
- D) drazhetë

465. Qelqi si material ambalazhues tretet pjesërisht në:

- A) acidet e holluara dhe ujë
- B) alkool etilik
- C) etilenglikol
- D) propilenglikol

466. Reaksionet fotokimike nxiten nga:

- A) temperatura
- B) ajri atmosferik
- C) mikroorganizmat dhe agjentët e tjerë biologjikë
- D) materiali ambalazhues

467. Fortësia e përkohshme e ujit shkaktohet nga:

- A) nitratet
- B) nitritet
- C) hidrogjenkarbonatet e kalciumit e të magnezit
- D) kloruret e magnezit e kalciumit

468. Fortësia e përhershme e ujit shkaktohet nga:

- A) kloruret e sulfatet e magnezit e të kalciumit
- B) nitritet
- C) nitratet
- D) hidrogjenkarbonatet e kalciumit

469. Uji i distiluar mund të ruhet:

- A) 24 orë
- B) 72 orë
- C) 1 javë
- D) 2 javë

470. Rrëshirat jonokëmbyese kationike janë produkte që rrjedhin nga:

- A) bazat
- B) kripërat
- C) acidet karboksilike të serisë aromatike
- D) alkoolet

471. Përqendrimi i tretësirave dhe formave të tjera farmaceutike të lëngëta që përmbajnë antibiotikë, kimioterapeutikë dhe antihistaminikë shprehet në:

- A) përqindje p/p
- B) përqindje v/v
- C) përqindje v/p
- D) përqindje p/v

472. Propilenglikoli metabolohet në:

- A) acid laktik
- B) acid klorhidrik
- C) acid acetik
- D) acid suksinik

473. Me anën e dezinfektimit shkatërrohen:

- A) mikrobet jopatogjene
- B) kërpudhat
- C) mikrobet patogjene
- D) myket

474. Cili nga sistemet tampone të mëposhtme nuk përdoret për përgatesat paranterale:

- A) boratik
- B) fosfatik
- C) acid citrik -citrat trisodik
- D) hidrogjenkarbonat natriumi - karbonat tatriumi

475. Cilat nga lëndët e mëposhtme është drogë bimore:

- A) emetina
- B) psihotrina
- C) kodeina
- D) opiumi

476. Uji i distiluar shërben si tretës për:

- A) linimentet
- B) pomadat
- C) tretësirat vajore
- D) tretësirat ujore

477. Barnat homeopatike përdoren me doza:

- A) jashtëzakonisht të vogla
- B) rendit të gramëve
- C) rendit të decigramëve
- D) të mëdha

478. Në cilat forma farmaceutike të mëposhtme probabiliteti për probleme me biodisponibilitetin është më i lartë:

- A) shurupet
- B) tabletat
- C) tretësirat ujore
- D) pezullitë

479. Përqendrimi i tretësirave ose pezullive për injeksion shprehet me:

- A) përqindje p/v
- B) përqindje p/p
- C) përqindje v/v
- D) përqindje v/p

480. Plazmoliza shkaktohet kur injektohen tretësira:

- A) vajore
- B) alkoolike
- C) ujore
- D) me trysni osmotike më të madhe se ajo e serumit të gjakut

481. Hemoliza shkaktohet kur injektohen tretësira:

- A) me trysni osmotike më të vogël se ajo e serumit të gjakut
- B) me trysni osmotike më të madhe se ajo e serumit të gjakut
- C) vajore
- D) glicerimore

482. Kripërat e alkaloidëve japin tretësira:

- A) me karakter bazik
- B) me karakter acid
- C) me karakter asnjës
- D) irrituese për indet

483. Nxehtësia ndikon negativisht në tretjen e:

- A) komponimeve të magnezit
- B) komponimeve të kalciumit
- C) acideve
- D) bazave

484. Asbesti nuk përdoret si material filtrues sepse:

- A) përndryshon pH-in e gjakut
- B) i jep karakter acid tretësirave
- C) i jep karakter bazik tretësirave
- D) është kancerogjen

485. Sakarolizatori është aparat që përdoret për përgatitjen e:

- A) emulsioneve
- B) pezullive
- C) shurubeve me anën e tretjes së sheqerit në të nxehtë
- D) shurubeve me anën e tretjes së sheqerit në të ftohtë

486. Invertimi i sheqerit në shurupet shkaktohet nga:

- A) acidet
- B) bazat
- C) kripërat
- D) alkoolet

487. Shkatërrimi i mikroorganizmave me anën e sterilizimit është një reaksion me kinetikë të rendit:

- A) zero
- B) të parë
- C) të dytë
- D) të tretë

488. Perfuzionet nuk duhet të përmbajnë:

- A) lëndë konservuese
- B) lëndë antioksiduese
- C) lëndë që stabilizojnë pH-in
- D) lëndë izotonizuese

489. Nga filtrat prej qelqi poroz cili tip përdoret për filtrim sterilizues:

- A) G1
- B) G4
- C) G2
- D) G5

490. Ku veprojnë më mirë lëndët antibakterore në:

- A) alkool

- B) vaj
- C) glicerinë
- D) tretësira ujore

491. Në cilat raste intensiteti i shpërhapjes është më intensiv:

- A) tretësira ujore
- B) tretësira vajore
- C) gaze
- D) lëngje

492. Infuzioni dhe dekoksioni zbatohen me tretësit e mëposhtëm:

- A) alkool etilik
- B) alkool izopropilik
- C) ujë
- D) vaj

493. Perkolimi zbatohet me tretësit e mëposhtëm:

- A) përzierje ujë-alkool
- B) vaj bimor
- C) vaj mineral
- D) izopropanol

494. Drogat që përmbajnë esenca ruhen:

- A) të paplukurizuara
- B) të plukurizuara imët
- C) të plukurizuara trashë
- D) të plukurizuara mesatarisht imët

495. Për tinkturat që përfitohen nga lëndë helmuese ose me veprim të fortë zbatohet raporti:

- A) 1:5
- B) 1:10
- C) 1:20
- D) 1:25

496. Ekuacioni i Stoksis zbatohet për sistemet e mëposhtme të shpërndara:

- A) tretësit vajore
- B) tretësit glicerinore
- C) sistemet e shpërndara heterogjene
- D) tretësit alkoolike

497. Në koloidet e shoqërimit bëjnë pjesë:

- A) lëndët tensiovepruese
- B) lëndët antibakterore
- C) lëndët antioksiduese
- D) propilenglikoli

498. Në lëndët pseudoplastike me (veshtulli strukturore) bëjnë pjesë:

- A) uji i distiluar
- B) komponimet makromolekulare ose të fijëzuara
- C) alkooli etilik

D) oleati i etilit

499. Në rastin e skremimit kemi të bëjme me ndarjen e:

- A) pezullive ujore
- B) pezullive vajore
- C) emulsioneve v/u ose u/v
- D) pomadave

500. Inversioni i fazave është formë e paqëndrueshmërisë së:

- A) emulsioneve
- B) tretësirave ujore
- C) tretësirave vajore
- D) pezullive

501. Sapunet alkaline janë emulgatorë:

- A) të tipit v/u
- B) të tipit u/v
- C) të tretshëm në yndyrna
- D) të patretshëm në ujë

502. Esteret e acideve yndyrore me sorbitanin (spenet) janë emulgatorët:

- A) të tipit v/u
- B) të tipit u/v
- C) të tretshëm në yndyrna
- D) të patretshëm në alkool

503. Emulgatorët jojonikë me lidhje esterore -eterore (polisorbitet) janë emulgatorë:

- A) të tipi v/u
- B) të tipit u/v
- C) të patretshëm në ujë
- D) të patretshëm në yndyrna

504. Shpejtësia e sedimentimit në pezullitë mund të ulet kur:

- A) rritet madhësia e grimcave
- B) dendësia e mjedisit shpërndarës është e përafërt me atë të grimcave
- C) ulet veshhtësia e mjedisit shpërndarës
- D) dispersioni tundet vazhdimisht

505. Kremrat janë pomada:

- A) emulsione
- B) pezulli
- C) pomada të përziara (emulsione-pezuilli -tretësira etj)
- D) mbrojtëse

506. Kontrolli organoleptik i pomadave bazohet në përcaktimin e:

- A) pH-it
- B) veshhtësisë
- C) ngjyrës
- D) depërtimit

507. Ekstensiomatësi është aparat që shërben për përcaktimin e:

- A) aftësisë së përhapjes së pomadave
- B) veshullisë
- C) depërtimit
- D) konsistencës

508. Shurupet ëmbëlsuese përdoren si:

- A) lëndë konservuese
- B) lëndë kundër oksidimit
- C) përmirësuese të shijes së barnave
- D) lëndë kompleksoformuese

509. Barnat oficinale janë të qëndrueshme për:

- A) 24 orë
- B) 48 orë
- C) 1 javë
- D) për kohë relativisht të gjatë

510. Barnat magjistrale kanë afat ruajtjeje:

- A) 24 orë
- B) 72 orë
- C) të shkurtër
- D) të gjatë

511. Barnat industriale kanë afat ruajtjeje:

- A) për 72 orë
- B) të gjatë (3-5 vjet)
- C) të shkurtër
- D) 1 javë

512. Në dispersionet makroheterogjene të trasha bëjnë pjesë:

- A) infuzet
- B) dekoktet
- C) maceratet
- D) emulsionet

513. Në dispersionet makroheterogjene të trasha me konsistencë të butë bëjnë pjesë:

- A) pilulat
- B) pomadat
- C) pezullitë
- D) mucilagjet e gomave dhe të komponimeve të tjera makromolekulare

514. Në dispersionet koloidale bëjnë pjesë:

- A) emulsionet
- B) pezullitë
- C) mucilagjet e gomave dhe të komponimeve të tjera makromolekulare natyrore gjysmësinetike ose sintetike
- D) tretesirat ujore

515. Në përgatesat që përftohen me anën e ekstraktimit bëjnë pjesë:

- A) dispersionet koloidale të lëngëta

- B) tretësirat alkoolike
- C) tinkturat
- D) emulsionet

516. Cilat farmakope shfrytëzohen më së shumti në vendin tonë:

- A) shqiptare
- B) franceze
- C) evropiane
- D) italiane

517. Prova e shpejtësisë së tretjes (dissolution test) lidhet me:

- A) zbërthimin
- B) qëndresën mekanike
- C) biodisponibilitetin
- D) qëndrueshmërinë

518. Shpejtësia e tretjes së barnave që treten me vështirësi rritet me:

- A) rritjen e madhësisë së grimcave
- B) rritjen e temperaturës
- C) përzierje
- D) zvogëlimin e madhësisë së grimcave

519. Bari quhet i qëndrueshëm kur përmbajtja e lëndës vepruese është:

- A) 100%
- B) 80%
- C) 90%
- D) 95%

520. Papajtueshmëritë farmaceutike zhvillohen kur shpejtësia e reaksionit është:

- A) shumë e vogël
- B) shumë e madhe
- C) e madhe
- D) mesatare

521. Laktoza konsiderohet si lëndë holluese e përshtatshme për tabletat vaginale, sepse:

- A) u jep tabletave masën e duhur
- B) rregullon pH-in vaginal
- C) ndimmon në qëndrueshmërinë e lëndëve vepruese
- D) ndihmon në zbërthimin e tabletave

522. Cila nga lëndët e mëposhtme është i prirur për reaksione hidrolize:

- A) acidi askorbik
- B) nitrati i argjendit
- C) adrenalina
- D) atropina

523. Shpejtësia e sedimentimit në pezullitë mund të ulet kur:

- A) rritet shumë madhësia e grimcave
- B) dendësia e mjedisit shpërndarës bëhet e përafërt me atë të grimcave
- C) ulet veshullia e mjedisit shpërndarës

D) rritet pak madhesia e grimcave

524. Cila është rruga themelore e depërtimit të lëndëve vepruese përmes lëkurës:

A) përmes folikulave (infiltrimit në hapësirat qelizore)

B) përmes qelizave

C) përmes gjëndrave

D) përmes folikulit të qimes

525. Lanolina bën pjesë në:

A) parafinat

B) dyllërat

C) yndyrnat

D) silikonet

526. Procesi i rendit të 2të zhvillohet:

A) për shkaqe të jashtme

B) për shkaqe të brendshme

C) kur shpejtësia e reaksionit është përpjestimore me përqendrimit e dy lëndëve bashkëvepruese

D) për shkak të konstantes së ulet të shpejtësisë së reaksionit

527. Metoda e Arrheniusit për parashikimin e qëndrueshmërisë së barnave bazohet në:

A) mbajtjen e barit në temperaturën e mjedisit

B) mbajtjen e barit në temperaturë të ulët

C) mbajtjen e barit në temperaturë të lartë

D) mbajtjen e barit në mjedis të gaztë

528. Cilat nga lëndët e mëposhtme janë më agresive për qelqin:

A) uji i distiluar

B) acidet e holluara

C) bazat e përqendruara

D) tretësira e citratit trisodik

529. Cilat nga lëndët e mëposhtme mund të ndajthithet më së shumti nga lëndët plastike:

A) lëndët kundër oksidimit

B) lëndët kompleksoformuese

C) lëndët antibakterore

D) lëndët lyrësuese

530. Elastomerët përdoren për përfitim të :

A) ampulave

B) shisheve të vogla (flakoneve)

C) tapave për shishe shumëdozëshe dhe të perfuzionit

D) qeseve plastike

531. Cili është faktori më i rëndësishëm që gjen zbatim në provat e vjetërimit të përshpejtuar:

A) rrezatimi jonizues

B) temperatura e ulët

C) temperatura e lartë

D) lagështia

532. Tretësirat janë:

- A) dispersione të komponimeve makromolekulare
- B) forma farmaceutike të lëngëta që përmbajnë një a më shumë kundërvepruese të tretura në një tretës ose përzierje tretësirash
- C) përzierje të dy lëngjeve të papërzieshme me njëri-tjetrin
- D) përzierje të lëndëve të ngurta të patretshme me ujë ose vaj

533. Zbutja e ujit me anën e këmbimit të kationeve bazohet në:

- A) shtimin e gëlqeres
- B) shtimin e karbonatit të natriumit
- C) zëvendësimin e Ca^{2+} , Mg^{2+} me kationin Na^{+}
- D) osmozën e anasjellë

534. Uji për injeksion përftohet me:

- A) me jonokëmbim
- B) me distilim
- C) valimin e ujit të zakonshëm
- D) osmozë të anasjellë

535. Izopropanoli përdoret për përgatitjen e:

- A) përgatesave për përdorim të jashtëm
- B) tretësirave për përdorim të brendshëm
- C) tinkturave
- D) ekstrakteve të lëngëta

356. Me anën e jonizimit tretja kryhet si rezultat i:

- A) afrisë midis lëndës që tretet dhe tretësit
- B) shpërbashkimit në jone të grimcave të ngarkuara elektrikisht
- C) pranisë së tretësve lipofile
- D) pranisë së lëndëve tensiovepruese

537. Lëndët me molekula polare treten në:

- A) tretës jopolarë
- B) vajra bimore
- C) tretës polare ose gjysmëpolare
- D) vajra minerale

538. Te kloruri i natriumit rritja e temperaturës e:

- A) rrit shumë tretshmërinë
- B) rrit pak tretshmërinë
- C) rrit shumë pak tretshmërinë
- D) nuk ndikon fare

539. Tretshmëria e bazave organike të dobëta (alkaloide, anestetikë lokalë) rritet:

- A) me rritjen e pH-it
- B) me uljen e pH-it
- C) me shtimin e lëndëve tensiovepruese
- D) me futjen e grupeve hidrofille në molekulë

540. Vitaminat e tretshme në yndyrna solubilizohen me anën e:

- A) përndryshimit të pH-it
- B) shtimit të lëndëve tensiovepruese
- C) formimit të kripërave
- D) futjes së grupeve hidrofile në molekulë

541. Solubilizimi i jodit mund të realizohet me anën e:

- A) lëndëve tensiovepruese kationike
- B) lëndëve tensiovepruese anionike
- C) jodureve alkaline
- D) formimit të kripërave

542. Shpejtësia e filtrimit jepet me anën e:

- A) ekuacionit të Noiz-Uitnit
- B) ekuacionit të Ajnshtajnit
- C) ekuacionit të Hagen-Puazëjit
- D) ekuacionit të Fikut

543. Nën ndikimin e dritës cilat lëndë reduktohen:

- A) adrenalina
- B) kripërat e argjendit
- C) fenolet
- D) eteri etilik

544. Makinat e tabletimit të tipit rrotativ krahasuar me makinat e tabletimit të tipit eksentrik kanë rendiment prodhimi:

- A) pak më të madh
- B) të barabartë
- C) më të vogël
- D) shumë më të madh

545. Cilat përgatesa nuk mund të ruhen në temperaturë nën 0 gradë C:

- A) supozitorët
- B) ovulat vaginale
- C) tretësirat për injeksion
- D) serumet dhe vaksinat

546. Aldehidi formik nën ndikimin e temperaturës së ulët:

- A) hidrolizohet
- B) polimerizohet
- C) oksidohet
- D) reduktohet

547. Adrenalina në tretësira ujore, në prani të oksigjenit:

- A) polimerizohet
- B) reduktohet
- C) oksidohet
- D) hidrolizohet

548. Për t'i mbrojtur barnat nga oksidimi përdoren:

- A) lëndë konservuese
- B) lëndë antibakterore
- C) lëndë antioksiduese
- D) lëndë aromatizuese

549. Hinkat me pllakë qelqi poroz, të tipit G (G4 dhe G5) përdoren për filtrim në:

- A) trysni mbi atë atmosferike të theksuar
- B) trysni hidrostatike
- C) zbrazëti
- D) trysni mbi atë atmosferike të ulët

550. Cilat tipa disqesh filtruese përdoren për filtrim sterilizues:

- A) EK
- B) EK1
- C) EK2
- D) EKS

551. Shurupet filtrohen kur janë:

- A) të ftohta
- B) të ngrira
- C) të nxehta
- D) në temperaturën e mjedisit

552. Cila nga lëndët e mëposhtme është më e përshtatshme për qartësimin e shurupeve:

- A) talku
- B) karbonati i magnezit
- C) letërfiltri
- D) oksidi i magnezit

553. Cilat nga lëndët konservuese të mëposhtme konsiderohet më e përshtatshme për shurupet:

- A) esteret e acidit p-hidroksibenzoik
- B) acidi benzoik
- C) acidi salicilik
- D) benzoati i natriumit

554. Kur shurupet janë tepër të përqendruara mund të shfaqet:

- A) fermentimi
- B) kristalizimi i sheqerit
- C) mykja
- D) invertimi i sheqerit

555. Vajrat për përgatitjen e përgatesave parenterale sterilizohen me:

- A) rrezatim jonizues
- B) lëndë kimike
- C) ngohje në termostat
- D) avuj uji të lirë

556. Tretësirat për injeksion që injektohen në kanalën truno-shpinor duhet të kenë trysni osmotike:

- A) më të lartë se serumit i gjakut

- B) të barabartë me serumin e gjakut
- C) më të ulët se serumi i gjakut
- D) më të ulët se një tretësirë klorur natriumi 5%

557. Sterilizimi me ajër të nxehtë kryhet në:

- A) autoklavë
- B) banjë uji
- C) termostat
- D) bek gazi

558. Sterilizimi me avuj uji nën trysni realizohet në:

- A) termostat
- B) autoklavë
- C) banjë uji
- D) llambë alkooli

559. Sterilizimi me filtrim zbatohet me:

- A) letërfiltri
- B) filtërpresë
- C) filtra bakteriologjikë
- D) nuçfiltra

560. Për sterilizimin me rrezatim përdoren:

- A) rrezatimi në zonën infra të kuqe
- B) ultratingujt
- C) rrezet ultravjollcë
- D) rrezet alfa

561. Oksidi i etilenit ka veprim baktericid më të theksuar në:

- A) temperaturën e mjedisit
- B) temperaturë të ulët
- C) temperaturë të lartë
- D) temperaturë nën 0°C

562. Tretësirat për injeksion përgatiten me përqindje:

- A) p/p
- B) v/v
- C) p/v
- D) v/p

563. Prova e shpejtësisë së tretjes (dissolution test) lidhet me:

- A) zbërthimin
- B) qëndresën mekanike
- C) biodisponibilitetin
- D) qëndrueshmërinë

564. Përqendrimi i perfuzioneve me elektrolitë shprehet me:

- A) përqindje p/p
- B) mmol
- C) përqindje p/v

D) përqindje v/p

565. Për korrigjimin e baraspeshës acido -bazike përdoren perfuzionet me:

- A) klorur natriumi
- B) glukozë
- C) hidrogjenkarbonat natriumi
- D) fruktozë

566. Në perfuzionet me lëndë energjetike më se shumti përdoren:

- A) glukozë
- B) kloruri i natriumit
- C) hidrogjenkarbonati i natriumit
- D) klorhidrati i argininës

567. Ujërat oftalmike janë tretësira:

- A) ujore
- B) alkoolike
- C) vajore
- D) propilenglikolike

568. Cila lëndë izotonizuese përdoret për komponimet e argjendit:

- A) kloruri i natriumit
- B) kloruri i kaliumit
- C) glukozë
- D) kloruri i magnezit

569. Në shurupet për diabetikë përdoren:

- A) glicerina
- B) propilenglikoli
- C) rrjedhësit e celulozës (metilcelulozë, karboksimetilcelulozë)
- D) sakaroza

570. Oleati i etilit përdoret për përgatitjen e :

- A) tretësirave ujore
- B) tretësirave vajore
- C) tretësirave për injeksion që injektohen në artere
- D) tretësirave për injeksion që injektohen në venë

571. Për tretësirat oftalmike vajore shtrohet si kërkesë:

- A) steriliteti
- B) izotonia
- C) izohidria
- D) natyra e tretësit

572. Pomadat oftalmike këshillohet që të përdoren:

- A) në orët e para të mëngjesit
- B) gjatë natës
- C) në orët e mesditës
- D) në orët e para të mbrëmjes

573. Cili ekuacion zbatohet gjatë procesit të shpërhapjes:

- A) Noiz-Uitni
- B) Fikut
- C) Hagën -Puazëjet
- D) Ajnshtajnit

574. Macerimi zbatohet duke përdorur si tretës:

- A) etanolin
- B) ujin
- C) eterin
- D) izopropanolin

575. Infuzioni kryhet me tretësat e mëposhtëm:

- A) ujë
- B) izopropanol
- C) eter etilik
- D) etanol

576. Ekstraktimi i lëndëve vepruese në rastin e tinkturave më së shumti kryhet me:

- A) alkool etilik të përqendruar
- B) alkool etilik të holluar
- C) ujë të distiluar
- D) alkool izopropilik

577. Kohëzgjatja e procesit të macerimit është:

- A) 15 minuta
- B) 30 minuta
- C) 45 minuta
- D) 60 minuta

578. Procesi i macerimit të drogës së futur në perkolator zakonisht zgjat:

- A) 12 orë
- B) 24 orë
- C) 48 orë
- D) 72 orë

579. Cila nga metodat e mëposhtme të ekstraktimit zbatohet më shumë për përgatitjen e ekstrakteve të lëngëta alkoolike:

- A) macerimi i thjeshtë
- B) macerimi i dyfishtë
- C) macerimi i shumëfishtë
- D) perkolimi

580. Në sistemet e shpërndara heterogjene bëjnë pjesë:

- A) tretësitat ujore
- B) tretësitat alkoolike
- C) emulsionet
- D) tretësitat vajore

581. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon pozitivisht në tretjen e koloideve:

- A) përzierja
- B) temperatura e lartë
- C) lënia në qetësi e lëndës koloidale në kontakt me tretësin
- D) temperatura e ulët

582. Kur ndodh peptizimi i një koloidi:

- A) kur rritet temperatura e mjedisit
- B) kur ulet temperatura e mjedisit
- C) kur shtohen elektrolitë
- D) kur shtohen joelektrolitë

583. Veshullia e tretësirave shumë të holluara të komponimeve makromolekulare është:

- A) më e ulët se ajo e mjedisit shpërndarës
- B) e barabartë me atë të mjedisit shpërndarës
- C) pak më e lartë se ajo e mjedisit shpërndarës
- D) shumë më e lartë se ajo e mjedisit shpërndarës

584. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në veshullinë e lëngjeve njutoniane:

- A) temperatura e ulët
- B) tensioni tangjencial
- C) temperatura e lartë
- D) temperatura e mjedisit

585. Si ndikon rritja e tensionit tangjencial në lëndët dilatante:

- A) e ul
- B) e rrit
- C) nuk ndikon fare
- D) ndikon pak

586. Veshullia strukturore e sistemeve jonjntoniane përcaktohet me veshullimatësit e mëposhtëm:

- A) Engler
- B) Ostvald
- C) veshullimatës rrotullues (Kuet)
- D) Hopler

587. Sapunet janë lëndë tensiovepruese:

- A) kationike
- B) jojonike
- C) anionike
- D) natyrore

588. Në cilin grup emulgatorësh bën pjesë goma arabike:

- A) anionikë
- B) natyrorë
- C) kationikë
- D) jojonikë

589. Tragakanta është emulgator:

- A) jojonik
- B) natyror
- C) kationik
- D) amfoter

590. Metoda e gomës së thatë shërben për përgatitjen e emulsioneve:

- A) që përdoren ex-tempore
- B) që ruhen për 24 orë
- C) që ruhen për 72 orë
- D) që ruhen për 1 javë

591. Emulsionet përgatiten në temperaturë:

- A) të ulët
- B) të ngrirjes
- C) të mjedisit
- D) të lartë

592. Metoda e majonezës zbatohet për përgatitjen e emulsioneve:

- A) për përdorim të brendshëm
- B) për përdorim të jashtëm
- C) të tipit v/u
- D) të tipit u/v

593. Shpërbërja vetoksiduese e vajrave në emulsionet ndodh më shpesh në emulsionet:

- A) e tipit u/v
- B) e tipit v/u
- C) për përdorim të brendshëm
- D) për përdorim të jashtëm

594. Pezullitë janë forma farmaceutike që përmbajnë:

- A) lëngje të shpërndara në lëngje të papërziueshme
- B) dy lëngje të përziueshme me njëri-tjetrin
- C) një lëndë të ngurtë të patretshme në tretës
- D) një lëndë të ngurtë të tretëshme në tretës

595. Në cilat forma farmaceutike biodisponibiliteti është më i lartë:

- A) tabletat
- B) kapsulat
- C) pezullitë
- D) tabletat me çlirim të përndryshuar

596. Dukuria e flotimit ndodh në rastet kur dendësia e lëndëve hidrofobe është:

- A) më e madhe se ajo e mjedisit shpërndarës
- B) më e vogël se ajo e mjedisit shpërndarës
- C) shumë më e madhe se ajo e mjedisit shpërndarës
- D) e barabartë me atë të mjedisit shpërndarës

597. Në cilat raste aftësia e njomjes së lëndëve të pezullta është më e madhe:

- A) kur këndi i kontaktit luhet nga 0 deri në 90°

- B) kur këndi i kontaktit është i barabartë me 0°
- C) kur këndi i kontaktit është $> 90^\circ$
- D) kur këndi i kontaktit është $=180^\circ$

598. Sedimentimi i lirë në pezullitë zhvillohet kur përqendrimi i pezullive është:

- A) i lartë
- B) 5-10%
- C) 10-15%
- D) i ulët

599. Pezullitë e shflokuluara sedimentojnë me shpejtësi:

- A) të madhe
- B) mesatare
- C) të vogël
- D) shumë të madhe

600. Pezullitë e shflokuluara më së shumti përgatiten:

- A) Në industrinë bioteknologjike
- B) Në farmaci
- C) Në industrinë farmaceutike
- D) Në laboratore

601. Në pezullitë e flokuluara sedimentimi është:

- A) i ngadalshëm
- B) me shpejtësi të vogël
- C) i shpejtë
- D) me shpejtësi mesatare

602. Cila nga metodat e mëposhtme të flokulimit është më e përdorshme:

- A) me anën e elektrolitëve
- B) me anën e lëndëve tensiovepruese jojonike
- C) me anën e polimerëve hidrofilë
- D) me anën e lëndëve tensiovepruese anionike

603. Pezullitë në farmaci përgatiten:

- A) në havan
- B) me përzierës me helikë
- C) me përzierës me spirancë
- D) me përzierës me turbinë

604. Shpejtësia e sedimentimit në aerosolet vlerësohet me anën e ekuacionit:

- A) të Stoksit
- B) të Stoks-Kaninjëmit
- C) të Higushit
- D) të Fikut

605. Nga tretësit e mëposhtëm, cili prej tyre përdoret më shumë për përgatitjen e aerosoleve:

- A) vajrat bimore
- B) alkooli izopropilik
- C) vaji i vazelinës

D) uji i distiluar

606. Gjeneratorët e aerosoleve të dorës ose të xhepit arrijnë:

- A) shkallë të përparuar shpërndarjeje
- B) shkallë mesatare shpërndarjeje
- C) shkallë të ulët shpërndarjeje
- D) shkallë tepër të përparuar shpërndarjeje

607. Pomadat bëjnë pjesë në:

- A) sistemet e shpërndara homogjene
- B) sistemet e shpërndara heterogjene
- C) sistemet e shpërndara heterogjene me shkallë të përparuar shpërndarjeje
- D) sistemet e shpërndara heterogjene me shkallë të vogël shpërndarjeje

608. Pomadat që përdoren për mbrojtjen e lëkurës nga veprimi agresiv i disa lëndëve të dëmshme quhen:

- A) pomada dermokozyetike
- B) pomada mbrojtëse
- C) pomada epitelizuese
- D) pomada freskuese

609. Hidroxhelet përftohen nga:

- A) polietilenglikolet
- B) lëndët markomolekulare natyrore, gjysmë-sintetike ose sintetike
- C) lëndët inorganike
- D) parafinat

610. Në pomadat pezulli lënda vepruese shpërndahet në bazën e pomadës në trajtë:

- A) tretësire
- B) pezullie
- C) emulsioni
- D) sistemi të shpërndarë të përzier: emulsion-pezulli, pezulli-tretësirë etj

611. Homogjenizatorët e pomadave janë mullinj me :

- A) rruaza
- B) 3 cilindra
- C) tretësira
- D) të përziera (emulsione-pezulli, tretësira-pezulli etj)

612. Depërtuesmatësi (penetrometri) është aparat që përcakton:

- A) veshullinë e pomadave
- B) aftësinë e bazave të pomadave për të trupëzuar ujë
- C) shkallën e depërtimit në pomadë
- D) tolerancën fiziologjike të lëkurës

613. Kremrat e thata janë:

- A) kremra nate
- B) kremra dite
- C) kremra që përmbajnë yndyrna
- D) kremra që përmbajnë hidrokarbure

614. Cila është kërkesa më e rëndësishme për pomadat oftalmike:

- A) përçindja e lëndëve vepruese
- B) përmbajtja e vazelinës
- C) përmbajtja e lanolinës
- D) steriliteti

615. Në supozitorët rektalë trajta më e përshtatshme është:

- A) cilindrike me majë
- B) silurit
- C) konike
- D) cilindrike pa majë

616. Rruga rektale kundërrindikohet:

- A) kur barnat nuk merren dot nga goja
- B) në dëmtimet lokale të rekumit
- C) për barnat lipofile
- D) kur barnat shkaktojnë vjellje kur merren nga goja

617. Lënda vepruese në supozitorët kalon drejtpërdrejt në qarkullimin e gjakut:

- A) kur çlirohet në nivelin e venave hemorroidale të poshtme
- B) kur çlirohet në nivelin e venave hemorroidale të sipërme
- C) kur gjaku kalon përmes venës hyrëse (vena portae)
- D) kur eksipienti (baza) emulsionohet në prani të mukusit

618. Baza supozitorësh me natyrë yndyrore quhen të përshtatshme kur:

- A) kanë qëndresë mekanike të vogël
- B) kanë qëndresë mekanike të mjaftueshme
- C) japin përzierje eutektike
- D) janë të paqëndrueshme nga ana kimike

619. Gjilpi i kakaos si bazë supozitorësh është i përshtatshëm sepse:

- A) nuk trupëzon ujë dhe tretësira ujore
- B) paraqitet në shumë trajta kristalore
- C) i çliron lëndët vepruese në temperaturën e trupit
- D) ka veti për të mos u tkurrur

620. Masa xhelatinore është bazë e përshtatshme për supozitorët:

- A) rektalë
- B) vaginalë
- C) uretralë
- D) përgatiten supozitorë me të trija metodat e rëndomta (modelim me dorë, presim, shkrirje e derdhje në forma)

621. Masa sapuno-glicerimore ushtron veprim

- A) antiinflamator
- B) laksativ
- C) antihemorroidal
- D) antipiretik

622. Cila nga bazat e mëposhtme mund të përdoret për përgatitjen e supozitorëve me presim :

- A) gjalpi i kakaos
- B) masa xhelatinore
- C) masa sapuno-glicerinore
- D) polietilenglikolet

623. Cila është lënda lyresuese më e përshtatshme e formave të supozitorëve, kur keto të fundit përftohen nga bazat yndyrore (gjalp kakaoje etj).

- A) alkooli sapunor
- B) alkooli sapunor-glicerinë
- C) vaji lulediellit
- D) glicerina

624. Havanët prej hekuri shërbejnë për pluhurizimin e :

- A) pluhurave të trasha
- B) pluhurave me madhësi mesatare grimcash
- C) drogave bimore
- D) pluhurave abrazive

625. Kur grimcat e një pluhuri kanë ngarkesa me të njëjtën shenjë, poroziteti:

- A) është i papërfillshëm
- B) mbetet i pandryshuar
- C) rritet
- D) ulet së tepërmi

626. Kur grimcat e një pluhuri kanë ngarkesë me shenjë të kundërt poroziteti;

- A) ulet
- B) rritet së tepërmi
- C) rritet në mënyrë të papërfillshme
- D) mbetet i pandryshuar

627. Efekti antimikotik i grizeofulvinës është më i madh kur grimcat e saj janë:

- A) të mëdha
- B) me madhësi mesatare
- C) të mikronizuara
- D) të vogla

628. Pluhurat tepër të imët përftohen:

- A) me anën e pluhurizimit në havanë
- B) në mullinjtë me ajër të ngjeshur
- C) në mullinjtë centrifugale me çekiçë
- D) në mullinjtë me rruaza

629. Pluhura efloreshentë janë ata që:

- A) përthithin lagështinë atmosferike
- B) humbasin ujin e kristalizimit në kontakt me ajrin
- C) oksidohen nën ndikimin e oksigjenit të ajrit
- D) nuk pësojnë asnjë ndryshim

630. Ç'lloj kapsulash përftohen me aparatën Sherer (në matrica rrotulluese):

- A) kapsula xhelatinore të forta
- B) kapsula xhelatinore të buta
- C) operkulate
- D) perla

631. Cili nga llojet e mëposhtme të tabletave është më i rëndësishëm:

- A) tabletat që mbahen në gojë
- B) tabletat që merren nga goja (me gëlltitje)
- C) tabletat gjinekologjike
- D) tabletat parenterale

632. Lëndët holluese të tabletave shtohen me qëllim që:

- A) të ndihmojnë në zërthimin e tabletave
- B) tabletave t'u jepet madhësia dhe pesha e duhur
- C) të ndihmojnë në formimin e granulave
- D) të sigurojnë rrëshqitjen e lehtë dhe të njëtrajtshme të granulatit

633. Talku shohet në tabletat si:

- A) lëndë holluese
- B) lëndë kundërngjitëse
- C) lëndë lidhëse
- D) lëndë zërthyese

634. Granulimi me rrugë të thatë më së shumti zbatohet për :

- A) lëndët që nuk shpërbëhen nga prania e lagështisë
- B) lëndët që shpërbëhen në prani të lagështisë
- C) lëndët që i durojnë temperaturat e larta
- D) lëndët e ndjeshme ndaj oksidimit

635. Granulimi me rrugë të njomë zbatohet për:

- A) lëndët që nuk e durojnë temperaturën e lartë
- B) lëndët që nuk ndikohen nga lagështia
- C) lëndët që shpërbëhen në prani të oksigjenit të ajrit
- D) lëndët që reduktohen në prani të agjentëve atmosferikë

636. Makinat e tabletimit të tipit të përzier (ndërmjetëm) ndryshojnë nga ato të tipit eksentrik për shkak të:

- A) punsonit të sipërm të lëvizshëm
- B) punsonit të poshtëm të palëvizshëm
- C) pranisë së një thundrre të lëvizshme të bashkuar me hinkën
- D) matricës të palëvizshme

637. Kontrolli organoleptik i tabletave merret me:

- A) masën mesatare
- B) pamjen e jashtme
- C) qëndrësën mekanike
- D) zërthimin

638. Thërrmueshmëria e tabletave lidhet me:

- A) kohën e zbërthimit
- B) qëndresën mekanike
- C) homogjenitetin
- D) masën mesatare

639. Qëndresa mekanike e theksuar e tabletave komprometon:

- A) masën mesatare
- B) zbërthimin
- C) pamjen e jashtme
- D) homogjenitetin

640. Cilat lëndë ndihmëse ndikojnë pozitivisht në zbërthimin e tabletave:

- A) lëndët lidhëse
- B) lëndët lyrësuese
- C) lëndët zbërthyes
- D) lëndët antistatike

641. Veshja e tabletave (drazhifikimi) zbatohet kryesisht që:

- A) përgatesat të zbërthehen në stomak
- B) përgatesat të zbërthehen në zorrë
- C) përgatesat të mbrohen nga ndikimi i agjentëve të mjedisit të jashtëm
- D) përgatesat të zbërthehen brenda një kohe të gjatë

642. Ngjyrosja e drazheve bëhet me qëllim që:

- A) t'u zgjatet veprimi
- B) të zbërthehen më shpejt në stomak
- C) të zbërthehen më ngadalë në zorrë
- D) të bëhen tërheqëse për të sëmurin

643. Prova e zbërthimit është e domosdoshme për tabletat:

- A) Përshkumëzuese
- B) Që merren nga goja
- C) Që mbahen në gojë
- D) Që përtypen

644. Nqs një pluhur për përgatitjen ex-tempore të shurupit të ampicilinës ka nevojë për 75 ml ujë që të japë 100 ml shurup me dozën 100 mg/5 ml, sa ujë duhet shtuar për të përfutuar një shurup me dozën 125mg/5 ml?

- A) 55 ml
- B) 100 ml
- C) 110 ml
- D) 125 ml

645. Sa është pH-i i një tretësire të bari acid të fortë në përqendrimin 0.01 M?

- A) 0.2
- B) 1
- C) 2
- D) 3

646. Vlera e pH-it të një tretësire 10^{-3} të një bari në formë acidi të fortë është:

- A) 3
- B) 6
- C) 9
- D) 11

647. Barnat A dhe B kanë karakteristika neutrale. Kur treten në një tretësirë tampone me $\text{pH}=7.5$ paraqesin një koeficient të ndarjes vaj/ujë të barabartë me 1×10^{-4} dhe 1×10^2 përkatësisht. Koha e eliminimit nga organizmi

- A) është më e gjatë për A sesa për B
- B) është më e shkurtër për A sesa për B
- C) është e barabartë për barnat A dhe B
- D) nuk varet nga tretshmëria në $\text{pH}=7.5$ pasi A dhe B janë neutralë

648. Cila nga përzierjet e mëposhtme i afrohet më shumë përbërjes së një tretësirë hidroalkoolike 30%?

- A) 30 g etanol dhe 70 g ujë
- B) 30 ml etanol dhe 70 ml ujë
- C) 30 g etanol dhe 70 ml ujë
- D) 40 g etanol 96% dhe 60 g ujë

649. Një tretësirë izotonike me plazmën ka një vlerë të uljes krioskopike $0.52 \text{ }^\circ\text{C}$. Tretësira 1% e adrenalinit tartrat ka një vlerë të uljes krioskopike prej $0.2 \text{ }^\circ\text{C}$. Cili është intervali i peshës së lëndës izotonizuese (me vlerë të uljes krioskopike $0.4 \text{ }^\circ\text{C}$) të

- A) 0.6 deri në 1 g
- B) 2 deri në 6 g
- C) 6 deri në 10 g
- D) 12 deri në 20 g

650. Barnat e jonizueshëm kanë një shkallë jonizimi që varet nga pH-i tretësirës ku ndodhen. Në cilën nga vlerat e mëposhtme të pH-it të një tretësire për injeksion, një bar acid dhe me $\text{pK}_a = 5$ është i jonizuar në masën 99%?

- A) 3
- B) 5
- C) 6
- D) 7

651. Nqs keni 18 g lëndë vepruese me dendësi aparente 0.6 g/ml dhe ju kërkohet të përgatisni kapsula me të, sa është numri i kapsulave Nr. 5 ($V=0.1 \text{ ml}$) që duhet të përdorni?

- A) 150
- B) 250
- C) 300
- D) 400

652. Një kollir përmban 0.2% atropinë klorhidrat dhe X g NaCl në një vëllim të caktuar. Nqs duhet të përgatitim një kollir tjetër me të njëjtën përqindje të lëndës vepruese por me dyfishin e vëllimit, cila nga sasi të mëposhtme i afrohet më shumë sasisë së lë

- A) $1/2 X$
- B) X
- C) $2 X$

D) 4 X

653. Një kollir përmban 0.2% atropine klorhidrat dhe X g NaCl. Po të përgjysmojmë % e atropinës klorhidrat dhe të lëmë të pandryshuar vëllimin, sasia e lëndës izotonizuese që duhet përdorur është më e përafërt me

A) 1/2 X

B) X

C) 2 X

D) 4 X

654. Një tretësirë izotonike me plazmën përmban 0.9 g NaCl në 100 ml. Lëndët A dhe B kanë të njëjtën vlerë të ekuivalentit të NaCl të barabartë me 0.1. Nqs 0.25 g të secilës prej këtyre dy lëndëve treten në 50 ml ujë, pesha e NaCl që nevojitet për izotonizuar

A) 0.1 deri në 0.5 g

B) 0.05 deri në 0.1 g

C) 0.5 deri në 1 g

D) 1.5 deri në 2 g

655. Nqs do ju duhet të përgatisni kapsula me 480 mg lëndë vepruese me dendësi aparente 0.8 g/ml, cila do të ishte madhësia më e përshtatshme?

A) 00 (V=1.0ml)

B) 0 (V=0.7 ml)

C) 2 (V=0.4 ml)

D) 3 (V=0.3 ml)

656. Nqs keni 50 g lëndë vepruese me dendësi aparente 1 g/ml dhe ju kërkohet të përgatisni kapsula me të, sa është numri i kapsulave Nr. 2 (V=0.4ml) që duhet të përdorni?

A) 100

B) 125

C) 140

D) 180

657. Pesë g pluhur i një lëndë vepruese me dendësi të vërtetë 2 g/ml zë një vëllim prej 10 ml nqs vendoset në një cilindër të shkallëzuar. Sa është poroziteti i këtij pluhuri?

A) 95 %

B) 85 %

C) 75 %

D) 65 %

658. Tretësira 1% e barit A ka një $\Delta T = 0.2$ °C. Në cilin interval gjendet pesha e lëndës izotonizuese (me $\Delta T = 0.2$ °C) që duhet shtuar për të izotonizuar një tretësirë që përmban 1g A të tretur në 100 ml ujë?

A) 0.1 deri në 0.2 g

B) 0.5 deri në 1 g

C) 1.5 deri në 2 g

D) 3 deri në 5 g

659. Nqs do ju duhet të përgatisni kapsula me 300 mg lëndë vepruese me dendësi aparente 1.2 g/ml, cila do të ishte madhësia më e përshtatshme?

A) 00 (V=1.0ml)

- B) 1 ($V=0.5$ ml)
- C) 2 ($V=0.4$ ml)
- D) 3 ($V=0.3$ ml)

660. Nqs keni 77 g lëndë vepruese me dendësi aparente 1.1 g/ml dhe ju kërkohet të përgatisni kapsula me të, sa është numri i kapsulave Nr. 1 ($V=0.5$ ml) që duhet të përdorni?

- A) 140
- B) 180
- C) 200
- D) 300

661. Lënda vepruese A ka një vlerë të ekuivalentit të klorurit të natriumit të barabartë me 0.1. Nqs 0.2 g të lëndës A treten në 50 ml ujë, pesha e NaCl që nevojitet për të izotonizuar tretësirën është

- A) 0.1 - 0.3 g
- B) 0.3 - 0.5 g
- C) 0.5 - 1.0 g
- D) 1.0 - 2.0 g

662. Në 20 grade C, 20 pika ujë janë të barabarta me 1 gram nqs përdorim një pikatore me diametër të jashtëm 3mm dhe të brendshëm 0.6 mm. Kjo i detyrohet

- A) tensionit sipërfaqësor të ujit
- B) veshullisë së ujit
- C) tensionit të avujve të ujit
- D) konstantes dielektrike të ujit

663. Lënda vepruese A ka një vlerë të ekuivalentit të klorurit të natriumit të barabartë me 0.5. Nqs 0.5 g të lëndës A treten në 50 ml ujë, pesha e NaCl që nevojitet për të izotonizuar tretësirën përfshihet në intervalin

- A) 0.1 deri në 0.5 g
- B) 0.5 deri në 1.5 g
- C) 1.5 deri në 2 g
- D) 2.5 deri në 3 g

664. Nqs do ju duhet të përgatisni kapsula me 100 mg lëndë vepruese me dendësi aparente 0.6 g/ml, cila do të ishte madhësia më e përshtatshme?

- A) 1 ($V=0.5$ ml)
- B) 2 ($V=0.4$ ml)
- C) 3 ($V=0.3$ ml)
- D) 4 ($V=0.2$ ml)

665. Nqs keni 9 g lëndë vepruese me dendësi aparente 0.9 g/ml dhe ju kërkohet të përgatisni kapsula me të, sa është numri i kapsulave Nr. 4 ($V=0.2$ ml) që duhet të përdorni?

- A) 30
- B) 40
- C) 50
- D) 60

666. Nqs kërkohet të përgatiten 50 kapsula N. 5 ($V=0.1$ ml) me lëndë vepruese me dendësi 0.6 g/ml, në çfarë intervali përfshihet pesha e lëndës vepruese?

- A) 3.0 - 3.3 g

- B) 5.4 - 5.6 g
- C) 6.4 - 6.6 g
- D) 7.0 - 8.0 g

667. Nqs keni 49 g lëndë vepruese me dendësi aparente 0.5 g/ml dhe ju kërkohet të përgatisni kapsula me të, sa është numri i kapsulave Nr. 0 ($V=0.7$ ml) që duhet të përdorni?

- A) 70
- B) 140
- C) 160
- D) 200

668. Një gram i lëndës vepruese A jep 20.0 ml tretësirë izotonike me plazmën kurse 1 g NaCl jep 108.7 ml. Nqs 0.5 g A treten në 50 ml ujë, pesha e NaCl që nevojitet për izotonizimin e tretësirës përfshihet në intervalin

- A) 0.05 - 0.1 g
- B) 0.1 - 0.5 g
- C) 0.5 - 1.0 g
- D) 1.5 - 2.0 g

669. Tretësira 1% e barit A ka një $\Delta T = 0.2$ °C. Në cilin interval gjendet pesha e lëndës izotonizuese (me $\Delta T = 0.32$ °C) që duhet shtuar për të izotonizuar një tretësirë që përmban 1g A të tretur në 100ml ujë?

- A) 0.1 deri në 0.2 g
- B) 0.5 deri në 1.5 g
- C) 1.5 deri në 2 g
- D) 3 deri në 5 g

670. Sa është sasia e vajit të parafinës (dendësi 0.9) që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatëse galenike emulsion në sasi 80 ml dhe që përmban 25% vaj parafine?

- A) 1.8 g
- B) 14 g
- C) 18 g
- D) 25 g

671. Tretësira 1% e barit A dhe barit B kanë të dyja një $\Delta T = 0.2$ °C. Në cilin interval gjendet pesha e lëndës izotonizuese (me $\Delta T = 0.2$ °C) që duhet shtuar për të izotonizuar një tretësirë që përmban 0.5g A dhe 0.5G B të tretur në 100ml ujë?

- A) 0.1 deri në 0.2 g
- B) 0.5 deri në 1.3 g
- C) 1.4 deri në 2.1 g
- D) 3 deri në 5 g

672. Sa është sasia e gomës arabike e nevojshme për përgatitjen e emulsionit parësor, sipas metodës kontinentale, të një përgatëse galenike të përbërë nga 80 ml emulsion me 25% vaj vazeline ($d=0.9$)?

- A) 1.6 g
- B) 2.3 g
- C) 4.5 g
- D) 10 g

673. Kërkohe të përgatiten 100 ml tretësirë HCl 0.1 M duke u nisur nga HCl 12 M. Në cilin interval gjendet sasia e HCl 12 M që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 ml
- B) 5 - 15 ml
- C) 80 - 100 ml
- D) 100 - 120 ml

674. Kërkohe të përgatiten 300 ml tretësirë HCl 2 M duke u nisur nga HCl 6 M. Në cilin interval gjendet sasia e HCl 6 M që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 ml
- B) 5 - 15 ml
- C) 80 - 95 ml
- D) 100 - 120 ml

675. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e vajit të parafinës (dendësi 0.9) që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatese galenike emulsion në sasi 75 ml dhe që përmban 15% vaj parafine?

- A) 4 - 6 g
- B) 9 - 11 g
- C) 15 - 18 g
- D) 20 - 25 g

676. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e ujit që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatese galenike emulsion në sasi 75 ml dhe që përmban 15% vaj parafine (dendësi 0.9)?

- A) 4 - 6 g
- B) 6 - 8 g
- C) 15 - 18 g
- D) 20 - 25 g

677. Kërkohe të përgatiten 300 ml tretësirë HCl 0.2 M duke u nisur nga HCl 6 M. Në cilin interval gjendet sasia e HCl 6 M që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 ml
- B) 5 - 15 ml
- C) 80 - 95 ml
- D) 100 - 120 ml

678. Nqs do ju duhet të përgatisni kapsula me 250 mg lëndë vepruese me dendësi aparente 0.8 g/ml, cila do të ishte madhësia më e përshtatshme?

- A) 1 (V=0.5 ml)
- B) 2 (V=0.4 ml)
- C) 3 (V=0.3 ml)
- D) 5 (V=0.1 ml)

679. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e ujit që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatese galenike të përbërë nga 50 ml vaj peshku (dendësi 1) në 75 ml emulsion total?

- A) 12 - 13 g
- B) 20 - 22 g
- C) 24 - 26 g

D) 46 - 50 g

680. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e vajit të recinit (dendësi 1) që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatëse galenike emulsion në sasi 150 ml dhe që përmban 30% vaj recini?

A) 4.4 - 4.6 g

B) 16 - 18 g

C) 28 - 30 g

D) 44 - 46 g

681. Rezultati i testit të uniformitetit të peshës së tabletave konsiderohet pozitiv kur jo më shumë sesa 2 tableta devijojnë me një përqindje të caktuar nga pesha mesatare. Sa është kjo përqindje për tabletat me peshë nga 80 deri në 250 mg?

A) 5%

B) 7.5%

C) 10%

D) 12.5%

682. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e ujit që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatëse galenike emulsion në sasi 150 ml dhe që përmban 30% vaj recini (dendësi 1)?

A) 4.4 - 4.6 g

B) 16 - 18 g

C) 20 - 23 g

D) 44 - 46 g

683. Në cilin nga intervalet e mëposhtme është e përfshirë sasia e gomës arabike që nevojitet për të përgatitur, sipas metodës kontinentale, emulsionin parësor të një përgatëse galenike emulsion në sasi 150 ml dhe që përmban 30% vaj recini me dendësi 1?

A) 4.4 - 4.6 g

B) 11 - 13 g

C) 20 - 23 g

D) 44 - 46 g

684. Farmakopeja parashikon testin e friabilitetit për kontrollin e cilësisë së tabletave. Limiti i humbjes në përqindje të peshës totale i lejuar për këtë test është

A) 0.5%

B) 1%

C) 1.5%

D) 2%

685. Cili nga acidet e mëposhtme, paraqet shkallën më të lartë të jonizimit kur ndodhet në tretësirë ujore?

A) benzilpenicilina (pKa = 2.8)

B) aspirina (pKa = 3.5)

C) indometacina (pKa = 4.5)

D) ibuprofeni (pKa = 5.2)

686. Duhet përgatitur 220 ml tretësirë hidroalkoolike me eosinë 0.1%. Në cilin interval gjendet sasia e eosinës që duhet peshuar?

- A) 0.05 - 0.1 g
- B) 0.215 - 0.250 g
- C) 1 - 3 g
- D) 20 - 25 g

687. Duhet përgatitur 0.250 l tretësirë NaOH 4%. Në cilin interval gjendet sasia e sodës që duhet peshuar?

- A) 2 - 5 g
- B) 5 - 10 g
- C) 10 - 15 g
- D) 20 - 25 g

688. Nqs kërkohet të përgatiten 30 kapsula N. 00 ($V=1.0$ ml) me lëndë vepruese me dendësi 1.2 g/ml, në çfarë intervali përfshihet pesha totale e lëndës vepruese që nevojitet?

- A) 30 - 33 g
- B) 34 - 38 g
- C) 54 - 56 g
- D) 64 - 66 g

689. Nqs kërkohet të përgatiten 100 kapsula N. 1 ($V=0.5$ ml) me lëndë vepruese me dendësi 1.1 g/ml, në çfarë intervali përfshihet pesha totale e lëndës vepruese që nevojitet?

- A) 54 - 56 g
- B) 60 - 63 g
- C) 64 - 66 g
- D) 70 - 73 g

690. Pesembedhjetë g oksid magneziumi zënë një vëllim prej 150 ml. Duke patur parasysh që dendësia e vërtetë e kësaj lënde është 3 g/ml, cilit interval i përket poroziteti i tij?

- A) 80 - 84%
- B) 85 - 89%
- C) 90 - 94%
- D) 95 - 99%

691. Kërkohet të përgatiten 1000 ml tretësirë HCl 0.1 M duke u nisur nga HCl 12 M. Në cilin interval gjendet sasia e HCl 12 M që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 ml
- B) 5 - 15 ml
- C) 80 - 100 ml
- D) 100 - 120 ml

692. Vëllimi i tretësit që nevojitet për të tretur 1 g lëndë, të përshkruar si "pak e tretshme" nga USP-ja është:

- A) nga 10 deri në 30 ml
- B) nga 30 deri në 100 ml
- C) nga 100 deri në 1000 ml
- D) nga 1000 deri në 10000 ml

693. Nqs do ju duhet të përgatisni kapsula me 350 mg lëndë vepruese me dendësi aparente 0.8 g/ml, cila do të ishte madhësia më e përshtatshme?

- A) 1 ($V=0.5$ ml)

- B) 2 (V=0.4 ml)
- C) 3 (V=0.3 ml)
- D) 5 (V=0.1 ml)

694. Nqs një pluhur për përgatitjen ex-tempore të shurupit të barit X ka nevojë për 170 ml ujë që të japë 200 ml shurup me dozën 300 mg/5 ml, sa ujë duhet shtuar për të përfutuar një shurup me dozën 250 mg/5 ml?

- A) 120 ml
- B) 140 ml
- C) 160 ml
- D) 200 ml

695. Tete g pluhur i një lëndë vepruese me dendësi të vërtetë 2 g/ml zë një vëllim prej 10 ml nqs vendoset në një cilindër të shkallëzuar. Sa është poroziteti i këtij pluhuri?

- A) 90 %
- B) 80 %
- C) 70 %
- D) 60 %

696. Nqs kërkohet të përgatiten 100 kapsula N. 4 (V=0.2ml) me lëndë vepruese me dendësi 0.6 g/ml, në çfarë intervali përfshihet pesha e lëndës vepruese?

- A) 7.0 - 7.3 g
- B) 8.4 - 8.6 g
- C) 10.4 - 10.6 g
- D) 12.0 - 13.0 g

697. Për të përcaktuar shkallën e përqendrimit të shurupeve që përgatiten në të nxehtë dhe për t'i çuar ato në përqendrimin e duhur mund të përdoret termometri. Termometri, i futur në një shurup që valon dhe që ka përqendrimin 64%, tregon temperaturën

- A) 100 grade C
- B) 105 grade C
- C) 110 grade C
- D) 115 grade C

698. Për të ambalazhuar 100 g shurup të thjeshtë është më e përshtatshme të përdoret një shishe më vëllim

- A) 80 ml
- B) 100 ml
- C) 130 ml
- D) 150 ml

699. Në qoftëse ju kërkohet të përgatisni 1000 ml shurup të thjeshtë, sa është sasia e sheqerit që ju nevojitet?

- A) rreth 850 g
- B) rreth 650 g
- C) rreth 500 g
- D) rreth 350 g

700. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 500 mg. Sa është doza për një fëmijë 3 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

- A) 50 mg
- B) 100 mg
- C) 150 mg
- D) 250 mg

701. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 250 mg. Sa është doza për një fëmijë 3 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

- A) 50 mg
- B) 100 mg
- C) 150 mg
- D) 200 mg

702. Pese g pluhur i një lëndë vepruese me dendësi të vërtetë 2.5 g/ml zë një vëllim prej 10 ml nqs vendoset në një cilindër të shkallëzuar. Sa është poroziteti i këtij pluhuri?

- A) 90 %
- B) 80 %
- C) 70 %
- D) 60 %

703. Barnat e jonizueshëm kanë një shkallë jonizimi që varet nga pH-i tretësirës ku ndodhen. Në cilën nga vlerat e mëposhtme të pH-it të një tretësire për injeksion, një bar bazik dhe me $pK_a = 8$ është i jonizuar në masën 99%?

- A) 3
- B) 5
- C) 6
- D) 7

704. Nqs kërkohet të përgatiten 50 kapsula N. 2 ($V=0.4\text{ml}$) me lëndë vepruese me dendësi 0.6 g/ml, në çfarë intervali përfshihet pesha e lëndës vepruese?

- A) 7.0 - 7.3 g
- B) 8.4 - 8.6 g
- C) 10.4 - 10.6 g
- D) 12.0 - 13.0 g

705. Kërkohet që të përgatiten 500 g tretësirë peroksid hidrogjeni 3% duke u nisur nga peroksid hidrogjeni i përqendruar 30-33%. Në cilin interval gjendet sasia e peroksidit të hidrogjenit të përqendruar që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 g
- B) 5 - 15 g
- C) 15 - 25 g
- D) 45 - 55 g

706. Nqs një pluhur për përgatitjen ex-tempore të shurupit të barit X ka nevojë për 85 ml ujë që të japë 100 ml shurup me dozën 150 mg/5 ml, sa ujë duhet shtuar për të përfutuar një shurup me dozën 125mg/5 ml?

- A) 60 ml
- B) 70 ml
- C) 80 ml
- D) 100 ml

707. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 450 mg. Sa është doza për një fëmijë 6 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

- A) 50 mg
- B) 100 mg
- C) 150 mg
- D) 200 mg

708. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 600 mg. Sa është doza për një fëmijë 4 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

- A) 100 mg
- B) 150 mg
- C) 300 mg
- D) 400 mg

709. Duhet përgatitur 200 ml tretësirë ujore e acidit borik 3%. Në cilin interval gjendet sasia e acidit borik që duhet peshuar?

- A) 0.5 - 0.7 g
- B) 1 - 3 g
- C) 5 - 7 g
- D) 25 - 30 g

710. Barnat e jonizueshëm kanë një shkallë jonizimi që varet nga pH-i tretësirës ku ndodhen. Në cilën nga vlerat e mëposhtme të pH-it të një tretësire për injeksion, një bar bazik dhe me $pK_a = 8.5$ është i jonizuar në masën 99%?

- A) 3.5
- B) 5.5
- C) 6.5
- D) 7.5

711. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 300 mg. Sa është doza për një fëmijë 6 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

- A) 100 mg
- B) 150 mg
- C) 200 mg
- D) 250 mg

712. Kërkohe të përgatiten 200 g tretësirë peroksid hidrogjeni 3% duke u nisur nga peroksid hidrogjeni i përqendruar 30-33%. Në cilin interval gjendet sasia e peroksidit të hidrogjenit të përqendruar që duhet marrë?

- A) 0.5 - 1.5 g
- B) 5 - 15 g
- C) 15 - 25 g
- D) 45 - 55 g

713. Rezultati i testit të uniformitetit të peshës së tabletave konsiderohet pozitiv kur jo më shumë sesa 2 tableta devijojnë me një përqindje të caktuar nga pesha mesatare. Sa është kjo përqindje për tabletat me peshë më të vogël se 80 mg?

- A) 5%
- B) 7.5%
- C) 10%

D) 12.5%

714. Rezultati i testit të uniformitetit të peshës së tabletave konsiderohet pozitiv kur jo më shumë sesa 2 tableta devijojnë me një përqindje të caktuar nga pesha mesatare. Sa është kjo përqindje për tabletat me peshë më të madhe se 250 mg?

A) 5%

B) 7.5%

C) 10%

D) 12.5%

715. Doza terapeutike e barit për një të rritur është 400 mg. Sa është doza për një fëmijë 4 vjeç (sipas formulës së Young-ut)?

A) 50 mg

B) 100 mg

C) 150 mg

D) 200 mg

716. Nqs një pluhur për përgatitjen ex-tempore të shurupit të amplicilinës ka nevojë për 150 ml ujë që të japë 200 ml shurup me dozën 200 mg/5 ml, sa ujë duhet shtuar për të përfutur një shurup me dozën 250 mg/5 ml?

A) 110 ml

B) 200 ml

C) 220 ml

D) 250 ml

717. Barnat e jonizueshëm kanë një shkallë jonizimi që varet nga pH-i tretësirës ku ndodhen. Në cilën nga vlerat e mëposhtme të pH-it të një tretësire për injeksion, një bar acid dhe me $pK_a = 3$ është i jonizuar në masën 99%?

A) 3

B) 5

C) 6

D) 7

718. Duhet përgatitur 300 ml tretësirë hidroalkoolike me jod 1%. Në cilin interval gjendet sasia e jodit që duhet peshuar?

A) 0.05 - 0.1 g

B) 0.215 - 0.250 g

C) 2 - 4 g

D) 20 - 25 g

719. Dhjete g pluhur i një lëndë vepruese me dendësi të vërtetë 2.5 g/ml zë një vëllim prej 10 ml nqs vendoset në një cilindër të shkallëzuar. Sa është poroziteti i këtij pluhuri?

A) 90 %

B) 80 %

C) 70 %

D) 60 %

720. Lënda quhet hidrophile kur ka afri për:

A) vajin yndyror

B) vajin e parafinës

- C) ujin e distiluar
- D) oleatin e etilit

721. Sulfonamidet ndër efektet anësore, paraqesin:

- A) Cianoze
- B) Eksitueshmëri
- C) Depresion
- D) Kristaluri

6. Biofarmaci

1. Supozimet mbi të cilat ngrihen modelet farmakokinetike kompartmentale janë:

- A) Procesi që e sjell barin në kompartment mund të jetë i rendit të parë ose të dytë
- B) Procesi që e sjell barin në kompartment është i rendit zero
- C) Kompartimenti mund ta ndryshojë vëllimin e tij në kohë
- D) Përqendrimi i barit në kompartment është në përpjesëtim të drejtë me dozën e marrë

2. Në modelet kompartmentale një kompartment i korrespondon:

- A) Një indi të veçantë
- B) Sistemit të qarkullimit të gjakut
- C) Një indi apo grupi indesh me fluks të përafërt të gjakut
- D) Një indi me vaskularizim më të lartë

3. Parametrat farmakokinetik që nxirren në bazë të modeleve fiziologjike kanë karakteristikë se:

- A) Janë parametra abstrakte që nuk i korrespondojnë realitetit
- B) Për llogaritjen e këtyre parametrave është e mjaftueshme të njihet vetëm përqendrimi urinar i barit.
- C) Përftohen duke u bazuar në studimet në kafshë
- D) Janë parametra më pak të besueshëm sesa ata që nxirren në bazë të modeleve kompartmentale

4. Modelet fiziologjike kanë karakteristikë se:

- A) Janë më larg realitetit se ata kompartmentale
- B) Përmes tyre nuk mund të studiohet ndikimi i patologjive të ndryshme mbi parametrat farmakokinetike
- C) Janë të vështirë për t'u realizuar krahasuar me modelet kompartmentale sepse kërkojnë më shumë informacion farmakokinetik
- D) Janë të thjeshtë për t'u realizuar sepse nuk kanë nevojë për shumë informacion farmakokinetik

5. Përthithja e shpejtë dhe e plotë e barnave ka përparësi sepse:

- A) Veprimi i barit bëhet më i zgjatur
- B) Veprimi i barit fillon më shpejt
- C) Lidhja me proteinat plazmatike fuqizohet
- D) Eliminimi i barit kryhet më ngadalë

6. Në cilat nga mënyrat e mëposhtme të administrimit të barit kërkohet një fazë paraprake përthithjeje:

- A) Injeksioni intramuskular
- B) Administrimi me perfuzion intravenoz

- C) Injeksioni bolus intravenoz
- D) Administrimi intraarterial

7. Transporti pasiv i barnave përmes membranave qelizore ndikohet nga:

- A) Forma farmaceutike e përdorur
- B) Natyra lipofile apo hidrofile e barit
- C) Madhësia e grimcave të barit në formulimin farmaceutik
- D) Numri i enzimave permeaza të pranishme në membranë

8. Gradienti i përqendrimit të barit ndikon në transportin:

- A) pasiv
- B) aktiv
- C) të aminoacideve
- D) të barit L-dopa

9. Shumica e barnave që merren nga goja përthithen kryesisht nga:

- A) Zorra e hollë
- B) Stomaku
- C) Mëlçia
- D) Tubulat renal

10. Levizja e barit nga vendi i administrimit për në sistemin e qarkullimit të gjakut quhet:

- A) Metabolizëm
- B) Përthithje
- C) Shpërndarje
- D) Biotransformim

11. Barnat që administrohen në rrugë intravenoze shfaqin biodisponibilitet:

- A) Të pjesshëm
- B) Me vlerë 75%
- C) Të plotë
- D) Me vlerë 50%

12. Biodisponibiliteti i një bari i dhënë nga një produkt krahasuar me një produkt standard të njohur i cili përmban të njëjtin bar dhe të administruar në të njëjtën rrugë quhet:

- A) Farmakokinetikë e një bari
- B) Biodisponibilitet relativ i një bari
- C) Biodisponibilitet absolut i një bari
- D) Biodisponibilitet standard i barit

13. Shkalla e përthithjes sistemike të barit nuk ndikohet nga:

- A) Rruga e administrimit të barit
- B) Fluksi i gjakut në vendin e përthithjes
- C) Madhësia e sipërfaqes përthithëse
- D) Përqendrimi i barit në vendin e veprimt

14. Sipërfaqja përthithëse e murit të zorrëve rritet dukshëm për shkak të elementëve të mëposhtëm strukturor:

- A) Palave rrethore të mukozës intestinale dhe vileve.
- B) Palave rrethore të mukozës intestinale dhe mikrovileve.

- C) Palave rrethore të mukozës intestinale, vileve dhe mikrovileve
- D) Enëve të gjakut që vaskularizojnë intestin

15. Një bar do të kalojë me lehtësi membranat qelizore nëse molekulat që e përbëjnë atë janë:

- A) Të tretshme në lipide
- B) Të jonizuara
- C) Më të mëdha se poret e membranës
- D) Polare

16. Lëvizshmëria gastrike është e rëndësishme në fillimin e veprimit të barnave sepse:

- A) Shton metabolizimin e barit
- B) Zvogëlon shkallën e lidhjes së barit me proteinat plazmatike
- C) Ndikon në shpejtësinë dhe shkallën e kontaktit të barit me mukozën intestinale.
- D) Frenon sekretimin aktiv në tubulat renal

17. Mbi shpejtësinë e zbrazjes së stomakut nuk ndikon:

- A) Gjendja emocionale e pacientit
- B) Temperatura e ushqimit
- C) Aftësia ekskretuese e veshkave
- D) Aktiviteti fizik i pacientit

18. Mbi lëvizshmërinë gastrointestinale ndikon cili nga faktorët e mëposhtëm:

- A) Patologjitë e traktit gastrointestinal
- B) Aftësia e barit të administruar për t'u fiksuar në inde
- C) Administrimi i një bari që lidhet fort me proteinat plazmatike
- D) Administrimi i një bari që lidhet dobët me proteinat plazmatike

19. Duke u bazuar në teorinë e pH-shpërndarjes, barnat acide të dobëta do të përthithen më mirë në:

- A) Ileum
- B) Jejunum
- C) Kolon
- D) Stomak

20. Cila nga format e mëposhtme farmaceutike është më e përshtatshme për përthithje nga ana e mukozës gastrointestinale?

- A) drazhe
- B) kapsulë
- C) pezulli
- D) tretësirë

21. Sipërfaqja specifike e një bari rritet me:

- A) rritjen e madhësisë së grimcave të tij
- B) zvogëlimin e madhësisë së grimcave të tij
- C) përdorimin e veshjeve enterosolvente
- D) përdorimin e formave farmaceutike me çlirim gradual

22. Sipërfaqja efektive e barnave është:

- A) e barabartë me sipërfaqen specifike
- B) ajo pjesë e sipërfaqes specifike që njomet nga tretësi
- C) ajo pjesë e sipërfaqes specifike që nuk njomet nga tretësi

D) ajo pjesë e barit që kalon membranat qelizore

23. Shtimi i lëndëve tensiovepruese në formën farmaceutike ndikon:

- A) gjithmonë në rritjen e përthithjes
- B) gjithmonë në zvogëlimin e përthithjes
- C) pozitivisht ose negativisht mbi përthithjen në varësi të përqendrimit të tyre
- D) në uljen e sipërfaqes efektive të barnave hidrofobe

24. Dukuria e polimorfizmit ka të bëjë me:

- A) praninë e grimcave me madhësi të ndryshme në formën farmaceutike
- B) praninë e lëndëve tensiovepruese në formën farmaceutike
- C) vendosjen e ndryshme të molekulave në rrjetin kristalor të lëndës
- D) praninë e formave të ndryshme kripore të një bari

25. Format metastabël kanë përparësi biofarmaceutike pasi:

- A) kanë veti kimike të ndryshme nga format stabël
- B) kanë shpejtësi tretjeje më të madhe se format stabël
- C) kanë veti farmakologjike më të mira se format stabël
- D) lidhen më pak me proteinat plazmatike se format stabël

26. Për një bar me tretshmëri të ulët në ujë, intensifikimi i çlirimit të tij nga forma farmaceutike mund të realizohet duke:

- A) rritur madhësinë e grimcave të barit
- B) përdorur një promedikament të patretshëm në ujë
- C) zgjedhur një formë të hidratuar të barit
- D) e formuluar barin si dispersion molekular në një mbartës inert të tretshëm në ujë

27. Me biodisponibilitet të barit kuptojmë:

- A) Shkallën e kalimit të barit nga forma farmaceutike në tretësi
- B) Shpejtësinë e depërtimit të barit në membranat biologjike
- C) Shkallën e metabolizimit të barit gjatë kalimit fillestar në mëlçi
- D) Shkallën dhe shpejtësinë me të cilën bari bëhet i disponueshëm në vendin e veprimit

28. Bioekuivalenca e barnave përcaktohet në mënyrë më të përshtatshme duke u bazuar mbi:

- A) të dhënat e biodisponibilitetit të barnave
- B) rezultatet terapeutike të përfuara nga barnat
- C) rezultatet klinike të përfuara nga barnat
- D) të dhënat e përfuara nga provat fiziko-kimike të barnave

29. Biodisponibiliteti i barnave nuk mund të vlerësohet përmes:

- A) Studimit të efekteve anësore të barnave
- B) Studimit të përgjigjes terapeutike
- C) Studimit të nivelit plazmatik të barit
- D) Studimeve in vitro

30. Një ndër parametrat që vlerësojnë biodisponibilitetin e një bari gjatë studimit të nivelit plazmatik të tij është:

- A) Sipërfaqja nën lakore (AUC)
- B) Kohezgjatja e efektit
- C) Klirensi i barit

D) Koha e fillimit të efektit

31. Cili nga parametrat e mëposhtëm shpreh vetëm shpejtësinë e përthithjes së barit:

- A) Përqendrimi i pikut (C_{max})
- B) Koha e pikut (t_{max})
- C) Sipërfaqja nën lakore (AUC ose SNL)
- D) Konstantja e eliminimit (k_e)

32. Cili nga parametrat e mëposhtëm është tregues vetëm i shkallës së përthithjes së barit:

- A) Përqendrimi i pikut (C_{max})
- B) Koha e pikut (t_{max})
- C) Sipërfaqja nën lakore (AUC ose SNL)
- D) Gjysmëjeta e barit (t_{1/2})

33. Cili nga parametrat e mëposhtëm ka varësi të dyfishtë si nga shkalla ashtu edhe nga shpejtësia e përthithjes së barit:

- A) Përqendrimi i pikut (C_{max})
- B) Koha e pikut (t_{max})
- C) Sipërfaqja nën lakore (AUC ose SNL)
- D) Klirensi i barit (Cl)

34. Faktorët që rrisin përthithjen e barit nga forma farmaceutike ndikojnë në:

- A) Rritjen e biodisponibilitetit të barit
- B) Uljen e biodisponibilitetit të barit
- C) Nuk ndikojnë mbi biodisponibilitetin e barit
- D) E modifikojnë biodisponibilitetin në mënyrë të paparashikueshme

35. Mungesa e bioekuivalencës mes dy produkteve farmaceutike rrezikon më seriozisht pacientin kur:

- A) Bari ka dritare të gjerë terapeutike
- B) Bari është një produkt OTC (që jepet pa recetë)
- C) Bari ka dritare të ngushtë terapeutike
- D) Bari përdoret nga një grupmoshë 30-40 vjeçare.

36. Përgatesa e cila është autorizuar për t'u hedhur në treg për herë të parë në bazë të dokumentacionit të plotë të paraqitur quhet bar:

- A) Xhenerik
- B) Shumëburimësh
- C) OTC
- D) Patentë

37. Cili nga tipet e mëposhtëm të këmbimit të barnave është në kompetencën e farmacistit:

- A) këmbimi xhenerik
- B) këmbimi terapeutik
- C) këmbim klinik
- D) këmbim farmakologjik

38. Protokollin e studimit të bioekuivalencës mes dy barnave zakonisht është ai i tipit:

- A) retrospektiv
- B) observacional

- C) crossover (model i kryqëzuar)
- D) me kohort

39. Dy produkte farmaceutike mund të ndërkëmbehen atëhere kur ata:

- A) Janë ekuivalentë farmaceutik
- B) Janë alternativë farmaceutik
- C) Janë barna cilësore, efikase dhe të sigurta
- D) Janë bioekuivalente

40. Rëndësia klinike e ndryshimeve në biodisponibilitet mes dy produkteve farmaceutike varet nga:

- A) shpejtësia e eliminimit të tyre
- B) natyra e sëmundjes për të cilën përdoren
- C) shkalla e shpërndarjes së tyre
- D) afiniteti për indet

41. Për vlerësimin e bioekuivalencës janë të domosdoshme edhe njohuritë mbi:

- A) kiminë klinike
- B) statistikën mjekësore
- C) farmakoekonominë
- D) farmakovigjilencën

42. Të gjitha karakteristikat e mëposhtme lidhen me procesin e transportit të lehtësuar të barnave PËRVEÇ:

- A) mekanizmi i transportit ngopet në përqendrime të larta të barit
- B) procesi nuk nevojit energji
- C) nëse dy komponime transportohen me të njëjtin mekanizëm, njëri do të frenojë në mënyrë konkurruese transportin e tjetrit
- D) bari e përshkon membranën kundër gradientit të përqendrimit dhe procesi ka nevojë për energji qelizore

43. Cila nga rrugët e mëposhtme të administrimit e ekspozon më shumë barin ndaj efektit të kalimit fillestar:

- A) Intravenoze
- B) Transdermale
- C) Orale
- D) Sublinguale

44. Barnat mund të çlirohen ngadalë nga rezervat indore të organizmit për periudha të gjata kohe. Rezervuari indor që mbart sasinë më të madhe të barbituratit tiopental është:

- A) Indi yndyror
- B) Mushkëria
- C) Mëlçia
- D) Muskuli

45. Cila nga rrugët e mëposhtme të ekskretimit të barnave është më pak e rëndësishme?

- A) Rruga biliare
- B) Veshkore
- C) Mushkërore
- D) Me qumësht

46. Nëse një bar administrohet si regjim shumëdozësh në intervale dozimi të barabarta me gjysmëjetën e tij të eliminimit, numri i dozave të nevojshme në mënyrë që përqendrimi plazmatik të arrijë gjendjen e qëndrueshme është:

- A) 2-3
- B) 4-5
- C) 6-7
- D) 8-9

47. Parametri farmakokinetik që reflekton më mirë sasinë e barit që arrin në indin target pas administrimit oral të barit është:

- A) Përqendrimi plazmatik pik
- B) Koha për arritjen e përqendrimit pik
- C) Prodhimi i vëllimit të shpërndarjes me konstanten e eliminimit
- D) Sipërfaqja nën lakoren përqendrim-kohë

48. Të gjitha reaksionet e mëposhtme janë biotransformuese të fazës së parë, PËRVEÇ:

- A) Formimi i sulfoksideve
- B) Nitro reduktimi
- C) Hidroliza e estereve
- D) Sulfato-konjugimi

49. Produktet medikamentoze mund të emërtohen në mënyra të ndryshme. Nga emërtimet e mëposhtme, cili është ai që konsiderohet zyrtar, dhe i referohet vetëm një bari dhe jo një produkti të veçantë të prodhuar nga një kompani e veçantë:

- A) Emri i përbashket nderkombetar
- B) Emri patentë
- C) Emri tregtar
- D) Emri pronësor

50. Një formëdoze orale e veshur me çlirim enterik mund të përdoret për të evituar të gjithë problemet e mëposhtme, PËRVEÇ:

- A) Irritimën e mukozës gastrike
- B) Shkatërrimin e barit nga lëngjet gastrike apo nga enzimën digjестive
- C) Shijen e papëlqyeshme të barit
- D) Variabilitetin në përthithje të shkaktuar nga variacionet në kohën e zbrazjes gastrike

51. Të gjitha thëniet e mëposhtme lidhur me lidhjen e barit me proteinat plazmatike janë të vërteta PËRVEÇ:

- A) Barnat acide lidhen zakonisht me albuminat plazmatike; barnat bazike lidhen më me preference me alfa₁-glukoproteinën acide
- B) Lidhja e barit me proteinat plazmatike është një proces i kthyeshëm
- C) Fraksioni i lidhur i barit në plazëm është inaktiv dhe zakonisht i padisponueshëm për shpërndarje indore
- D) Lidhja me proteinat plazmatike zakonisht rrit filtrimin glomerular në veshka

52. Përqindja më e madhe e dozës së një bari të administruar nga goja do të përthithet në zorrën e hollë. Gjithsesi, bazuar mbi faktin se transporti pasiv i formës së pajonizuar të një bari përcakton shkallën e tij të përthithjes, cili nga komponimet e mëposhtme do të përthithet më mirë në zorrën e hollë:

- A) Ampicilina (pKa=2.5)

- B) Aspirina (pKa= 3.0)
- C) Varfarina (pKa= 5.0)
- D) Propranololi (pKa = 9.4)

53. Cili nga reaksionet e mëposhtme të biotransformimit nuk është reaksion biotransformimi i fazës së dytë?

- A) Glukuronimi
- B) Sulfatimi
- C) Acetilimi
- D) Hidroliza

54. Cili nga reaksionet e mëposhtme të biotransformimit është i fazës së dytë dhe jo të parë?

- A) Oksidimi
- B) Reduktimi
- C) Konjugimi
- D) Dezaminimi

55. Cili nga organet ose indet e mëposhtme përbën organin kryesor biotransformues të ksenobiotikëve?

- A) Lëkura
- B) Veshkat
- C) Mushkëritë
- D) Mëlçia

56. Lidhur me sistemin metabolizues mikrozomial të barnave, një pacient përdorues kronik i barbiturateve do të nevojisë dozë më të madhe bari për të përfutur të njëjtin efekt për shkak të cilit prej koncepteve të mëposhtme?

- A) Induktimit enzimatik të shtuar
- B) Induktimit enzimatik të reduktuar
- C) Frenimit enzimatik të shtuar
- D) Frenimit enzimatik të reduktuar

57. Një litër përmban 1000 mg të një bari. Pas një ore, në një litër kemi 900 mg të tij. Cili është klirensi për këtë bar?

- A) 100 ml
- B) 100 ml/orë
- C) 1 mg/ml
- D) 100 mg

58. Nëse një bar me gjysmëjetë 2 orë jepet me një dozë fillestare prej 8 mcg/ml, sa bar do të mbetet në organizëm pas 6 orësh? (supozojmë kinetikë të rendit të parë)

- A) 8 mcg/ml
- B) 4 mcg/ml
- C) 2 mcg/ml
- D) 1 mcg/ml

59. Ksenobiotikët konsiderohen substanca:

- A) Endogjene
- B) Toksina
- C) Ligandë

D) Ekzogjene

60. Cili nga të mëposhtmit nuk është një veprim i organizmit mbi barin?

- A) Përthithja
- B) Shpërndarja
- C) Metabolizimi
- D) Efektet anësore

61. Nëse një bar lidhet 80% me proteinat plazmatike, sa përqind mendoni se është forma e lirë?

- A) 20%
- B) 40%
- C) 80%
- D) 100%

62. Cili nga pohimet e mëposhtëm përshkruan përqendrimin minimal efektiv?

- A) Përqendrimi më i vogël i barit që mund të përcaktohet eksperimentalisht
- B) Përqendrimi më i vogël i barit që arrin në inde
- C) Përqendrimi më i vogël i barit që jep efekte anësore
- D) Përqendrimi më i vogël i barit që jep efekt

63. Nëse membrana qelizore që bari duhet të përshkojë e dyfishon trashësinë e saj, atëherë kalimi pasiv i barit përmes saj do të:

- A) Rritet
- B) Reduktohet
- C) Nuk do të ndryshojë
- D) Jetë i menjëhershëm

64. Cili nga konceptet e mëposhtëm shpreh sasinë e barit të përthithur kundrejt sasisë së barit të administruar?

- A) Bioekuivalenca
- B) Biodisponibiliteti
- C) Bioinekuivalenca
- D) Raporti i ekstraktimit

65. Cili nga kriteret e mëposhtëm nuk nevojitet të plotësohet për të dëshmuar bioekuivalencën?

- A) I njëjti përbërës aktiv
- B) E njëjta dozë ose përqendrim
- C) E njëjta formë farmaceutike
- D) Të njëjtat efekte anësore

66. Cila nga rrugët e mëposhtme të administrimit paraqet me siguri biodisponibilitet 100%?

- A) inhalatore
- B) rektale
- C) transdermale
- D) intravenoze

67. Cili nga të mëposhtmit nuk është një proces farmakokinetik?

- A) Përndryshimi kimik i barit nga enzimat hepatike
- B) Largimi i barit përmes urinës
- C) Kalimi i barit nga trakti gastrointestinal për në qarkullimin e përgjithshëm të gjakut

D) Dilatacioni që bari shkakton në enët koronare të gjakut

68. Cila nga format e mëposhtme të barit mund të prodhojë përgjigje terapeutike në receptorët e indit muskolor?

- A) Bari i lidhur me albuminat e plazmës
- B) Bari i përqendruar në lëngun biliar
- C) Bari i përqendruar në urinë
- D) Bari i palidhur me proteinat plazmatike

69. Shumica e barnave janë acide të _____ ose baza të _____:

- A) Fortë, forta
- B) Fortë, bobëta
- C) Dobët, dobëta
- D) Dobët, forta

70. Nëse $\text{pH}=\text{pKa}$, sa përqind e një baze të dobët do të jetë e pajonizuar?

- A) 99%
- B) 90%
- C) 50%
- D) 10%

71. Ndikimi mbi ekskretimin e barit jashtë tubulit renal mund të realizohet përmes:

- A) Acidifikimit të urinës
- B) Rregullimit të pH urinar për të protonizuar barnat acide të dobët
- C) Rregullimit të pH urinar për të deprotonizuar barnat bazike të dobët
- D) Rregullimit të pH urinar për të jonizuar barin

72. Për cilin nga barnat e mëposhtëm ekskretimi urinar shpejtohet më ndjeshëm përmes acidifikimit të urinës:

- A) Acide të dobët me $\text{pKa}= 5.5$
- B) Acide të dobët me $\text{pKa}= 3.5$
- C) Baza të dobëta me $\text{pKa}= 7.5$
- D) Baza të dobëta me $\text{pKa}= 7.1$

73. Biodisponibiliteti abosult ka të bëjë me përqindjen apo fraksionin e barit të administruar që arrin sistemin e qarkullimit të gjakut, krahasuar me cilën rrugë administrimi?

- A) Orale
- B) Intravenoze
- C) Cerebrospinale
- D) Intratekale

74. Cili organ është zakonisht përgjegjës për "efektin e kalimit fillestar" (first pass)?

- A) Truri
- B) Zemra
- C) Veshka
- D) Mëlçia

75. Cili nga indet e mëposhtëm e merr barin më ngadalë?

- A) Mëlçia
- B) Veshka

- C) Muskuli
- D) Yndyra

76. Cili bar do të kalojë më lehtë barrierën hematoencefalike përmes difuzionit pasiv?

- A) Me përmasa të mëdha dhe i tretshëm në yndyrna
- B) Me përmasa të mëdha dhe i patretshëm në yndyrna
- C) Me përmasa të vogla dhe i tretshëm në yndyrna
- D) Me përmasa të vogla dhe i patretshëm në yndyrna

77. Barnat acide të dobët tentojnë të lidhen kryesisht me:

- A) Eritrocitet
- B) Albuminat e plazmës
- C) Globulinat e plazmës
- D) Alfa 1 glikoproteinën

78. Barnat bazike të dobët tentojnë të lidhen kryesisht me:

- A) Albuminat e plazmës
- B) Leukocitet
- C) Eritrocitet
- D) Globulinat e plazmës

79. Reduktimi i lidhjes së barit me proteinat plazmatike do të çojë në:

- A) Rënie të përqendrimit të palidhur të barit
- B) Rritje të përqendrimit të barit të lirë
- C) Rënie të klirensit të përgjithshëm
- D) Fuqizim të ciklit enterohepatik

80. Cili nga organet e mëposhtme mund të grumbullojë barna të tretshëm në yndyrna?

- A) Mëlçia
- B) Veshka
- C) Yndyra
- D) Shpretka

81. Cili nga vendet e mëposhtme ka fluks të lartë gjaku dhe është vend ekskretimi për barnat?

- A) Mëlçia
- B) Veshka
- C) Yndyra
- D) Sistemi nervor qendror

82. Cili nga përqendrimet e mëposhtëm të barit është më i përdorshmi në përcaktimin e eleminimit të barit në tërësi nga organizmi?

- A) Përqendrimi i barit në lëngun biliar
- B) Përqendrimi i barit në feçe
- C) Përqendrimi i barit në gjak
- D) Përqendrimi i barit në sistemin nervor qendror

83. Cilat janë njësitet e klirensit të një bari?

- A) mg/ml
- B) mg/orë
- C) ml/orë

D) 1/orë

84. Cilat janë njësitë e konstantes pjesore të eliminimit të barnave?

- A) mg/ml
- B) mg/orë
- C) ml/orë
- D) 1/orë

85. Cilat janë njësitë e përqendrimit të barit në fazë stacionare (në gjendjen e qëndrueshme)?

- A) mg/ml
- B) mg/orë
- C) ml/orë
- D) 1/orë

86. Cili nga elementet e mëposhtëm përbën një disavantazh të administrimit oral:

- A) Kompliancë e ulët
- B) Ekonomikisht e paleverdisshme
- C) Bari mund të shkatërrohet në pH-in acid të stomakut
- D) Metodë invasive

87. Cili nga elementët e mëposhtëm përbën një avantazh të administrimit oral?

- A) Bari i marrë nga goja mund të irritojë stomakun
- B) Bari i marrë nga goja mund të biotransformohet nga flora mikrobike intestinale
- C) Bari i marrë nga goja mund të ndërveprojë me elementë të ndryshëm ushqimor
- D) Bari i marrë nga goja paraqet compliancë të mirë për pacientin

88. Cila nga vetitë e mëposhtme nuk është një veti e transportit të barnave përmes bartësve?

- A) Transport i pangopur
- B) Transport aktiv
- C) Transport i frenueshëm
- D) Transport që kërkon energji

89. Forca lëvizëse e procesit të difuzionit pasiv përmes membranave qelizore është:

- A) Konsumi i energjisë
- B) Transporti i lehtësuar
- C) Gradienti i përqendrimit të barit
- D) Biotransformimi i barit

90. Proçesi ekskretues që ndikohet më shumë nga shkalla e jonizimit të barit është:

- A) Ekskretimi me ajrin e ekspiruar
- B) Ripërthithja tubular pasive në veshka
- C) Ekskretimi me feçe
- D) Sekretimi tubular aktiv në veshka

91. Për barnat me raport të lartë të ekstraktimit hepatic, ndryshimi i biodisponibilitetit nga pacienti në pacient nuk mund t'i dedikohet ndryshimeve në:

- A) Funkcionin hepatic
- B) Fluksin e gjakut në hepar
- C) Praninë e sëmundjeve të heparit
- D) Fluksin e gjakut në veshka

92. Cilët nga faktorët e mëposhtëm të lidhur me përthithjen e barit nga trakti gastrointestinal nuk çon në përthithje të pjesshme?
- A) Metabolizimi i barit nga flora gastrointestinale
 - B) Prania e ushqimit në traktin gastrointestinal
 - C) Prania e ujit në traktin gastrointestinal
 - D) Paqëndrueshmëria e barit në mjedisin gastrik
93. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën një karakteristikë të administrimit intravaskular?
- A) Më pak i parashikueshëm krahasuar me administrimin oral
 - B) I papranueshëm për pacientë në gjendje të pavetëdijshme
 - C) Shkalla e arritjes së barit në qarkullimin e përgjithshëm nuk ndikohet nga tretshmëria e barit në lengjet intestinale
 - D) Paraqet biodisponibilitet të ulët
94. Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk përbën një avantazh të administrimeve transdermale?
- A) Përqendrim plazmatik relativisht konstant
 - B) Zakonisht incidencë e ulët e efekteve anësore
 - C) Kompliancë mesatarisht e mirë
 - D) Biodisponibilitet jo i plotë dhe i parashikueshëm
95. Cili nga barnat e mëposhtme ka më shumë shanse për të kaluar membranat qelizore?
- A) Bari i lidhur me proteinat plazmatike
 - B) Bari i ngarkuar me ngarkesë pozitive
 - C) Bari i ngarkuar me ngarkesë negative
 - D) Bari i pajonizuar
96. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk ka të bëjë me efektin e kalimit fillestar (first pass)?
- A) Biotransformimi i barit mund të ndodhë në murin intestinal
 - B) Efekti first pass mund të reduktojë biodisponibilitetin e barit
 - C) Efekti first pass mund të reduktojë efikasitetin e barit
 - D) Efekti first pass mund të shtojë ndërveprimin e barit me komponentët ushqimor
97. Cili nga faktorët e mëposhtme nuk ndikon mbi vëllimin aparent të shpërndarjes?
- A) Prania e sëmundjeve
 - B) pKa-ja e barit
 - C) shkalla e ndërveprimit të barit me receptorin e tij
 - D) shkalla e lidhjes së barit me proteinat plazmatike
98. Dy vende që konsiderohen më të rëndësishme për eliminimin e barit janë:
- A) mushkëria dhe mëlçia
 - B) mëlçia dhe trakti gastrointestinal
 - C) veshkat dhe mëlçia
 - D) lëkura dhe mëlçia
99. Cila nga karakteristikat e mëposhtme i përket ekskretimit veshkor të barit?
- A) Pothuaj të gjithë barnat filtrohen në glomerul
 - B) Barnat acide të dobët ekskretohen më lehtë kur mjedisi urinar është acid
 - C) Bazat e dobëta ekskretohen më lehtë kur mjedisi urinar është bazik
 - D) Barnat e lidhur me proteinat plazmatike e kanë më të lehtë të filtrohen në veshka

100. Cili është kuptimi i klirensit plazmatik?

- A) Përqindja e barit që largohet nga plazma në njësinë e kohës
- B) Vëllimi plazmatik hipotetik që pastrohet nga bari në njësinë e kohës përmes të gjitha proceseve eliminuese në organizëm
- C) Vëllimi plazmatik hipotetik që pastrohet nga bari në një minutë gjatë kalimit në mëlçi
- D) Vëllimi plazmatik hipotetik që pastrohet nga bari në një minutë gjatë kalimit në veshkë

101. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk vlerëson biodisponibilitetin e barit?

- A) Vlera e sipërfaqes nën lakoren C/t (përqendrim/kohë)
- B) Përqendrimi plazmatik maksimal
- C) Dritarja terapeutike
- D) Koha për arritjen e përqendrimit maksimal

102. Cili është kuptimi i gjysmëjetës biologjike të barit?

- A) Koha gjatë së cilës gjysma e barit biotransformohet në organizëm
- B) Koha gjatë së cilës realizohet gjysma e efektit biologjik
- C) Koha gjatë së cilës gjysma e barit çlirohet nga lidhja me proteinat plazmatike
- D) Koha gjatë së cilës sasia e barit në organizëm përgjysmohet

103. Cilat janë pasojat e të qenit bar i lidhur me proteinat plazmatike?

- A) Krijohet një depozitë e barit dhe mund të zgjatet koha e veprimit të tij
- B) Rritet mundësia e barit për t'u filtruar në glomerulat
- C) Ulet mundësia për ndërveprime
- D) Rritet mundësia për t'u grumbulluar në indet yndyrore

104. Ekskretimi veshkor i bazave të dobëta:

- A) Reduktohet përmes acidifikimit të urinës
- B) Fuqizohet përmes acidifikimit të urinës
- C) Nuk ndryshon përmes modifikimeve të pH-it urinar
- D) Mund të rritet nga administrimi i bikarbonatit të natriumit

105. Kur përcaktohet një regjim dozimi, cili nga faktorët e mëposhtëm duhet mbajtur parasysh?

- A) Gjysmëjeta biologjike
- B) Vëllimi urinar i ekskretuar
- C) Numri i metabolitëve të ekskretuar
- D) Sasia e eksipientëve të përthithur nga forma farmaceutike

106. Cila nga thëniet e mëposhtme e përshkruan më mirë farmakokinetikën e barit?

- A) Studimi i arritjes së barit në vendin e tij të veprimit dhe se si kjo rrugë e barit ndikohet nga faktorë të ndryshëm
- B) Studimi i modelimit të barit përmes modelimit molekular të bazuar mbi grupet farmakofore të tij
- C) Studimi i ndërveprimit të barit me vendin e tij të veprimit në nivel molekular
- D) Studimi i grupeve funksionale të rëndësishme për lidhjen e barit në vendin e tij të veprimit dhe identifikimi i grupeve farmakofore

107. Cili nga infeksionet e mëposhtme mund të trajtohet në rrugë orale përmes një agjenti antibakterial me polaritet të lartë?

- A) Infeksion në sistemin nervor qendror
- B) Infeksion në veshka

- C) Infeksion në traktin gastrointestinal
- D) Infeksion në mushkëri

108. Cili nga pohimet e mëposhtme lidhur me barrierën hematoencefalike është i gabuar?

- A) Muret e kapilarëve që ushqejnë trurin janë shumë të ngjeshur pas njëri-tjetrit dhe nuk lejojnë kalimin e barnave për në këtë organ
- B) Barnat me natyrë hidrofobe kalojnë më lehtë se barnat hidrofile përmes barrierës hematoencefalike
- C) Barnat polare kalojnë mjaft thjesht përmes barrierës hematoencefalike me difuzion pasiv
- D) Disa barna shfrytëzojnë mekanizma të transportit aktiv për të kaluar në tru

109. Parametri farmakokinetik që vlerëson më mirë procesin e eliminimit të barnave është:

- A) Vëllimi aparent i shpërndarjes
- B) Fraksioni i mbetur nga doza
- C) Klirensi i përgjithshëm
- D) Sipërfaqja nën lakore

110. Parametri farmakokinetik që vlerëson më mirë procesin e shpërndarjes së barit në organizëm është:

- A) Gjysmëjeta biologjike
- B) Vëllimi aparent i shpërndarjes
- C) Konstantja pjesore e eliminimit
- D) Klirensi plazmatik

111. Cila nga tipet e mëposhtme të lidhjeve kimike nuk ekziston zakonisht në lidhjen e barnave me proteinat plazmatike?

- A) Lidhje Van Der Vals
- B) Lidhje hidrofobe
- C) Lidhje kovalente
- D) Lidhje hidrogjenore

112. Bari konsiderohet i lidhur në shkallë të lartë me proteinat plazmatike kur ai lidhet me proteinat:

- A) Mbi 90%
- B) Mbi 70%
- C) Mbi 50%
- D) Mbi 10%

113. Bari konsiderohet i lidhur në shkallë të ulët me proteinat plazmatike kur ai lidhet me proteinat:

- A) Nën 10%
- B) Nën 20%
- C) Nën 50%
- D) Nën 60%

114. Nëse për një të rritur normal klirensi total është 200 ml/min dhe klirensi veshkor është 10 ml/min, mund të themi se:

- A) Bari biotransformohet në shkallë të lartë
- B) Ekskretimi veshkor është i theksuar
- C) Bari nuk lidhet me proteinat plazmatike
- D) Bari përqendrohet në indet yndyrore

115. Rruga kryesore e administrimit të një bari për të realizuar një efekt lokal është:

- A) Orale
- B) Topike
- C) Parenterale
- D) Subkutane

116. Rruga më efikase dhe e shpejtë për të administruar një bar me qëllim arritjen e një efekti sistemik është:

- A) Topike
- B) Orale
- C) Bolus intravenoz
- D) Transdermale

117. Administrim intravaskular i një bari do të thotë administrimi i tij në cilën nga mënyrat e mëposhtme:

- A) Në rrugë orale
- B) Në rrugë inhalatore
- C) Në rrugë intramuskulare
- D) Në rrugë intravenoze

118. Katër proceset kryesore farmakokinetike janë:

- A) Receptorët, kanalet jonike, sistemet e transportit dhe enzimët
- B) Administrimi, përthithja, metabolizimi dhe eliminimi
- C) Përthithja, shpërndarja, biotransformimi dhe ekskretimi
- D) Stomaku, hepari, veshkat dhe mushkëritë

119. Kalimi i barnave në veshkë mund të përshkruhet si:

- A) Sekretim pasiv dhe ripërthithje pasive
- B) Sekretim aktiv dhe ripërthithje pasive
- C) Sekretim aktiv dhe ripërthithje aktive
- D) Sekretim pasiv dhe ripërthithje aktive

120. Konstantja e ndarjes vaj / ujë të një bari ndikon:

- A) Në përpjesëtim të drejtë mbi shpejtësinë e difuzionit pasiv përmes membranave
- B) Në përpjesëtim të zhdrejtë mbi shpejtësinë e difuzionit pasiv përmes membranave
- C) Në përpjesëtim të drejtë mbi shpejtësinë e transportit aktiv përmes membranave
- D) Në përpjesëtim të zhdrejtë mbi shpejtësinë e transportit aktiv përmes membranave

121. Klirensi i kreatininës është tregues i funksionalitetit:

- A) Hepatik
- B) Biliar
- C) Veshkor
- D) Mushkëror

122. Doza fillestare ngarkesë në një regjim shumëdozësh synon:

- A) Uljen e efekteve anësore
- B) Ndryshimin e gjysmëjetës biologjike
- C) Arritjen sa më të shpejtë të niveleve efektive të përqendrimit të barit
- D) Rritjen e aftësisë së barit për të ndërvepruar me receptorët

123. Regjimi i administrimit (regjimi i dozimit) të një bari bazohet kryesisht mbi:

- A) Ritmin e eliminimit
- B) Ritmin e qarkullimit enterohepatik
- C) Ritmin e grumbullimit të tij drejt indeve periferike
- D) Ritmin e përshkueshmërisë së membranës hematoencefalike

124. Koha e arritjes së përqendrimit maksimal (pik) pas administrimit oral varet nga:

- A) Ka dhe Kel (konstantja e përthithjes dhe konstantja e eliminimit)
- B) Kel (konstantja e eliminimit)
- C) Kel dhe F (konstantja e eliminimit dhe biodisponibiliteti)
- D) Vshp (vëllimi aparent i shpërndarjes)

125. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon mbi klirensin veshkor të barnave?

- A) Numri i nefroneve funksionale
- B) Prania e sëmundjeve të veshkës
- C) Fluksi i gjakut në veshka
- D) Biodisponibiliteti i administrimit oral (F)

126. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon mbi sekretimin aktiv tubular në veshka?

- A) Prania e heteroatomeve në molekulën e barit
- B) Ngopja e enzimave transportuese
- C) Shkalla e lidhjes së barit me proteinat plazmatike
- D) Fluksi veshkor i gjakut

127. Cili është tipi i lidhjes kimike që mbizotëron gjatë kalimit të barit lipofil në membranat qelizore?

- A) Kovalente
- B) Elektrostatike
- C) Hidrofobe
- D) Hidrogjenore

128. Cila nga mënyrat e mëposhtme të kalimit të barnave përmes membranave qelizore paraqet një proces të ngopshëm?

- A) Difuzioni pasiv
- B) Difuzioni përmes poreve të membranës
- C) Difuzioni lipidik
- D) Transporti aktiv

129. Bari A i tipit bazë e dobët ka $pK_a = 6.5$. Nëse pH i mjedisit është 9.5, bari gjendet kryesisht në formë:

- A) Pothuaj plotësisht të jonizuar
- B) Pothuaj plotësisht të pajonizuar
- C) 50% të jonizuar
- D) 50% të pajonizuar

130. Cila nga lidhjet e mëposhtme kimike konsiderohet si "më e forta"?

- A) Van Der Vals
- B) Dipolare
- C) Hidrofobe
- D) Kovalente

131. Proçesi gjatë të cilit një substancë inglobohet nga muri qelizor brenda një vezikule dhe në këtë mënyrë arrin të hyjë brenda qelizës quhet:

- A) Ekzocitozë
- B) Difuzion i thjeshtë
- C) Difuzion i lehtësuar
- D) Endocitozë

132. Dëmtimet apo patologjitë e cilit nga organet e mëposhtme do të ndikonin më shumë në biotransformimin e fazës së dytë?

- A) Lëkurës
- B) Mushkërive
- C) Mëlçisë
- D) Traktit gastrointestinal

133. Përthithja e përbërësit aktiv zakonisht është e pavarur nga:

- A) Përmasat e molekulës
- B) Tretshmëria
- C) pH i mjedist
- D) pika e shkrirjes e përbërësit aktiv

134. Cila nga rrugët e mëposhtme të administrimit konsiderohet si "invazive"?

- A) Administrimi subkutan
- B) Administrimi okular
- C) Administrimi nazal
- D) Administrimi rektal

135. Cili nga pohimet e mëposhtëm të lidhur me biodisponibilitetin është i saktë?

- A) Biodisponibiliteti relativ vlerësohet përmes përgatesave intravaskulare
- B) Administrimi i një perfuzioni përbën bazën krahasuese për biodisponibilitetin
- C) Njësia e biodisponibilitetit është mg/orë
- D) Biodisponibiliteti është ajo pjesë e barit që ushtron efekt terapeutik pas çlirimit me një shpejtësi të caktuar nga forma farmaceutike, pas përthithjes dhe arritjes së vendit të veprimit

136. Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më shumë ndikim mbi përthithjen e një formëdoze orale nga trakti gastrointestinal?

- A) Ndryshimi i pH-it përgjatë traktit gastrointestinal
- B) Kalimi i ngadalshëm përmes ezofagut
- C) Sipërfaqja përthithëse e kolonit
- D) Sipërfaqja e kavitetit oral

137. Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me ekskretimin është i gabuar?

- A) Organe të tjera përveç veshkës mund të marrin pjesë në ekskretimin e barit
- B) Dalja e barit në qumështin e gjirit nuk quhet proçes ekskretimi
- C) Vlera e klirensit përbën një karakteristikë të ekskretimit
- D) Vlera e klirensit renal jep informacione lidhur me funksionimin e veshkës

138. Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me proçesin e shpërndarjes së barit është i saktë?

- A) Shpërndarja e barit ndodh gjithnjë përpara çlirimit nga forma farmaceutike
- B) Shpërndarja është një proçes që tregon se sa ka arritur bari në qarkullimin sistematik

- C) Shpërndarja është një proces që varet nga shkalla dhe shpejtësia e perfuzimit të indeve dhe organeve me gjak
D) Përqendrimi i barit në fund të procesit të shpërndarjes është i njëjtë kudo në të gjithë organizmin

139. Cila nga zonat e traktit gastrointestinal ka $pH > 8$?

- A) Stomaku
- B) Duodeni
- C) Kaviteti oral
- D) Jejunumi

140. Cili nga faktorët fiziologjik të mëposhtëm nuk ndikon dukshëm mbi përgjigjen biologjike të barit në një të rritur të shëndetshëm?

- A) Vetitë lipofile apo hidrofile të barit
- B) Shpejtësia e zbrazjes gastrike
- C) Efekti i kalimit fillestar (first pass)
- D) Gjendja fizike në përgjithësi

141. Cili nga përkufizimet e mëposhtëm i përket indeksit terapeutik (dritares terapeutike) të një bari?

- A) Diferenca mes dozës toksike dhe dozës efektive
- B) Diferenca mes barit të biotransformuar pas efektit të kalimit fillestar dhe sasisë totale të barit
- C) Diferenca mes përqendrimit fillestar plazmatik dhe klirensit të barit
- D) Diferenca mes dozës së administruar dhe përqendrimit plazmatik të barit

142. Cili/cilët nga parametrat e mëposhtëm nevojitet për të vërtetuar bioekuivalencën mes dy përgatesave?

- A) Klirensi i përgjithshëm
- B) C_{max}
- C) t_{max}
- D) SNL (AUC), C_{max} dhe t_{max}

143. Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me regjimet shumëdozëshe të administrimit është i saktë?

- A) Kur aplikohen doza shumëfishe, luhatja e përqendrimeve plazmatike nuk duhet të kalojë vlerën 5%
- B) Komplanca e pacientit rritet nga zgjatja e intervalit kohor ndërmjet marrjes së dozave
- C) Doza e parë në çdo regjim shumëdozësh merret e lartë në vlerë, pasuar nga dozat e tjera më të ulëta
- D) Në rast të harrimit të një doze në një regjim shumëdozësh, nuk ka ndryshime në efektin terapeutik

144. Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me jonizimin e barit është i saktë?

- A) Jonizimi i barit luan vetëm një rol të vogël në efektin e barit
- B) Forma e pajonizuar e barit kalon më thjesht përmes membranave qelizore në sajë të karakterit lipofil të këtyre të fundit
- C) Shkalla e jonizimit të barit është e pavarur nga pH-i i mjedisit ku bari ndodhet
- D) Shkalla e jonizimit varet në radhë të parë nga përmasat e molekulës së barit

145. Cili nga proceset e mëposhtme është një proces eliminues i barit nga organizmi?

- A) Çlirimi i barit nga forma farmaceutike

- B) Biotransformimi i barit në metabolit inaktiv
- C) Përthithja e barit në qarkullimin sistemik
- D) Grumbullimi i barit lipofil në indin yndyror

146. Cilët janë proceset farmakokinetike që pëson bari në organizëm pas administrimit intravenoz?

- A) Përthithje, shpërndarje, biotransformim, ekskretim
- B) Përthithje, shpërndarje, ekskretim
- C) Përthithje, shpërndarje, biotransformim
- D) Shpërndarje, biotransformim, ekskretim

147. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë në momentin kur është arritur t_{max} pas një administrimi oral?

- A) Në këtë kohë shpejtësia e përthithjes është e barabartë me shpejtësinë e eleminimit
- B) Në këtë kohë shpejtësia e përthithjes është më e ulët se shpejtësia e eleminimit
- C) Në këtë kohë shpejtësia e eleminimit është më e ulët se shpejtësia e përthithjes
- D) Që nga ky moment konstantja e përthithjes vjen duke u rritur

148. Njësia e konstantes së përthithjes së barit gjatë administrimit oral (k_a ose k_p) është:

- A) L
- B) Mg/ml
- C) Orë⁻¹
- D) ml/orë

149. Këmbimin e një bari me një bar tjetër të së njëjtës klasë farmakologjike mund t'a bëjë vetëm:

- A) Mjeku
- B) Farmacisti
- C) Infermieri
- D) Mamia

150. Cila nga rrugët e mëposhtme të administrimit nuk konsiderohet "invazive"?

- A) Intramuskulare (në muskul)
- B) Sublinguale (nën gjuhë)
- C) Subkutane (nën lëkurë)
- D) Intravenoze (në venë)

7. Urdhri i Farmacistit

1. Rrethoni alternativën e saktë:

Çfarë është Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë?

- A) Ent Publik
- B) OJF
- C) Shoqatë
- D) Sindikatë

2. Cili pajiset me Çertifikatë Regjistrimi nga Urdhri i Farmacistëve duke mos qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve?

- A) Farmacisti
- B) Mjeku
- C) Ndihmës farmacisti

D) Praktikanti

3. Kush e ka të drejtën e anëtarësimit në Urdhrin e Farmacistëve?

- A) Farmacisti
- B) Mjeku
- C) Ndhmës farmacisti
- D) Praktikanti

4. Kush nuk bën pjesë në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve?

- A) Presidentët e Këshillave Rajonale
- B) Presidenti
- C) Sekretari i Përgjithshëm
- D) Zëvendës Presidenti

5. Pranë kujt ngrihet Komisioni Disiplinor i shkallës së parë?

- A) Këshillit Kombëtar
- B) Këshillit Rajonal
- C) Asamblesë së Përgjithshme (Kombëtare)
- D) Asamblesë Rajonale

6. Çfarë kompetencash ushtron Komisioni Disiplinor i ngritur pranë Këshillit Kombëtar? Të shkallës së:

- A) parë
- B) dytë
- C) tretë
- D) katërt

7. Cili është afati i ankimimit të vendimit të marrë nga Komisioni Disiplinor i shkallës së parë?

- A) 50 ditë nga komunikimi me shkrim i vendimit
- B) 30 ditë nga depozitimi i ankesës
- C) 30 ditë nga komunikimi me shkrim i vendimit
- D) 30 ditë nga marrja e vendimit

8. Sa herë në vit duhet të mbledhet Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve?

- A) Jo më pak se katër herë në vit
- B) Jo më pak se tre herë në vit
- C) Jo më shumë se katër herë në vit
- D) Jo më shumë se tre herë në vit

9. Me cilin funksion është i pajtueshëm funksioni i anëtarit të Komisionit Disiplinor të Gjyimit Profesional?

- A) Presidentit të Këshillit Rajonal.
- B) Sekretarit të Urdhrit.
- C) Sekretarit të Këshillit Rajonal.
- D) Anëtarit të Urdhrit.

10. Cilën nga këto alternativa nuk përmban Betimi i Hipokratit?

- A) Detyrën time do ta ushroj me ndërgjegje dhe dinjitet
- B) Përkushtimi im do të jetë shëndeti i të sëmurit

- C) Kolegët e mi di t'i kem shokë dhe vëllezër
- D) Do t'u shërbej vetëm të sëmurëve që i përkasin fesë sime

11. Kush i miraton Modelet e Çertifikatave të Anëtarësimit dhe Regjistrimit?

- A) Këshilli Rajonal
- B) Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve
- C) Këshilli Kombëtar
- D) Ministria e Shëndetësisë

12. Në cilat raste anëtarësimi në Urdhër vazhdon të ekzistojë?

- A) Kur anëtari largohet nga jeta
- B) Kur anëtari vuan dënim me heqje lirie për krime
- C) Kur anëtarit i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit me vendim gjykate
- D) Kur anëtari kryen kurse kualifikimi apo specializimi jashtë vendit

13. Cila nga këto alternativa nuk është kompetencë e Presidentit të Urdhrit?

- A) Të udhëheqë dhe mbikëqyrë të gjitha veprimtaritë e Urdhrit
- B) Të rrëzoje vendimet e miratuara nga Këshilli kombëtar
- C) Të nxjerrë urdhra dhe të miratojë rregullore
- D) Të emërojë apo shkarkojë punonjësit e Aparatit, që nuk janë të zgjedhur

14. Në përmbushje të misionit të tij Urdhri i Farmacistëve nuk:

- A) Jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e profesionit
- B) Mbikqyr zbatimin e detyrave profesionale
- C) Mbikqyr zbatimin e kërkesave të Kodit Deontologjik
- D) Mbikqyr veprimtarinë e Drejtorisë Farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë

15. Kush punësohet në farmacitë e spitaleve:

- A) Farmacisti
- B) Kimisti
- C) Mjeku
- D) Veterineri

16. Në hartimin e cilave dokumenteve nuk merr pjesë Urdhri i Farmacistëve?

- A) Projektligjeve të farmaceutikës
- B) Dokumenteve të rëndësishme të farmaceutikës
- C) Legjislacionit shëndetësor shqiptar
- D) Kodit rrugor.

17. Karta e anëtarësimit nuk është:

- A) Mjet identifikimi për farmacistin e anëtarësuar
- B) E detyrueshme të mbahet në bluzën e bardhë
- C) E detyrueshme të mbahet gjatë kohës së punës
- D) E barazvlefshme me kartën e identitetit

18. Kush e bën të detyrueshëm anëtarësimin në Urdhrit të Farmacistëve?

- A) Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë
- B) Ligji i posaçëm
- C) Vendimi i qeverisë
- D) Vendimi i gjykatës

19. Farmacisti kur regjistrohet në Urdhrin e Farmacistëve duhet të njohë:
- A) Kodin e Procedurës Civile
 - B) Kodin e Procedurës Administrative
 - C) Kodin Deontologjik Farmaceutik
 - D) Kushtetutën e Shqipërisë
20. Gjatë ushtrimit të profesionit të tij, farmacisti nuk e ka të detyrueshme të njihet me:
- A) Ligjin " Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë"
 - B) Ligjin " Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik"
 - C) Të gjitha aktet nënligjore të shërbimit farmaceutik
 - D) Ligjin " Për Urdhrin e Infermierëve në Republikën e Shqipërisë"
21. Cila nga kategoritë e mëposhtme të rimbursimit përfiton barna me rimbursim të pjesshëm?
- A) Pensionistë
 - B) Veteranë
 - C) Invalid lufte
 - D) Pensionist i pjesshëm
22. Farmacisti i shpërndarësit farmaceutik duhet të shesë me shumicë barna:
- A) Mjekëve
 - B) Infermierëve
 - C) Farmacistëve
 - D) Mamive
23. Farmacisti që ka hapur një farmaci, nuk lejohet të punësojë:
- A) Vetën e tij kur është anëtar i UFSH
 - B) Farmacistë të tjerë anëtarë të UFSH
 - C) Nd / farmacistë të regjistruar në UFSH
 - D) Farmacistë jo anëtarë të UFSH
24. Kriteret për pranimin në Urdhrin e Farmacistëve përcaktohen nga:
- A) Asambleja e Përgjithshme (Kombëtare)
 - B) Asambletë Rajonale
 - C) Këshillat Rajonale
 - D) Këshilli Kombëtar
25. Nuk janë organe kryesore të Urdhrit të Farmacistëve:
- A) Asambletë Rajonale
 - B) Këshillat Administrative
 - C) Këshillat Rajonale
 - D) Komisionet disiplinore
26. Sekretari i përgjithshëm i Urdhrit të Farmacistëve emërohet nga:
- A) Asambleja e përgjithshme (Kombëtare)
 - B) Asambletë rajonale
 - C) Këshilli Administrativ
 - D) Këshilli Kombëtar

27. Në Këshillin Kombëtar nuk bëjnë pjesë:
- A) Presidentët e Këshillave Rajonalë
 - B) Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve
 - C) Sekretarët e Këshillave Rajonalë
 - D) Zv/ Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve
28. Kodi Deontologjik Farmaceutik hartohet nga:
- A) Asambleja e Përgjithshme(Kombëtare)
 - B) Asambletë Rajonale
 - C) Këshilli Kombëtar
 - D) Komisioni i Gjykimi Disiplinor
29. Nuk është detyrë e Këshillit Rajonal të Urdhrit të Farmacistëve:
- A) Administrimi i buxhetit të Qarkut
 - B) Caktimi i komisionit të regjistrimit të anëtarëve
 - C) Miratimi i strukturës organizative të Urdhrit
 - D) Zbatimi i vendimeve të Këshillit Kombëtar
30. Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë të Urdhrit të Farmacistëve është organ i:
- A) Asamblesë së Përgjithshme (Kombëtare)
 - B) Këshillit Administrativ
 - C) Këshillit Kombëtar
 - D) Këshillit Mbikëqyrës
31. Përfshihen nga detyrimi por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhrit të Farmacistëve, farmacistët:
- A) Funkionarë të administratës publike
 - B) Që punojnë në farmacitë e rrjetit të hapur
 - C) Që punojnë në farmacitë e spitaleve shtetërore
 - D) Që punojnë në shpërndarësit farmaceutikë
32. Ndërprerja e anëtarësimit në Urdhrit të Farmacistëve, nuk ndodh kur anëtari:
- A) Është duke kryer dënim penal
 - B) I hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit
 - C) Kryen specializime brenda apo jashtë shtetit
 - D) Ndërron jetë
33. Asambleja e Përgjithshme (Kombëtare) e Urdhrit të Farmacistëve përbëhet nga tërësia e anëtarëve të:
- A) Këshillave Rajonale
 - B) Këshillit Kombëtar
 - C) Urdhrit të Farmacistit
 - D) Urdhrit të Rajonit
34. Nuk është detyrë e Presidentit të Urdhrit të Farmacistëve:
- A) Hartimi i Kodit Deontologjik Farmaceutik
 - B) Nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve
 - C) Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme
 - D) Udhëheqja dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së Urdhrit

35. Burimet financiare të Urdhrit nuk përdoren për:
- A) Raste të veçanta që përcaktohen nga Këshillat Rajonal
 - B) Raste të veçanta që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar
 - C) Shpenzime operative të Urdhrit
 - D) Shpenzime për botime të ndryshme profesionale
36. Gjykimi profesional në Urdhrin e Farmacistëve kryhet në:
- A) Dy shkallë
 - B) Katër shkallë
 - C) Një shkallë
 - D) Tre shkallë
37. Mbledhja e Këshillit Rajonal të Urdhrit të Farmacistëve, nuk thirret:
- A) Nga Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve
 - B) Nga Sekretari i Këshillit Rajonal
 - C) Nga Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Farmacistëve
 - D) Nga Zv. Presidenti i Këshillit Rajonal
38. Dokumente bazë të Urdhrit të Farmacistit nuk janë:
- A) Karta personale e identitetit
 - B) Kodi Deontologjik Farmaceutik
 - C) Ligji "Për Urdhrin e Farmacistëve"
 - D) Rregullorja e Gjyimit Disiplinor Profesional
39. Kodi Deontologjik Farmaceutik:
- A) Është i baras vlefshëm me Ligjin "Për Urdhrin e Farmacistëve":
 - B) Është një bashkësi parimesh dhe rregullash
 - C) Nuk është i detyrueshëm të respektohet nga farmacistët
 - D) Zëvendëson Statutin e Urdhrit të Farmacistëve
40. Gjени alternativën e saktë: Drejtuesi teknik i farmacisë:
- A) Është i detyruar të qëndrojë në farmaci gjatë gjithë kohës
 - B) Mund të zëvendësohet nga një farmacist anëtar i Urdhrit
 - C) Mund të zëvendësohet nga një ndihmës farmacist
 - D) Mund të zëvendësohet nga pronari i farmacisë
41. Farmacisti që pranon praktikantë duhet të ketë eksperiencë pune mbi:
- A) 6 muaj
 - B) 1 vit
 - C) 2 vjet
 - D) 3 vjet
42. Mosnjohja e Kodit Deontologjik Farmaceutik:
- A) E justifikon farmacistin për gabimet gjatë ushtrimit të profesionit
 - B) E lehtëson farmacistin nga përgjegjësia që vjen nga moszbatimi i tij
 - C) E përjashton farmacistin nga përgjegjësia që vjen nga moszbatimi i tij
 - D) Nuk e përjashton farmacistin nga përgjegjësia që vjen nga moszbatimi i kodit
43. Gjykimi Disiplinor Profesional nuk ka si qëllim:
- A) Mbrojtjen e interesave personale të farmacistëve

- B) Mbrojtjen e interesave të pacientëve nga keq ushtrimet e profesionit
- C) Të sigurojë një gjykim të paanshëm disiplinor
- D) Të sigurojë një gjykim të drejtë disiplinor

44. Objekt për Veprim Disiplinor në Komisionin e Gjyimit Disiplinor profesional nuk mund të jenë ankesa:

- A) gojore, kur nuk vërtetohen
- B) gojore kur vërtetohen
- C) me shkrim nga kolegë
- D) me shkrim nga pacientë

45. Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional në Urdhrit të Farmacistëve:

- A) Duhet të konsultohet me Këshillin Kombëtar për masën disiplinore
- B) Është organi i vetëm që jep masën disiplinore për anëtarët e Urdhrit
- C) Jep masën disiplinore pasi ka marrë miratimin e Presidentit të Urdhrit
- D) Nuk mund të japë masën disiplinore pa u konsultuar me Këshillin Rajonal

46. Shkalla e parë e gjyimit profesional kryhet pranë:

- A) Aparatit Qendror të Urdhrit të Farmacistit
- B) Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistit
- C) Këshillit Rajonal dhe zhvillohet në dy faza
- D) Këshillit Rajonal dhe zhvillohet në tre faza

47. Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve është e vlefshme vetëm kur janë te pranishëm:

- A) Gjysma e anëtarëve të tij me të drejtë vote këshillimore
- B) Gjysma e anëtarëve të tij me të drejtë vote vendimore
- C) Më shumë se gjysma e anëtarëve të tij me të drejtë vote vendimore
- D) Të gjithë anëtarët e tij me të drejtë vote këshillimore

48. Lista e Barnave pa recetë miratohet nga:

- A) Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
- B) Ministria e Shëndetësisë
- C) Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave
- D) Urdhri i Farmacistëve

49. Reklama (Publiciteti) e barnave OTC në mjetet e informimit publik:

- A) Është e ndaluar
- B) Lejohet me miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë
- C) Lejohet me miratimin e Urdhrit të Farmacistit
- D) Lejohet me miratimin e ISKSH

50. Grupet e punës së posaçme pranë Urdhrit të Farmacistëve nuk bëjnë:

- A) Çertifikim dhe riçertifikim të anëtarëve të Urdhrit
- B) Gjykim disiplinor të shkallës së parë
- C) Përditësim të Regjistrimit të Urdhrit
- D) Regjistrimin e anëtarëve

51. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Urdhrit të Farmacistëve thirret nga:

- A) 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar

- B) Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve
- C) Presidenti i Këshillit Rajonal Tiranë
- D) Zv/ Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve

52. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional janë:

- A) Eksperiencë si farmacist jo më pak se 10 vjet
- B) Përvojë jo me pak se 5 vjet si farmacist
- C) Të jenë persona drejtues të Institucioneve Shëndetësore
- D) Të mos kenë përvojë administrative

53. Urdhri i Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë është një:

- A) Ent publik i pavarur i përbërë nga individë që ushtrojnë profesionin e farmacistit
- B) Institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë për regjistrimin e farmacistëve
- C) Shoqatë e pavarur që përfaqëson interesat ekonomike të farmacistëve
- D) Sindikatë e pavarur që përfaqëson interesat profesionale të farmacistëve

54. Farmacistët, të cilët janë jo-anëtarë të Urdhrit të Farmacistëve, mund të ushtrojnë profesionin e farmacistit:

- A) Në farmacitë e rrjetit të hapur pa kontratë me ISKSH
- B) Në farmacitë spitalore të spitaleve private
- C) Në farmacitë spitalore të spitaleve publike
- D) Nëpunës civilë të administratës publike

55. Dhënia me sukses e provimit të shtetit ju garanton të drejtën e:

- A) Drejtimit teknik të distributorit farmaceutik
- B) Drejtimit teknik të farmacisë
- C) Pronësisë së farmacisë
- D) Ushtrimit të profesionit

56. Kriteret për pranimin e farmacistit në Urdhër të Farmacistëve përcaktohen nga:

- A) Bordi Drejtues i Urdhrit të Farmacistëve
- B) Drejtoria Farmaceutike e Ministrisë së Shëndetësisë
- C) Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve
- D) Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave

57. Kuotat e anëtarësimit në Urdhër caktohen me:

- A) Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë
- B) Vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit
- C) Vendim të Këshillit të Ministrave
- D) Vendim të Bordit të ISKSH

58. Të drejtën për të përjashtuar anëtarët nga Urdhri e ka:

- A) Asambleja e Përgjithshme e Urdhrit
- B) Bordi Drejtues i Urdhrit
- C) Këshilli Kombëtar i Urdhrit
- D) Komisioni Disiplinor i Urdhrit

59. Kodi Deontologjik Farmaceutik është një bashkësi rregullash dhe parimesh që shërben për:

- A) Mbrojtjen e etikës, dinjitetit dhe nderit të farmacistit
- B) Mbrojtjen e interesave ekonomike të farmacistit

- C) Rregullimin normativ të veprimtarive të Urdhrit
- D) Rregullimin normativ të zgjedhjes së Këshillit Kombëtar

60. Në mjetet e informimit publik mund të reklamohen vetëm barnat që sipas legjislacionit farmaceutik në fuqi jepen:

- A) Me rimbursim nga ISKSH(Fondi)
- B) Me përshkrim nga mjeku
- C) Pa përshkrim nga mjeku
- D) Pa rimbursim nga ISKSH(Fondi)

61. Komisionet Disiplinore pranë Urdhrit marrin masa ndaj anëtarëve në rastet kur ka shkelje të:

- A) Kodit Civil
- B) Kodit Deontologjik
- C) Kodit Penal
- D) Kodit të Punës

62. Burime Financiare të Urdhrit, nuk janë:

- A) Kuotizacionet e anëtarëve
- B) Tarifat e certifikatës së anëtarëve
- C) Tarifat e regjistrimit për provimin e shtetit
- D) Tarifat e regjistrimit të anëtarëve

63. Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga:

- A) Asambleja Rajonale
- B) Asambleja e Përgjithshme(Kombëtare)
- C) Këshilli Kombëtar
- D) Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve

64. Kuotizacionet mujore për anëtarët caktohen nga:

- A) Këshilli Kombëtar
- B) Këshilli Rajonal
- C) Presidenti i Urdhrit
- D) Sekretari i Përgjithshëm

65. Gjykimi profesional kryhet në:

- A) 1 nivele
- B) 2 nivele
- C) 3 nivele
- D) 4 nivele

66. Asambleja e Përgjithshme (Kombëtare) e Urdhrit të Farmacistëve përbëhet nga:

- A) Anëtarët e Këshillave Rajonale
- B) Farmacistët e Këshillave Rajonale
- C) Farmacistët në rang kombëtar
- D) Presidentet e Këshillave Rajonale

67. Në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve, nuk bëjnë pjesë:

- A) Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit
- B) Presidentët e Këshillit Rajonal
- C) Presidenti i Këshillit Kombëtar

D) Zv Presidenti i Këshillit Kombëtar

68. Cilët nga personat e mëposhtëm nuk e kanë detyrim regjistrimin në Urdhrin e Farmacistëve:

- A) Farmacistët pensionistë që nuk ushtrojnë aktivitet privat
- B) Farmacistët që punojnë në sektorin privat
- C) Farmacistët që punojnë në sektorin publik
- D) Studentët pas përfundimit të provimit të shtetit, kur duan të ushtrojnë profesionin

69. Cilët nga personat e mëposhtëm nuk kanë të drejtë të punojnë në farmaci:

- A) Farmacistët shtetas shqiptarë
- B) Farmacistët shtetas të huaj pas konvertimit të diplomës
- C) Ndhmësfarmacistët në prani të drejtuesit teknik
- D) Studentët pas përfundimit të Universitetit që nuk kanë fituar provimin e shtetit

70. Nëse gjatë ushtrimit të profesionit ju vjen një recetë e pa vulosur nga mjeku a duhet t'i jepni barnat:

- A) Jo dhe ktheni recetën për vulë
- B) Jo dhe mbani recetën si provë
- C) Po, nëse është recetë e pa-ribursueshme
- D) Po, nëse është recetë e ribursueshme

71. Shtetasit e huaj mund ta ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë:

- A) Pa u regjistruar në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë
- B) Mjafton të jenë anëtarë të Urdhrit të Farmacistit në vendin e origjinës
- C) Duhet detyrimisht të anëtarësohen në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë
- D) Duhet të jenë anëtarë të Sindikatës së Farmacistëve në vendin e origjinës

72. Nuk janë burime financiare të Urdhrit të farmacistëve:

- A) Tarifat e regjistrimit
- B) Donacionet vendase dhe të huaja
- C) Të ardhura të tjera të ligjshme
- D) Gjobat për kequshtrim të profesionit

73. Urdhri i Farmacistëve është:

- A) Person fizik
- B) Person juridik i pavarur
- C) Person juridik i varur nga Ministria e Shëndetësisë
- D) Institucion i pavarur shëndetësor

74. Urdhri i Farmacistëve nuk bën Gjykim Disiplinor Profesional të farmacistëve në rastet e mëposhtme:

- A) Mosrespektimi i standarteve të etikës profesionale
- B) Mosrespektimi i parimeve dhe normave të etikës profesionale
- C) Mosorganizimi i farmacistëve sipas praktikës së mirë të farmacistëve
- D) Respektimi i Ligjshmerisë për kodin rrugor.

75. Praktikanti në farmaci ka të drejtë të ushtrojë profesionin:

- A) Vetëm pa praninë e askujt
- B) Në prani të ndihmës farmacistit anëtar të Urdhrit
- C) Në prani të pronarit
- D) Në prani të farmacistit anëtar të Urdhrit të Farmacistëve me eksperience pune mbi 3 vjet

76. Praktikanti në Farmaci ekzekuton recetën:

- A) Vetë pasi është e bindur për saktësinë
- B) Në prani të farmacistit mbikëqyrës
- C) Në prani të ndihmësfarmacistit
- D) Në prani të pronarit të farmacisë

77. Njohja e praktikantit me Kodin Deontologjik Farmaceutik është:

- A) E pranueshme
- B) E nevojshme
- C) Jo e domosdoshme
- D) E detyrueshme

78. Përgatitjet galenike për praktikantin gjatë ushtrimit të praktikës janë:

- A) Detyrim që burojnë nga programi i praktikës
- B) Dëshirë e vetë praktikantit
- C) Detyrë që i vendos pronari
- D) Detyra që i ngarkon ndihmësfarmacisti

79. Gjatë procesit të një përgatije galenike në Farmaci nga praktikanti është e nevojshme që:

- A) Praktikanti të punojë i pavarur
- B) Të kërkojë ndihmën e të tjerëve
- C) Të mbikqyret nga drejtuesi i praktikës
- D) Të mbikqyret nga një ndihmësfarmacist

80. Komunikimi me pacientin për praktikantin vlerësohet me shkrim nga:

- A) Pacienti që i shërben
- B) Farmacisti mbikqyrës
- C) Ndihmësfarmacisti
- D) Urdhri i Farmacistëve

81. Informacioni mbi barin që përshkruhet me recetë jepet:

- A) Vetëm me shkrim
- B) Vetëm me gojë
- C) Me gojë dhe me shkrim
- D) I jepet receta pacientit e ta shohë vetë.

82. Kontrata e lidhur midis DRSKSH-së dhe Farmacisë është:

- A) E detyrueshme për zbatim nga palët
- B) Jo e detyrueshme për zbatim
- C) Zbatohet vetëm nga DRSKSH-ja
- D) Zbatohet vetëm nga Farmacia

83. Dorëzimi i barnave pacientit në farmaci, bëhet vetëm nga:

- A) Praktikanti
- B) Ndihmësfarmacisti
- C) Mjeku
- D) Farmacisti

84. Dorëzimi i barnave pacientit në agjensi farmaceutike bëhet vetëm nga:

- A) Mjeku
- B) Ndhmësmjeku
- C) Ndhmësfarmacisti
- D) Ndhmësdentisti

85. Dorëzimi i barnave nga praktikanti bëhet vetëm në prani të:

- A) Mjekut të familjes
- B) Mjekut specialist
- C) Ndhmësfarmacistit
- D) Farmacistit

86. Për të shmangur gabimet e mundëshme profesionale në farmaci, farmacisti duhet të njohë:

- A) Legjislacionin e administrimit ekonomik
- B) Kodin e punës
- C) Kodin procedurave administrative
- D) Kodin dhe legjislacionin farmaceutik

87. Kur pacienti paraqitet në farmaci për ndihmë urgjente duhet:

- A) Ta shmangë dhënien e saj
- B) Të japë ndihmën urgjente
- C) Ta drejtojë në një farmaci tjetër pa e ndihmuar vetë
- D) Ta dërgojë në spital pa e ndihmuar

88. Farmacia nuk mund të hapet nëse nuk ka licence:

- A) Drejtuesi teknik
- B) Farmacisti lartë, por jo drejtues teknik
- C) Praktikanti
- D) Studenti

89. Cilat nga alternativat e mëposhtme nuk janë kompetencë e Presidentit të Urdhrit?

- A) Udhëheq dhe mbikëqyr veprimtarinë e Urdhrit
- B) Përcakton dhe miraton strukturën organizative të Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale
- C) Nxjerr urdhra dhe udhëzime dhe miraton rregullore
- D) Miraton propozimet e bordit drejtues.

90. Cila nga kategoritë e mëposhtme të rimbursimit përfiton barna me rimbursim të plotë?

- A) Pensionist i pjesshëm
- B) Fëmijë, nxënës, student 1-14 vjec
- C) Fëmijë 0-12 muajsh
- D) Aktiv

91. Kush e cakton Komisionin Disiplinor të shkallës së dytë?

- A) Asambleja Rajonale
- B) Asambleja e Përgjithshme(Kombëtare)
- C) Këshilli Kombëtar
- D) Këshilli Rajonal

92. Nga kush nuk përfitohet Karta e Anëtarësimit në Urdhër?

- A) Farmacisti i punësuar

- B) Farmacisti drejtues teknik
- C) Nd/Farmacisti drejtues teknik
- D) Praktikanti

93. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ndodhet në Formularin e Vlerësimit të praktikantit?
Komunikimi dhe sjellja me:

- A) pacientin
- B) kolegët
- C) drejtuesin e praktikës
- D) profesionistët e tjerë të shëndetit

94. Kujt duhet t'i drejtohet farmacisti në rastet kur ka vërejtje në lidhje me një
recetë të lëshuar nga mjeku?

- A) Ministrisë së Shëndetësisë
- B) ISKSH (Fondit)
- C) Urdhrit të Farmacistëve
- D) Vetë mjekut

95. Mosmarrëveshjet me kolegët duhet të zgjidhen nëpërmjet:

- A) Urdhrit me shkrim të presidentit të UFSH
- B) Urdhrit me shkrim të Presidentit të Këshillit Rajonal
- C) Ballafaqimeve të drejtpërdrejta
- D) Urdhrit të Drejtorisë Farmaceutike

96. Shkeljet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë janë objekt i gjykimit nga:

- A) Gjykata
- B) Prokuroria
- C) Ministria e Shëndetësisë
- D) Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional të Urdhrit të Farmacistëve

97. Në marrëdhënie me qytetarët farmacistit i ndalohe:

- A) Ta drejtojë atë te mjeku kur kërkon nga farmacisti të vetëmjekohet
- B) Të detyrojë qytetarin të shkojë në një farmaci të caktuar
- C) Dhënia e informacionit për barna kur nuk i ka marrë në farmacinë e tij
- D) Dhënia e informacionit për farmacitë roje nate

98. Pajisja e farmacistit me Dëshminë e Ndhmës së Shpejtë është:

- A) E pranueshme
- B) E domosdoshme
- C) Jo e domosdoshme
- D) E detyrueshme

99. Parimi i ruajtjes së sekretit në lidhje me shëndetin e të sëmurit shkelet kur:

- A) Të dhënat i kërkon bashkëshorti apo bashkëshortja
- B) I kërkon prindi për fëmijën e tij
- C) Mos kallzimi i së fshehtës mund të përkeqësojë shëndetin e të sëmurit
- D) Kur këmbëngulet nga të afërmit e të sëmurit

100. Marrëdhëniet e farmacistit me punonjësit e tjerë të shëndetësisë nuk duhet të kushtëzohen nga
interesa:

- A) Ekonomike e financiare
- B) Bashkëpunimi reciprok
- C) Profesionale
- D) Respekti reciprok

101. Farmacisti gjatë aktivitetit të tij profesional nuk duhet t'i japë barna:

- A) Të rriturve
- B) Të paaftëve mendorë
- C) Mjekëve
- D) Dentistëve

102. Kush është qëndrimi i farmacistit ndaj gabimeve të bashkëpunëtorëve:

- A) T'ia vërë në dukje gabimet bashkëpunëtorëve
- B) T'ia tregojë gabimet e tij të sëmurëve
- C) T'ia thotë familjarëve të sëmurit
- D) T'ia bëjë të ditur miqve të tij më të mirë

103. Respekti i farmacistit ndaj mësuesve të tij nuk duhet të tregohet për:

- A) Nderim dhe mirënjohje
- B) Dijet dhe aftësimin profesional
- C) Mjeshtërinë në ushtrimin e profesionit
- D) Karakterin personal të tij

104. Për të lidhur kontratë me ISKSH (*Fondi*) farmacia duhet të ketë gjendje në farmaci alternativa të para të listës së barnave që rimbursohen:

- A) Jo më pak se 50%
- B) Jo më pak se 60%
- C) Më shumë se 60%
- D) Jo më pak se 70%

105. Për të lidhur kontratë me ISKSH (*Fondi*) farmacisë i kërkohet që drejtuesi teknik i farmacisë dhe farmacistët e punësuar të jenë anëtarë të:

- A) Sindikatës së Farmacisteve
- B) Shoqatës së Farmacisteve
- C) Dhomës së Tregtisë
- D) Urdhrit të Farmacisteve

106. Bazuar në kontratën me ISKSH (*Fondi*), farmacia duhet të mbajë në ambjetet e saj:

- A) Formularin Farmaceutik
- B) Listën e barnave që rimbursohen
- C) Regjistrin e barnave të regjistruara
- D) Revista mjekësore

107. Bazuar në kontratën me ISKSH (*Fondi*), farmacia duhet të ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të:

- A) Drejtuesit teknik ose farmacistit të punësuar
- B) Drejtuesit teknik
- C) Farmacistit të punësuar
- D) Ndhmësfarmacistit

108. Bazuar në kontratën me ISKSH (*Fondi*), farmacia duhet të ruajë dokumentacionin për një periudhë kohe:

- A) 1 vit
- B) 2 vjet
- C) 3 vjet
- D) 4 vjet

109. Recetat me rimbursim farmacia duhet t'i pranojë vetëm të shoqëruara me:

- A) Fletëdalje të bazës grosiste
- B) Listë tregues
- C) Pasaportë
- D) Fletën e Librezës së Shëndetit

110. Farmacia duhet të pranojë dhe të ekzekutojë recetat e tjera me Rimbursim (jo me antibiotikë) brenda:

- A) 5 ditëve
- B) 6 ditëve
- C) 7 ditëve
- D) 8 ditëve

111. Sa herë në muaj farmacia paraqet recetat dhe dokumentet e tjera pranë DRSKSH për rimbursim?

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

112. Recetat me rimbursim të pjesshëm ekzekutohen kur përmbajnë deri në:

- A) 3 barna për diagnoze
- B) 4 barna për diagnoze
- C) 5 barna për diagnoze
- D) 6 barna për diagnoze

113. Recetat me rimbursim për pensionistë ekzekutohen kur përmbajnë deri në:

- A) 3 barna për diagnozë
- B) 4 barna për diagnozë
- C) 5 barna për diagnozë
- D) 6 barna për diagnozë

114. Kontrata me ISKSH(*Fondin*) zgjidhet kur gjendet në farmaci duke shërbyer vetëm:

- A) Drejtuesi teknik
- B) Farmacisti
- C) Drejtuesi teknik dhe farmacisti
- D) Ndihmësfarmacisti

115. Lista e barnave që rimbursohen është e konceptuar sipas klasifikimit:

- A) ATC
- B) Tregtar
- C) Xhenerik
- D) INN

116. Në vendin tonë deklarohen në Ministrinë e Shëndetësisë, çmimet:

- A) FOB
- B) CIF
- C) Referencë
- D) E pullës

117. Rimbursohet në masën e mbulimit 100% për pensionistët, bari alternativë:

- A) E parë
- B) E dytë
- C) E tretë
- D) E fundit

118. Masa e mbulimit të çmimit të barnave në listën e rimbursimit varion në masën:

- A) 20-30%
- B) 20%-40%
- C) 30%-40%
- D) 50%-100%

119. Përfitojnë me rimbursim të pjesshëm alternativën e parë të listës kategoritë:

- A) Invalidë të plotë
- B) Fëmijë 0-12 muaj
- C) Te sëmurë me CA
- D) Aktiv

120. Kategoritë veterane dhe invalidë të luftës përfitojnë falas alternativën:

- A) E parë
- B) E dytë
- C) Çdo alternativë
- D) E fundit

121. Në sa nivele klasifikohen barnat në klasifikimin ATC?

- A) 4
- B) 5
- C) 6
- D) 7

122. Grupi "kryesor terapeutik" në klasifikimin ATC përfshihet në nivelin:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

123. Grupi "Kryesor anatomik" në klasifikimin ATC përfshihet në nivelin:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

124. "Nëngrupi kimik" në klasifikimin ATC përfshihet në nivelin:

- A) 1
- B) 3
- C) 4
- D) 5

125. Një bar ka çmim reference 100 lekë dhe çmim pacienti 30 lek, sa është masa e mbulimit?

- A) 50%
- B) 60%
- C) 70%
- D) 90%

126. Alternativa e parë e një bari ka çmim reference 100 lekë dhe çmim pacienti 20 lekë, alternativa e 3 e po të njëjtit bar ka çmim reference 150 lekë. Sa lekë duhet të paguajë pacienti i kategorisë marëdhënie pune?

- A) 20 lekë
- B) 30 lekë
- C) 50 lekë
- D) 70 lekë

127. Çmimet e barnave në vendin tonë janë:

- A) Të kontrolluara
- B) Të lira
- C) Të kontrolluara dhe të lira
- D) FOB

128. Në listën e rimbursimit bari Nebivolol 5mg ka kufizim "Në Insufiçence kardiake kronike" ky kufizim është në:

- A) Sasinë e barit
- B) Indikacion
- C) Kohën e trajtimit
- D) Mendimin e specializuar

129. Në listën e rimbursimit bari Tamsulozin 0.4 mg ka kufizim "Deri ne 2 vjet mjekim" ky kufizim është në:

- A) Sasinë e barit
- B) Indikacion
- C) Kohën e trajtimit
- D) Mendimin e specializuar

130. Tatimi mbi vlerën e shtuar ose TVSH e barnave është në masën:

- A) 20%
- B) 0%
- C) 30%
- D) 40%

131. Cila është mënyra korrekte e përshkrimit të përdorimit të barit nga ana e farmacistit:

- A) Pas buke
- B) Nuk lidhet me ushqimin

- C) Gjatë ushqimit
- D) 1 ore para ushqimit ose 2 orë pas tij

132. Barnat psikotrope vendosen në:

- A) Dollapin e barnave SNQ
- B) Dollapin e barnave narkotike dhe me çelës
- C) Raftin e dukshëm të farmacisë
- D) Raft sipas rendit alfabetik

133. Një vaksinë tregtohet në farmaci:

- A) Është detyrë e farmacistit për ta aplikuar
- B) Nuk mund të aplikohet nga ana e farmacistit
- C) Nëse farmacisti ka eksperience mund ta aplikojë
- D) Është urgjencë dhe duhet dhënë ndihma e parë

134. Nëse një farmacist dallon një ndërveprim të njohur barnash në një recete me më shumë se dy barna:

- A) Jep këshilla për mënyrën e marrjes ose e kthen te mjeku
- B) Nuk e ekzekuton recetën
- C) Bën ekzekutim të pjesshëm të saj
- D) Ekzekuton duke larguar barin që shkakton ndërveprimin.

135. Cila është pyetja më racionale kur japin një bar OTC:

- A) Arsyen e marrjes së këtij bari
- B) Moshën e përdoruesit
- C) Kohëzgjatjen e përdorimit
- D) E merr si bashkëshoqërues me barna të tjerë

136. Nëse në kuti shkruhet "Të ruhet në temperaturën e dhomës" atëherë kufijtë e temperaturës janë:

- A) Nën 30°C
- B) 15°-25°C
- C) 25°-30°C
- D) Mbi 30°C

137. Nëse në kuti shkruhet " Të ruhet në vend të freskët" atëherë kufijtë e temperaturës janë:

- A) Nën 15°C
- B) 15°-25°C
- C) 15°-30°C
- D) 25°C

138. Cili është ndërveprimi më i rrezikshëm që nuk ekzekutohet një recetë e mundshme:

- A) Varfarin-aspirin
- B) Digoxin-diltiazem
- C) Penicilinë-cefalexinë
- D) Hidrokodon-kodeinë

139. Shfaqja e kristaleve të manitolit në tretësirën 15% të tij për perfuzionim tregon se:

- A) Bari ka qenë ekspozuar në temperaturë të ulët
- B) Ka patur probleme gjatë transportit
- C) Përmban papastërti

D) Eshtë formulim që është përdorur kripë jo korrekte

140. Nëse një recetë përshkruan formën farmaceutike në gjuhën latine gtt atëherë në kuti:

- A) Shkruajmë vetëm regjimin e marrjes
- B) Nuk e shkruajmë fare formën në kuti
- C) E shkruajmë tretësirë me pika në kuti
- D) E informojmë të sëmurin për rrugën e përdorimit

141. Cila nga informacionet e mëposhtme duhet të shkruhet si me e rëndësishmja në kutinë e një pezullie klaritromicine 250mg/5ml?

- A) Mos e mbani në grirje (frigorifer)
- B) Tundeni mirë para përdorimit
- C) Mos e merrni së bashku me produkte të qumështit
- D) Ndalohet ekspozimi në diell

142. Një farmacist ka një recetë me një bar antihipertensiv. Cila është mënyra korrekte e të shkruarit të këtij bari?

- A) Norvasc 5mg
- B) Norvasc tab 5mg
- C) Amlopil 5mg
- D) Amlodipini 5mg

143. Në cilën datë mund ta ekzekutojë farmacisti një recetë me amoksiciline kaspula 500 mg të leshuar në datë 1 shtator?

- A) 1 shtator
- B) 5 shtator
- C) 10 shtator
- D) 15 shtator

144. Të gjitha shkurtimet që pranohen në një recetë janë në gjuhën:

- A) Greke
- B) Latine
- C) Angleze
- D) Shqipe

145. Cilat nga tipet e tabletave nuk mund të rekomandohen për tu ndarë në mes për të marrë gjysmën e dozës, tabletat:

- A) E e ndara me vizë në mes
- B) Përshkumbëzuese
- C) Që përtypen
- D) Gastrorezistente

146. Sa duhet të jenë kufijtë e lagështisë relative në një farmaci ose depo barnash:

- A) 0%
- B) Nën 40%
- C) Mbi 70%
- D) 40-60%

147. Cili është ndërveprimi më i rrezikshëm që nuk ekzekutohet një recetë e mundshme:

- A) Digoksine - kinidine

- B) Tiokolkikozid - ketoprofen
- C) Amoksiline - ibuprofen
- D) Enalapril - simvastatin

148. Cili është kombinimi më pak i arsyeshëm që nuk ekzekutohet një recetë e mundshme:

- A) Ketotifen - baktrim
- B) Metforminë - glibenklamid
- C) Atenolol - amlodipinë
- D) Penicilinë - cefazolinë

149. Cili është kombinimi më i rrezikshëm që nuk ekzekutohet në një recetë të mundshme:

- A) Nifedipinë - hidrokloriazid
- B) Karbamezinë - alprazolam
- C) Amiodaron - kinidinë
- D) Losartan - amlodipinë

150. Distributori farmaceutik (shpërndareshi farmaceutik) primar ose sekondar mund t'i japë barna me faturë vetëm:

- A) Pacientëve
- B) Farmacistëve
- C) Mjekëve
- D) Infermierëve

151. Nuk quhen gabime profesionale, rastet kur pacienti mjekohet në mënyrë të gabuar nën mbikëqyrjen e:

- A) Mjekut
- B) Farmacistit
- C) Infermierit
- D) Pacientit

152. Cilat raste nuk konsiderohen gabim profesional gjatë ekzekutimit të një recetë nga farmacisti:

- A) Nuk lexohet saktë receta
- B) Nuk lexohet saktë doza e barit
- C) Nuk lexohet saktë formëdoza
- D) Kur mjeku shkruan " kështu dua"

153. Transporti i barnave termolabile nga shpërndareshi te farmacia bëhet me mjete:

- A) Të zakonshme
- B) Të pajisura me ftohës
- C) Motorrike, në qese plastike
- D) Canta dore të zakonshme

154. Lejohen të jepen nga farmacisti vetëm barnat që:

- A) Janë brenda afatit të përdorimit
- B) Kanë kaluar gjysmën e kohës së përdorimit
- C) Kanë dhe një muaj kohë përdorimi
- D) Afati i përdorimit ka kaluar 1 ditë

155. Zgjidhja e kontrates me DRSKSH për diferenca në plus, për farmacitë bëhet kur vlefata e tyre është:

- A) mbi 150 000 lekë

- B) nën 150 000 lekë
- C) deri në 150 000 lekë
- D) mbi 100 000 lekë

156. Zgjidhja e kontratës me DRSKSH për diferenca në minus, për farmacitë bëhet kur vlefata e tyre është:

- A) mbi 500.000 lekë
- B) nën 200 000 lekë
- C) deri në 500 000 lekë
- D) deri në 150 000 lekë

157. Gjeni alternativën jo të saktë: Fenotiazina e marrë së bashku me:

- A) Alkool: sjell rritje të efektit qetësues
- B) Antiacide: sjell rritje të përthithjes së fenotiazinave
- C) Anestezik: sjell rritje të efektit hipotensiv
- D) Anksiolitikë dhe Hipnotikë: sjell rritje të efektit qetësues

158. Cili nga detyrimet e mëposhtme që rrjedh nga Kontrata me DRSKSH është detyrim specifik:

- A) Mbajtja në ambjentin e farmacisë e Librit të Listës së Barnave që Rimbursohen
- B) Vendosja e tabelës "Farmaci me Kontratë me Sigurimet Shëndetësore"
- C) Nuk duhet të mbajë në ambjentet e saj librezat e shendetit të pacientëve që nuk ndodhen në farmaci
- D) Farmacia të ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.

159. Rimbursohen nga DRSKSH recetat që kanë:

- A) Mungesë vule mjeku.
- B) Kod diagnozë
- C) Mungesë e kategorizimit të pacientit.
- D) Mungesë e datës së ekzekutimit të recetës.

160. DRSKSH nuk vendos gjobë në rastet kur:

- A) Farmacia ka kontratë me DRSKSH
- B) Farmacisë i zgjidhet kontrata
- C) Farmacia nuk respekton orarin
- D) Farmacia ndryshon drejtuesin teknik

161. Kontrata e farmacisë me DRSKSH nuk zgjidhet në rast se:

- A) Ka perfunduar afati për të cilën ajo është lidhur
- B) Mbyllet ose pezullohet veprimtaria
- C) Në farmaci gjendet faturë fiktive, receta fiktive
- D) Lajmerohet DRSKSH për ndërimin e drejtuesit teknik

8. Legjislacioni

1. Barnat xhenerike janë:

- A) Barnat që përdoren me shpesh
- B) Barnat që jepen pa recete në farmaci
- C) Barna të cilave ju ka skaduar afati i patentës

D) Preparate qe perdoren vetem ne industri

2. Cili pohim nuk eshte i sakte: Ministri i Shëndetësisë, me propozimin e QKKB-së (sot Agjensia), urdhëron çregjistrimin e një bari nëse:

- A) bari nuk ka cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin, të deklaruara në dosjen e regjistrimit;
- B) bari nuk plotëson më standardet kohore zyrtare për cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin;
- C) shfaq efekte të dëmshme gjatë përdorimit edhe kur është konsumuar në përputhje me udhëzimet e sakta.
- D) Bari nuk preferohet nga pacientet

3. Cili nga pohimet eshte i sakte:

- A) Praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë miratohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga importuesit, shpërndarësit dhe farmacitë.
- B) Praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë miratohen nga QKKB (sot Agjensia) dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga importuesit, shpërndarësit dhe farmacitë.
- C) Praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë miratohen nga DSHP-ja dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga importuesit, shpërndarësit dhe farmacitë.
- D) Praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë miratohen nga UFSH-ja dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga importuesit, shpërndarësit dhe farmacitë.

4. Cili nga pohimet nuk eshte i sakte:

- A) Shpërndarësi farmaceutik mund të tregtojë me shumicë barna
- B) Shpërndarësi farmaceutik mund të tregtojë me shumicë materiale mjekimi, aksesore, si dhe artikuj higjieno-kozmetikë dhe dietetikë
- C) Shpërndarësi farmaceutik mund të tregtojë edhe me pakice barnat
- D) Shpërndarësi farmaceutik mund të tregtojë me shumicë si barnat ashtu edhe materiale mjekimi, aksesore, si dhe artikuj higjieno-kozmetikë dhe dietetikë.

5. Cili pohim eshte i sakte: Licenca e drejtuesit teknik te shperndareshit farmaceutik jepet nga:

- A) Ministria e Shendetesise
- B) QKKB (sot Agjensia)
- C) DSHPja
- D) QKL

6. Recetat e zakonshme te ekzekutuara ne farmaci, ruhen si me poshte:

- A) 2 vjet
- B) 3vjet
- C) Mbi 3 vjet
- D) Nuk ka nevojte te ruhen

7. Recetat per barna narkotike e psikotrope, te ekzekutuara ne farmaci ruhen si me poshte:

- A) 2 vjet
- B) 3 vjet
- C) 4 vjet
- D) Nuk ka nevojte te ruhen

8. Recetat e ekzekutuara ruhen ne farmaci si me poshte per barna helme me veprim te forte

- A) 2vjet
- B) 3vjet
- C) 5 vjet

D) Nuk ka nevojë të ruhen

9. Cili nga pohimet nuk është i sakte:

- A) Nuk lejohet ruajtja dhe përgatitja e barnave për shitje nga mjekët dhe stomatologët.
- B) Lejohet ruajtja dhe përgatitja e barnave për shitje nga mjekët dhe stomatologët.
- C) Sasia dhe lloji i lendeve që mjeku stomatolog përdor dhe ruan në klinike përcaktohet nga lista e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.
- D) Nuk lejohet ruajtja dhe përgatitja e barnave për shitje nga mjekët dhe stomatologët. Sasia dhe lloji i lendeve që mjeku stomatolog përdor në klinike, përcaktohet nga lista e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

10. Cili nga pohimet nuk është i sakte:

- A) Çmimi i barnave në treg është i kontrolluar
- B) Kontrolli i çmimit të barnave në treg realizohet përmes marzheve të fabrikimit e të tregtimit, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
- C) Çmimet e barnave të listës së rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave
- D) Çmimet e barnave përcaktohen nga konkurrenca e lirë në treg

11. Cili nga pohimet nuk është i sakte:

- A) Lejohet reklama me mjetet e informimit masiv vetëm për barnat OTC,
- B) Për barnat me recete nuk lejohet reklama me mjetet e informimit masiv
- C) Lejohet reklama me mjetet e informimit masiv për të gjithë barnat
- D) Për barnat me recete, bëhet promovim vetëm në literaturë ose në veprimtari shkencore profesionale.

12. Lidhur me klasifikimin e lendeve narkotike e psikotrope: Cili nga pohimet nuk është i sakte:

- A) Tabela I: bime dhe lende me rrezikshmeri të lartë që nuk përdoren në mjekësi.
- B) Tabela I: bime dhe lende me rrezikshmeri të lartë që përdoren në mjekësi
- C) Tabela II: bime dhe lende me rrezikshmeri të lartë që përdoren në mjekësi.
- D) Tabela III: bime dhe lende të rrezikshme që përdoren në mjekësi.

13. Një vlerësim farmakoekonomik quhet i plotë kur:

- A) kryhet vetëm vlerësimi i efektivitetit klinik për një bar të dhënë
- B) kur kryhet vetëm vlerësimi i plotë i kostove për një bar të dhënë
- C) kur kryhet vlerësimi i efektivitetit si dhe analiza e kostove për një bar të dhënë
- D) kur kryhet vlerësimi i efektivitetit si dhe analiza e kostove e bëhet ballafaqimi i të paktën dy alternativave

14. Në analizen kosto-dobi, cila është njësia matëse e rezultatit:

- A) vite jete të shpetuara,
- B) rastet e zgjidhura,
- C) rastet e parandaluara,
- D) Vite jete të shpetuara X cilesinë e jetes

15. Cili është pohim jo i sakte lidhur me analizen kosto-efektivitet. Njësia matëse e efektivitetit është:

- A) vite jete të shpetuara,
- B) rastet e zgjidhura,
- C) rastet e parandaluara,
- D) Vite jete të shpetuara X cilesinë e jetes

16. Cili është pohimi i saktë lidhur me analizën kosto-efektivitet. Njesia matëse e efektivitetit është:

- A) vite jete të shpetuara,
- B) raste të zgjidhura,
- C) raste të parandaluara,
- D) Perfitimet ekonomike që shkakton ky trajtim

17. Cili është pohimi i saktë lidhur me analizën kosto-fitim. Njesia matëse e rezultatit është:

- A) Njesi monetare
- B) Njesi fizike
- C) raste të zgjidhura,
- D) Njesi dobie

18. Për analizën kosto-fitim cili është pohimi i saktë:

- A) Rezultatet e analizës kanë kuptim në vetvete, pra nuk është e domosdoshme të krahasosh me ato të programeve të tjera
- B) Perfitimet maten në terma të dobisë
- C) Kriteri i vlerësimit përfshin llogaritjen Kosto për QALY
- D) Rezultatet vlerësohen duke iu referuar paramatrave klinike të normalizimit si ulja e presionit diastolik në trajtimin e hipertensionit arterial

19. Për analizën kosto-efektivitet cili është pohimi i saktë:

- A) Rezultatet e analizës kanë kuptim në vetvete, pra nuk është e domosdoshme të krahasosh me ato të programeve të tjera
- B) Perfitimet maten në terma të dobisë
- C) Kriteri i vlerësimit përfshin llogaritjen Kosto për QALY
- D) Rezultatet vlerësohen duke iu referuar paramatrave klinike të normalizimit si ulja e presionit diastolik në trajtimin e hipertensionit arterial

20. Për analizën kosto-dobi cili është pohimi i saktë:

- A) Përfitimet e analizës maten në terma monetarë
- B) Kriteri i vlerësimit është vetëm mbijetesja
- C) Kriteri i vlerësimit përfshin llogaritjen Kosto për QALY
- D) Kriteri i vlerësimit është vetëm kosto më e ulët

21. Për analizën kosto-minimizim cili është pohimi i saktë:

- A) Rezultatet e analizës kanë kuptim në vetvete, pra nuk është e domosdoshme të krahasosh me ato të programeve të tjera
- B) Perfitimet maten në terma të monetare
- C) Kriteri i vlerësimit përfshin llogaritjen Kosto për QALY
- D) Në këtë analizë merret si e mirëqene barazvlefshmeria e rezultateve klinike mbi dy alternativave

22. Cila nga kostot e mëposhtme që përdoren në analizat farmakoekonomike janë më të sakta:

- A) Kostot indirekte
- B) Kostot direkte
- C) Kosot e padukshme
- D) Kostot që vijnë si rezultat i fitimit të munguar

23. Cili nga pohimet e mëposhtme është i sakte:
A) Procedura e importit bëhet pranë QKKB (sot Agjensia), në prani të inspektorit farmaceutik
B) Procedura e importit bëhet pranë Ministrisë së Shëndetësisë në prani të inspektorit farmaceutik
C) Procedura e importit bëhet pranë zyrave doganore të hyrjes, në prani të inspektorit farmaceutik
D) Procedura e importit bëhet pranë Drejtorisë farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë, në prani të inspektorit farmaceutik

24. Cili nga perkufizimet e mëposhtme është i pasakte. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet:
A) kultivimi i hashashit (*Papaver somniferum*) për prodhimin e opiumit dhe të kashtës
B) kultivimi i bimës së kokës (*Erythroxylon coca*) për prodhimin e alkaloidëve e të lëndëve aromatike
C) kultivimi i të gjitha llojeve dhe varieteteve të bimëve të gjinisë *cannabis* për prodhimin e kanabisit, të rrëshirës dhe vajit
D) kultivimi i kërpit (*Cannabis sativa L*) për qëllime industriale për prodhimin e fibrave dhe të farërave edhe për varietetet që përmbajnë jo më shumë se 0,1 për qind tetrahidrokanabinol

25. Gjeni alternativën e gabuar:
Analiza rritese (Inkrementale ICER) është një tip i analizave farmakoekonomike.
A) Ndhmon për njehsimin e madhësisë së kostos /për njësi shtese efikasiteti
